

ANDREA LLUKANI

**KOMENTI I UNGJILLIT
SIPAS MATHEUT**

Tiranë, 2005

Faqosja: Afrim Tonuzi

HJRJE

Shkruesi i ungjillit. Ungjilli sipas Matheut, ashtu si edhe ungjijtë e tjerë nuk e jep emrin e shkruesit. Në shekullin e dytë, tradita e vjetër kishtare njohu si shkruesin e ungjillit të parë Matheun. Bëhet fjalë për nxënësin e njohur të Zotit, i cili përfshihet në të gjitha listat e dymbëdhjetë apostujve. (Marku 3, 18, Veprat 1,13). Thirrjen e tij nga Krishti e komentojnë të tre ungjijtë sinoptikë. (Matheu 9, 9-13, Marku 2, 13-17, Lluca 5, 27-32). *1-Fjala “sinoptikë” do të thotë se ata duken si të njëjtë. Këta tre ungjij janë shumë të ngjashëm në përmbajtje dhe në formë.* Vetëm tek ungjilli sipas Matheut 9, 9 quhet Matheo, ndërsa në ungjijtë e tjerë quhet Levi. Tek ungjilli sipas Markut 2, 14 përmendet babai i tij që quhej Alfeo. Gjithashtu vetëm tek Matheu 10, 3 paraqitet si doganier. Nuk përjashtohet mundësia që të kishte dy emra judaikë: Simon Kifas dhe Josif Varnava (Veprat 4, 36). Por emri kryesor i tij ishte Levi dhe pas thirrjes në rrethin e dymbëdhjetë apostujve, Jisui e quajti Matheo, që do të thotë “dhuratë Perëndie”. Këto janë informacionet që na jep Dhiata e Re për ungjillorin Matheo. Dëshmitë e mëvonshme vërtetojnë se predikoi ungjillin tek hebrejtë e Palestinës e më vonë shkoi në Etiopi. Kisha e feston kujtimin e tij më 16 nëntor.

Vendi i shkrimit. Ungjillor Matheu ishte judeokristian dhe siç vërtetohet nga ungjilli i tij, ishte i mirëinformuar për veçoritë e Palestinës, për shembull: zakonet fetare, traditat e judenjve etj. Gjithashtu karakteristike e ungjillit është se besimtarët të cilëve iu

drejtohet Matheu, janë nga rrethe judaike. Nuk është e mundur që të përcaktojmë me saktësi komunitetin e krishterë, të cilit i drejtohet Matheu, si dhe vendin e shkrimit të ungjillit të tij. Shumë komunitete judeokristiane gjendeshin jashtë Palestinës, në diasporën e Sirisë, domethënë në Antioki. Kishën e Antiokisë e përbënin të krishterë që i flisnin të dy gjuhët hebraisht dhe greqisht. Kërkuesit e sotëm e përcaktojnë prejardhjen e Matheut nga rrethinat e Finiqit ose në qytetet Edhesa e Pela në lindje të Jordanit.

Koha e shkrimit. Shumica e studiuesve pranojnë si kohë të shkrimit të ungjillit sipas Matheut vitet 70-80 pas Krishtit. Qëllimin e shkruarjes mund ta dallojmë nga diagrama që paraqitet në ungjill, prej mënyrës se si i përdor burimet dhe mbi të gjitha nga materiali i veçantë. Është e sigurt se Matheu me paraqitjen e shpeshtë të profecive mesianike të Dhiatës së Vjetër na tregon se: Jisui nga Nazareti është Mesia i premtuar, domethënë plotësimi përfundimtar i profecive të Dhiatës së Vjetër. Sigurisht që një gjë e tillë ekziston edhe tek ungjijtë e tjerë, por tek Matheu është më e theksuar. Kjo duket qartë tek dy kapitujt e parë të ungjillit me gjenealogjinë e Jisuit, ku theksohet prejardhja e Tij nga Abrahami, të cilit Perëndia i dha lajmin për Mesian. Gjithashtu ungjillori Mathe nuk e përkufizon prespektivën e ungjillit të tij vetëm tek judenjtë, sepse Jisui nuk është vetëm shpëtimtari i judenjve, por i gjithë botës. Kjo është arsyea që Matheu e përfundon ungjillin me porosinë e të Ngjallurit ndaj nxënësve të tij për të mësuar gjithë kombet.

Në historinë e kërkimeve rreth ungjillit të Matheut me interes janë edhe dy çështje të tjera, të cilat flasin për qëllimin e shkrimit. Sipas së parës, ungjilli sipas Matheut është një vepër e një komuniteti kishtar, të cilit i nevojitej një libër liturgjik për nevojat e adhurimit dhe sipas teorisë së dytë, Matheu ishte i krishterë rabin (mësues) i cili kishte një rreth nxënësish. Ungjilli i tij është vepër e “shkollës së Matheut” dhe përdorej për nevojat e mësimdhënies e të katekizmit.

Forma e ungjillit. Ungjilli sipas Matheut dallohet nga forma dhe përmbajtja e tij nga ungjijtë sinoptikë. Përveç traditës së veçantë të preardhjes së Krishtit (kapitujt 1 dhe 2) dallojmë tek ai edhe tre shtresa të traditës. 1-Përmban një sasi të madhe material të Markut dhe e paraqet aktivitetin publik të Jisuit në të njëjtin ambient gjeografik, pra kryesisht në Galile. Mësimdhënien dhe mrekullitë gjatë udhës për në Jerusalem etj. 2-Përmban shumë fjalë të Zotit. 3-Materialin e rëndësishëm të Matheut nuk e gjejmë tek ungjijtë e tjerë sinoptikë (Marku, Luka). Kjo i detikohet burimit të veçantë të Matheut si dhe shënimeve personale të tij (Sumaria). Gjithashtu materiali i Matheut përmban shpesh fjalë të Zotit me të cilat sqaron një temë të përgjithshme që i përket qëndrimit të ardhshëm të kishës. Karakteristike tek Matheu është edhe renditja sistematike e materialit të tij. Kështu fjalët e Zotit, që përbëjnë edhe materialin kryesor tek matheu ndahen në pesë grupime të mëdha, ku të gjitha përfundojnë me frazën: “Tani kur Jisui i mbaroi këto fjalë”. (Matheu 7,28 11,1 13,53 19,1 26,1) Bëhet fjalë për:

1-Predikimi në mal. (Matheu kapitujt 5-7)

2-Porositë për Dishepujt. (Matheu 9,35-11,1)

3-Paravolitë e Mbretërisë. (Matheu kapitulli 3)

4-Fjala këshilluese drejtuar nxënësve. (Matheu kapitulli 18)

5-Qortimi i farisenjve. (Matheu kapitulli 23)

Ungjillori Mathe e vendosi Pentatefkun e ri kristian përballë atij të Dhiatës së Vjetër, ose mund të shprehemi ndryshe me ligjvënës të ri Jisu Krishtin ndaj të vjetërit Moisi. Një tjetër veçori e ungjillit të parë është se Matheu i lidh ngjarjet e jetës së Jisuit me paralajmërimet përkatëse të Dhiatës së Vjetër. Qëllimi kryesor i tij është që t’iu tregojë lexuesve judeokristianë se: Jisui nuk erdhi të shfuqizojë ligjin e Dhiatës së Vjetër, por ta plotësojë e ta përfundojë atë. (Matheu 5,17). Matheu dispononte një koleksion vargësh nga Dhiata e Vjetër (kryesisht librat e Psallmeve e të Profetëvë) të cilat kisha e hershme

i komentonte me kuptim mesianik. Nga kërkimet e bëra, ky koleksion është njohur me emrin Testimonia.

Temat kryesore të ungjillit. Matheu përshkruan në materialin e tij planin e shenjtë për shpëtimin e Izraelit dhe të botës. Perëndia u njoftua në Dhiatën e Vjetër:- se nga pasardhësit e Abrahamit do të lindte Shpëtimtari Krisht. Ky i fundit zbuloi drejtësinë e Perëndisë dhe vërtetoi Mbretërinë e tij. Ai e ftoi popullin hebraik që të pranojë ungjillin e ri të shpëtimit, por hebrenjtë e mohuan Shpëtimtarin dhe vazhdonin traditën judaike. Veçse ky mohim e shkëputi popullin hebre nga Perëndia. Tek ungjilli sipas Matheut kemi këto tema kryesore:

1-Ikona e Krishtit, tek Matheu ka karakteristika të veçanta. Ajo shfaqet si plotësim i profecive të Dhiatës së Vjetër. Episodet më të shumta të jetës së Tij, lidhen me dëshmitë profetike. Matheu dhe kisha e parë ruanin me rreptësi traditën e vjetër mesianike. Matheu këmbëngul se mohimi i Krishtit do të thotë njëkohësisht, mohim i dëshmisë së Dhiatës së Vjetër. Kristologjia e Matheut jepet tek dëshmia e Petros:”Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë” (Matheu 16,16).

Titujt “Krisht” dhe “Biri i Perëndisë” mbizotërojnë tek Matheu, por ai paralelisht përdor edhe “Biri i Davidhit”, “Mësues” dhe “Biri i Njeriut”. Figurën e Krishtit e shohim më tepër tek Predikimi në mal, ku shfaqet ligjëvënësi i ri, i cili komenton me zotësi ligjin e Dhiatës së Vjetër, plotëson profecitë e saj dhe përsos urdhëresat morale e ligjore. Tek Matheu shfaqet në mënyrë të veçantë Hyjnia e Krishtit, ndërsa ngjarjet e jetës njerëzore të tij, vërtetojnë misionin e shenjtë.

2-Tek Matheu gjejmë një komentim të ri të ligjit të Dhiatës së Vjetër. Kjo është edhe tema kryesore e Predikimit në mal. Krishti i pranon urdhërimet kryesore të Dhiatës së Vjetër, por Ai përjashton komentimin e ligjit nga shkronjësit dhe farisenjtë. Mbretëria e Perëndisë që predikon Krishti është drejtësia e besimit dhe dashurisë.

(Matheu 9,13 12, 7 23,23) Njeridashja e pafund e Perëndisë zbulon respektin tipik të ligjit dhe kultivon dashurinë ndaj të tjerëve, madje edhe ndaj armiqve. në bazë të kësaj kisha ndahet tërësisht nga sinagoga.

3-Matheu është i vetmi ungjillor që përdor për fjalën “kishë” (Matheu 16,18 18,17). Kisha është populli i ri i Perëndisë, Izraeli i ri, që trashëgon porosinë e Dhiatës së vjetër. Me Predikimin në Mal, Krishti e shpie përpara këtë popull për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë.

Epiqendra e përmbajtjes së Ungjillit të Shenjtë është Mbretëria e Qiejve. Këtë frazë së bashku me sinonimet paralele “Mbretëria e Perëndisë” dhe “Mbretëria e Atit” e gjejmë 51 herë tek Matheu, 14 herë tek Marku dhe 34 herë tek Lluka. Me predikimin e Mbretërisë e filloi Jisui predikimin e Tij pas pagëzimit dhe ngasjeve (Mat 4:17) dhe e përfundon misionin e Tij historik me deklarin se u dha në atë “Çdo pushtet, si në qiell, ashtu edhe mbi dhe”. (Matheu 28,18) Në mënyrë të veçantë Mbretërinë e Qiejve e sqaron Jisui nëpërmjet paravolove të tij duke iu rrëfyer Dishepujve “misteret e Mbretërisë së Qiejve”. (Matheu 13,11)

“Mbretëria e Qiejve i ngjan një kokër sinapi, të cilën e merr dikush dhe e mbjell në arën e tij” (Matheu 13,31).

“Mbretëria e Qiejve i ngjan një thesari të fshehur” (Matheu 13,44).

“Mbretëria e Qiejve i ngjan një tregtari që shkon të kërkojë margaritarë të bukur” (Matheu 13,45).

“Mbretëria e Qiejve i ngjan një rrjete të hedhur në det” (Matheu 13,47).

Jisui i mëson dishepujt më të fshehtat e Mbretërisë së Qiejve (Matheu 13,31).

Mbretëria e Qiejve paraqitet si e vërtetë historike dhe mbetet të plotësohet në të ardhmen. Matheu e thekson se kush do jetë i denjë të hyjë në këtë Mbretëri.

Në Mbretërinë e Qiejve do të hyjnë të gjithë të varfërit dhe të përndjekurit (Matheu 5,3-10).

Në Mbretërinë e Qiejve do të hyjnë targambledhësit dhe gratë e përdala që pendohen (Matheu 21,31).

Në Mbretërinë e Qiejve do të hyjnë gjithë ata që bëhen të pastër si fëmijë të vegjël (Matheu 18,3).

Në Mbretërinë e Qiejve do të hyjnë ata që zbatojnë dëshirën e Atit që është në qiej (Matheu 7,21).

Në Mbretërinë e Qiejve do të hyjnë të gjithë ata që do të mohojnë pasuritë e tyre (Matheu 19,24).

Në Mbretërinë e Qiejve do të hyjnë të gjithë ata që do të sakrifikojnë veten për Hir të Mbretërisë së Mbretërisë së Qiejve (Matheu 19,12).

Hyrja në Mbretërinë e Perëndisë arrihet me ruajtjen e porosive të Perëndisë. Mbretëria do të vijë shpejt (Matheu 11,12). Koha përfundimtare që lidhet me gjykimin është e panjohur, prandaj duhet të rrimë zgjuar (Matheu 24,42) dhe të jemi të përgatitur si virgjëreshat e paravolisë (Matheu 25,1). Me këtë kuptim Mbretëria e Perëndisë realizohet brenda pranisë së historisë dhe të botës, mëpërmjet Kishës dhe plotësohet pas gjykimit të dytë e përfundimtar të Krishtit.

Andrea Llukani

KREU I PARË

GJENEALOGJIA E JISU KRISHTIT

(Luka 3:23-38)

1 -Vivll' e gjenealogjis' së Jisu Krishtit, të birit të Dhavidhit, të birit t' Avraamit.

1-**Libri i gjenealogjisë** përmban gjenealogjinë e Krishtit, e cila jepet në ungjillin sipas Matheut 1,2-16. Ungjillori Mathe e fillon ungjillin me gjenealogjinë e Jisu Krishtit për të treguar se Jisui është Mesia i premtuar i lindur prej fisit të Davidit. Gjenealogjia përbën urën lidhëse midis Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re. Në Dhiatën e Vjetër gjenealogjia na jepet tek Gjeneza 5,1-32 ku pema gjenealogjike fillon prej Adamit deri tek djemtë e Noes. Hebrenjtë i mbanin me kujdes të madh statistikat e breznive të mbretërve dhe priftërinjve të tyre. Librat e gjendjes civile ruheshin në tempull. Këto katalogë u ruajtën deri në shkatërrimin e Jeruzalemit në vitin 70 p.K. Ata prisnin me padurim adhjen e Shpëtimtarit Jisu Krisht.

2-**Jisu** është emri që iu vu Mesias në ditën e tetë pas lindjes, kur iu bë rrethprerja, prandaj në përkthimin e të 70-ve e gjejmë me emrin **Jeshua** që do të thotë: “Perëndia është Shpëtimtar”. Rrethprerja e Krishtit u bë tetë ditë pas lindjes. Në kohët e hershme familjet kishin shumë fëmijë dhe jo të gjithë prej tyre jetonin, sepse kushtet e lindjes ishin të këqija dhe sëmundjet bënin kërdrinë. Megjithatë nëse fëmija rezistonte deri në ditën e tetë, atëhere sipas

marrëveshjes që kishte bërë Abrahami me Perëndinë, duhej që të rrethpritej. Pikërisht gjatë ritualit të rrethprerjes fëmijës i vihej emri. Jisui e mori emrin prej qiellit kur engjëlli njoftoi Josifin (Matheu 1,21). “Ajo do të lindë djalë dhe ti do ti vësh emrin Jisu, sepse ai do të shpëtojë popullin e tij nga mëkatet”. Emri Jisu në kohët e mëparshme ishte përdorur tek fëmijët, por më vonë për nderim të Zotit Krisht nuk u përdor më.

3-**Krisht** është titull që do të thotë “lyej me miro” ose “i lyeri”. Në hebraisht ai që është “i lyer” quhej “Meshiah” dhe grekët e përkthyen në “Mesia”. Misteri i lyerjes ka qenë që në kohët e hershme. Kryeprifti Haroni përgatiti një vaj dhe pasi u lye me të u quajt “krisht”, madje edhe “krisht Zoti”, sepse vaji ishte porositur nga Perëndia. Më pas u lye edhe pasardhësit e tij. Gjithashtu me vaj luheshin edhe mbretërit si Sauli, (Libri I i Samuelit 10,1) Davidi etj. Në rast se vaji u kullonte nga hunda, atëhere quheshin krisht. Por edhe profetët lyheshin me miro dhe quheshin “krisht”. Pra kemi emrin krisht për Kryepriftin, Mbretin dhe Profetin, por këta ishin krishti me “k” të vogël, sepse hebrenjtë prisnin atë Krisht, i cili do t’i shpëtonte. Këtë e ka profetizuar Davidi:”Unë jam krishti, por një pasardhësi im do të jetë Krishti që do të shpëtojë”. Hebrenjtë prisnin me padurim Krishtin, ardhjen e tij e profetizon aq bukur Davidi në psalmet Kristologjile:”Unë u leva me vaj si të gjithë mbretërit, kurse ti o Krishti im do të lyhesh me vaj nga vetë Perëndia dhe ky vaj do të jetë Shpirti i Shenjtë”. Për lyerjen e Krishtit flet ungjillori Lluca 4,18.

Ardhjen e Krishtit e prisnin të gjithë, madje profetët kishin profetizuar se si do kryqëzohej, do të pësonte dhe do të shkonte drejt vdekjes si një qengj i pafajshëm, do të ngjallej etj. Në gjuhën hebraike nuk ekziston folja (jam) prandaj kur hebrenjtë donin të thonin “ky është Krishti” përdornin “Jisu Krishti”. Me këtë donin të thonin se

Jisui është Krishti. Kur thonin Jisu nënkuptonin një person dhe kur thonin Krisht nënkuptonin Perëndinë.

4-Birit të Davidit, birit të Abrahamit. Fjala “bir” në gjuhën greke ka një kuptim të gjerë. Me këtë fjalë do të thotë se prej fisit të Davidit dhe Abrahamit është origjina e Jisuit.

2-Avraamit i lindi Isaaku; edhe Isaakut i lindi Jakovi; edhe Jakovit i lindi Judha edhe të vëllezërit’ e ti;

1-Abrabamit i lindi Isaku. Ungjillori Mathe e fillon pemën gjenealogjike nga Abrahami, i cili konsiderohet si Ati i popullit të zgjedhur të Perëndisë. Cila është arrsyeya që Matheu nuk e fillon gjenealogjinë prej Adamit? Ai e fillon prej Abrahamit sepse ky i fundit ishte jude i vërtetë. Judenjtë e kishin për nder të thonin: “Ne kemi Abrahamin për at” (Matheu 3,9). Fjala hebraike Abraham do të thotë babai i të shumtëve. Ai lindi në vitin 1996 p.K në Uhr të Haldheon ku qëndroi aty rreth 70 vjet. Më pas shkoi me Sarën në Mesopotami. Më pas vajti në Hanan, Egjypt etj. Në Dhiatën e Vjetër tregohet se Abrahamit (në moshën 99 vjeçare) dhe Sarës, pas një mrekullie u lindi Isaku, (Gjeneza 21,2) i cili mori edhe bekimin e Atit të tij. Përsa i përket fëmijëve të tjerë të Abrahamit si Ismaili etj, ata nuk qenë të denjë që të quheshin trashëgimtarë të Abrahamit. Pasardhësit e tyre nuk kishin asgjë të përbashkët me popullin e zgjedhur, prandaj edhe ungjillori nuk i përmend.

2-Isakut i lindi Jakovi. Tek Gjeneza 25,21-24 tregohet se Ikasut dhe gruas së tij Rebekës i lindën dy fëmijë binjakë Esau dhe Jakovi. U quajt Jakov sepse kur lindi mbante me dorë thembrën e vëllait të tij Esaut (Gjeneza 25,26). Esau nuk ishte i denjë që të quhej trashëgimtar i Abrahamit, kështu përparësia i kaloi vëllait më të vogël Jakovit, prej pasardhësve të tij do të lindte Jisui. Jakov në hebraisht do të thotë :”ai që të zë thembrën” që e ka kuptimin “ai që të zë vendin”. Jakovi lindi në vitin 1836 para Krishtit.

3-Jakovit i lindi Juda. Fëmija i parëlindur i Jakovit ishte Rubeni, por në ungjillin sipas Matheut përmendet Juda, i cili ishte fëmija i katërt dhe prej tij do të rridhte Jisui. (Gjeneza 49, 1-10). Ptriarku i Izraelit Jakovi ndërhmjet 12 bijve të tij zgjodhi Judën (Gjeneza 49,10) (Hebrenjve 7,14) (Zbulesa 5,5). Prej djemve të Jakovit do të lindnin 12 fiset e Izraelit. (Gjeneza 49,28).

3 Edhe Judhësë i lindi Faresi edhe Zaraj nga Thamara; edhe Faresit i lindi Esromit; edhe Esromit i lindi Arami;

1-Judës i lindi Faresi. Juda shkoi me kunatën e tij dhe i lindën binjakët Faresi dhe Zara. Jo pa qëllim ungjillori Mathe na e thotë se i lindën nga Tamara, e cila nuk ishte gruaja e Judës, por e kunata, e cila mëkatoi. Është evident fakti që në pemën gjenealogjike të Jisu Krishtit përmenden edhe emrat e disa grave mëkatare Tamarës, Rahabi, Ruthi dhe gruaja e Urias. Fëmija i parëlindur qe Faresi, prej fisit të këtij të fundit do të lindte Jisui.

4 Edhe Aramit i lindi Aminadhavi; edhe Aminadhavit i lindi Naassoni: edhe Naassonit i lindi Sallmonit;

1-Naasoni. Ishte kryetari i fisit të Judës në kohën e eksodit të izraelitëve nga Egjypti. (Numrat 1,7). Naasoni ishte bashkëkohës i Moisiut.

5 Edhe Sallmonit i lindi Voozi nga Rahava; edhe Voozit i lindi Ovidhi nga Rutha; edhe Ovidhit i lindi Jesseu;

1-Rahava dhe Rutha. Në Dhiatën e Vjetër Rahava nuk përmendet që ka qenë gruaja e Sallmonit. Tradita thotë se Rahava ka qenë nga Jerikoja, ishte idhujatre dhe grua e përdalë. Në kohën kur izraelitët pushtuan Palestinën, ajo pranoi një pjesë të ushtrisë në shtëpinë e saj. Megjithatë në (Hebrenjve 11,31) tregohet besimi i saj. “Me anë të besimit Rahava, një prostitutë, nuk humbi bashkë me ata që nuk besuan, sepse kishte pritur paqësisht zbuluesit”.

Gjithashtu për të flitet edhe tek (Letra e Jakovit 2,25) ku thotë:” Gjithashtu a nuk u shfajësua edhe Rahava, lavirja nga veprat, kur i priti të dërguarit dhe i përcolli nga një udhë tjetër?” Rahava i ndihmoi izraelitët në pushtimin e Jerikosë.

Rutha ishte idhujtare dhe pasi u martua me Boazin lindi një djalë, Obedin, gjyshin e Davidit. (Rutha 4,13)

6 Edhe Jesseut i lindi Dhavidhi mbreti. Edhe mbretit Dhavidh i lindi Sollomoni nga gruaja e Uriut;

1-Mbretit David. Në hebraisht David do të thotë “i dashur”. Davidi ishte djali i vogël i Jeseut nga fisi i Judës dhe kishte lindur në Bethlehem në vitin 1085 p. K. dhe vdiq në moshën shtatëdhjetë vjeçare. Ai u shqua që në vogëli për trimërinë e tij, si një bari i vogël që fitoi mbi Goliatin. Gjithashtu Davidi ishte muzikant dhe poet. Aftësitë e tij i tregoi në shkruarjen e psalmeve. U quajt i zgjedhuri i Perëndisë në vendin e Saulit dhe mbretëroi në fisin e Judës afërsisht shtatë vjet dhe në gjithë Izraelin 33 vjet. Gjatë mbretërimit të tij Jeruzalemi u bë kryeqytet dhe i shtriu zotërimet tutje kufinjve të Palestinës duke mundur armiqtë e tij. Këtu Davidi është mbreti i parë që përmendet në gjenealogjinë e Jisuit duke i dhënë këtij të fundit origjinë mbretërore. (Lluka 1,32). Trashëgimtari i Davidit ishte Sollomoni, (Libri II Samuelit 12,24) i cili lindi nga Vithsava, gruaja e Urias. (Libri II Samuelit 11,2). Ungjillori Mathe nuk e përmend Vithsavën në ungjillin e tij, por thotë nga gruaja e Urias. Në këtë rast ai tregon për padrejtësinë që i bëri Davidi ndaj Urias. Më pas Davidi u pendua për këtë dhe shkroi psalmin 50, i cili quhet ndryshe edhe psalmi i pendimit. (Libri II Samuelit 12,13).

7 Edhe Sollomonit i lindi Rovoami; edhe Rovoamit i lindi Aviaj; edhe Aviajt i lindi Asaj;

1-**Rovoami**. Në kohën e Rovoamit 12 fiset që përbënin popullin e Izraelit u ndanë në dy mbretëri. Fisi i Beniaminit dhe i Judesë nën mbretërinë e Judenjve dhe dhjetë fiset e tjerë në mbretërinë e Izraelitëve.

8 Edhe Asajt i lindi Josafati; edhe Josafatit i lindi Jorami; edhe Joramit i lindi Ozia; 9 Edhe Ozisë i lindi Joathamit; edhe Joathamit i lindi Ahazi; edhe Ahazit i lindi Ezeqia; 10 Edhe Ezeqisë i lindi Manassiu; edhe Manasiut i lindi Amoni; edhe Amonit i lindi Josia; 11 Edhe Josisë i lindi Jehonia edhe të vëllezërit' e ti, mbë të-çpërgulurit të Babillonisë,

1-**Babilonia**. Qytet i vjetër që gjendej midis lumenjve Tigri dhe Euftratit. Prej Babilonisë u nis Abrahami për të shkuar dhe të vendosej në tokën e premtuar në Palestinë. Babilonia njihej edhe nga kulla e famshme e Babelit, ku u pëstjelluan gjuhët e botës (Gjeneza 11,1-9). Ky qytet e arriti kulmin e lulëzimit në shekullin VI para Krishtit në kohën e mbretit Nabukodonosor, i cili e zmadhoi dhe zbukuroi. Babilonia ishte e rrethuar prej një muri me trashësi rreth 25 metrash. Kishte njëqind porta bronxi, nga 25 për çdo krah. Prej tyre rridhnin rrugë të cilat kryqëzoheshin, duke e ndarë qytetin në katrorë të barabartë. Gjithashtu edhe Eufрати, që rridhte në qendër e ndante qytetin në dy pjesë. Shkatërrimi i qytetit filloi atëhere kur ra nën sundimin e Mbretit Persian Kirit, duke u plotësuar kështu të gjitha profecitë (Isaia 14,1-23 21,1-10 46,1-2 47,1-3). Jeremia profetizonte se Babilonia do të shndërohej në një grumbull gërmadhash dhe kështu ndodhi (Jeremia 51,37).

12 Edhe pas të-çpërgulurit të Babillonisë, Jehonisë i lindi Sallathieli; edhe Sallathielit i lindi Zorobabeli; 13 Edhe

Zorobabelit i lindi Aviudhi; edhe Aviudhit i lindi Eliaqimi; edhe Eliaqimit i lindi Azori;

1-**Zorobabeli.** Ky i fundit ishte më i përmenduri prej fisit të Davidit. Zorobabeli ishte ushëheqësi i Judenjve, të cilët u kthyen në Palestinë me lejen e mbretit të persianëve Kirit. Në katalogun gjenealogjik të Matheut mungojnë disa nga emrat e pasardhësve të Zorobabelit. Kjo duket qartë tek ungjilli sipas Llukës, ku ndërmjet Josifit dhe Zorobabelit janë 18 emra (Lluka 3,23-38).

14 Edhe Azorit i lindi Saduku; edhe Sadukut i lindi Aqimi; edhe Aqimit i lindi Eliudhi; 15 Edhe Eliudhit i lindi Eleazari; edhe Eleazarit i lindi Matthani; edhe Matthanit i lindi Jakovi; 16 Edhe Jakovit i lindi Josifi, burr’i Marisë, prej së cilësë lindi Jisuj që thuhetë Krisht.

1-**Josifi.** Në ungjillin sipas Matheut 1,16 kemi: “Jakovit i lindi Josifi”, ndërsa tek ungjilli sipas Llukës 3,23 thotë: “Josifi biri i Ilisë”. Interpretuesit e Shkrimit të Shenjtë thonë se Matheu na jep Atin natyral dhe Llukai Atin ligjor të Josifit.

2-**Burri i Marisë.** Josifi ishte burri ligjor i Marisë. Kështu sipas ligjit të hebrenjve ai kishte të drejtën që t’i vinte emrin Foshnjës Hyjnore. Josifi rridhte prej fisit të Davidit, duke plotësuar thëniet e profetëve. Josifi ushtronte zanatin e zdrukhtarit.

17 Gjithë brezatë pra që nga Avraami e gjer mbë ditët të Dhavidhit janë katër-mbë-dhetë breza; edhe që nga Dhavidhi e gjer mbë të-çpërgulurit të Babillonësë janë katër-mbë-dhjetë breza; edhe nga të-çpërgulurit’ e Babillonësë e gjer mbë ditët të Krishtit janë katër-mbë-dhjetë breza.

1-**Gjithë brezat.** Ungjillori Mathe në gjenealogjinë e tij na thotë se që nga Abrahami e deri tek Davidi janë 14 breza dhe kështu me radhë deri tek breznia e tretë, prej së cilës do të vinte Jisu Krishti.

Matheu përdor simbolikën e numrave, në katërmbëdhjetë vjeçarin e parë ngjitet deri tek mbretëria, në të dytin zbret nga mbretëria tek skllavëria dhe në të tretin nga skllavëria Babilonike deri tek marangozi i varfër Josif. Numri tre është simbolika e frymës. Numri shtatë do të thotë se fisi iu përkushtua Perëndisë. Kështu tre katërmbëdhjetësja që përbëhen nga dy shtatëshe do të thonë se zhvillimi i trashëgimisë arriti në përsosmëri. Kështu Matheu duke përdorur breznitë ia arrin qëllimit që të tregojë origjinën mbretërore të Josifit (Lluka përdor më tepër brezni). Në pemën gjenealogjike të hebrenjve nuk qenë gratë, por burrat e fisit. Kështu që Josifi rrjedh nga Davidi i fisit të Judës.

LINDJA E JISU KRISHTIT

(Lluka 2: 1-7)

18 Edhe të-lindurit' e Jisu Krishtit kështu ka qënë; pasi uvlua e ëm' e ati Maria me Josifnë, përpara se të bashkoneshinë, u gjënt me barë nga Frym' e-Shënjtëruarë.

1-Maria. Shkrimi i Shenjtë nuk e përshkruan lindjen e Marisë, prandaj informacionet për jetën e saj na i jep literatura apokrifë. Kjo e fundit na jep shumë informacione rreth aktivitetit të kishës së parë dhe më konkretisht me disa ngjarje të jetës së Marisë e Jisuit, të cilat nuk përmenden nëpër Ungjinjtë Kanonikë.

Sipas traditës, prindërit e Hyjlindëses Joakimi dhe Ana kishin mbetur pa fëmijë. Në kohën e atëhershme mospasja e një fëmije (shterpësia) konsiderohej si një mallkim i Perëndisë, por ata qenë shpresëtarë dhe luteshin pandërprerë. Një ditë tek po luteshin në kopështin e shtëpisë së tyre në Jeruzalem, një engjëll iu shfaq të dyve duke i lajmëruar se Ana do të mbarsej dhe do të lindte fëmijë. Sapo mori lajmin e mirë nga engjëlli, Ana premtoi që fëmijën do ta ofronte si dhuratë tek Perëndia. Lindja e një fëmije është një shkak për lumturi tek nëna dhe babai, veçanërisht në ato raste kur ata kanë qenë të

dëshpëruar nga mospasja e një fëmije. Në rastin e lindjes së Marisë, gëzimi i prindërve është i pakufishëm, madje e gjithë krijesa gëzohet sepse lindja e saj ishte shenjë paralajmëruese për shpëtimin që pritej të vinte.

Ajo erdhi në jetë si çdo njeri, duke trashëguar mëkatën e parëlindur, sepse ndërhyrja e Perëndisë i zhduku shterpësinë prindërve të saj, por jo natyrën. Hyjlindësja ishte njeri si të gjithë, por e deshi Perëndinë më tepër nga të gjithë dhe kështu u bë më e lavdëruar dhe më e nderuar se engjëjt. “Shpirti im madhëron Zotin dhe mendja ime u ngazëllua për Perëndinë, shpëtimtarin tim”. Këto fjalë japin një përmbledhje të jetës së Marisë, pasi tregojnë se ajo jetoi një jetë të përkushtuar plotësisht ndaj Perëndisë. Ajo është e vetmja grua në historinë e mbarë njerëzimit që do të sillte në botë Mesian e shumëpritur. Hyjlindësja është “hirëplotë”, e pastër dhe e bekuar nga Perëndia ku të gjithë brezat do ta lumërojnë. Në Sinodin e tretë Ekumenik të vitit 431 asaj iu dha titulli “Hyjlindëse”, ndërsa në Sinodin e pestë Ekumenik të vitit 553 u quajt “Virgjëreshë e Shenjtë”.

2-Lindja e Jisu Krishtit. Në letrën drejtuar Galatasve 4, 4 thuhet: “Kur erdhi koha, Perëndia dërgoi Birin e Tij, të lindur prej gruaje, të nënshtruar prej ligjit”. Trashëgimtari i Abrahamit dhe i Davidit, Jisu Krishti erdhi në jetë nga Virgjëresha Mari, e cila ishte e fejuara e Josifit. Sipas ligjit të hebrenjve fejesa ishte premtim për martesë dhe Maria qëndronte në shtëpinë e prindërve të saj. Pikërisht gjatë kësaj kohe, Maria mbeti shtatzënë prej Frymës së Shenjtëruar.

19 Edhe Josifi, burr’ i asaj, dyke qënë i drejtë, e dyke mos dashurë t’ i nxjerë asaj zë të-lik, desh t’a lëshonjë fshehurazi.

1-Josifi, i fejuari i saj. Ungjillori Mathe e paraqet Josifin njeri të drejtë, sepse kur mësoi që e fejuara e tij kishte mbetur shtatzënë nuk e poshtëroi, por vendosi që ta linte fshehtëazi. Ligji i hebrenjve ishte: në rast se e fejuara mëkatonte me ndonjë tjetër, atë duhej që ta vrisnin me gurë. Konkretisht në (Ligjin e Përtërirë 22, 23-24) thuhet: “Kur një vajzë e virgjër është e fejuar, dhe një burrë e gjen në qytet

dhe bie në shtrat me të, që të dy do t'i çoni në portën e ati qyteti dhe do t'i vritni me gurë dhe ata do të vdesin...”

20 Po ay tek po ishte dyke menduarë këto punë ja nj'ëngjëll i Zotit tek i u duk nd'ëndërrë, dyke thënë, Josif, i bir' i Dhavidhit, mos u frikëso të marrç me vetëhe gruanë t' ende Mariamënë; sepse të-mbarsuritë që u bë tek ajo është nga Frym' e-Shënjtëruarë.

1-Ju shfaq një engjëll i Zotit. Pikërisht në momentin që Josifi filloi të dyshonte për ndershmërinë e Marisë i shfaqet një engjëll i Zotit. Providenca Hyjnore vepron në momentin e përshtatshëm. Engjëll në gjuhën hebraike dhe greke (malak, angjelos) do të thotë lajmëtar, prandaj engjëlli i solli atij lajmin e mirë, që ngjizja e Marisë ishte prej Frymës së Shënjtëruar. Por engjëlli i shfaqet edhe Marisë duke i thënë: “Ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë dhe do t'ia vësh emrin Jisu” (Luka 1,31). Kështu Josifi dhe Maria, nuk i treguan askujt për këtë mister, sepse e dinin që njerëzit nuk do t'i besonin, por vetëm pas Ngjalljes së Krishtit, kur u duk qartë që ai ishte dhe Njeri dhe Perëndi, Maria e tregoi. Vetëm pas Ngjalljes, njerëzit që besonin tek mrekullitë mund të besonin edhe tek lindja e mbinatyrshe e Jisu Krishtit. Kështu Josifi i drejtë e pranoi Marinë në shtëpi, duke besuar se djali që do të lindte prej saj nuk ishte fryt i mëkatit, por që vepër e Frymës së Shënjtëruar.

2-Josif, bir i Davidit. Perëndia e quan kështu Josifin me qëllim që ta qetësojë dhe ti kujtojë se është bir i Davidit, nga breznitë e të cilit sipas profecive do të lindte Mesia. I drejti Josif e kuptoi mesazhin.

3-Davidi. Fjala hebraike David do të thotë “I dashur”. Davidi ishte djali i vogël i Jeseut nga fisi i Judës. Ai ka lindur në Betlehem në vitin 1985 para Krishtit dhe ka vdekur në moshën 70-vjeçare. Davidi u shqua për burrërinë e tij. Që kur ishte bari i vogël fitoi

dyluftimin me gjigandin Goliat. Ai ishte muzikant dhe poet. Gjithashtu ka shkruajtur shumë psalme. Davidi ishte i zgjedhuri i Perëndisë dhe u bë mbret duke i zënë vendin Saulit. Ai udhëhoqi fisin e Judës për shtatë vjet dhe popullin hebre për 33 vjet. Davidi shpalli kryeqytet Jerusalemin dhe doli fitimtar mbi armiqtë e tij, duke i dëbuar ata jashtë kufinjve të Palestinës. Jisui shpesh quhet “Bir i Davidit” që e ka kuptimin që ai është nga pasardhësit e tij.

21 Edhe dotë pjellë djalë edhe dot’ j’a quanç emërinë Jisu; sepse ay do të shpëtonjë llauzin’ e ti nga fajet’ e atyre.

1-Do ti vësh emrin Jisu. Hebrenjtë e kishin për zakon që babai i vinte emrin fëmijës. Jisu do të thotë Shpëtimtar dhe ishte ai që do të shpëtonte popullin e tij nga mëkati. Por hebrenjtë kishin koncept të gabuar për shpëtimtarin. Ata prisnin Mesinë e premtuar, i cili do t’i shpëtonte ata nga zgjedha e romakëve. Por, Jisui erdhi në botë që t’i çlironte nga mëkati stërgjyshëror.

22 (Edhe gjithë këjo u bë, që të mbushetë e-thëna prej Zotit me anë të profitit, që thotë, 23 “Ja vërgjërësha tek do të mbarsetë, edhe do të pjellë djalë, edhe do t’ j’a quanjën’ emërin’ Emanuil” që e-kthyerë do me thënë, Perëndia bashkë me ne.)

1-Do ta quajë Emanuel. Ungjillori Mathe rrëfen se u plotësua thënia e profetit Isaia:”Ja e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel (Isaia 7,14). Emanuel është fjalë hebraike që do të thotë: “Perëndia me ne”.

24 Edhe Josifi si u zgjua nga gjumi, bëri sikundrë e urdhëroj ëngjëll’ Zotit, edhe mori përanë vetëhesë gruan’ e ti: 25 Edhe nuk’e njohu atë, gjersa bëri të birin’ e saj të-parëlindurinë; edhe j’a quajti emërinë Jisu.

1-Nuk e njohu atë. Këto fjalë e kanë kuptimin se i drejti Josif e mori Marien në shtëpinë e tij, për t’u kujdesur për të, si burri

i saj ligjor që ishte dhe jo për të bërë jëtë bashkshortore. Maria i bindet engjëllit por përsëri e pyet: “Si do të ndodhë kjo, përderisa unë nuk njoh burrë?” (Lluka 1,34). Kështu Maria edhe pas lindjes së Jisu Krishtit mbeti e virgjër.

KREU I DYTË

FALJA E MAGËVE

1 Edhe Jisuj si lindi në Vithleemë të Judhesë, ndë ditt të mbretit Irodh, ja ca magjistarë nga të-lindurit' e djellit erthnë ndë Jerusolim, e thoshinë.

1-Lindi në Bethlehem të Judesë. Bethlehem ishte rreth dy orë larg nga Jerusalemi dhe kishte toka të begata, prandaj quhej “shtëpia e bukës”. Pikërisht në Bethlehem kishte lindur edhe mbreti David. Ekzistonte edhe një Bethlehem tjetër rreth shtatë milje larg nga Galilea. Judea ishte në Jug të Palestinës. Ungjillori Mathe e thekson në Bethlehem të Judesë, jo për ta dalluar nga Bethlehem i Galilesë, por për të vërtetuar se Krishti lindi në truallin e fisit të Judës, djalit të katërt të Jakovit. Bethlehem në kohët e lashta quhej Efratah. Këtë e thotë profeti Mikea: “Por ti o Bethlehem Efratah, megjithëse je i vogël midis mijërave të Judës, nga ti do të dalë për mua ai që do të jetë sundues në Izrael, origjinat e të cilit janë nga kohët e lashta, nga ditët e përjetësisë” (Mikea 5,2). Maria e kishte origjinën nga Nazareti, por u gjend me Josifin në Bethlehem për regjistrimin, sipas urdhëresës së Qesar Augustit (Lluka 2,1-5). Jisuj lindi në Bethlehem të Judesë, ashtu sikundër e kishin parathënë profetët.

2-Në kohën e mbretit Herod. Herodi i Madh ishte sundimtari i Palestinës në vitin 47 para Krishtit dhe qe aleat besnik

i romakëve në kohën e Augustit. Në Dhiatën e Re përmenden katër vetë me emrin Herod. Herodi i Madh shquej për mizoritë e tij. Ai kishte katër djem, dy prej të cilëve i vrau, së bashku me të shoqen. Ungjillori përmend: “në kohën e Herodit”, për vërtetuar profecinë se Jisu Krishti do të lindte atëherë kur mbretëria e Judesë udhëhiqej nga një i huaj.

3-Magët. Qenë nga Persia, Egjypti dhe Babilonia, vende që gjendeshin në lindje të Jerusemit. Qenë filozofë, priftërinj, astrologë dhe merreshin me astrologjinë, komentimin e ëndrrave, të magjive etj. Ardhja e magëve në Jeruzalem mendohet të ishte 40 ditë e më tepër pas lindjes së Jisuit. Nëse Herodi do ta dinte se foshnja Jisu Krisht, 40 ditë pas lindjes u shpu në tempull dhe u prit nga i urti Simeon, atëhere ai do ta kishte zhdukur.

4-Jeruzalemi. Ka qenë kryeqyteti i Palestinës. Në gjuhën aramaiste përbëhet nga dy fjalë *Jerush* dhe *Shalem* që e ka kuptimin *vendi i paqes*. Asirianët e quanin *Urusalimu*, ndërsa grekët dhe romakët *Hierusolyma*. Mbreti David pasi pushtoi Jebusenjtë e bëri kryeqytet.

2 Ku është Mbret’ i Judhenjvet që ka lindur? sepse pam’ yllin’ e ati ndë të-lindurit të djellit, e erthmë t’ i falemi.

1-Pamë yllin. Magët qenë të sigurtë se kishte lindur Mbreti i Judenjve. Popujt e lindjes besonin se me lindjen e një lideri shfaqej edhe ylli i tij. Pra magët duke parë yllin erdhën nga Babilonia në Jerusalem.

2-Ti falemi. Në vendet e Lindjes, mënyra për të përshëndetur një mbret ishte që t’i binin në gjunjë. Këtu tregohet besimi i magëve, të cilët ndonëse qenë idhujtarë, vijnë që nga larg për t’iu falur foshnjës së porsalindur.

3 Edhe mbreti Iroth kur dëgjoj, u ndroth edhe gjithë Jerusalimi bashkë me atë.

1-Mbreti Herod u shqetësua. Me të drejtë shqetësohet Herodi, tashmë që lindi Mbreti i Judenjve. Herodi nuk ishte hebre, por i huaj, prandaj nuk e gëzonte mbështetjen e popullit, aq më tepër që nga mizoritë e tij, e urrenin të gjithë.

4 Edhe si mblodhi gjithë krye-priftërit' edhe shkronjësit' e gjindjesë, pyeste të marrë vesh prej atyre, ku lint Krishti.

1-Sinedri. Gjëja e parë që bëri Herodi mblodhi Sinedrin më qëllim që të merte vesh se ku kishte lindur Mbreti i judenjve. Sinedri, ishte gjykata e lartë priftërore e judenjve dhe përbëhej nga Kryepriftërinjtë dhe njerëzit e komentimit të ligjit (farisenjtë, skribët, saducenjtë). Sinedri përbëhej nga 71 anëtarë me të drejta ligjvënëse. Sinedri mund të vendoste për çdo gjë, veçse për dënimin me vdekje. Kryetari i Sinedrit ishte Kryeprifti në fuqi. Fjalën Sinedër në Shkrimin e Shenjtë e ndeshim tek: (Matheu 26,59), (Lluka 8,41), (Veprat 13,15) etj.

5 Edhe ata i thanë ati, ndë Vithlehemë të Judhesë; sepse kështu është shkruarë me anë të profitit, 6 “Edhe ti Vithlehemë, dheu i Judhesë, asfare nukë je m’ e-vogëla ndër zotërinjt të Judhesë, sepse prej teje dotë dalë një i-parë, i-cili dotë kullosnjë llauzinë t’ im Israil.”

1-Në Bethlehem të Judesë. Anëtarët e Sinedrit qenë shumë strikt me shkrimet e Shenjta dhe iu përgjigjën me fjalët e profetit Mikea 5, 2. Ata nuk i besuan lindjes, por qëndronin besnikë të profecivë që Mesia i shumëpritur do të lindte vetëm në Bethlehem të Judesë.

7 Atëhere Irodhi thirri fshehurazi magjistarëtë, e mori vesh mirë nga ata kohën' e yllit që ishte dukurë; 8 Edhe dyke dërguarë ata ndë Vithlehemë tha; Shkoni e vëshgoni mirë për djalënë; edhe si t'a gjeni, të më epni zë, që të vinj edhe unë e t'i falem ati.

1-Të shkoj edhe unë t'i falem. Për vendin se ku kishte lindur Mbreti i Judenjve, Herodi u sigurua prej Sinedrit, por nuk dinte kohën e lindjes, prandaj këtë gjë donte ta vërtetonte nga magët. Ai thotë se do të shkonte që t'i falej, por në të vërtetë donte ta vriste, sepse mendonte se do t'i zinte vendin.

9 Edhe ata si dëgjuanë mbretinë vanë; edhe ja ylli që kishinë parë ndë të-lindurit të djellit tek shkonte përpara atyre, gjersa erdhi e qëndroj sipër tek ishte djali.

1-Duke ndjekur yllin. Magët duke ndjekur yllin shkuan në shpellën e Bethlehemit, ku gjetën foshnjën e sapolindur, nënën e tij dhe të drejtin Josif.

10 Edhe ata kur panë yllinë, u gëzuanë gëzim të-math fort.

1-U gëzuan. Magët sapo panë yllin u gëzuan pa masë, sepse kishin mbërritur në vendin që dëshironin.

11 Edhe si erthnë ndë shtëpit, gjetnë djalënë bashkë me t'ëmën e ti Mari, edhe ranë mbë dhe e iu falnë ati, edhe si hapnë thesarët' e tyre, i prunë ati dhurëti, ar e livan e smirnë.

1-Në shtëpi. Qe e natyrshme që Josifi me Marien tashmë banonin në një shtëpi. Udhëtimi i magëve zgjati me muaj.

2-Ranë përmbys dhe e adhuruan. Në vendet e Lindjes ishte zakon që kur gjendeshin përpara mbretit duhej që t'i binin ndër gjunjë dhe t'a adhuronin. Gjithashtu duhej që t'i ofronin dhurata. Kështu

bënë edhe magët, sapo e panë foshnjën hyjnore iu falën dhe i dhuruan atij ar, livan dhe smirë, të cilat qenë gjërat më të çmuara.

12 Edhe si u dëftye atyre nga Perëndia nd'ëndërrë të mos kthenenë tek Irodhi, nga një tjetër' udhë shkuanë ndë vënt të tyre.

1-**Të mos ktheheshin tek Herodi.** Perëndia përdor format e tij, për të shpëtuar foshnjën e porsalindur. Kështu magët nuk u kthyen nga Jeruzalemi për të njoftuar Herodin se e gjetën Mesian, por ata i ranë nga një udhë tjetër sepse nuk donin që të bëheshin bashkëpunëtorë në krim.

13 Edhe passi iknë ata, ja një ëngjëll' i Zotit tek i duketë nd'ëndërrë Josifit, dyke thënë, ngreu e mer me vetëhe djalën' edhe t'ëmën' e ati, edhe ikë ndë Egjyptë; edhe rri atje gjer kur të të them tyj; sepse Irodhi do të kërkonjë djalënë që t'a prishnjë.

1-**Merr fëmijën e nënën dhe ik.** Perëndia e njoftoi Josifin me anën e një engjëlli, që të largohej drejt Egjyptit që ishte nën sundimin e romakëve, kështu Herodi nuk kishte mundësi ta kapte dhe ta asgjësonte sepse juridiksioni i tij ishte vetëm Palestina.

2-**Egjypti.** Ishte nën zotërimin e romakëve dhe gjendej afërsisht rreth 60 milje larg prej Bethlehemit. Në Egjypt gjendeshin shumë judenj.

14 Edhe ay u ngrit, e mori me vetëhe djalën' edhe t'ëmën' e ati natënë, edhe iku ndë Egjyptë;

1-**Iku në Egjypt natën.** Palestinezët zakonisht udhëtonin natën, sepse udha ishte më e lehtë. Kështu Josifi mori foshnjën dhe nënën e tij dhe u nisën për t'u vendosur në Egjypt, në një vend që quhej Materej në afërsi të Kairos. Udhëtimi prej Bethlehemit në Egjypt zgjaste dy ditë.

15 Edhe ndenji atje gjer mbë vdekëjet të Irodhit; që të mbushetë e-thëna prej Zotit me anë të profitit, që thotë; “Nga Egjypta thirra t’ im bir.”

1-Nga Egjypti e thirra tim bir. Familja e shenjtë qëndroi në Egjypt derisa vdiq Herodi. Egjypti ishte që në kohët e vjetra, si vend mbrojtje për hebrenjtë. Atje kishte mjaft judenj, të cilët përbënin diasporën judaike. Qëndrimi i foshnjës hyjnore në Egjypt u bë edhe për një arrësye tjetër, sepse duhej të përmbushej profecia e Oseas: “Nga Egjypti e thirra tim bir” (Osea 11, 1).

VRASJA E FOSHNJAVE

16 Atëhere Irodhi, kur pa se u gënjye nga magjistarëtë, u zëmërua fort, edhe dërogoj e vrau gjithë djemtë që ishinë ndë Vithehemë e ndë për gjithë sinoret t’asaj, që mbë dy vjeç e poshtë, si pas kohës që kishte marrë vesh mirë nga magjistarëtë. 17 Atëhere u mbush ç’është thënë nga profiti Jeremi, që thotë; 18 “Zë u dëgjua ndë Rama, vajë e të qarë e gjëmë shumë; Rahilla qante djemt’e saj, edhe nukë donte të ngushllonej, sepse nukë janë.”

1-Në Ramë u dëgjua një klithmë. Rama ishte një fshat i vogël rreth 6 milje në afërsi të Bethlehemit. Ramë në gjuhën hebraike do të thotë vend i ngritur ose kodër.

2-Rakela vajton bijtë e saj. Kjo ishte një profeci e profetit Jeremia për vrasjen e foshnjave të Bethlehemit. E shoqja e Jakovit, Rakela u mor si shembull nëne për të gjithë fëmijët e hebrenjve, sepse varri i saj gjendej në afërsi të Bethlehemit. U plotësua kështu profecia e Jeremisë: “Rakela vajton bijtë e saj dhe nuk pranon të ngushëllohet për ta, sepse ata nuk janë më” (Jeremia 31,15).

KTHIMI NGA EGJIPTI

19 Edhe si vdiq Irodhi ja një ëngjëll' i Zotit tek i duketë ndë ëndërrë Josifit ndë Egjyptë e i thotë, **20** Ngreu e merr me vetëhe djalën' edhe t' ëmën e ati, edhe ecë ndë dhet të Israilit; sepse vdiqnë ata që kërkonin jetën' e djalit.

1-**Ata që donin të vrisnin fëmijën kanë vdekur.** Ai që kërkonte të vriste Jisuin ishte Herodi, përse engjëlli flet në numrin shumë: -Ata që donin të vrisnin fëmijën? Vërtet që Herodi kishte vdekur, por njerëzit e avllisë i kishin marë porositë që ta vrisnin Jisuin.

21 Edhe ay u ngrit e mori me vetëhe djalën' edhe t' ëmën' e ati, edhe erdhi ndë dhet të Israilit. **22** Po kur dëgjoj, se Arhellau mbretëron ndë Judhet ndë vëntt të Irodhit t'et, pat frikë të vejë atje; edhe si i u dëftye ati nga Perëndia nd'ëndërrë, iku nd'anët të Galilesë.

1-**Arqilai mbretëronte në Jude.** Pas vdekjes së Herodit, mbretëria iu nda dy djemve të tij. Arqilai u bë sundimtari i Judesë, Samarisë dhe Judimesë, ndërsa Herod Antipa, u bë sundimtari i Galilesë dhe i Peresë.

23 Edhe erdhi e ndënjt i ndë një qytet që thuhetë Nazaret; që të mushetë ç'është thënë nga profitëritë, se Nazoreas do të quhetë.

1-**Nazaret.** Josifi i bindet engjëllit dhe niset për në Bethlehem, por kur mësoi që aty mbretëronte Arqilai shkoi në krahinë e Galilesë dhe u vendos në qytetin e vogël Nazaret. Kështu u plotësua thënia e profetit: "Ai do të quhet Nazareas". Foshnja Hyjnore i kaloi vitet e fëmijërisë në Nazaret, pranë nënës së tij Maries dhe Josifit, që ushtronte zanatin e marangozit.

KREU I TRETË

PREDIKIMI I JOAN PAGËZORIT

(Marku 1:1-9, Lluca 3:1-9, 15-17, Joani 1:19-28)

1 Edhe nd' ato dit vjen Joan Pagëzori dyke lëçiturë ndë shkretëtirët të Judhesë, e dyke thënë.

1-**Në ato ditë.** Ungjillori Mathe me këto fjalë do të na kujtojë kohën kur Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti nisi predikimin e tij. Jisui jetonte ende në Nazaret.

2-**Erdhi Joan Pagëzori.** Joani ishte gjashtë muaj më i madh se Jisui. Joani u shfaq, kur Judea ishte nën udhëheqjen e Pilatit dhe sundimtar (Tetraqis) i Galilesë ishte Herod Antipa. Në kohën e Çezarit Tiver, siç na e thotë edhe Ungjilli: -"Tani në vitin e 15-të të mbretërimit të Tiberit Çezar" (Luk.3,1). Por, siç e dimë Tiberi erdhi në fron rreth viteve 767 nga themelimi i Romës. Duke hequr nga kjo shifër, datën e themelimit të Romës, vitin 753 kemi ($767-753=14$). Kësaj shifre i shtojmë edhe 15 vjetët e qeverisjes së Tiberit dhe na del viti 29 pas Krishtit, si viti i fillimit të aktivitetit publik të Joanit.

3-**Predikonte në shkretëtirën e Judesë.** Joani u paraqit në një mënyrë të çuditshme në shkretëtirën e Judesë pranë lumit Jordan. Predikonte për gjykimin hyjnor dhe i ftonte njerëzit të pendoheshin. Shkretëtira e Judesë gjendej në anën perëndimore të Detit të Vdekur.

2 Pendohuni; sepse u afërua mbretëria e qiejvet.

1-Pendohuni. Joani e ftonte popullin për pagëzimin e pendimit, me qëllim që të parapërgatiste udhën për ardhjen e Jisuit. Pendimi ishte mohimi i jetës së mëparshme dhe parapërgatitja për të hyrë në Mbretërinë e Qiejve. Gjithë ata që pendoheshin ishin të denjë të merrnin nga Joani pagëzimin e pendimit, në lumin Jordan. Shumë besonin se ishte Krishti, por Joani iu jepte përgjigje se Krishti ishte më i lartë se ai dhe do të vinte pas tij.

2-Mbretëria e qiejve. Mbretërinë e Qiejve e kishin parathënë profetët: Danieli 2, 44 dhe 7, 13-14. Por Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti predikonte: “Jo çdo njeri që më thotë: “Zot, Zot” do të hyjë në Mbretërinë e Qiejve, por do të hyjë ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiej” (Matheu 7,21). Pararendësi i ftonte njerëzit të pendoheshin e të pagëzoheshin, si parakusht për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë. “Pendohuni, sepse Mbretëria e Qiejve është e afërt”, predikonte Joani.

3 Sepse ky është ay që u fol nga profeti Isai që thotë, “Zër’ i ati që bërtet ndë shkretëtirët, bëni gati udhën’ e Zotit: bëni rrugat’ e ati të drejta”.

1-Një zë që buçet në shkretëtirë. Për Joanin kishte profetizuar profeti Isaia 40, 3. Joani nuk predikonte nëpër sinagoga por në shkretëtirën e Judesë. Shkretëtira ishte vendi i parapregatitjes së Moisiut, Ilias, Joanit (Lluka 3,2) dhe Jisuit (Matheu 4,1). Profeti Isaia prej vitesh kishte profetizuar se Joani “është një zë që buçet në shkretëtirë”. Në shkretëtirë Pararendësi u kultivua shpirtërisht.

4 Edhe Joani vetë kishte të-veshurit’ e ti prej qimesh kamille, edhe bres të-lëkurtë rreth mezit të ti; edhe ushqimi i ati ishte karkalecë e mjalt’ e-egre.

1-Një rrobë prej leshi të devesë. Përsa i përket veshjes dhe mënyrës së të ushqyerit, Joani imitonte profetin Ilia (Libri II i mbretërve 1,8). Për thjeshtësinë, varfërinë e jetës asketike të Joanit na thotë Ungjillor Matheu: “Vishej me një rrobë leshi të devesë dhe me një brez lëkure në bel ai ushqej karkaleca dhe mjaltë”.

5 Atëhere dilte jashtë tek ay Jerusalimi edhe gjithë Judhea, edhe gjithë vëndi qark Jordhanit;

1-Rendnin tek ai. Ardhja e Joanit në brigjet e Jordanit bëri që shumë njerëz nga e gjithë Judea të rendnin tek ai, për të marrë pagëzimin e pendimit.

6 Edhe pagëzoshinë ndë Jordhan nga ay, dyke rrëfyerë fajet’ e tyre

1-Pagëzimi. Kryej me të zhyturit në ujë ashtu siç e kishte parathënë profeti Jezekel: “Do të lëshoj pastaj ujë të pastër mbi ju dhe do të jeni të pastër; do t’ju pastroj nga të gjitha ndyrësitat tuaja dhe nga të gjithë idhujt tuaj” (Jezekiel 36, 25). Mirëpo ky nuk ishte pagëzimi i vërtetë, sepse atë do ta mernin nga Zoti Krisht, i cili predikonte: “Në të vërtetë, në të vërtetë po iu them se kush nuk ka lindur nga uji dhe nga fryma, nuk mund të hyjë në Mbretërinë e Perëndisë” (Joani 3,5).

7 Edhe kur pa se shumë nga Farisenjt’e Sadduqenjtë po vinjnë ndë pagëzimt të ti, u tha atyre, të pjellë nepërkash, cili u dëftu juve të ikëni nga zëmërimi që vjen?

1-Farisejtë. Ishin mbrojtësit e ligjit dhe të traditës gojore. Kjo gjë i bënte të dalloheshin nga të tjerët, prandaj jetonin të veçuar. Vetë emri “farise” do të thotë “i ndarë”. Kanë pasur një autoritet të madh në popull sepse komentonin dhe zbatonin me përpikmëri Ligjin. Megjithatë çdo gjë e bënin nga ana e jashtme. Kanë qenë

mendjemëdhenj e dëshironin që të përshëndeteshin me titullin “Rabin” që do të thotë “Mësues”. Nëpër Sinagoga dhe vende të tjera publike, kërkonin që të uleshin gjithnjë nëpër vendet e para. Megjithatë nga rradhët e Farisenjve ka dalë edhe Apostull Pavli. Në Veprat e Apostujve ai thekson: “Unë jam farise dhe bir fariseu...”(Veprat e Apostujve 23:6).

2-Saducejtë. Ishin shtresat më të larta dhe më të fuqishme. Nga rradhët e tyre zgjidheshin organet më të larta në Sinedrin. Ishin aristokratë dhe simpatizantë të helenizmit. Pranonin ligjin e Pentatevku, si ligjin suprem. Ata mohonin ngjalljen e të vdekurve, pavdekshmërinë, ekzistencën e shpirtave dhe providencën hyjnore. Zotëronin fuqi politike dhe nuk ishin popullorë.

3-Esenjtë. Ishin të organizuar në një klasë të veçantë. Ata ruanin ligjin e shkruar e gojor me saktësi, bënëin jetë të përbashkët duke kultivuar tokën në anën perëndimore të Detit të Vdekur. Prodhimet dhe fitimet e tyre i ndanin bashkarisht. Jetonin në bashkësi e të izoluar nga jeta publike. Për jetën e tyre kemi të dhëna nga Shkrimet e Kumranit. Këto u zbuluan rastësisht në vitin 1947 nga një bari beduin i quajtur Muhamed ed-Dib, teksa po kërkonte dhinë e humbur në shpellën Kumran. Në këto shpella qenë vendosur qypat e mëdhenj, në të cilët ishin roletë prej papirusi. Në to gjendeshin të shkruara gati të gjitha librat e Dhiatës së Vjetër. Materialet e gjetura në Kumran (Qumran) dëshmojnë se Esenjtë janë marrë me çështje apokaliptike: si ringjallja e të vdekurve, dita e gjykimit të fundit etj.

4-Pjellë nëpërkash. Predikimi i Joanit në Jordan bëri aq bujë, sa që bashkë me popullin rendën edhe shumë farisenj dhe saducenj. Pararendësi sapa i pa u tha:” Pjellë nëpërkash”. Joani e dinte se ata qenë njerëz të këqinj nga zemra.

5-Zemërimi. Me këto fjalë kuptojmë zemërimin e Perëndisë, që do të bjeri mbi njerëzit e pabesë, të cilët nuk u penduan për mëkatet e tyre. Tek këta njerëz futen edhe farisenjtë e saducenjtë.

8 Bëni pra pemë të-vjejtura për pendim;

1-Jepni pra frute të denja të pendesës. Nëse me të vërtetë doni t'i shpëtoni zemërimin të Perëndisë, ndiqni të vetmen udhë, atë të pendimit. Joani në predikimin e tij, i krahason njerëzit me pemët duke marrë parasysh frutin, që është pendesa. Vepra kryesore e Joanit ishte parapërgatitja e popullit për ardhjen e Mesisë. Për këtë ai quhet dhe Pararendësi i Zotit tonë Jisu Krisht. Këtë e bëri realitet me anën e predikimit të tij.

9 Edhe mos shkoni ndër mend të thoni më vetëhenë t'uaj? Atë kemi Avraamnë; sepse po u them juve, se Perëndia munt edhe nga këta gurë t'i ngrerë djem Avraamit.

1- Atë kemi Avraamin. Farisenjtë dhe Saducenjtë, së bashku me judenjtë pretendonin që ishin populli i zgjedhur i Perëndisë. Pas besëlidhjes që pati Perëndia me Abrahamin, i premtoi që ishte populli i zgjedhur prej tij.

2- Perëndia munt edhe nga këta gurë t'i ngrerë djem Avraamit. Joan Pararendësi me këto vargje, tërheq vëmendjen duke thënë se Perëndia mund të krijojë njerëz të tjerë edhe prej gurëve të lumit Jordan. Ai i kritikon judenjtë se ata qenë të lidhur me Avrahamin, vetëm në sajë të lidhjes farefisnore dhe jo të asaj shpirtërore, prandaj duhet që të pendosheshin, për të pritur Shpëtimtarin e botës.

10 E tashi edhe sëpata rri për anë rrënjës'së drurëvet; çdo dru pra që s'bën pemë të-mirë pritetë edhe hidhetë ndë zjar.

1- Sëpata rri për anë rrënjës'së drurëvet. Këtu e ka kuptimin, që koha e pendimit ka ardhur dhe e krahason me sëpatën përpara se të presi drutë.

2- Çdo dru pra që s'bën pemë. Drutë që nuk japin ftyte do të hidhen në zjarr, ndërsa ata që japin ftyte do të kursehen. Me këtë kuptojmë se vetëm njerëzit që pendohen, mund të hyjnë në Mbretërinë e Perëndisë.

11 Un' u pagëzonj juve me ujë për pendim; po ay që vjen pas meje është më i fortë se unë, të-cilit nukë jam i zoti t'i mbanj këpucët; Ay dot' u pagëzonjë juve me frymë të-Shënjtëruar' e me zjar.

1- Un' u pagëzonj juve me ujë për pendim. Mjaft njerëz i dëgjonin predikimet e tij dhe pagëzoheshin në lumin Jordan, duke rrefyer mëkatet e tyre. Pagëzimi i Pararendësit, ishte parapërgatitja për ardhjen e Mesisë. "Unë po ju pagëzoi me ujë për pendim, por ai që vjen pas meje është më i fortë se unë dhe unë nuk jam i denjë as t'i mbaj sandalet e tij, ai do t'ju pagëzoi me Frymën e Shenjtë".

2-T'i mbaj këpucët. Shtresat e pasura zakonisht mbanin rreth vetes sklevër, të cilët ju zgjidhnin këpucët dhe ua mbathnin.

12 Ay ka lopatënë ndë dorët të ti, edhe do të qëronjë lëmën' e ti, edhe do të mbledhë grurin' e ti ndë grunart, po kashtënë dot' a djegë ndë zjar të-pashuarë.

1- Ka lopatën ndë dorët të ti. Në këtë rast Ungjillori Mathe, përdor një shembull nga jeta e buqve, duke na kujtuar se me atë mënyrë që pastrohet gruri, kështu edhe me ardhjen e dytë të Krishtit do të ndahen të drejtët nga mëkatarët. Të drejtët krahasohen me grurin dhe mëkatarët me kashtën, e cila do të hidhet në zjarr.

PAGËZIMI I JISUIT

(Marku 1:9-11, LLuka 3:21,22)

13 Atëhere Jisuj vjen nga Galilea ndë Jordhant te Joani, që të pagëzonetë prej ati.

1-**Jisui erdhi nga Galilea** në Jordan për t' u pagëzuar tek Joani, i cili dëshmoi duke thënë: “E pashë Frymën duke zbritur nga qielli si një pëllumb dhe ndenji mbi të”. Unë e njihja, por ai që më dërgoj të pagëzohem me ujë më tha “Ai mbi të cilin do të shikosh se zbret Fryma është ai që pagëzon me Frymën e Shenjtë.”

2-**Jordani** është lumi i shenjtë i Palestinës. Buron nga liqeni i Galileës e derdhet në Detin e Vdekur. Mjaft të krishterë nga vende të ndryshme të botës kur vizitojnë Vendet e Shenjta, zhyten në lumin Jordan, për të marrë hirin e bekimit dhe të shenjtërimit.

14 Po Joani e ndalonte atë, dyke thënë: Unë kam nevojë të pagëzohem prej teje, e ti vjen tek unë?

1- **Unë kam nevojë të pagëzohem prej teje.** Këto janë fjalët me të cilat i drejtohet Joani Jisuit. Ata të dy qenë kushërinj dhe mund të njiheshin më përpara, ndonëse Joani kishte dalë që në moshë të re për të asketuar në Shkretëtirën e Judesë. Në momentin që Jisui erdhi për t' u pagëzuar në bregun e Jordanit, Joani e kuptoi që Jisui ishte Ai do të pagëzonte me frymën e Shenjtëruar.

15 Edhe Jisuj u përgjeq e i tha: Le tashi; sepse kështu gjan neve të mbushmë ç' do drejtëri. Atëhere e le atë.

1- **Sepse kështu gjan neve të mbushmë ç' do drejtëri.** Jisui ndonëse nuk kishte nevojë që të pagëzohej, i bindej urdhërit të Perëndisë. Ai më parë kishte pranuar të rrethpëtejt, për të qenë i bindur ndaj ligjit të Moisiut, si të gjithë judenjtë. Ndërsa tani erdhi që të pagëzohej prej Joanit, me qëllim që të përmbushej drejtësia e Perëndisë.

16 Edhe Jisuj si u pagëzua për-një-herë doli nga ujët; edhe ja tek u hapnë qiejtë, edhe pa Frymën'e Perëndisë dyke zbriturë posi pëllump, e dyke ardhurë mbi atë.

1- **Jisui u pagëzua.** Theofania ose siç quhet ndryshe Uji i Bekuar, na kujton manifestimin e Trinitetit të Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Pagëzimi shënon fillimin e misionit publik të Jisu Krishtit mes njerëzve, tashmë jo si zdruckhtar, por si mësues me autoritet për të hapur dyert e Mbretërisë së Perëndisë. Kur turmat e njerëzve shkonin tek Joani për tu pagëzuar, ai u predikonte mesazhin e Pendimit dhe pagëzimin për ndjesën e mëkateve. Meqenëse Jisu Krishti ishte pa mëkat, ai nuk kishte nevojë që të pagëzohej. Megjithatë Krishti pranoi të pagëzohej, për të treguar se ai e aprovonte pagëzimin, si një përgatitje për në Mbretërinë e Perëndisë. Ai donte që njerëzit të kuptonin, se pagëzimi ishte një portë, nëpërmjet së cilës, gjithsecili hyn në Mbretërinë e Qiejve.

2- **U hapnë qiejtë.** Hebrenjtë e përfytyronin qiellin me një rasë të fortë, prandaj përdorin fjalët “u hapnë qiejtë”. Këtu e ka kuptimin se qielli u hap, sepse do të zbriste Shpirti i Shenjtë, në formën e një pëllumbi.

3- **Pëllumbi** ishte shpend i dashur për judenjtë sepse është simboli i paqes.

17 Edhe ja një zë nga qiejtë që thoshte, Ky është biri im-i-dashurë, që e kam pëlqyerë.

1- **Një zë.** Zëri i Perëndisë në Dhiatën e Re u dëgjua tre herë: 1) në pagëzimin, 2) në shpërfytyrimin dhe 3) përpara vdekjes (Joani 12, 28-30).

2- **Ky është biri im-i-dashurë.** Me këto fjalë kuptojmë që Joani dhe gjithë ata që ishin të pranishëm në pagëzim dhe prej tyre gjithë bota mbarë, ta dinin që Jisui ishte me të vërtetë Biri i Perëndisë.

Kjo vërtetohet nga fakti që Ai u zu pa mëkat, u ngjall së vdekurësh dhe më vonë u ngjit në qiell.

KREU I KATËRT

NGASJET E JISUIT

(Marku 1:12-13, Lluca 4:1-13)

1 Atëhere Jisuj u pru dnë shkretëtirët prej Frymësë, që të ngitej prej djallit.

1- **Jisuj u pru në shkretëtirë.** Me shkretëtirë kuptojmë atë pjesë të shkretë të Judesë, me male të lartë, ku qëndroi 40 ditë e netë.

2- **Të ngitej prej djallit.** Djalli ka qenë kryetari i engjëjve, i cili nga kryelartësia u rebelua ndaj vullnetit të Perëndisë. Djalli nuk kurseu as Jisuin për ta shtyrë në mëkat. Vullneti i Perëndisë ishte që Jisui pas pagëzimit të përballej me tundimet e djallit. Ky i fundit synon që të shkatërrojë Mbretërinë e Perëndisë. Njeriu i parë Adami, si pasojë e ngasjes që i shkaktoi djalli shkeli urdhërin e Perëndisë. Ndërsa Krishti, i cili konsiderohet si Adami i Dytë, triumfoi mbi djallin.

2 Edhe si agjëroj dy-zet dit e dy-zet net, pastaj i erdhi uri.

1- **Agjëroj dyzet ditë e net.** Argjërimi i Jisuit ishte për 40 ditë dhe netë, pa ngrënë e pa pirë asgjë. Kështu kishin vepruar edhe Moisiu dhe Ilia. Pas argjërimit 40 ditor, natyra njerëzore e Jisuit ishte dobësuar prej urisë, kështu djalli e kishte më të lehtë për ta shtënë në mëkat.

3 Edhe ay që nget erdhi tek ay e tha: Ndë je i bir'i Perëndisë, thuaj të bënenë bukë këta gurë.

1- **Thuaj të bënenë bukë këta gurë.** Djalli ndonëse e dinte që Jisui ishte Biri i Perëndisë, për ta shtënë atë në ngasje i thotë që të kthente gurët në bukë.

4 Po ay u përgjeq e tha: është shkruarë, “Njeriu nukë do të ronjë me bukë vetëmë, po me çdo farë fjalë që del nga goj’e Perëndisë.”

1- **Njeriu nuk do të rojë vetëm me bukë.** Këtu Jisui e bindi djallin se ishte me të vërtetë Biri i Perëndisë dhe dinte ta shuante urinë që kishte. Për njeriun buka nuk e ka atë rëndësi që ka Fjala e Perëndisë. Perëndia na jep fuqi për të përballuar të gjitha tundimet. Në Dhiatën e Vjetër, Moisiu e ushqeu popullin me mana, me qëllim që t’u forconte judenjve frikën e Perëndisë.

5 Atëhere djalli e merr me vetëhe ndë qytete të-shënjtëruarë, edhe e vuri përmbi fletëzët të hieroresë, edhe i thot’ ati,

1- **Í dë qytett të-shënjtëruarë.** Qyteti i Jerusalemit, quhej i shenjtë prej tempullit. Me ç’ mënyrë e mori djalli prej shkretëtirës dhe e shpuri në qytetin e Jerusalemit, ungjillori Mathe nuk na e tregon.

6 Ndë je i bir’ i Perëndisë, hidhu poshtë; sepse është shkruarë. “Se dot’ urdhëronjë ëngjëjt’ e ti për ty edhe dotë të ngrënë ty mbi duart, që të mos përpyekç këmbënë t’ënde mbë gur.”

1- **Hidhu poshtë.** Këtu djalli mbështetet në një varg të Psalmi 91,11 ku flitet mbi fuqinë e Perëndisë.

7 Jisuj i tha ati, përsëri është shkruarë, “Të mos ngaç Zotinë Perëndinë t’ënt.”

1- **Të mos ngaç Zotin Perëndinë tënt.** Ky varg gjendet tek (Libri V i Moisiut 6,16) dhe ka kuptimin që të mos kërkonin ndihmën e Perëndisë për punë të këqija.

8 Përsëri djalli e merr me vetëhe mbë një mal shumë të lartë, edhe i dëften gjithë mbretërit’ e botësë edhe lavdin’ e atyre, e i thotë.

1- **Mal shumë të lartë.** Nuk dihet se cili është ai mal aq i lartë sa të shihen gjithë mbretëritë e botës, por nënkuptohet që ka përdorim figurativ.

9 Të gjitha këto dotë t’i ap tyj, ndë rënc të më falesh.

1- **Ndë rënc të më falesh.** Djalli kërkon që Jisui t’i falet atij dhe në vend që të krijojë Mbretërinë e Perëndisë, ai përpiqet ta largojë Jisuin nga Perëndia. Kjo botë nuk i përket djallit, por krijuesit të saj Perëndisë.

10 Atëhere Jisuj i thot’ati: Ikë prej meje, Satana; sepse është shkruarë, “Zotit Perëndisë t’ënt dot’i falesh, edhe vetëm ati do t’i lutesh.”

1- **Ikë prej meje, Satana.** Këtu Jisui e largon djallin dhe nuk bie në grackën e tij.

11 Atëhere djalli e le atë; edhe ja ëngjëjtë tek erdhë përanë e i shërbeninë.

1- **Engjëjtë tek erdhë.** Engjëjt zbresin prej qiellit dhe e ushqejnë Jisuin, në atë mënyrë që patën ushqyer dikur profetin Ilija.

12 Edhe Jisuj kur dëgjoj se Joani u dha ndër duar, iku ndë Galilet.

1- Iku ndë Galilet. Pas burgosjes së Joanit prej Irod Antipës, Jisui e largua nga Judea dhe vajti në Galile. Me Galile kuptojmë atë pjesë të Palestinës, e cila është e ndarë në tre pjesë. Nga veriu gjendet Galilea e kombeve, e cila quhet me këtë emër sepse banohej prej shumë popujsh. Në qendër të Galilesë ishte Samaria dhe në jug gjendej Deti i Vdekur.

13 Edhe si la Nazaretinë, erdhi e ndënji ndë Kapernaum që është përënë detit, ndë sinoret të Zavullonit edhe të Nefthalinit,

1- Kapernaumi gjendej në perëndim të liqenit Gjenisaret. Pikërisht në Kapernaum Jisui filloi predikimin, prandaj edhe në ungjill quhet qyteti i tij. Kapernaumi ishte në kufi me fiset e Zavullonit dhe të Nefthalinit.

14 Që të mbushetë ç’ është thënë nga profiti Isai që thotë, 15 “Dheu Zavullon edhe dheu Nefthalim, mb’ udhët të detit përtej Jordhanit, Galilea e kombevet;

1- Galilea e kombevet. Këto vende banohehin nga idhujtarë dhe sipas profecisë së (Isaia 9, 1-2) prej perëndimit, pra Mesopotamisë do të vinte Mesia, që të fillonte misionin e tij. Këto vende qenë qendra e predikimit të Jisuit.

16 Llauzi që rrinte nd’erësirë pa dritë të madhe, edhe mb’ata që rrininë ndë vënt e ndë hijet të vdekjesë lindi dritë.”

1- Llauzi që rrinte në erësirë. Këtu e ka kuptimin se ato vende qenë idhujtare dhe me shfaqen e Jisuit panë dritën e madhe.

2- Lindi dritë. Kuptohet Mesia, i cili u tregoi udhën e drejtë. “Unë jam drita e botës, ai që do të vijë pas meje nuk do të mbesi në erësirë, por do të shohi dritën e jetës” (Joani 8,12).

17 Që atëhere Jisuj zuri të lëçisnjë e të thotë: Pendohuni, sepse u afërua mbretëri' e qiejvet.

1- **Pendohuni.** Jisui e nisi predikimin e tij, pikërisht me ato fjalë që e pat nisur edhe Joan Pararendësi.

THIRRJA E DISHEPUJVE

(Marku 1:16-20, Lluka 5:1-11)

18 Edhe Jisuj tek ecënte për anë detit të Galileës, pa dy vëllezër, Simoninë, që thuhej Pjetër, edhe Andrenë të vëllan' e ati dyke hedhurë rrjetë ndë dett; sepse ishinë peshkatarë.

1- **Jisuj tek ecte pranë detit të Galileës.** Duke kaluar buzë detit pranë qytetit të Betsaidës, Jisui pa dy vëllezërit Andrean dhe Simon Petrin. Nuk është e rastësishme që Krishti e donte shumë detin, prandaj edhe dishepujt e parë i zgjodhi peshkatarë. Deti është nga krijesat më të bukura dhe në mënyrë alegorike paraqet gjendjen e shpirtit të njeriut. Me qetësinë e tij paraqet qetësinë e shpirtit tonë, ndërsa me furtunën, pësimet tona. Limanet e shumtë simbolizojnë shpëtimin, ndërsa pafundësia e detit është simboli i ëndrave tona.

19 Edhe u thot' atyre: Ejani prapa meje, edhe do t'u bënj juve peshkatarë njerëzish.

1- **Peshkatarë njerëzish.** Ai i fton ata për t'u përgatitur në misionin e madh të shpëtimit të botës. Nga peshkatarë të thjeshtë, ata u bënë predikues të Ungjillit të Krishtit. Të çuditshme na duken kriteret, me të cilat Krishti zgjedh dishepujt e tij. Ai ftoi për t'u bërë Apostuj njerëz të pashkolluar dhe jo të ditur, njerëz të varfër dhe jo të pasur. I ftoi ata jo për gjëra të thjeshta, por për të ndryshuar historinë e botës, duke zhvleftësuar filozofi, perandori, qytetërimi, akoma edhe vdekjen.

20 Edhe ata për-një-herë lanë rrjetatë, e vanë pas ati.

1- Lanë rrjetat, e vanë pas ati. Ungjilli që ai predikoi që i përkryer dhe kërkonte shpirta të pastër, prandaj Krishti iu thotë: “Ejani pas meje, sepse unë jam udhërrëfyesi dhe ju pasuesit e mi”. Andrea dhe Simoni e kishin parë Jisuin kur u pagëzua në Jordan prej Joanit dhe tashmë kishin privilegjin që të përzgjidhen apostuj të tij.

21 Edhe si vate më tej, pa dy vëllezër të-tjerë, Jakovinë të birin’ e Zevedheut, edhe Joantinë të vëllan’ e ati, ndë lundrët bashkë me Zevedhenë t’ an’ e tyre, dyke ndrequrë rrjetat’ e tyre, edhe i thiri ata. 22 Edhe ata përnjë-herë lanë lundrën’ e tyre, edhe vanë pas ati.

VEPRIMTARIA NË GALILE

(Lluka 6:17-19)

23 Edhe Jisuj vinte përqark gjithë Galilesë, dyke mësuarë ndëpër sinagogjit t’ atyre, edhe dyke lëçiturë ungjillin’ e mbretërisë, edhe dyke shërruar çdo smundje e çdo lëngatë ndë llaust.

1- I thiri ata. Dishepujt e ndoqën Krishtin ngado. Ata iu përgjigjën ftesës menjëherë, braktisën gjithshka dhe e ndoqën pas. Krishti i zgjodhi dishepujt e tij, në momentin që ata po punonin. Ata qenë peshkatarë dhe ishin duke peshkuar. Rrjetat e peshkimit janë simbolika e fjalës së Perëndisë, ndërsa barkat simbolizojnë anijen e madhe që quhet kisha e krishterë. Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti përdori predikimin dhe mrekullitë, për të afruar njerëzit që do ta ndiqnin pas. Predikimi ishte zbulimi i së vërtetës Hyjnore, ndërsa mrekullitë, prova e fuqisë së pushtetit Hyjnor.

Vetë fjalët e Krishtit të Ringjallur: “Ashtu siç më dërgoi mua Ati, unë ju dërgoj juve” (Joan 20:21), i japin kuptim emërtimit

të nxënëve të tij “Apostuj”. Ata sjellin mesazhin e ri, që nga Qielli tek njerëzit në mbarë botën. Emërtimin “Apostuj” ua dha nxënësve të tij, vetë Krishti, siç na tregon Ungjillori Luka: “Kur zbardhi dita i thirri nxënësit e vet dhe prej tyre zgjodhi dymbëdhjetë, të cilët dhe i quajti Apostuj ...” (Luk. 6:13). Jisu Krishti para se të fillonte veprën e tij shpëtimtare, filloi të formonte grupin e nxënësve të tij. Në jetën e tyre personale, ata ishin të thjeshtë, analfabetë, të parëndësishëm, peshkatarë në profesion, por edhe doganierë, por më e rëndësishme është mënyra e përzgjedhjes së tyre. Dëgjuan vetëm një “më ndiq” dhe e ndoqën pas Mesian.

Kujt ia drejtonte Krishti ftesën e tij? Sigurisht jo të gjithëve. Nuk mund të bëhej kushdo nxënës dhe apostull i Tij. Rrethi i parë i nxënësve ishte mjaft i kufizuar. Të paktë ishin ata që do ta ndiqnin kudo. Ata pak, Krishti i zgjodhi vetë. Nuk mund të mos ndalemi tek ftesa që i bëri Krishti Nathanailit. Fjalët: “Ja një izraelit të vërtetë tek i cili nuk ka dredhi” (Joani 1:48), na zbulojnë karakterin e vërtetë të Apostujve. Domethënë ata ishin izraelitë të cilët prisnin Mesinë e vërtetë. Ishin ata, të cilët nga brezi në brez, kishin ruajtur të gjallë shpresën e realizimit të premtimit të Perëndisë (Zanafilla 3:15). Ishin ata të cilët kërkonin të shihnin fakte për tu bindur, se Perëndia e mban premtimin e dhënë. Tek personi i Krishtit ata gjetën atë, të cilin kërkonte dhe priste zemra e tyre.

2- **Sinagogë.** Sinagogat qenë vende të lutjes dhe të faljes ku mbllidheshin judenjtë, kryesisht të shtunave për të kryer adhurimin. Ndërtimi i Sinagogave kishte filluar që nga koha e Babilonisë e vazhdonte deri në kohën e Jisuit. Pikërisht në këto vende lutje, e filloi Jisu predikimin e Mbretërisë së Perëndisë. Çdo sinagogë kishte kryetarin e saj, i cili bënte përzgjedhjen se kush do t’i lexonte shkrimet e shenjta, kujdesej për rregullin dhe pastërtinë etj. Sinagogat ndërtoheshin jashtë qytetit pranë detit ose lumit, me qëllim që ata që do të hynin në to, të bënin pastrimin përpara shërbesës.

24 Edhe vate zër i ati ndë-për gjithë Syrinë, edhe bininë tek ay gjith'ata që kishinë keq, të-përmbajturë prej çdo farë sëmundjesh e mundimesh, edhe të-djallosurë, e të-zënë nga lëngat' e hënësë, e ulogë; edhe i shëroj ata.

1- **Në gjithë Sirinë.** Në gjuhën hebraike ishte Arami dhe grekët quajtën Siri. Në atë kohë ishte një vend shumë i madh.

2- **Prej çdo farë smundjesh.** Mrekullitë e Jisuit qenë duke shëruar të sëmurë, iu falte dritën e syve të verbërve etj. Të gjitha këto i bënte në sajë të fuqisë së tij hyjnore.

25 Edhe i vanë pas shumë gjindje nga Galilea e nga Dhekapoli e nga Jerusalmi e nga Judhea, edhe qe i përtej Jordhanit.

1- **Dekapoli.** Dekapoli gjendej në bregun lindor të Jordanit dhe përbëhej prej dhjetë qyteteve, popullsia e të cilave ishte idhujtare. Më kryesori prej tyre ishte Skithopoli, i cili gjendej në bregun perëndimor të Jordanit.

KREU I PESTË

PREDIKIMI NË MAL

(Luka 6:17-49)

1 Edhe ay kur pa gjindjenë, hipi ndë malt, edhe si ndënji, i erthnë për anë nxënësit' e ti.

1-**Në mal.** Mali ndodhej në afërsi të Kapernaumit. Një natë përpara se të mbante ligjëratën mbi mal, Jisui iu fal Perëndisë (Luka 6,12). Mbi këtë mal, Krishti u thotë dishepujve fillimet e misionit të tij.

2 Edhe atëhere hapi gojën' e ti, e i mësonte dyke thënë,

1- **Hapi gojën.** Fraza “hapi gojën” është një mënyrë të foluri në gjuhën hebraike.

3 Lum të vobektë ndë shpirt; sepse e atyre është mbretëri' e qiejvet.

1- **Të vobektët në shpirt,** janë njerëzit e përlur, të cilët ndonëse e dinë që kanë shumë të meta morale dhe mendore, mbajnë shpresën tek Perëndia dhe do të mundin të hyjnë në Mbretërinë e Qiejve.

4 Lum ata që bëjnë vajë; sepse ata dotë ngushëllonenë.

1- Ata që vajtojnë, jo për pasuritë e kësaj bote, por për të mirat e jetës së përjetëshme. Vajtonjësit janë ata që hidhërohen për mëkatet e tyre.

5 Lum ata që janë të-butë; sepse ata do të trashëgojnë dhenë.

1- Të butët, janë ata të cilët durojnë çdo vuajtje dhe pësim prej të ligut. Të butët janë të pafajshmit dhe zemërmirët.

6 Lum ata që kanë uri e etje për drejtërinë; sepse ata do të nginjenë.

1- Të uriturit për drejtësi, janë ata njerëz që adhuronë e pëlqejnë drejtësinë e Perëndisë. Të uriturit për drejtësi përpiqen për drejtësinë e krishterë.

7 Lum ata që janë të përdëlllyershim; sepse ata dotë përdëllenenë.

1- Të mëshirëshmit, janë ata që bëjnë vepra njeridashëse, qortimin e mëkatit, arsimimin e të paditurit, ngushëllimin e njerëzve në nevojë, durimin e padrejtësive, luten për të gjallët e të vdekurit.

8 Lum ata që kanë zemërë të-qëruarë; sepse ata dotë shohënë Perëndinë.

1- Të qëruarit nga zemra, janë ata njerëz, të cilët e kanë zemrën e qëruar prej çdo lloj mendimi të keq dhe mëkati. Të mirët do ta shohin Perëndinë në sy, ndërsa mëkatarët nuk munden, sepse drita e perëndisë nuk ua hap sytë e shpirtit që të shohin.

9 Lum ata që bëjnë paqtim; sepse ata dotë quhenë bij Perëndie.

1- Ata që bëjnë paqim, janë njerëzit që mundohen të paqësojnë. Profetët e quanin Jisuin *Mbret të Paqes*, sepse me ardhjen e tij, solli paqen në botë.

10 Lum ata që ndiqenë për punë drejtërie; sepse e atyreve është mbretëri' e qiejvet.

1- **Të përndjekurit,** janë ata që vuajnë për drejtësinë e krishterë.

11 Të-lumurë jeni ju, kur t' u çpërnderonjën' e t' u ndjekënë, e të thonë kundrëjsh çdo farë fjale të-keqe me tërremë për punë t' ime. 12 Gëzohi e gazmohi, sepse paga juaj është' e-shumë ndë qiejt; sepse kështu ndoqnë edhe profitëritë që kanë qënë përpara jush.

1- **Të poshtëruarit për shkakun e Zotit,** janë dëshmorët që vdesin për idealet e krishtera.

DISHEPUJT, KRIPË DHE DRITË E BOTËS

(Marku 9:50, Lluka 14:34,35)

13 Ju jeni krip' e dheut; po ndë u prishtë kripa, me se do të kripetë? as për farë gjëje s'vëjen më, përveç të hidhetë jashtë, edhe të shkeletë nga njerëzitë.

1- **Ju jeni kripa e dheut,** iu drejtohet Krishti Apostujve. Kripa nëse priset nuk mund që të kthehet më në gjendjen e mëparëshme, kështu edhe nëse ndonjë nga rrethi i Apostujve largohet prej mësimëve të Krishtit, nuk mund të kthehet më në rrethin e tij. Kjo ndodhi me Judën, i cili e tradhëtoi Jisuin.

14 Ju jeni drit' e botësë. Një qytet që është mbi mal nukë munt të fshihetë.

1- Ju jeni drita e botës, me qëllim që të mësojnë gjithë njerëzit. Ata janë të thirrur nga Krishti që ta rezatojnë dritën kudo.

2- Një qytet mbi mal, ka kuptimin që ata do të jenë gjithnjë në krye dhe nuk mund të fshihen. Ata nuk mund t'i largohen armikut dhe predikimi i tyre do të jetë hapur, që t'i dëgjojë çdo njeri.

15 As nukë ndesnjënë kandilinë, që t'a vënë atë dnënë shinikt, po e vënë mbi kandilert, edhe ndrit mbë gjith' ata që janë ndë shtëpit.

1- Ndririt mbi të gjithë, e ka kuptimin: Apostujt ato që mësuari prej Krishtit nuk do t'i mbajnë për vete, por do t'ua mësojnë të gjithë atyre që i pranojnë këto mësimet.

16 Kështu letë ndritnjë drita juaj përpara njerëzvet, që të shohënë punëtë t' uaj të-mira, e të lavdurojnë Atinë t' uaj që është ndë qiejt.

1- Drita juaj përpara njerëzve, do të thotë që predikimi i Apostujve të bëhet ditën nëpër diell dhe virtytet e tyre të shihen prej gjithë njerëzve, sepse vetëm në këtë mënyrë, ata do të besojnë tek Krishti.

KRISHTI DHE LIGJI

17 Mos kujtoni se erdha të prish nomnë a profitëritë; nuk' erdha të prish, po të mbush.

1- Erdha të prish nomnë, Jisui do të bindë popullin se ligjet e Dhiatës së Vjetër qenë deri në ardhjen e Mesias dhe tashmë zemrat e tyre do të pajisen me virtytet e Krishtera.

18 Sepse me të-vërtetë po u them juve, gjersa të shkonjë qielli edhe dheu, një jotë a një pikë nukë do të shkonjë nga nomi, gjersa të bënenë të-gjitha. 19 Ay pra që të zgithnjë një nga këto

porosit' e vogëla, edhe të mësonjë kështu njerëzitë, i-vogëlë do të quhetë ndë mbretërit të qiejvet; po ay që të bënë e të mësonjë, ky do të quhetë i-math ndë mbretërit të qiejvet. 20 Sepse po u them juve, se ndë mos tepëroftë drejtëria juaj më tepër se ajo e shkronjësvet edhe e Farisenjvet, nukë do të hyni ndë mbretërit të qiejvet.

1- **Nomi.** Jisui nuk erdhi që të prishi ligjin e Dhiatës së Vjetër, por për ta plotësuar atë.

21 Kini dëgjuarë së u është thënë të moçimëvet, “Mos vraç” edhe ay që të vrasë do të jetë fajtuar ndë gjyqt.

1- **Mos vrit.** Në Dekalog është porosia e gjashtë. Gjëja më e çmuar për njeriun është jeta. Vetëm Perëndia ka të drejtë që t’ja marrë jetën njeriut. Kisha jonë thekson se vrasja është një ndër mëkatet më të rënda. Ai që vret ose mendon të vrasë dikë ose veten e tij, kryen mëkatin më të madh ndaj Perëndisë, sepse merr jetën, të cilën na e ka dhënë Perëndia dhe vetëm Ai mund të na e marrë. Gjithashtu fajtorë janë edhe të gjithë ata që vrasin me anë të të tjerëve, si edhe ata që kanë mundësi ta ndalojnë vrasjen dhe nuk e bëjnë. Njerëzit që kanë kryer vrasje ose vetvrasje, kisha nuk i varros si të Krishterë, me përjashtim të rastit kur ata kanë pësuar tronditje të mëdha psikike, përpara aktit të vrasjes.

22 Po unë po u them juve, se kushdo që zëmëronetë mbë kot kundrë vëllajt të ti, do të jetë fajtuar ndë gjyqt; edhe ay që t’i thotë të vëllat, Rrake, dotë jetë fajtuar nde bashkëndënjjet; edhe ay që t’i thotë, i-marrë, do të jetë fajtuar për ndë gjeenët të zjarit.

1- **Vëlla,** e ka kuptimin që të gjithë njerëzit janë bijtë e Perëndisë, pra vëllezër me njeri-tjetrin.

2- **Rake** dhe i **marë** janë fyerjet që përdoreshin prej judenjve. Rake është fjalë siriane dhe ka këto kuptime: i çmendur, i marë, i panxënë etj.

3- **Gjeenët e zjarrit** ishte një fushë në jug të Jerusalemit ku hidheshin trupat e vdekur të njerëzve të gjykuar, si dhe bagëtisë e ngordhura, ku digjeshin që të mos prishej ajri. Kështu me Gehena e zjarrit ungjillori Mathe nënkupton ferrin. Në kohët e hershme aty flijoheshin foshnjat për hir të perëndisë Molek. Fjala Gehena në Dhiatën e Re përdoret 12 herë.

23 Ndë prufsh pra dhurëtinë t'ënde ndë theroret, edhe atje kujtonesh, se yt vëlla diç ka kundrë teje.

1- **Dhuratën tënde**, kuptojmë kafshët ose shpendët që sileshin për tu flijuar. Flija i dorëzohej priftit dhe ky i fundit e therrte mbi terroren që zakonisht ishte në oborrin e tempullit.

24 Ler' atje dhurëtinë t'ënde përpara theroresë, edhe shko e paqtohu më përpara me t'ët vëla, edhe atëhere si të vish bjerë dhurëtinë t'ënde.

1- **Paqtohu me tët vëlla.** Profetët i kushtonin rëndësi më të madhe zemrës së njeriut, se sa flisë. Pra kur je në çastin më të shenjtë, të sjelljes së flisë në tempull, shko e pajtohu me vëllanë tënd (Psallmi 51,17).

25 Ndrequ shpejt me kundrë-gjyqësinë t'ënt, gjersa të jesh mb' udhë bashkë me atë; se mos të apë kundrë-gjyqësi ndë dorët të gjyqtarit edhe gjyqtari të ep ndë dorët të shërbëtorit, e hidhesh ndë burg.

1- **Ndrequ shpejt me kundërshtarin.** Sipas ligjit romak, paditësi kishte të drejtë që ta sillte kundërshtarin përpara gjyqit. Krishti na këshillon që të pajtohemi me kundërshtarin përpara se ai

të dali përpara gjyqit, sepse po vajti aty do t' i nënshtrohet procedurave gjyqësore.

26 Me të vërtetë po të them tyj. Nukë do të dalç andej, gjersa të paguanjç asprën' e funçime.

1- **Aspra** ishte një monedhë romake. Sipas ligjit kur paditësi kërkonte borxhin dhe ky i fundit nuk kishte mundësi që t' ia kthente, borxhliu përfundonte në burg derisa të shlyente borxhin.

2- **Borxh.** Këtu ka kuptim simbolik dhe kuptojmë kur njeriu fyen moralisht vëllanë e tij. Në këtë rast gjyqtari është Perëndia, shërbëtorë janë engjëjt, burgu është ferri, udha deri tek gjyqi është jeta jonë. Duhet që të pendohemi për mëkatet tona, sepse Perëndia do të na hedhi në ferr.

KURVËRIMI

27 Kini dëgjuarë se u është thënë (të moçimëvet), “Mos kurvëronjç.”

1- **Mos Kurvëro** është porosia e shtatë e dekalogut. Martesa bashkon burrin me gruan në një lidhje të shenjtë dhe të pathyeshme, është e nderuar dhe askush nuk lejohet të fyej shenjtërinë dhe pastërtinë e saj. Ai që guxon të poshtëroj nderin familjar, do të gjykohet dhe do të ndëshkohet nga Perëndia. Gjithkush nga ne ndjehet i lumtur dhe krenar, kur familja e tij gëzon një emër të mirë në shoqëri. Në të kundërtën, jemi të dëshpëruar dhe të turpëruar, kur nderi dhe konsiderata e familjes tonë është e diskredituar dhe e njollosur. Sikurse ne kërkojmë nga të tjerët që të respektojnë dhe të nderojnë familjen tonë, kështu edhe për ne është detyrë tepër e rëndësishme dhe e shenjtë që të respektojmë të nderojmë dhe të kujdesemi për familjen e të tjerëve, me qëllim që të mos japim shkas për turpërimin dhe degradimin e familjes. I krishterë i mire, është ai që kujdeset për

jetën, që drejtohet nga Porositë dhe Ligjet e shenjta, në lidhje me frenimin e dëshirave dhe pasioneve negative. Ai që nuk mund të gabojë dhe të bëhet shkelës i Porosive të Perëndisë.

28 Po unë po u them juve, se kushdo që vë re grua me dëshërim, e ka kurvëruar' atë ndë zëmëret të ti.

1- **Kushdo që shikon një grua.** Në Dhiatën e Vjetër, kurvërim ishte kur një burrë shkonte me grua tjetër. Ky akt konsiderohej si mëkat dhe gjykohej. Ndërsa në Dhiatën e Re, mjafton që vetëm me e parë me qëllim të keq një grua, pra pa kryer marrëdhënie, konsiderohet mëkat.

29 Edhe ndë të skandalistë syri yt i-djathtë, nxir-e atë e hidhe prej teje; sepse është më mirë për ty të humbasë një nga copat'e trupit t' ënt, edhe të mos hidhetë tërë trupi yt ndë gjeenët.

1- **Syri yt i djathtë të shpie në mëkat.** Me anën e syrit mund të shohim një grua me qëllim të keq. Kjo e parë drejtohet prej zemrës, pra nga gjendja shpirtërore. Kështu mëkati quhet trupor sepse shpirti kuptohet bashkë me trupin.

30 Edhe ndë të skandalistë dora jote e-djathtë, pre-e atë, edhe hidhe prej teje, sepse është më mirë për ty të humbasë një nga copat'e trupit t'ënt, edhe të mos hidhetë tërë trupi yt ndë gjeenët.

1- **Dora jote e djathtë të çon në mëkat.** Dora vepron që të realizohet dëshira e njeriut. Kështu më mirë të humbasim këtë pjesë të trupit, se sa të biem në mëkat.

DIVORCI

(Matheu 19:3, Marku 10:11,12, Lluca 16:18)

31 Edhe është thënë, se ay që të lëshonjë gruan' e ti, let' i apë asaj kartën' e ndarjes.

1- **Letrën e ndarjes.** Nomi i Moisiut i lejonte hebrenjtë, që kur ta ndanin gruan t' i jepnin asaj *letrën e ndarjes*, me qëllim që të martohej me dikë tjetër. Gruaja nuk gëzonte asnjë të drejtë dhe burri mund ta ndante kur të donte dhe në rastin kur ajo kishte gatuar gjellë jo të shijshme.

32 Po unë po u them juve, se ay që të lëshonjë gruan' e ti, veç për fjalë kurërie, e bën atë të kurvëronjë; edhe ay që të marrë grua të ndarë kurvëron.

1- **Shkel kurorën.** Në kundërshtim me ligjin e Moisiut, Krishti thekson se ai që përzë gruan e tij, shkel kurorën, por edhe ai që martohet me një grua të ndarë e ka shkelur kurorën.

BETIMI

33 Përsëri kini dëgjuarë se u është thënë të moçimëvet, mos bënç be mbë të rrem, po t' i apç Zotit të-betuarat' e-tua.

1- **“Mos bëj dëshmi të rreme”.** I krishteri nuk mashtron, por përherë thotë të vërtetën. Zoti tha: “Unë jam udha e vërteta dhe jeta” (Joan. 14, 6). Perëndia që është e vërteta, e urren dhe përçmon gënjeshtren. Lidhur me këtë çështje, Apostull Pavli u rekomandon të Krishterëve që: “Duke e lënë mënjanë gënjeshtren, secili t' i thotë të vërtetën të afërmit të vet, sepse jemi gjymtyrë njëri me tjetrin” (Efes. 4, 25). Pra është shumë e tmerrshme që njerëz të pandërgjegjshëm të bëjnë dëshmi të rreme në gjykatë, duke mashtruar në lidhje me të

afërmin e tyre. Ne si të krishterë, kemi për detyrë ta respektojmë të vërtetën dhe ta mbrojmë atë.

34 Po unë po u them juve, të mos bëni be fare; as për qiellinë, sepse është fron'i Perëndisë;

1- **Mos u betoni.** Sipas ligjit të Miosiut kur dikush betohej për diçka, konsiderohej si premtim i dhënë. Ndërsa Jisui e ndalon fare betimin.

35 As për dhenë; sepse është vëndi që vë këmbet'e tia; as për Jerusalmnë, sepse është qytet i mbretit të-math.

1- **As për qiellin.** Hebrenjtë nuk e përdornin emrin e Perëndisë, por betoheshin për qiellin.

2- **As për dhenë.** Gjithashtu hebrenjtë betoheshin edhe për dhenë, por Jisui ua ndalon.

3- **As për Jerusalemin.** Hebrenjtë betoheshin edhe për qytetin e shenjtë Jerusalemin.

36 As për kryetë t'ënt të mos bënç be, sepse nukë munt të bënç një qime të-bardhë a të zezë.

1- **As për kokën tënde.** Nuk lejohet betimi as për kokën tënde, sepse nuk je ti krijuesi.

37 Po le të jetë fjala juaj, Po, po; Jo, jo; sepse e-tepëra e këtyreve është nga i-ligu.

1- **Të jetë fjala juaj, Po, po; Jo, jo.** Pra betimi është krejtësisht i ndaluar. Tek (Matheu 26,63) Kryepifti iu drejtua Jisuit: "Pë të bësh be për Perëndinë e gjallë të na thuash nëse je ti Krishti, Biri i Perëndisë".

HAKMARRJA

(Lluka 6:29-30)

38 Kini dëgjuarë se është thënë “Sy ndë vënt të syrit, edhe dhëmp ndë vënt të dhëmbit”.

1- Sy për sy dhe dhëmb për dhëmb”. Ligji hebraik e lejonte hakmarrjen, ndërsa Krishti na këshillon që të falim.

39 Po unë po u them juve, të mos i qëndroni kundër të ligut; po ay që të bjerë tyj një shuplakë ndë nofullët t’ënde të djathtë, kthe-i ati edhe tjatrënë. **40** Edhe ay që do të gjykonetë me ty, e të marrë këmishënë t’ënde, lër’-i ati edhe rrobënë; **41** Edhe ay që të marrë ty angari një mil, ec bashkë me atë dy.

1- Ecë bashkë me të dy. Krishti na meson, që të mos t’i kundërpërgjigjemi të keqes, por të jemi tolerantë.

42 Ep-i ati që lypen prej eje; edhe mos e kthe faqenë mbë nj’anë prej ati që do të huhetë prej teje.

1- Mos refuzo të japësh hua. Krishti na meson, që t’i gjendemi njeri-tjetrit dhe ta ndihmojmë.

DASHURIA PËR TË AFËRMIN

(Lluka 6:27-28, 32-36)

43 Kini dëgjuarë se është thënë, “Të duash të afërminë t’ënt, edhe t’i kesh mëri armikut t’ënt. Po unë po u them juve.

1-Të duash të afërmim tënd. Ligji hebraik nënkuptonte vetëm hebreun me hebreun si të afërm, ndërsa njerëzve të tjerë nuk duhej që t’u bëje mirësi.

44 Doni armiqhtë t’uaj, bekonj ata që u mallëkomënë juve, bëni mirë a’yre që u kanë mëri uve, edhe fali për ata që u bëjnë keq e u djekënë juve;

1-Doni armiqhtë tuaj. A është e lehtë që të duash armiqhtë? Natyrisht që jo. Por “të pamunduratur për njerëzit janë të mundura për Perëndinë” (Lluk.18, 27). Le të kujtojmë Krishtin në momentin e kryqëzimit dhe do të shohim se dashurinë që predikoi, e zbatoi vetë i pari. Mbi Kryqin e martirizimit shtriu duart duke përfaqëuar gjithë njerëzit, madje edhe armiqhtë e Tij. Ai nuk u mjaftua vetëm me kaq, por u lut për ata që e kryqëzuan dukë thënë : “O Atë, fali se nuk dinë se ç’bëjnë” (Lluk 23, 34). Le të ndjekim edhe ne shembujt e dashurisë së vërtetë, duke dashur të gjithë botën, ashtu siç e dëshiroi Ati Qiellor.

2- Bekoni ata që u mallkojnë. Krishtërimi na mëson se të gjithë njerëzit janë vëllezër dhe të barabartë përpara Perëndisë. Në nëntë Porositë e para, Perëndia na ndalon që të mos kryejmë veprime të liga, ndërsa në Porosinë e fundit, nuk na lejon edhe ta mendojmë dhe ta dëshirojmë të keqen. Kjo gjë na urdhërohet për faktin, sepse njeriu në fillim e mendon dhe e dëshiron të ligën, e më pas kryen veprimin. Gjithsesi ai që kujdeset për mendimet, dëshirat dhe zemrën e tij që të jenë përherë të pastra dhe larg së ligës, kurrë nuk do të dëshiroj të kryej një veprim mëkatar. Për këtë gjë Apostull Jakovi thotë: “Secili tundohet i udhëhequr dhe i mashtruar nga lakmia e vet. Pastaj lakmia pasi mbarset, pjell mëkatin dhe mëkati, si të kryhet, ngjiz vdekjen” (Letra e Jakovit 1, 14-15).

3- Falini ata që u bëjnë keq. Vetëm duke falur fajtorët tanë, ne mund t’i largohemi veprimit të padëshiruar të mëkatit dhe të së keqes, duke jetuar një jetë të qetë dhe të pastër, pa dëmtuar askënd, pa pasur zili dhe pa u rrëmbyer nga veprimet e liga. Në këtë mënyrë, ne do të jetojmë të gëzuar dhe të lumtur brenda shoqërisë. Do ta kemi ndërgjegjen e pastër, sepse nuk kemi bërë ligësi kundrejt të afërmit tonë.

45 Që të bëhi bij Atit t'uaj që është ndë qiejt sepse ay bën djellin' e ti të lintnjë mbi të-liq e mbi të-mirë, edhe lëshon shinë mbi të-drejt' e mbi të-shtrëmbërë.

1- Dielli lind për të mirët e të ligjtë. Perëndia nga dashuria që ka për njerëzit, e lëshon diellin për të drejtët dhe mëkatarët, kështu edhe ne duhet që të falim fajtorët tanë. Gjithkush nga ne tërhiqet nga e liga. Më pas dëshira e keqe lind mëkatin dhe veprimin e padrejtë, i cili kur vihet në zbatim, sjell vdekjen dhe dënimin e përjetshëm.

46 Sepse ndë daçi ata që u duanë juve, ç'far page kini? a nukë bëjnë këtë edhe kumerqarët? 47 Edhe ndë përshëndofshi vetëmë vëllezëritë t' uaj, çmë tepërë bëni? a nukë bëjnë kështu edhe kumerqarët? 48 Bëhi pra ju të-sosurë sikundër Ati j-uaj që është ndë qiejt është' i-sosurë.

1- Bëhuni të sosurë sikundër Ati. Nëse dëshirojmë që të jetojmë si të krishterë të mirë dhe të virtytshëm, është e domosdoshme që të tregojmë shumë kujdes, me qëllim që mendjen dhe zemrën tone, t'a ruajmë të pastër nga mendimet dhe dëshirat e liga dhe të jemi të pastër, siç është Ati ynë Qiellor.

KREU I GJASHTË

LËMOSHA

1 Shikoni të mos bëni eleimosinënë t'uaj përpara njerëzet, që të shiheni nga ata; ndë mos, nukë keni pagë përënë Atit t'uaj që është ndë qiejt. 2 Kur të bënjç pra eleimosinënë, mos vërshëlënjç përpara teje, sikundrë bëjnë ipokritëritë ndëpër sinagogjit e ndëpër udhët, që të lavduronenë nga njerëzitë; me të vërtetë po u them juve, se ata e kanë marrë pagën' e tyre. 3 Po ti kur të bënjç eleimosinënë, le të mos e marrë vesh e-mëngjëra jote se ç bën e-djathta jote; 4 Që të jetë eleimosina jote fshehurazi; edhe yt'Atë që sheh fshehurazi, ay do të t'a çpaguejë tyj faqeza.

1- Kur të japër lëmoshë të mos vërshëllesh. Këtu e ka kuptimin se hebrenjtë kur përfundonin lutjet e gjata shfrynin. Ata luteshin në sinagogji dhe nëpër rrugë, që të dukeshin nga njerëzit. Në rastin që po analizojmë, ungjillori na thotë që kur të japim lëmoshë, të mos dukemi nga të tjerët për bamirësinë që bëme.

2- Të mos e marrë vesh e majta se ç'dha e djathta. Kjo është një hiperbolë, e cila na bën të kuptojmë se lëmosha duhet të jetë tepër e fshehtë dhe jo për t'u dukur.

LUTJA

5 Edhe kur të falesh, mos jesh posi ipokritëritë; sepse ata duanë të falenë dyke ndënjurë ndëpër sinago gjit e ndëpër sinago gjit e ndëpër çipet të rrugavet, që t’u dukenë njerëzet; me të-vërtetë po u them juve se ata e kanë marrë pagën e tyre.

1- **Mos jesh si hipokritët.** Hebrenjtë orët e lutjes në tempull i kishin të përcaktuara. Kështu në orën 9, 12 dhe 15 tempulli ishte i mbushur plot me judenj. Farisenjtë duke u falur më këmbë dhe me gjeste gjenin rastin për t’u dukur përpara popullit, që vetëm ata qenë të drejtë përpara Perëndisë.

6 Po ti kur të falesh, hyrë ndë dhomët t’ënde, edhe mbyll derënë t’ënde, e iu fal t’ yt Et që është ndë të-fshehëtë: edhe yt Atë që sheh fshehurazi, do të t’a paguanjë tyj faqeza.

1-**Kur të lutesh.** Besimtari duhet të lutet jo vetëm njëherë, por shumë herë ashtu siç na mëson edhe Apostull Pavli në letrën e tij dërguar Selanikasve: “Lutuni pa pushim”. Lutja është shpëtimi jonë, përikja e jetës sonë, ruajtësi i shpirtit tonë. Le të lutemi pra me besim të pandërprerë e të jemi të sigurt se çdo gjë do të na jepet.

2-**Hyrë në dhomën tënde.** Krishti kur lutej shkonte në ndonjë mal me qëllim të gjente qetësinë e shpirtit. Prandaj na këshillon që kur të lutemi të hymë në dhomën tonë dhe të kërkojmë përdëllimin e Perëndisë.

7 Edhe kur të faleni, mos thoni fjalë të-tepëra, posi gjindarëtë; sepse pandehnjënë, se me fjalët’ e-shumta të tyre do të dëgjonenë. 8 Mos u gjani pra atyre; sepse Ati juaj e di për ç’gjë kini nevojë, para se të lypni juve prej ati.

1- **Mos thoni fjalë të tepërta.** Këtu e ka kuptimin që lutja të jetë sa më e thjeshtë, me fjalë të pastra dhe të kuprueshme.

URATA ZOTËRORE

(Lluka 11:2-4)

9 Po ju faluni kështu: Ati ynë që je ndë qiejt, u shënjtëroftë emëri yt;

1- Po ju faluni kështu. Urata Zotërore në Shkrimin e Shenjtë përmendet në dy forma. Në ungjillin sipas Matheut 6: 9-13 kemi formën e gjatë dhe në ungjillin sipas Llukes 11: 2-4 kemi formën e shkurtuar. Një gjë është e qartë, që kjo lutje është thënë nga vetë goja e Krishtit, por se në cilin variant atë nuk mund që ta vërtetojmë.

2-Ati ynë që je në qiejt. Këto fjalë me anë të të cilave thërrasim emrin e shenjtë të Atit dhe Perëndisë të gjithëfuqishëm, përbëjnë epilogun e Lutjes Zotërore. Së pari ne pohojmë me bindje të plotë se Perëndia është Ati dhe Krijuesi ynë. Ai na krijoi nga asgjëja dhe na dhuroi jetën që të jetojmë dhe të gëzojmë së bashku me Krijuesin. Së dyti e thërrasim dhe e pohojmë Atin tonë Perëndi, sepse jo vetëm na krijoi nga asgjëja dhe na dha ekzistencën e jetës, por na ofroi mundësinë që në fillim për t' u bërë fëmijë dhe trashëguesit e Mbretërisë së Tij, nëpërmjet Zotit tonë Jisu Krisht, me anë të të cilit ne rilindim dhe bëhemi fëmijë të Perëndisë Atë. Perëndia është prezent kudo dhe i plotëson të gjitha.

3- U shënjtëroftë emëri yt. Cili është Emri i Perëndisë? Ai është i të njëjtit Perëndi, i cili gjithçka e krijoi nga zeroja dhe që na u zbulua ne të krishterëve me anë të Jisu Krishtit, si Perëndia Atë, prej të cilit lindi Biri dhe buron përjetësisht Shpirti i Shenjtë. Për këtë çështje Zoti thotë: “Unë ia kam treguar emrin tënd njerëzve” (Joani 17, 6). Perëndia sipas natyrës së Tij është i Shenjtë. Ne kur urojmë që të shënjtërohet emri i Perëndisë nuk kuptojmë që të bëhet Perëndia i Shenjtë, por këtë gjë e dëshirojmë që të bëhet e njohur tek të gjithë njerëzit, si edhe të dinë që ta adhurojnë dhe ta lavdërojnë. Urojmë që emri i Perëndisë, shënjtërimi, ligjet dhe dëshira e Tij, të bëhen të

njohura që të adhurohet dhe respektohet nga të gjithë. Pra ne nuk urojmë thjeshtë që të shenjtërohet, por që të bëhet e ditur dhe të lavdërohet nga të gjithë ne, emri i tërëshenjtë i Perëndisë.

10 Arthtë mbretëria jote; u bëftë dashurimi yt, si ndë qiell, edhe mbë dhet;

1-**Arthtë mbretëria jote.** Duke thënë “ardhtë mbretëria Jote”, ne urojmë që të mbizotëroj mbretëria e tretë dhe e katërt e Perëndisë, d.m.th të paraqesë Ungjillin e Tij tek të gjithë njerëzit për t’i shenjtëruar dhe mbretëruar në shpirtet dhe zemrat tona, me qëllim që të drejtohem i përherë në zgjedhjen e së mirës dhe të vityteve. Së fundi urojmë që të na denjësojë, sikurse ne dëshirojmë të përjetojmë dhe të shijojmë lavdinë hyjnore dhe madhështinë e mbretërisë së përjetshme.

2- **U bëftë dëshira Jote,** Urimi i tretë është shpjegimi i dy pjesëve të mëparshme. Të tre këto urime, përbëjnë një zinxhir të pandarë, sepse është e kuptueshme, kur emri i Perëndisë lavdërohet nga të gjithë, si dhe kur mbretëria shpirtërore vjen në tokë, në këtë moment bëhet dëshira e Tij, e cila do të mbizotërojë në të gjithë njerëzit. Kjo do të ndodhë se mbretëria e Perëndisë ka ligje, në bazë të së cilave qeverisen të krishterët. Këto ligje janë dëshira e Perëndisë, të cilën na e zbuloi Biri i mishëruar dhe Fjala e Tij, Zoti ynë Jisu Krishti.

3- **Si në qiell ashtu edhe mbi dhe.** Urojmë dhe kërkojmë që dëshira e Perëndisë të përfshijë gjithçka që ndodhet në tokë, sikurse ndodh në qiell tek ëngjëjt dhe shpirtet e shenjta. Me fjalë të tjera kërkojmë që nëpërmjet kësaj dëshire të mbizotërojë në tokë me çdo mënyrë dëshira e Perëndisë, me qëllim që njerëzit të dëshirojnë të qeverisen vetëm nga një dëshirë, nga ajo e Perëndisë.

11 Bukënë t’ënë të përditëshmen’ ep-na neve sot;

1- Bukën tonë të përditshme Me anë të kësaj lutje kërkojmë nga Ati ynë që të na jap ne, vëllezërve tanë dhe të gjithë njerëzve, bukën, për të cilën kemi aq shumë nevojë për të mbijetuar. Çfarë kuptojmë me “të përditshme”? Sipas esencës dhe përbërjes tonë, buka e përditshme është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme për të jetuar trupërisht. Zoti ynë Jisu Krishti na thotë se është e nevojshme që të kemi për t’u ushqyer, por kjo të bëhet me shumë maturi dhe vetëpërmbytje.

2- Jepna neve sot. Ne nuk kërkojmë që të kemi bukë për gjithë jetën, por për “sot”. E ardhmja jonë është e padukshme, por duke pasur besim tek Perëndia, këtë shqetësim njerëzor ja lemë përkujdesjes së Tij. Asnjëherë nuk duhet të jemi në agoni dhe të përpiqemi me mjetet njerëzore, për të siguruar të mirat materiale, por duhet të kujdesemi se si mund të jemi të virtytshëm dhe të dashur për Perëndinë, ku padyshim Ai do të na japë çdo gjë që ne kemi nevojë.

Njeriu nuk përbëhet vetëm nga trupi, por edhe nga shpirti dhe për rrjedhojë ai nuk ka vetëm nevoja materiale, por edhe shpirtërore. Në Shkrimin e Shenjtë, Zoti e quan veten si “buka e jetës”. Ai thotë: “Unë jam buka e jetës. Etërit tuaj hëngrën *mana* në shkretëtirë dhe vdiqën. Kjo është buka që zbret nga qielli, që një mund të hajë e të mos vdesë” (Joani 6, 48-50). Me anë të kësaj lutje, ne kërkojmë ushqimin më të domosdoshëm material dhe shpirtëror, Zotin tonë Jisu Krisht, Trupin dhe Gjakun e Tij të tërëshenjtë që transmetohet tek ne nëpërmjet Kungimit. Ashtu sikundër kemi çdo ditë nevojë për ushqimin trupor, kështu e njëjta gjë ndodh edhe me atë shpirtëror. Ne mund të kungohemi për çdo ditë po të dëshirojmë, por e rëndësishme është që të jemi të pastër dhe të falur nga çdo mëkat i bërë.

12 Edhe fal-na fajetë t'anë, sikundër edhe neve u'a falimë fajtorëvet t'anë;

1- **Dhe falna fajet tona.** Gjithkush nga ne është mëkatar, dhe për këtë arsye kemi nevojë për mëshirën e Perëndisë. Ne kërkojmë nga Ati ynë i tërëshenjtë që të na i falë mëkatet që ne kryejmë për çdo ditë me fjalë, me vepra si edhe me dëshirat e liga. Që Perëndia të na falë, është e dobishme që më parë të tregojmë pendimin tonë për gjithçka të keqe që kemi bërë. Perëndia na ka krijuar që të zbatojmë vullnetin e Tij dhe të trashëgojmë jetën e përjetshme. Kur ne e shkelim ligjin e Perëndisë, biem në mëkat dhe për këtë arsye, duhet që të pendohemi sinqerisht dhe të kërkojmë falje.

2- **Sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë.** Njëkohësisht me lutjen për faljen e mëkateve tona, pohojmë gjithashtu nga zemra edhe për faljen që ne i bëjmë të tjerëve. Pohojmë se nuk mbajmë mëri dhe nuk gjykojmë askënd. Nëse dëshirojmë që Perëndia të na i falë mëkatet, është mëse e domosdoshme që edhe ne t'ua falim fajtorëve tanë. Lidhur me këtë Apostull Pavli thotë: "Jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njeri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin. Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe na e dha veten e tij për ne, si ofertë e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë" (Efesianëve 4, 32. 5, 1-2). Pra të mësohemi që të jemi të durueshëm, ndaj të gjithë atyre që na bëjnë padrejtësi, duke e treguar edhe me anë të veprave, se doktrina e Ungjillit rreth dashurisë ka nxitur realisht zemrën tonë.

13 Edhe mos na shtjerë ndë ngasje, po shpëto-na nga i-ligu; sepse jotja është mbretëria e fuqia e lavdia ndë jetët të jetëvet; Amin.

1- **Dhe mos na shtjer në ngasje.** Kujtimi dhe ndjenja e mëkateve të përparshme, na bëjnë që të kemi më shumë kujdes në

jetën tonë. Vazhdimisht kërkojmë nga Perëndia që të mos na shtjerë në ngasje dhe t'i largohemi qëllimit final. "Ngasje" quhet çdo gjë e cila ngacmon, d.m.th provon besimin dhe bindjen që ka njeriu tek Perëndia. "Ngasje" quajmë edhe dinakërinë e djallit, sepse ai përherë përpiket dhe na nxit, që të mos e zbatojmë vullnetin e Perëndisë, por të kryejmë vepra të liga.

2- **Po shpëtona nga i ligu.** Fjala "i ligu" ka kuptimin e mëkatit. Apostulli Petro thotë se: "djalli sillet rreth e qark si një luan vrumbullues, duke kërkuar cilin mund të përpijë" (Letra e I. e Petros 5, 8). Pra i lutemi Perëndisë, që të na ruaj nga i ligu, si edhe nga çdo mëkat e çdo gjë tjetër e keqe. Gjithashtu i kërkojmë që të na ruajë nga kurthet e djallit, që mundohet të na tërheqi drejt mëkatit duke na larguar nga Perëndia. I lutemi Perëndisë që të forcojë dobësitë tona, nëpërmjet hirit hyjnor. Përgjegjësi në këtë drejtim kemi edhe ne, sepse duhet të bëjmë shumë kujdes, me qëllim që mos të biem pre e tundimeve dhe në rast se kjo ndodh, duhet që të rrëfëhemi me sinqeritet të lartë dhe të kërkojmë mëshirë dhe falje nga Perëndia. Falja mundësohet vetëm rastin kur kërkohet me besim, shpresë dhe dashuri Perëndie.

3- **Se jotja është mbretëria, fuqia dhe lavdia në jetë të jetëve.** Epilogu i lutjes Zotërore na mëson tre gjëra të rëndësishme: Se Perëndia është mbreti i botës, i plotfuqishmi i Gjithësisë, dhe se lavdia e Tij është e pafundme dhe e përjetshme.

Përse kërkojmë nga Perëndia realizimin e kërkesave të lutjes Zotërore? Kjo bëhet për faktin se veçoria e Tij është mbretëria, e cila pohohet në epilog. Ai është mbreti dhe zotëruesi i Gjithësisë, i botës së dukshme dhe asaj të padukshme. Gjithashtu kërkojmë nga Perëndia të lartat, sepse vetëm Ai ka fuqi dhe pushtet mbi çdo gjë. Si i plotfuqishëm dëshiron që lutjet dhe kërkesat e fëmijve të Tij, t'i plotësojë me të gjithë forcën e pushtetit të përjetshëm. Pohojmë se Perëndia si rezultat i përsosmërisë së Tij të përjetshme dhe është e

drejtë që të lavdërohet, të nderohet dhe të lartësohet përherë në jetë të jetëve.

4-Fjala “**Amin**” është ndajfolje në gjuhën hebraike dhe do të thotë “me të vërtetë, sigurisht”. Kështu në lidhje me ato që thuhet në epilog, pohojmë se realisht, me të vërtetë dhe sigurisht pranojmë se mbretëria, fuqia dhe lavdia i përkasin vetëm Perëndisë Triadike, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në jetë të jetëve.

KUSHTI PËR FALJEN NGA PERËNDIA

14 Sepse ndë u’a falçi njerëzvet fajet’ e atyre, dot u’a falnjë edhe juve Ati juaj qiellori. 15 Po ndë mos u’a falçi njerëzvet fajet’ e atvres, as Ati juaj nukë dotë falnjë fajetë t’uaj.

1-Falja. “Nëse doni të udhëtoni drejt Mbretërisë së Qiejve duhet që t’i falni të gjithë, sepse falja është çmimi më i madh.” Falja është dhurata më e mirë për Perëndinë, sepse edhe vetë Krishti, përpara se të sakrifikohej në Kryq, i fali të gjithë armiqtë e tij. Nëse do të mendojmë edhe pak më thellë do të kuptojmë se ia vlen që t’ua falim të gjitha fajtorëve tanë, sepse edhe Perëndia do të na përdëllejë neve duke na i falur fajet tona ndaj të tjerëve. Njeriu që fal është i paqtuar me të gjithë dhe mund t’i shohi të gjithë në sy.

ARGJËRIMI

16 Edhe kur të agjëroni, mos bëhi të-vrerëtë, posi ipokritëritë; sepse ata prishnjënë fytyrat’e tyre, që të dukenë ndër njerëzit se agjëronjënë. Me të-vërtetë po u them juve, se ata e kanë marrë pagën’e tyre. 17 Po ti kur të agjëronjç, lyej kryetë t’at, edhe laj fytyrënë t’ënde; 18 Që të mos dukesh ndë njerëzit se agjëron, po tek yt Atë, që është ndë të-fshehëtë; edhe yt Atë që sheh fshehurazi, dotë t’a çpaguanjë tyj faqeza.

1-**Kreshma** siç e dimë u afirmua nga vetë Perëndia. Në Dhiatën e Re, i pari ishte vetë Krishti, që kreshmoi për 40 ditë dhe në vazhdim filloi predikimin e Tij shpëtimtar në tokë. Por edhe nga Dhiata e Vjetër dimë se Profeti Moisi përpara se të merrte 10 Porositë nga Perëndia në Malin Sina, kreshmoi për 40 ditë. Sipas etërve të kishës, kreshma frenon pasionet, forcon njeriun shpirtërisht, nënshtron dhe dëbon demonët, jep pendim, ndriçim dhe pastërti në shpirt.

2- **Të mos dukeni përpara njerëzve që kreshmoni.** Hebrenjtë kishin të hënën dhe të enjten si ditë kreshmimi. Pikërisht gjatë këtyre ditëve farisenjtë nuk laheshin dhe kriheshin me qëllim që të binin në sy të popullit që kreshmonin.

THESARI

(Lluka 12:30-34)

19 Mos mblithni thesarë për vetëhenë t'uaj mbë dhet, ku krimbi edhe ndryshku i prish, edhe ku vjedhësit rëmojn' edhe vjedhënë; 20 Po mblithni thesarë për vetëhenë t'uaj ndë qiell, ku nuk' i prish as krimp as ndryshk, edhe ku vjedhësitë nukë rëmojn' as vjedhënë. 21 Sepse tek është thesari juaj; atje do të jetë edhe zëmëra juaj.

1-**Mos mblidhni thesarë.** Në këtë rast Krishti nuk është kundër pasurisë, sepse vetë ai kishte miq të pasur. Ai nuk kërkon prej të pasurve që ata të shesin pasurinë dhe të vuajnë, por i këshillon që të ndihmojnë njerëzit në nevojë. Në Dhiatën e Vjetër të pasur kanë qenë Abrahami, Jovi etj, të cilët ndonëse qenë pasanikë ndihmonin ata që vuanin.

2-**Mblidhni thesarë në qiell.** Thesarët e judenjve qenë rrobat e reja dhe të ndritshme, zbukurime të ndryshme prej diamanti, floriri etj. Krishti na këshillon se këto janë gjëra tokësore dhe të përkohshme,

sepse rrobat i ha krimbi dhe metalet i konsumon ndryshku, ndërsa diamantët dhe florinjët, na i vjedhin keqbërësit. Të krishterët me anën e veprave të mira që bëjnë, do të kenë thesare në qiell, atje ato do të jenë të përjetshme.

KANDILI I TRUPIT

(Luka 11:33-36)

22 Kandil' i trupit është syri; ndë qoftë pra se syri yt është' i kthjellëtë, gjithë trupi yt do të jetë i-ndriçim; 23 Po ndë qoftë se syri yt është' i-lik, gjithë trupi yt do të jet' i-errëtë. Ndë qoftë pra se drita që gjëndetë te ti është' errësirë, errësira sa e madhe do të jetë?

1-Syri. Syri i të krishterit duhet që të jetë i pastër. Këtu e ka kuptimin për sytë e shpirtit. Ndërgjegjja e njeriut quhet ndryshe edhe syri i brendshëm, sepse është ajo që na bën të shohim vetëm gjëra të mira.

PERËNDIA DHE PARATË

(Luka 16:13)

24 Asnjë s'munt t'u shërbenjë dy zotërinjve; sepse a njërit do t'i ketë mëri, edhe t'atrinë do t'a dojë; a njërit do t'i ngjitetë prapa, edhe t'atërit do t'i kthenjë krahëtë. Nukë munt t'i shërbeni Perëndisë edhe Mammonajt.

1-Nuk mund t'i shërbeni dy zotërinjve. Njeriu nuk mund që ti shërbejë edhe Perëndisë edhe Mammonait, pra e ka kuptimin e parasë. Letrën e parë e Jakovit (3-4), na këshillon: "Ju kërkoni dhe nuk merrni, sepse kërkoni keqaz që të shpenzoni për kënaqësitë tuaja. O shkelës dhe shkelëse të kurorës, a nuk e dini se miqësia me botën

është armiqësi me Perëndinë? Ai, pra që don të jetë mik i botës bëhet armik i Perëndisë”.

ANKTHI PËR JETËN

(Lluka 12:22-34)

25 Përandaj po u them juve, mos mendohi për jetënë t’uaj, ç’të hani a ç’të pini; as për trupinë t’uaj ç’të vishni; a nuk’ është jeta më e nderçime se ushqimi, edhe trupi se të-veshuritë? **26** Vështroni shpest’e qiellit, se nukë mbjellënë, as nukë korrnjënë, as nukë mbledhënë ndë grunarë, edhe Ati juaj qiellori i ushqen; a nukë ndani ju më tepërë se ata? **27** Po cili nga ju dyke pasurë kujdes munt të shtonjë një kut ndë shtat të ti? **28** Edhe ç’mendoni për të-veshuritë? Vështroni lulet’e arësë, si rritenë; as mundonenë, as dredhënë. **29** Po u them juve, se as Sollomoni me gjithë lavdin’ e ti nukë qe veshurë posi një nga këto. **30** Po ndë qoftë se barin’e arësë, që sot është, e nesërë hidhetë ndë furrë, Perëndia e vesh kështu, nukë do t’ u veshnjë juve shumë më tepërë, o besë-pakë? **31** Mos mentohi pra dyke thënë, ç’të hamë a ç’të pimë a ç’të veshimë? **32** Sepse gjithë këto i kërkojnë kombetë; sepse Ati juaj qiellori e di, se keni nevojë për gjithë këto. **33** Po kërkonti më përpara mbretërin’ e Perëndisë, edhe drejtërin’ e ati; edhe këto të-gjitha do t’u shtonenë juve. **34** Mos mendohi pra për të-nesërmenë; sepse e-nesërmja do të ketë mendim për punët’ e saja; mjaft është mbë çdo ditë e-keqeja e saj.

1- Mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij. Epiqendra e përmbajtjes së Ungjillit të Shenjtë është Mbretëria e Qiejve. Me predikimin e Mbretërisë e filloi Jisui predikimin e Tij pas pagëzimit dhe ngasjeve. Në ungjill thuhet: “Pendohuni sepse u afruan ditët kur do të vijë mbi tokë Mbretëria e Qiejve” (Matheu 4, 17). Për të hyrë

në Mbretërinë e Re duhet të pendohemi, duke lënë pas jetën tonë mëkatore dhe të ndryshojmë rrugë. Të gjithë ne, kush më shumë dhe kush më pak kemi rënë në mëkate, por tashmë na jepet rasti për pendesë, që do të thotë të ndryshojmë mendjen dhe jetën tonë.

2- **Të gjitha do t'u shtohen.** Mbretëria e Perëndisë është ardhja e Shpirtit të Shenjtë në zemrat tona. Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti e ka thënë qartë: “Mbretëria e Perëndisë ndodhet brenda jush” (Lluka 17, 21). Me këtë na jep të kuptojmë se kur njeriu e lejon Shpirtin e Shenjtë të banojë brenda tij, pastrohet nga pasionet dhe gjen udhën e vërtetë, e cila do ta shpie drejt Perëndisë. Gjithashtu në lutjen drejtuar Shpirtit të Shenjtë “O mbret Qiellor” themi:”Eja dhe qëndro brenda në zemrën tonë dhe pastrona nga çdo mëkat dhe shpëto shpirtrat tanë”.

KREU I SHTATË

GJYKIMI

(Lluka 6:37,38,41,42)

1 Mos gjykoni, që të mos gjykoneni;

1-Mos gjykoni. Këtu e ka fjalën për gjyqin që i bëjnë njerëzit njeri-tjetrit, duke folur keq, pa pasur fakte. Këtë gjykim na ndalon Jisu Krishti dhe jo gjykimin që bëhet nga ana e gjykatës për fajet e kryera. Krishti kritikon farisenjtë, të cilët me mëndjemadhësinë e tyre gjykonin të tjerët.

2 Sepse me ç'farë gjyqi gjykoni, do të gjykoneni; edhe me ç'farë matësi matni, do t'u matet edhe juve.

1-Me çfarë gjyqi gjykoni. Tek hebrenjtë ishte zakon që nëse kishin qenë të mëshirshëm në gjykimin tyre atëherë edhe Zoti qe i mëshirshëm me ta.

3 Edhe përse shikon lëmishtenë që është ndë syt të t'yt vëllaj, edhe tranë që është ndë syt t'ënt nuk'e ndjen? 4 A si do t'i thuash t'yt vëllaj, le të nxjer lëmishtenë nga syri yt, edhe ja trari tek është ndë syt t'ënt? 5 Ipokrit, nxir më përpara tranë nga syri yt, edhe atëhere do të shohç mirë të nxjerç lëmishtenë nga syri i t'yt vëllaj.

1-Ka njerëz të cilët flasin me passion për të metat e të tjerëve dhe nuk shikojnë veten e tyre.

MARGARITARËT DHE DERRAT

6 Mos u'a epni gjën'e shënjtëruarë qenvet; as mos hithni margaritarëtë t'uaj përpara derravet, se mos i shkelnjën' ata me këmbët' e tyre, edhe pastaj kthenen' e u çqyenjën' edhe juve.

1- **Mos ua hidhni margaritarët tuaj derrave.** Derrat kanë qenë kafshë të ndyta për hebrenjtë, madje ata nuk e hanin mishin e tyre. Kështu edhe Krishti bën krahasimin që margaritarët kur ua hedhim derrave, ata pasi nuk ua dinë vlerën i shkelin me këmbë. Kuptimi alegorik i kësaj shprehje është që të mos ua japim gjënë më të shtrenjtë që kemi, pra besimin të pabesëve. Krishti na këshillon që të mos flasim me ta për çështje të besimit.

PLOTËSIMI I KËRKESAVE TË LUTJES

(Luka 11:9-13)

7 Lypni, edhe do t' u epetë juve; kërkoni edhe do të gjeni; trokollini, edhe do t' u hapetë juve; 8 Sepse kushdo që lypën merr, edhe ay që kërkon gjën, edhe ati që trokollin do t' i hapetë. 9 A cili është' ay njeri nga ju, i-cili, ndë lyptë i biri bukë, do t' i apë ati gur? 10 Edhe ndë lyptë peshk, mos do t' i apë ati gjarpër? 11 Ndë qoftë pra se ju që jeni të-liq dini t' u epni të-dhëna të mira bijvet t' uaj, sa më tepërë Ati juaj që është ndë qiejt do t' u apë të-mira atyre që lypëjnë nga ay?

1- **Lutuni.** E jo vetëm njëherë, por shumë herë ashtu siç na mëson edhe Apostull Pavli në letrën e tij dërguar Selanikasve: “Lutuni pa pushim”. Lutja është shpëtimi jonë, përikja e jetës sonë, ruajtësi

i shpirtit tonë. Le të lutemi pra me besim të pandërprerë, e të jemi të sigurt se çdo gjë do të na jepet.

LIGJI I ARTË

12 Gjithë sa të doni pra t’u bëjnë juve njerëzitë, kështu bëni edhe ju atyre; sepse ky është nomi edhe profitëritë.

1- **Sikundër doni të sillen ndaj jush njerëzit e tjerë.** Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti na dha një kanon të përsosur, i cili është cilësuar si “Kanon i artë i dashurisë”. Ky kanon duhet të zbatohet tek të gjithë njerëzit pa përjashtim, sepse ky ligj i dashurisë ekziston brenda nesh. Zëri i dashurisë kumbon në çdo shpirt njerëzor dhe na thërret të mos bëjmë padrejtësira, të mos çenojmë pronën e tjetrit, të mos shpifim e gënjejmë etj.

2- **Ashtu duhet të silleni edhe ju ndaj tyre.** Këto janë pra porositi e Kanonit të artë të dashurisë, por ky ligj nuk mbaron deri këtu, ai shkon edhe më tutje dhe na thotë se nuk mjafton vetëm të mos bëjmë të këqija, por t’u bëjmë të mira të tjerëve. Ti ndihmojmë ata kur janë në nevojë me sa kemi mundësi, materialisht dhe shpirtërisht, me përshëndetje të përzemërt dhe sjellje miqësore. Të ngushëllojmë të hidhëruarit dhe të vizitojmë të sëmurët e të përkujdesemi për të moshuarit. Duke marrë pjesë në gëzimet dhe hidhërimet e të tjerëve, do të bëhemi të krishterë të vërtetë, respektues të kanonit të artë të dashurisë.

3- **Sepse ky është nomi.** Kanoni i dashurisë dhe mirësjelljes është ligj i përgjithshëm. Të gjithë duhet të jemi të drejtë dhe të mos dëshirojmë të keqen e askujt. Atë që nuk duam të na bëjnë të tjerët, le të mos ua bëjmë edhe ne të tjerëve. Pra nëse nuk duam të na gënjejnë dhe mashtrojnë atëhere nuk duhet të gënjejmë e të mashtrojmë edhe ne të tjerët. Nëse nuk duam të na akuzojnë e të shpifin për ne, atëhere të mos akuzojmë e të mos shpifim për të tjerët. Kur tregohemi të

drejtë atëhere ndërgjegjen e kemi të qetë dhe e bëjmë jetën tonë të bukur. Krishti erdhi në botë për të plotësuar ligjin moral dhe për të zgjeruar kufinj të dashurisë. Por dashuria nuk duhet kufizuar vetëm tek ata njerëz që i duam dhe na duan. Ajo duhet të shpërndahet njësoj ndaj të gjithëve edhe ndaj mëkatarëve ose atyre që i konsiderojmë si armiq.

DERA E NGUSHTË

(Luka 13:24)

13 Hyni ndëpër derët të-ngushtë; sepse e-gjerë është dera, edhe e-hapët udha që shpie ndë humbjet, edhe shumë veta jan'ata që hyjnë ndëpër atë. 14 Sepse e-ngushtë është dera, edhe e-shtrënguar' është udha që shpie ndë jetët, edhe të-pakë jan'ata që e gjejn'atë.

1- **Dera e ngushtë.** Me këto fjalë ungjillori do të na tregojë se ashtu sikundër është e vështirë për të kaluar dikush në një derë të ngushtë, kështu për të hyrë në parajsë duhet përshkruar një udhë e vështirë dhe në shtrëngim.

PROFETËT E RREMË

(Luka 6:43-44)

15 Edhe ruhi nga profitërit' e-rrem, të-cilëtë vijnë te ju me te-veshura dhësh, po përbrënda janë ujë që rrëmbenjë. 16 Nga pemët' e tyre do t' i njihni ata; mos mbledhënë rrush nga drizatë, a fiq nga murrizatë? 17 Kështu çdo dru i-mirë bën pemë të-mira; po drur'i-dobëtë bën pemë të-liga. 18 Drur' i-mirë s'munt të bënë pemë të-liga, as drur' i dobëtë të bëjë pemë të-mira. 19 Çdo dru që s'bën pemë të mirë pritëtë e hidhetë ndë zjarr. 20 Përandaj nga pemët' e atyre do t' i njihni ata.

1-Ruhuni nga profetët e rremë. Profetët e rremë e vetëquhen si të dërguar të Perëndisë, por në të vërtetë janë uqër që na rrëmbejnë.

2-Do t’i njihni nga pemët e tyre. Të gjithë profetët e rremë kanë një gjë të përbashkët, gënjeshtren. Prej saj ata mund të njihen. Prandaj në kërë rast ai këshillon të krishterët që t’i njohin ata nga virtytet dhe jo prej fjalëve.

NXËNËSI I VËRTETË

(Lluka 13:25-27)

21 Nukë do të hynjë ndë mbretëri të qiejvet kushdo që më thotë, Zot, Zot; po ay që bën dashurimn’e t’im Et që është ndë qiejt. 22 Shumë veta do të më thonë nd’atë, Zot, Zot, nukë profitepsmë mb’emërit t’ënt, edhe mb’emërit t’ënt nxuarmë djaj, edhe mb’emërit t’ënt bëmë shumë çudira? 23 Po atëhere do t’u rrëfenj atyre, se kurrë nuk’u kam njohurë juve; ikëni prej meje ju që keni punuarë paudhërinë.

1-Kurrë nuk kam për t’u njohur juve. Kuptimin e këtyre vargjeve e gjejmë te ungjilli sipas Joanit: “Sepse Ati nuk gjykon asnjë, por gjithë gjyqin ia dha Birit, që të gjithë të nderojnë Birin ashtu siç nderojnë Atin, kush nuk nderon Birin, nuk nderon Atin që e ka dërguar” (Joani 5, 22-23).

PARAVOLIA E DY SHTËPIVE

(Lluka 6:47-49)

24 Kushdo pra që dëgjon këto fjalët’ e mia, edhe i bën ato, do t’a përgjanj atë me një njeri të-mënçim që ndërtoj shtëpin’e ti mbi shkëmpt; 25 Edhe zbriti shiu, e erdhë lumënjtë, e frynë erëratë, edhe u përpoqnë pas asaj shtëpie, po nuk’u rrëzua; sepse ishte themelosurë mbi shkëmpt. 26 Po kushdo që dëgjon këto fjalët’e mia, edhe nuk’i bën, do t’i gjanjë një njeriu

të-marrë, që ndërtoj shtëpin' e tij mbi rërët; 27 Edhe zbriti shiu, e erdhë lumenjtë, e frynë erëratë, edhe u përpoqnë pas asaj shtëpie, edhe u rrëzua; edhe të-rrëzuarit'e asaj ishte të-math.

1- Shtëpia mbi shkëmb. Krishti themeloi besimin e krishterë, prandaj na porositi në mënyrë alegorike që shtëpinë tonë ta ndërtojmë mbi shkëmb dhe jo në rërë. Këtu e ka kuptimin që besimi ynë të jetë mbi baza të shëndosha shkëmbore dhe jo mbi themele ranore. Në rastin e parë besimi ynë nuk tundet nga stuhitë e jetës, ndërsa në rastin e dytë, besimi do të jetë i cekët.

JISUI, MËSUES I VËRTETË

28 Edhe Jisuj kur mbaroj këto fjalë, gjindja tmeroneshinë për mësimin'e ati. 29 Sepse i mësonte ata si një që ka pushtet e jo si shkronjësitë.

1- Që ka pushtet. Krishti me pushtetin e tij, themeloi ligjin e përkryer. Ai fliste me autoritet të plotë, sepse e dinte shumë mirë që ai ishte Mesia i dërguar nga Perëndia, për shpëtimin e mbarë njerëzimit.

KREU I TETË

SHËRIMI I LEBROZIT

(Marku 1:40-45, Lluka 5:12-16)

1 Edhe kur zbriti nga mali, i vanë prapa shumë gjindje.

1-Kur zbriti nga mali. Pas mbajti ligjëratën, Krishti zbriti nga mali dhe shumë popull i venin nga pas.

2 Edhe ja tek erdhi një i kromosur’e iu fal ati, dyke thënë, Zot, ndë daç, munt të më qëronjç. 3 Edhe Jisuj ngjati dorënë, edhe e preku dyke thënë: Dua, qërohu. Edhe për-njëherë iu qërua kroma.

1- Zot a mund të më shërosh. Ai njeri jetonte i veçuar nga shoqëria, sepse sëmundja e tij konsiderohej shumë e rrezikshme. Megjithatë ai ju afrua Jisuit, sepse kishte dëgjuar për dashurinë e tij për të gjithë njerëzit pa dallim. Kishte dëgjuar për mrekullitë e tij, prandaj ju afrua me besim se do t’a shëronte.

4 Edhe Jisuj i thot’ati; Shiko mos i thuash ndonjëj; po shko e dëfte vetëhenë t’ënde te prifti, edhe shpjerë dhurëtinë që ka urdhëruarë Moisiu për dëshmim mb’ata.

1-Për dëshmim tek ata. Krishti tha të kromosurit që të shkonte tek priftërinjtë dhe t’u thoshte që nuk ishte kundër ligjit të Moisiut.

SHËRIMI I SHËRBËTORIT TË KRYEQINDËSHIT

(Luka 7:1-10, Joani 4:43-54)

5 Edhe Jisuj kur hyri në Kapernaum, i erdhi për anë një urdhër-qindës, dyke lutur’ ati, e dyke thënë, 6 Zot, shërbëtori im dergjetë ndë shtëpit ulok, e mundonetë keq. 7 Edhe Jisuj i thot’ati, Unë do të vinj e do t’a shëronj.

1-Kryeqindëshi. Ai ishte idhujtar dhe shërbente si oficer në ushtrinë e Herod Antipës.

2-Unë do të vij e ta shëroj. Një kryeqindësh romak i afrohet Jisuit dhe i kërkon që t’i shpëtojë shërbëtorin e tij, që ishte i sëmurë e po vuante. Krishti, pranoi të shkonte në shtëpinë e tij dhe t’ia shëronte shërbëtorin, ndonëse e dinte që ai ishte pagan.

8 Edhe urdhër-qindësi u përgjegjeq e tha, Zot, nukë jam i-zoti të më hynjë ndënë strehët; po thuaj vetëmë një fjalë, edhe shërbëtori im do të shëronetë.

1- Nuk jam i denjë që Ti të hysh nën strehën time. Këto fjalë vërtetojnë që kryeqindëshi ishte njeri i përulur. Me të vërtetë përulësia e kryeqindëshit është e admirueshme.

2- Por thuaj vetëm një fjalë dhe shërbëtori im do të shërohet. Jisui u mrekullua nga fjalët e kryeqindëshit, nga besimi i tij.

9 Sepse edhe unë jam një njeri ndënë urdhërë, edhe kam ndënë vetëhenë t’ime ushtëtarë; edhe i them këti, shko, edhe shkon; edhe tjatërit, eja, edhe vjen; edhe shërbëtorit t’im, bëj këtë, edhe e bën.

1- Kam nën veten time ushtarë. Si një oficer i lartë romak që ishte, ai nuk sillet me ashpërsi por përkundrazi paraqitet me besim

të ngrohtë dhe përlësi të thellë, me zemrën mbushur dhimbje dhe dashuri. Dashuria e Perëndisë, i jep njeriut nderimin më të lartë nëse ky i fundit nuk pushon së qeni shërbëtor i Zotit. Madje edhe pse zotëron një funksion të lartë dhe të admirueshëm, ai e konsideron veten si shërbëtor të tjerëve. Kryeqindëshi i propozon Krishtit për të vajtur në shtëpinë e tij për t'i shëruar shërbëtorin që ishte duke vdekur.

2- **“Bëje këtë”**. Këto fjalë të Kryeqindëshit na tregojnë se ai si njeri e kishte këtë pushtet. Megjithatë Kryeqindëshi i lutet Krishtit. Prandaj thuaj vetëm një fjalë dhe mrekullia do të bëhet. Shërbëtori im do të shërohet edhe pa praninë tënde. E kështu u bë.

3- **Ai e bën**. Si komandant romak që ishte ai e njihte mirë bindjen. Ai e dinte se, nëse urdhëronte një nga ushtarët e tij për diçka, nuk ja kthente kush urdhërin. Në të njëjtën mënyrë kryeqindëshi e kishte kuptuar, se Krishti kishte fuqi të mbinatyrshme, prandaj besonte me gjithë shpirt, nëse Jisui do të urdhëronte, shpirti i sëmundjes do t'i bindej menjëherë. Duke u kuptuar edhe nga aspekti i bindjes, besimi i tij u bë i plotë.

10 Edhe Jisuj kur dëgjoj u çudit, e u tha atyre që i vininë prapa, me të vërtetë u them juve, se as ndë Israilt nukë kam gjeturë kaqë besë.

1-”**As tek judejtë nuk kam gjetur besim kaq të madh”**. Me besimin tek Krishti, kryeqindëshi ndonëse ishte idhujtar del më besnik se judenjtë e pabesë. Krishtit i bënë përshtypje fjalët e kryeqindëshit, të cilat na tregojnë besimin e madh e të admirueshëm të tij. Besimi i kryeqindëshit u shoqërua edhe me bindje.

11 Edhe po u them juve, se shumë do të vijnë nga të-lindurit’e nga të-perënduarit’e djellit, edhe do të rrinë bashkë me Avraaminë e me Isaakunë e me Jakovinë ndë mbretërit të qiejvet; 12 Po të bijt’e mbretërisë do të hidhenë nd’errësirët të-

përbashkë; atje do të jetë të-qarët'e të-kërcëlliturit' e dhëmbëvet. 13 Edhe Jisuj i tha urdhër-qindësit, shko, edhe t'u bëftë sindëkur besove. Edhe shërbëtor' i ati u shërua që mb'atë herë.

1-"Shko dhe u bëftë ashtu si besove!". Shërbëtori i tij u shërua në çast. Jisui e shëroi atë, sepse tek ai njeri zbuloi besimin e sinqertë që megjithëse nuk ishte jude, por një kryeqindësh i një ushtrie të huaj. Rrallë Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti mrekullohet nga besimi i një idhujtari, i cili ndonëse nuk i ishte dhënë mundësia të njihej me besimin e vërtetë, megjithatë ai beson se shërbëtori i tij do të shërohet.

SHËRIMI I VJEHRRËS SË PJETRIT

(Marku 1:29-34, Lluca 4:38-41)

14 Edhe Jisuj kur erdhi ndë shtëpit të Pjetrit, pa të vjehërrën'e ati qe po dergjej ndër ethe. 15 Edhe e zuri atë prej dore, edhe e lanë ethetë; edhe ajo u ngrit e u shërbente atyre. 16 Edhe si u ngrys, i prun' ati shumë të-djallosurë; edhe ay nxori frymat' e ndyra me fjalë, edhe shëroj gjith' ata që kishinë keq; 17 Që të mbushetë ç'ëshë thënë nga profiti Isai, që thotë, "Ay mori smundjetë t'ona, edhe mbajti lëngatatë t' ona".

1- E zuri për dore dhe e lanë ethet. Kur Krishti hyri në shtëpinë e apostull Petros, pa vjehrën e tij, e cila dergjej në shtrat dhe vuante nga ethet. Sapo Krishti e zuri për dore, ajo u ngrit dhe filloi t'u shërbente.

2- Edhe si u ngrys. Këtu e ka kuptimin "si kaloi e shtuna". Krishti shëroi shumë njerëz duke ua nxjerrë frymat e këqija.

KUSHTET PËR TË QENË DISHEPULL

(Lluka 9:57-62)

18 Edhe Jisuj kur pa shumë gjindje rreth vetëhes' së ti, urdhëroj që të shkojnë përtej.

1-Urdhëroj që të shkojnë përtej. Krishti dëshironte që të shlodhej dhe pasi nuk gjeti qetësi në Kapernaum, urdhëroi që të shkonin përtej liqenit, në Pere.

19 Edhe një shkronjës u afërua e i tha ati: Mësonjës, do të vinj prapa teje kudo që të veç. 20 Edhe Jisuj i thot' ati: dhelperatë kanë strofka, edhe shpest' e qiellit fole; po i bir' i njeriut s'ka ku të pëstetnjë kryetë. 21 Pastaj një tjetërë nga nxënësit' e ati i thotë, Zot, lë-më përpara të vete të kllas ndë varr t'im atë. 22 Po Jisuj i tha ati, Eja pas meje, edhe lërë të-vdekuri i të kllasënë ndë varr të-vdekurit' e tyre.

1-Mësonjës. Kështu quhej çdo komentues i ligjit. Në gjuhën hebraike e ka kuptimin Rabin.

2-Bir i njeriut. Në gjuhën hebraike quhej Bar-enash. Këtë e gjejmë tek libri i profetit Daniel (7, 13).

QETËSIMI I STUHISË

(Marku 4:35-41, Lluka 8:22-25)

23 Edhe kur hyri ndë lundrët, i vanë pas nxënësit' e ati. 24 Edhe ja tek u bë një tërmet i-math ndë detë, kaqë sa po mbulonej lundra nga valëtë po ay flinte. 25 Edhe nxënësit' e ati i ertnë përënë edhe e ngritnë atë, dyke thënë, Zot, shpëto-na, se po humbasëmë. 26 Edhe ay u thot' atyre: Përse jeni frikacarë, o besë-pakë? Atëhere u ngrit e qërtoj erëat' edhe detinë. Edhe u bë bunacë e-madhe. 27 Edhe njerëzitë çuditëshinë e thoshinë: Ç' farë njeriu është ky që edhe erërat' edhe deti e dëgjonjënë?

1- **Dishepujt në rrezik.** Vargjet ungjillore na tregojnë se Jisui bashkë me dishepujt e tij po kalonin detin e Galilesë. Udhëtimi po shkonte mirë, por papritur një furtunë e fuqishme i vuri dishepujt përpara një rreziku të madh. Deti i Galilesë sa vinte e bëhej më i egër. Errësira mbretëronte kudo, ndërsa barka e tyre lëkundej nëpër dallgët e fuqishme. Deti i trazuar shpesh hapte gojën për t' i përpirë. Në sytë e dishepujve të Krishtit agonia shtoej.

2- **Jisui qetëson stuhinë.** Sigurisht që Krishti nuk i la të humbisnin. Në të gdhirë, kur barka ishte larg bregut ai e qetësoi stuhinë. Kjo që u ndodhi dishepujve, na ndodh edhe ne. Sapo na zënë furtunat e jetës, tërhiqemi dhe humbasim, sepse nuk kemi besim të plotë tek vetja jonë. Pikërisht kur vështirësitë shtohen, atëherë kujtohemi për Perëndinë. I lutemi që të na ndihmojë dhe të na shpëtojë. Perëndia i dëgjon lutjet tona dhe nuk nguron të na ndihmojë.

IDEMONIZUARI I GERGESASË

(Marku 5:1-20, Lluca 8:26-39)

28 Edhe ay kur erdhi mb' anët të-përtejme, ndë dhet të Gjergjesinëvet, i dualië përpara dy të-djallosurë, qe dilninë nga varretë, fort të-egërë, kaqë sa s'munt të shkonte njeri nga ajo udhë. 29 Edhe ja tek bërtitnë dyke thënë: Ç'ke me ne edhe ti, o Jisu, i Bir' i Perëndisë? erdhe këtu përpara kohësë që të na mundonjë? 30 Edhe lark atyre ishte nië tufë e madhe derrash dyke kulloturë. 31 Edhe djajtë i luteshin' ati, e i thoshinë: Ndë na nxjerç që këtej, lë-na të shkojmë ndë tufët të derravet. 32 Edhe ay u tha atyre: Shkoni. Edhe ata duallnë e shkuanë ndë tufët të derravet; edhe ja gjithë tuf' e derravet tek u druth nga gremina ndë dett, edhe ngorthnë ndë ujërat.

1- **I dolën përpara dy të demonizuar.** Kjo ngjarje e ndodhur në fshatin Gergesa. Pamë se demonët, që kishin hyrë tek ata njerëz

fatkeqë u detyruan, me urdhër të Jisuit të largoheshin dhe të çlironin viktimat e tyre. Ungjilli i Shenjtë na informon për një të vërtetë serioze. Frymat dinake kërkuan leje dhe miratim nga Krishti që të hynin tek kopeja e derrave që ishte aty pranë. Në të dy rastet shohim qartë dhe konstatojmë, se fuqia dhe pushteti i së keqes janë të kufizuara. Pra e keqja nuk mund të veprojë si të dojë dhe sa të dojë. Ky është një konstatim shumë i rëndësishëm dhe u jep guxim dhe fuqi atyre që luftojnë kundër së keqes.

2- **Ikonat e ungjillit.** Kjo pjesë ungjillore na paraqet tre ikona, një pozitive dhe dy negative. E para është takimi ndërmjet Krishtit dhe dy të demonizuarve. Këta të demonizuar kishin dalë nga varret dhe ishin aq të tërbuar, saqë askush nuk mund të kalonte nga ajo udhë. Krishtit i erdhi keq për ta dhe me fuqinë e tij i çliroi nga skllavëria e demonëve. Së dyti shohim ndeshjen e Krishtit me demonët, të cilët u sprapsën dhe të frikësuar iu lutën duke thënë; “Në qoftë se na dëbon, na lejo të futemi tek tufa e derrave”. Si përfundim edhe ata u mbytën në det bashkë me derrat, sepse nuk donin që të pendoheshin dhe të ndiqnin Krishtin. Ishte e pamundur që të ecnin së bashku gjënjeshtra me të vërtetën, errësira me dritën e urrejtja me dashurinë.

33 Edhe barinj të iknë e erthnë ndë qytet, e dhanë zë për të-gjitha edhe për punët’ e të-djallosurvet. 34 Edhe ja gjithë qyteti tek dolli përpara Jisujt: edhe kur e pan’atë, iu lutnë ati të ikënjë nga sinorët’ e atyreve.

1- **Largohu prej nesh sepse na zhduke pasurinë.** Barinj të që kullosnin derrat sapo panë dëbimin e demonëve dhe shërimin e të demonizuarve, vrapuan menjëherë për të parë Krishtin. Me cilin qëllim veçse; -Ata dolën për ta përzënë Krishtin duke i thënë; -Largohu prej nesh, sepse na zhduke pasurinë, duke na e mbytur kopenë e derrave në det. Etërit e kishës, këtë sjellje të barinjve e

krahasojnë shpesh me pasionet njerëzore. Kështu edhe ne shpesh nuk ngurojmë të themi; -Largohu o Krisht prej nesh, sepse na i mbyte pasionet e zemrës. -Largohu o Zot prej nesh, sepse ti na mëson drejtësinë dhe ne preferojmë padrejtësinë. Perëndia duke e respektuar lirinë tonë, largohet prej nesh dhe menjëherë na sundon e keqja me anën e demonëve. E keqja vjen vetëm atëhere kur ne e braktisim të mirën dhe biem në kthetrat e djallit. Edhe vetë djalli në fillim nuk ishte i keq, por u bë i tillë, atëhere kur u largua nga Perëndia.

KREU I NËNTË

SHËRIMI I TË PARALIZUARIT

(Marku 2:1-12, Lluka 5:17-26)

1 Edhe ay si hyri ndë lundrët u hoth përtej, e erdhi ndë qytet të ti.

1-Në qytetin e ti. Këtu bëhet fjalë për qytetin e Kapernaumit. Bethlehemi e lindi, Nazareti e rriti, por qyteti i preferuar i Jisuit ishte Kapernaumi, prandaj edhe ai e quan “qytetin e tij”.

2 Edhe ja tek i prunë një ulok të-dërgjurë mbi shtrat; edhe Jijuj si pa besën’ e atyre, i tha ulokut: Merr zëmërë, o bir; të janë falurë fajet’ e tu. 3 Edhe ja ca nga shkronjësitë tek thanë me vetëhen’e tyre, se ky po vllasfimis. 4 Edhe Jisuj si pa mendimet’e atyre, tha: Përse mendoni ju punëra të-liga ndër zëmërat t’uaja? 5 Sepse ç’ është më lehtë, të them, 6 T’ u-fal në fajet’e tu, apo të them, ngreu e ecë? Po që t’a dini se i bir’i njeriut ka pushtet mbi dhet të falnjë faje. (atëhere i thot’ ulokut) ngreu, e merr mbë krahë shtratinë t’ënt, edhe ecë ndë shtëpit t’ënde. 7 Edhe ay u ngrit edhe vate ndë shtëpit të ti. 8 Edhe gjindja, kur panë, u çuditnë, edhe lavdëruanë Perëndinë, që u dha njerëzet një të-këfillë pushtet.

1- “Tani çohu, merre shtratin dhe shko në shtëpi”. I paralizuari u ngrit menjëherë, mori shtratin në krahë dhe doli

përrjashta. Të gjithë u habitën dhe lavdëruan Perëndinë duke thënë: “Një gjë të tillë nuk e kemi parë kurrë”. Para pak çastesh ishte krevati që mbante prej vitesh trupin e të paralizuarit, ndërsa tani ishte njeriu i paralizuar që ngrinte shtratin e tij.

2- **Shpjere shtratin në shtëpinë tënde.** Shtrati dhe i paralizuari, që prej vitesh qëndronin bashkë, tani erdhi momenti që të ndahen. Si për çudinë e të gjithëve, Krishti nuk e lejoi të paralizuarin që shëroi, të braktisë shtratin e tij, por e urdhëroi që ta shpinte atë në shtëpi.

THIRRJA E MATHEUT

(Marku 2:13-17, Lluca 5:27-32)

9 Edhe dyke shkuarë Jisuj andej, pa një njeri që thuhej Matthe, dyke ndënjurë ndë kumerqt; edhe i thotë, eja pas meje. Edhe ay u ngrit e vate pas ati.

1-**Kumerqt.** Ishte ai vend i shenjtë ku populli judaik paguante taksat. Kumerqti ishte si doganë. Matheu ka qenë kumerqar, pra doganier.

2-**Pa një njeri që quhej Mathe.** Bëhet fjalë për nxënësin e njohur të Zotit, i cili përfshihet në të gjitha listat e dymbëdhjetë apostujve. (Marku 3, 18, Veprat 1,13). Thirrjen e tij nga Krishti e komentojnë të tre ungjijtë sinoptikë (Matheu 9, 9-13, Marku 2, 13-17, Lluca 5, 27-32). Vetëm tek ungjilli sipas Matheut 9, 9 quhet Matheo, ndërsa në ungjijtë e tjerë quhet Levi. Tek ungjilli sipas Markut 2, 14 përmendet babai i tij që quhej Alfeo. Gjithashtu vetëm tek Matheu 10,3 paraqitet si doganier. Nuk përjashtohet mundësia që të kishte dy emra judaikë: Simon Kifas dhe Josif Varnava (Veprat 4, 36). Por emri kryesor i tij ishte Levi dhe pas thirrjes në rrethin e dymbëdhjetë apostujve, Jisui e quajti Matheo, që do të thotë “dhuratë

Perëndie”. Këto janë informacionet që na jep Dhiata e Re për ungjillorin Mathe.

3-Eja pas meje. Matheu e kishte parë Jisuin edhe më përpara dhe sapo ai e ftoi për t’i shkuar nga pas, nuk mendoi gjatë, por menjëherë u ngrit dhe vajti pas Krishtit.

10 Edhe tek po rrinte ndë mësallë ndë shtëpit, ja tek erthnë shumë kumerqarë e fajtorë, edhe rrininë bashkë me Jisunë edhe me nxënësit’ e ati.

1- Ja tek erdhën shumë kumerqarë. Matheu e ftoi Krishtin në shtëpinë e tij. Në gostinë e organizuar me këtë rast ai thirri edhe kumerqarë të tjerë. Matheu nga përlësia që kishte nuk e trajton gostinë në ungjillin e tij, por tek ungjilli sipas Markut 2, 15 dhe sipas Llukës 5, 29 thonë se pritja u organizua në mësallë të shtëpisë.

11 Edhe Farisenjtë kur panë, u thanë nxënëset t’ati: Përse mësonjësi juaj ha bashkë me kumerqarë e me fajtorë?

1-Ha bashkë me kumerqarë e me fajtorë. Farisenjtë gjetën rastin për t’a kritikuar Krishtin duke e akuzuar që ai hante me kumerqarët, të cilët qenë njerëz mëkatarë sepse vidhnin popullin.

12 Po Jisuj kur dëgjoj u tha atyre, ata që janë të shëndoshë s’kanë nevojë për shëronjës, po ata që kanë keq. 13 Edhe shkoni e mësoni ç’është: “Dua përdëllim, e jo kurban”, sepse s’kam ardhurë të thërres të-drejtë, po fajtorë ndë pendim.

1-Ata që janë të shëndoshë nuk kanë nevojë për shëronjës. Krishti u përgjigjet farisenjve që ai vërtet po hante me kumerqarët, por nuk ishte si ata. Krishti si mjeku i shpirtrave që ishte, me fjalën e tij donte që t’i shëronte edhe ata njerëz. Jo pa qëllim nga rradhët e tyre zgjodhi edhe dishepullin e tij Mathe.

2- Dua përdëllim dhe jo kurban. Kjo është shprehje e marrë nga Dhiata e Vjetër tek thotë: “Sepse unë dëshiroj mëshirë dhe jo flijimet dhe njohjen e Perëndisë më shumë se olokaustet” (Osea 6,6). Perëndia kërkon që të mos rrimë larg mëkatarëve, por të përpiqemi që t’i nxjerrim ata nga bataku ku kanë rënë. Kjo duket qartë në paragrafin e fundit, ku Krishti nuk ka ardhur të thërresi të drejtët, por mëkatarët, të cilët kanë nevojë për pendim.

PYETJA PËR ARGJËRIMIN

(Marku 2:18-22, Lluca 5:33-39)

14 Atëhere vijnë tek ay nxënësit’ e Joanit, e i thonë, Përse ne edhe Farisenjtë agjërojmë shumë, po nxënësit’e tu nuk’agjërojnë? 15 Edhe Jisuj u tha atyre, Mos muntjnë të mbajnë zi dasmorëtë, gjersa të jetë dhëndëri bashkë me ata? po kanë për të ardhurë dit, kur të merretë dhëndëri prej atyrere, edhe atëhere dot’ agjëronjnë.

1-Përse nuk argjërojnë nxënësit e tu? Krishti e kishte parandjerë fundin e tij që do të gjykohej për mëkatet e mbarë njerëzimit. Ai kur ndodhet në mes të dishepujve e quan veten si dhëndër, prandaj sa kohë që Krishti të ishte me ta nuk do të argjëronin, por të gëzonin. Argjërimi është shenjë mjerimi, por dishepujt duhet të qenë entuzjastë, sepse kishin Krishtin në mes tyre.

16 Edhe as ndonjë nukë vë anërë pëlhure së-re mbi rrobë të-vjetërë; sepse tëmbushurit’e asaj heq nga rroba, edhe të-grisuritë bënetë më të-keq. 17 Edhe as nukë vënë verë të-re ndë kacekë të-vjetërë; sepse ndë vënçinë, kacekëtë çirenë, edhe vera derdhetë, edhe kacekëtë humbasënë; po vënë verë tëre nde kacekë të-rinj, edhe kështu ruhenë të-dyja.

1-Verë të re në kacekë të rinj. Në vendet e Lindjes vera ruhej nëpër kacekë, të cilët qenë lëkura kafshësh. Kështu ishte e natyrshme që vera e re, të ruhej nëpër kacekë të rinj. Krishti përdori këtë shembull, për të justifikuar mosargjërimit e dishepujve. Me verë të re, Krishti nënkupton mësimet e tij, të cilat nuk qenë të njejta me mësimet e farisenjve, prandaj ai i krahason me verën e vjetër.

**SHËRRIMI I GRUAS ME HEMORAGJI
NGJALLJA E VAJZËS SË KRYETARIT TË SINAGOGËS**
(Marku 5:21-43, Lluca 8:40-56)

18 Tek po u fliste ay atyre këto, ja tek erdhi një i-parë, edhe i falej ati, dyke thënë. Se ime bijë vdiq tashti; po eja edhe vërë dorënë t'ënde mbi atë, edhe do të rronjë. 19 Edhe Jisuj u ngrit e vate prapa ati, bashkë me nxënësit' e ti.

1- Ime bijë ka vdekur. Ndërsa Jisui po predikonte në mes të një grumbulli njerëzish i afrohet kryetari i sinagogës, i cili quhej Jairos dhe i kërkoi të shkonte në shtëpinë e tij për t' i shëruar vajzën që ishte duke vdekur. Jisuit i erdhi keq dhe u nis menjëherë për në shtëpinë e tij. Nga pas e ndiqte turma e njerëzve që shtyeshin.

2- Eja e vër dorën tënde mbi të. Me këto fjalë i drejtohet kryetarit të sinagogës Krishtit. Besimi është ai që shpëton, dhe që sjell mrekullitë në jetën tonë. Këtë realitet e kishin ndjerë edhe dishepujt e Krishtit, atëhere kur i luteshin mësuesit të tyre duke i thënë: “Na e shto besimin”. Sado që e ndjejmë brenda vetes forcën e besimit, në momente të caktuara ai mund ta humbasë gjallërinë e tij dhe të kthehet në besim formal.

20 Edhe ja një grua që i rrithte gjak nga vetëheja dy-mbë-dhjetë vjet, u afërua së-prapësmi, edh' e preku anën' e rrobës s'ati. 21 Sepse thoshte me vetëhen' e saj, vetëmë ndë prekça

rrobën' e ati, do të shëronem. 22 Edhe Jisuj kur u kthye, e pa atë, tha: Kij zëmërë, o bijë; besa jote të shpëtoj. 23 Edhe gruaja shpëtoj që mb'atë herë.

1- Preku anën e rrobës së tij. Në mesin e turmës ishte edhe një grua e sëmurë, e cila vuante prej shumë vjetësh, kishte shpenzuar gjithë pasurinë e saj për t'u kuruar, por më kot. Megjithatë sapo pa Jisuin, i lindi një shpresë, me kurajo dhe besim ajo çau turmën, preku rrobën e Jisuit dhe menjëherë u shërua. Nëse e verrejme Ungjillin e sotëm nga tre këndvështrime të ndryshme do të dallojmë: Zotin, turmën që shtyhej dhe gruan e sëmurë që vuante. Nëse do ta përqëndronim shikimin tonë tek Krishti, do ta përjetonim mrekullinë. Nëse i afrohemi turmës, njerëzit do të na shtyjnë, për të na flakur tutje. Nëse vëmë re fizionominë e gruas së sëmurë, do të na vijë keq për të, sepse është një qenie njerëzore që vuan. Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti shëroi një grua, e cila kishte dymbëdhjetë vjet që vuante nga një hemoragji aq e rëndë, saqë asnjë mjek nuk kishte mundur që t'i bënte derman. Megjithatë ajo u shërua, vetëm nga një prekje e thjeshtë që i bëri rrobës së Krishtit.

2-Besa jote të shëroi. Vetëm marrëdhënia jonë personale me Krishtin, na bashkon me Perëndinë. Nëse nuk i çajmë turmat, të cilat na pengojnë për prekur Krishtin, atëhere nuk mbërrim në fronin e Perëndisë. Nëse nuk do të ecim me kurajo dhe besim drejt Krishtit, atëhere nuk do ta ndjejmë përdëllimin e ngrohtësinë e Perëndisë. Vetë Krishti në Ungjillin e sotëm i tha gruas së sëmurë: “Shko në paqe bija ime se besimi yt të shëroi”.

24 Edhe Jisuj passi erdhi ndë shtëpit të të parit, edhe pa ata që u bininë fyejvet edhe gjindjenë dyke bërë gjëmë, u thot'atyre, lkëni; sepse vashëza s'ka vdekurë, po po fle. 25 Po ata e përqeshnin' atë. 26 Edhe gjindja si u nxuar jashtë, hyri edhe e zuri prej dore; edhe vashëza u ngrit. Edhe ky zë doli ndëpër gjith' atë dhe.

1- **Hyri dhe e zuri për dore.** Krishti shkon dhe sapo e kapi vajzën nga dora, ajo u kthye në jetë. Duhet që të zgjasim dorën për ta prekur Krishtin dhe menjëherë do ta ndjejmë se edhe Krishti do të zgjasi dorën drejt nesh.

2-**Vashëza u ngrit.** Por dikush mund të pyesi:- Përse Zoti bën mrekullira dhe kur kryhen ato? Mrekullia është rezultat i besimit të njeriut, apo është ajo që na shpie drejt besimit? Përgjigjja është se vetëm rruga e besimit është ajo që na shpie për të pranuar dhe jetuar mrekullitë e Zotit. Disa njerëz i afrohen Krishtit për përfitime materiale, disa të tjerë i shtyn forca e zakonit, pasi kështu u edukuan nga prindërit, disa e ndjekin turmën pa ndonjë ndenjë përgjegjësie. Por nuk mungojnë edhe ata që i afrohen Krishtit me besim dhe me ndjenjë, duke i premtuar se do ta ndjekin pas kudo dhe nuk do ta mohojnë kurrë. Le të zgjasim duart dhe ta prekim Krishtin dhe menjëherë do ta kuptojmë se edhe Ai, në të njëjtën kohë ka zgjatur duart drejt nesh, për të na shëruar dhe ngushëlluar.

SHËRRIMI I DY TË VERBËRVE

27 Edhe Jisuj dyke ikur'andej, i vanë prapa dy të-verbërë, dyke klithur'e dyke thënë: Përdëlle-na, o bir'i Dhavidhit. 28 Edhe ay kur erdhi ndë shtëpit, erthnë përnanë ati të-verbëritë, edhe Jisuj u thot' atyre: Besoni se munt t'a bënj këte unë? 29 Ata i thon'ati, Po, Zot. Atëhere preku syt'e atyreve, dyke thënë: Pas besësë s'uaj u bëftë mbë ju.

1-**Përdëllena o bir i Davidit.** Kjo pjesë ungjillore na përshkruan një mrekulli të mahnitshme. Dy të verbër, të cilët jetonin prej vitesh në erësirrë, fituan dritën e syve, sapo shëruesi i shpirtrave dhe i trupit Jisu Krishti u preku sytë me duart e tij të shenjta. Njerëzit që qenë aty, i panë mrekullitë dhe u gëzuan. Ashtu siç e dëgjuam edhe në Ungjillin e sotëm, Krishti sapo i shëroi dy të verbërit, iu tha atyre që të mos i thonin askujt për mrekullinë. Por kjo gjë veçse nuk

që e mundur, sepse ata i njihnin të gjithë si të verbër që zvarriteshin pas murreve, ndërsa tani shihnin për mrekulli.

2-Po o Zot. Një “Po o Zot” thanë njerëzit e verbër dhe Krishti u solli atyre dritën e syve. Fjalë plot kuptim, të cilat fshehin brenda tyre një mesazh dhe përbëjnë bazën e marrëdhënieve të njeriut me Perëndinë. Pa kuptimin e kësaj fraze, është e pamundur marrëdhënia e komunikimit tonë me Perëndinë.

30 Edhe u hapnë syt’e atyreve. Edhe Jisuj i porositi ata shtrënguarshim, dyke thënë: Shikoni mos e marrë vesh njeri këtë.

31 Po ata posa duallnë dhanë zë për atë ndëpër gjith’atë dhe.

1- **Të mos e marrë vesh njeri.** Dy të verbërit e Ungjillit të sotëm, megjithëse kishin marë porosi nga Krishti që të mos e përhapnin lajmin e shërimit të tyre, nga entuzjazmi dhe gëzimi që gjetën dritën e syve nuk duruan. Të njenjtën gjë bëri edhe populli që i pa të shëruar.

SHËRRIME TË NDRYSHME

32 Edhe ata kur po dilninë, ja tek i prun’ ati një njeri shurth të-djallosurë. 33 Edhe djalli si u nxuar, foli i-shurdhëri; edhe gjindja u çuditnë, dyke thënë: Se kurrë ndonjëherë nuk’ është parë kështu ndë Israilt. 34 Po Farisenjtë thoshinë, se me anë të të-parit të djajvet nxjer djajtë. 35 Edhe Jisuj shkante për qark ndëpër gjithë qytetet e krye-fshatrat, dyke mësuarë ndëpër sinagogjit t’atyreve, edhe dyke lëçiturë ungjillin’e mbretërisë, edhe dyke shëruarë çdo sëmundje e çdo lëngatë ndë gjindjet.

1-**Me anën e të parit të djajve.** Farisenjtë duke pasur zili për mrekullitë që kryente Krishti, zunë të sajnin me qëllim që populli ta urrente. Populli i Judesë, mrekullohej nga shërimet e ndryshme që

bënte Krishti, ndërsa farisenjtë thonin që këto mrekulli ai i bënte me ndihmën e të parit të djajve.

JISUI DHE IZRAELITËT

36 Edhe kur pa gjindjenë, iu dhëmp për ata; sepse ishinë lodhur'e përndarë posi dhën që s'kanë bari. 37 Atëhere u thotë nxënësve të ti: Të korrët' është të-shumë, po punëtorëtë janë të-pakë. 38 Lut-j-uni pra të-zotit të të-korrit, që të nxjerrë punëtorë, për të korrët'e ti.

1-Lutjuni Zotit të sjelli punëtorë. Krishti i porositi dishepujt që t'i luten Zotit, që të sjelli punëtorë të tjerë në vreshtin e Perëndisë. Kështu dymbëdhjetë dishepujt, kishin me vete edhe nxënës të jerë, rrethin e të shtatëdhjetëve. “Pastaj Zoti zgjodhi edhe shtatëdhjetë nxënës” (Lluka 10, 1). Këtij rrethi i shtohen edhe gratë mirapurrëse (Lluka 8, 3). Po t'i mbledhje të gjithë bashkë bëheshin 120 veta (Veprat e Apostujve 1,15).

KREU I DHJETË

DËRGIMI I DYMBËDHJETË DISHEPUJVE

(Marku 3:13-19, Lluca 6:12-16)

1 Edhe si thirri të dy-mbë-dhjetë nxënësit’ e ti, u dha atyre pushtet kundër frymave të-ndyra, që t’i nxjerrën’ ato edhe të shëronjënë çdo sëmundje e çdo lëngatë.

1- **Thirri dymbëdhjetë apostujt.** Numri dymbëdhjetë simbolizon dymbëdhjetë fiset e Israelit. Krishti i dërgon dishepujt dy e nga dy për të predikuar. Në ungjillin sipas Llukës thuhet që për hetë të parë ai i quan ata apostuj. “...thirri nxënësit e tij dhe zgjodhi nga ata dymbëdhjetë dhe i quajti apostuj” (Lluca 6,13). Apostull është fjalë greke dhe do të thotë “*I dërguar*”. Përse Krishti zgjodhi dymbëdhjetë apostuj? Numri dymbëdhjetë ishte simbolik sepse në Dhiatën e Vjetër 12 qenë patriakët, 12 qenë fiset e Izraelit etj.

2 Edhe emërat’ e të dy-mbë-dhjet’ Apostojvet janë këta: i-pari Simoni që thuhetë Pjetër, edhe Andreu i vëllaj i ati; Jakovi i Zevedheut, edhe Joani i vëllaj i ati;

1-**Simoni që quhet Pjetër.** Petro ishte biri i Joanasë, Simoni ose Simeoni nga Betsadia e Galilesë peshkonte në liqen, kur Krishti e ftoi së bashku me të vëllanë Andrean. Më vonë i ndërroi emrin duke e quajtur Kifa, pra Petro, që do të thotë gur. Ishte i martuar dhe përmendet si babai i Pentronilës dhe bashkëshort i Marisë. Së bashku

me apostujt Jakov e Joan ishin tre nxënësit e dashur të Zotit, që u gjendën në çaste të rëndësishme. Petro u bë korifeu i apostujve dhe mori pjesë në mënyrë aktive në të gjithë veprimtarinë tre-vjeçare të Krishtit, e cili e lumuroi, sepse ai e kuptoi dhe e pohoi si bir të Perëndisë por dhe e qortonte për ndryshimet e tij.

2-Andrea vëllai i tij. Andrea është i pari prej peshkatarëve të Galilesë, të cilët Krishti i ftoi për t'u bërë apostuj dhe predikues. Andrea i parathirruri është vëllai i parakreut Pjetër, i biri i Joanit prej Betsaidës së Galilesë. Ushtroi profesionin e peshkatarit në ujrat e qeta të Tiberiadës. Është njeri i durimit, që di të presë, që di të hedhë rrjetën dhe e lë veten në mëshirën e Perëndisë. Por disa ujra të tjera do të luajnë rol të rëndësishëm në jetën e Andreas, ato që do ta bënin peshkatar të njerëzve. Atje, në ujrat e Jordanit, dëgjoji predikimin e Joanit, i cili ishte një personalitet i madh profetik. U bë njëri prej dëgjuesve dhe nxënësve të Pararendësit, ndoqi predikimin e tij dhe ditë e natë priste Mesinë e shumpritur.

3- Jakovi i Zevedeut. Jakovi ishte biri i Zevedeut dhe i Salomës, vëllai i madh i Joan Teologut, me origjinë nga qyteti Betsaida të Galilesë. Pas ftesës që i bëri vëllezërve Andrea dhe Petro, të bijve të Joanit, për të dëgjuar mësimin e tij, Krishti ftoi dhe Jakovin së bashku me vëllain e tij Joanin. Që të dy vëllezërit lanë të atin, lundrën dhe gjithë pasurinë e tyre dhe pasuan Krishtin. Kjo thirrje ishte përfundimtare, pasi edhe më parë ata e kishin pasuar Zotin, pas pagëzimit të Tij, kur Joan Pagëzori dëshmoi se ai është Mesia. Siç e shikojmë dhe nga ngjarjet e përshkruara në Ungjill, Jakovi sikurse Pjetri dhe Joani, zinte një vend të veçantë dhe u vlerësua shumë nga Zoti ynë Jisu Krisht.

4 - Joani i vëllai. Joani ishte nga një fshat i humbur i Galilesë i quajtur Betsaida. Ishte djali i Zebede peshkatarit dhe i Salomës, e cila ishte bijë e Josifit, burrit të Hyjlindëses, sepse Josifi kishte patur nga martesë e parë katër djem dhe tre vajza. Joani, së bashku me

vëllanë e tij Jakovin, po ndihmonte të atin e tij kur u thirr nga Zoti për ta ndjekur pas dhe për t'u bërë peshkatar njerëzish. Ai la menjëherë gjithçka dhe ndoqi pas mësimin qiellor. Ai ishte një nga tre nxënësit që Zoti mori me vete në malin Tabor, ishte një nga tre nxënësit e pranishëm në shërimin e të bijës së Ijairit, ishte ai që pushoi në gjirin e Isuit gjatë Darkës Mistike. Kur u kryqëzua Zoti, ai dhe Hyjlindësja ishin të vetmit që qëndruan pranë Kryqit. Ai e pa Krishtin pas Ngjalljes së bashku me nxënësit e tjerë duke marrë prej tij misionin për të përhapur kudo Lajmin e Mirë. Joani predikoi në Azinë e Vogël që ishte në atë kohë vendi me më shumë idhujtari.

3 Filippi, dhe Varthollomeu; Thomaj, edhe Matthe kumerqari; Jakovi i Allfeut, edhe Levveu që u quajt me përmbiemërë Thadhe;

1- **Filipi dhe Varthollomeu.** Filipi qe me prejardhje nga Betsaida e Galilesë dhe ishte një nga 12 apostujt. Menjëherë pas thirrjes së tij në misionin apostolik nxitoi dhe bindi mikun e tij Nathanaël, ose Vartholome, se kishin gjetur Mesinë e shumpritur. Para shumëfishimit të pesë bukëve, mësuesi vuri Filipin në provë dhe e pyeti se ku do të blinin aq bukë për gjindjen dhe Filipin nga ana e tij u habit se ku do të gjëndeshin aq para për të blerë bukët. Filipin dhe Andrea i parathirruri dëgjuan nga Perëndi-njeriu se erdhi ora që të lavdërohet Biri i Njeriut. Gjatë darkës mistike, Krishti, duke marrë shkas nga lufta e Filipit që t'i tregonte Atin, shpalli njëqëndshëmërinë e tyre: “Kush më ka parë mua ka parë Atin”.

2- **Vartholomeu ose Nathanaeli.** Ai rridhte nga Kana e Galilesë dhe u thirr prej Filipit për të njohur Mesinë. Tradita e shenjtë na thotë se ai predikoi krishtërimin tek indianët, të cilëve u dorëzoi Ungjillin sipas Matheut. U kryqëzua nga idhujtarët në Armeni.

3- **Thomai.** Apostulli i shenjtë Thoma, i quajtur edhe binjak, lindi në Jude nga prindër të varfër të cilët e mësuan me një përkushtim të madh për Ligjin e Moisiut. Sapo Krishti u shfaq dhe e ftoi ta

ndiqte, Thomai la barkën dhe rrjetat dhe u bë një prej të dymbëdhjetëve. Megjithëse u përndoq, u poshtërua dhe u godit shumë herë me gurë nga judejtë, ai prapë se prapë e ndoqi kudo Zotin me një zell të madh. Kur Krishti po shkonte në Jeruasalem për t’u flijuar, Thomai u tha apostujve të tjerë: “Të shkojmë dhe ne që të vdesim me të”. Pasi mundi vdekjen me ngjalljen e tij, shpëtimtari i botës iu shfaq dishepujve të cilët ishin mbyllur në një shtëpi në Jerusalem nga frika e jedejve. Kur ai u tregoi shenjat e plagëve të tij mbi trup, ata u mbushën plot gëzim sepse e njohën atë. Nga një vendim hyjnor, Thomai nuk ndodhej me të tjerët atë moment. Kur dishepujt i thanë se kishin parë Zotin e ngjallur ai nuk i besoi.

4- **Mathe Kumerqari.** Matheu ishte nga Kana e Galilesë, pra nga vendi ku Krishti bëri mrekullinë e parë. Para se të bëhej nxënës i Krishtit ai quhej Levi dhe profesioni i tij ishte ai i tagrambledhësit, pra kishte të drejtën nga shteti romak që të mblidhte taksat. Dhe ai në vend që të merrte sa e urdhëronte ligji, merrte më tepër dhe pasurohej duke vjedhur të tjerët. Pas ftesës që i bëri Krishti duke i thënë “Më ndiq”, Matheu e pasoi menjëherë. Jo vetëm braktisi profesionin mëkatar për atë kohë, por me gëzim e ftoi Zotin në shtëpinë e tij. Gjithashtu ai ftoi në shtëpinë e tij shumë mëkatarë e tagrambledhës të tjerë që donin të dëgjonin mësimin e Krishtit.

5- **Jakovi i Alfeut.** Jakovi ishte vëllai i ungjillor Mateut dhe i biri i Alfeut. Jakovi, pasi luftoi për të vërtetën e Krishtit në Jerusalem, më pas shkoi edhe në vende të tjera për të predikuar ungjillin. Atje shkatërroi dhe përmbysi altarët e idhujve dhe me hirin e Perëndisë shëroi sëmundje të ndryshme. Shën Jakovi, duke imituar shembullin e Krishtit pësoi vdekje në kryq.

6- **Leveu që u quajt Tade.** Tade ka kuptimin dashamirës. Emri i tij i vërtetë ishte Juda dhe qe i vëllai i Jakovit. (Lluka 6,16), (Veprat 1,13), (Joani 14,22).

4 Simon Kananiti, edhe Judhë Iskarioti, i-cili edhe e trathëtoj atë.

1-**Simon Kananiti.** Simoni, ky apostull i shenjtë, është ai i cili quhet dhe Nathanail. Ishte nga Kana e Galilesë, 7 milje në veri të Nazaretit. Thuhet se ai është dhëndri i dasmës në Kana, në të cilën Krishti bëri mrekullinë e parë të shndërrimit të ujit në verë. Kur pa këtë mrekulli, Simoni la shtëpinë e tij dhe pasoi Krishtin. Ai u bë një nga apostujt më të zellshëm të Krishtit. Nga ungjillor Matheu, ky apostull quhet Simon Kananeasi, kurse nga ungjillor Lluka quhet Simon Zeloti, që do të thotë i zellshëm.

2-**Judë Iskarioti.** Juda ishte i biri i Simonit. Këtë fakt na e jep ungjillori Joan (6,71). Juda ishte i vetmi që nuk ishte nga qyteti i Galilesë. Ai kishte lindur në qytetin Kariot, prandaj quhej edhe Judë Iskarioti duke marrë emrin e vendlindjes së tij.

UDHËZIME PËR MISIONIN

(Marku 6:6-13, Lluka 9:1-6)

5 Këta të dy-mbë-dhjetë dërgoj Jisuj, pasi i porositi ata, dyke thënë: Nd’udhë gjindarësh mos shkoni, edhe ndë qytet Samaritësh mos hyni;

1-**Mos hyni në qytet samaritanësh.** Samaria gjendej midis Judesë dhe Galilesë. Samaritanë qenë fis i përzjerë dhe kishin armiqësi me judenjtë. Samaritanët njihnin vetëm pesë librat e Moisiut dhe prisnin ardhjen e Mesisë. Armiqësia midis judenjve dhe samaritanëve kishte lindur në kohën kur judenjtë u kthyen nga rrobëria babilonike. Samaritanët nuk i ndihmuan ata që të rindëronin tempullin, por ndërtuan një tempull në malin Garizin.

6 Po shkoni më tepërë ndëpër dhënt të-humbura të-shtëpis s’Israilit. 7 Edhe dyke vaturë, lëçitni dyke thënë: Se u

afërua mbretëri' e qiejvet. **8** Shëroni të-sëmurë, qëroni të-krromosurë, (ngjallni të-vdekurë), nxirni djaj; dhurëti muartë, dhurëti epni. **9** Mos kini ar, as ergjënt, as remë ndëpër brezat t' uaj; **10** Mos kini trastë mb'udhë, as dy rroba, as këpucë, as stap; sepse punëtori e vëjen ushqimn' e ti.

1- Dhentë e humbura të shtëpisë të Izraelit. Krishti i porositi dishepujt që të shkonin tek delet e humbura të shtëpisë së Izraelit.

11 Edhe mbë çdo qytet a krye-fshat që të hyni, vëshgoni cili është'i-vëjejturë nd'atë, edhe mbetuni atje gjersa të dilni. **12** Edhe kur të hyni ndë shtëpit, përshëndet-e-ni atë.

1-Përshëndeteni atë. Përshëndetja e hebrenjve në atë kohë ishte: "Paqe mbi ju" që do të thoshte bekimi i Perëndisë ardhhtë mbi ju.

13 Edhe ndë qoftë shtëpia e-vëjejturë, paqtimi juaj letë vinjë mb'atë; po ndë mos qoftë e-vëjejturë, paqtimi juaj letë kthenetë mbë ju. **14** Edhe ay që të mos u presë juve, as të mos dëgjonjë fjalëtë t'uaj, kur të dilni prej asaj shtëpie, a prej ati qyteti, shkuntni pluhurin' e këmbëvet t'uaj. **15** Me të-vërtetë po u them juve, se më i-duruarshim do të jetë mundimi mbë dhet të Sodhomavet e të Gomorravet ndë ditët të gjyqit, se mb'atë qytet.

1- Shkundni pluhurin e këpucëve. Hebrenjtë e kishin për zakon që kur udhëtonin nëpër vendet idhujtare, sapo futeshin në tokën e premtuar, pra në Palestinë, ata shkundnin pluhurin e këpucëve të tyre. Këtu e ka kuptimin që të ndërprisnin çdo lloj lidhje me idhujtarët.

2- Sodomi dhe Gomora. Qenë dy qytete në juglindje të Palestinës. Këto qytete në vitin 1900 para Krishtit u dënuan nga Perëndia dhe u përmbytën nga Deti i Vdekur (Gjeneza 19).

KUNDËRSHTIMI I BOTËS PËR MISIONIN

(Marku 13:9-13, Lluka 12:2-7, 21:12-19)

16 Ja tek po u dërgonj unë juve posi dhën ndë mest të ujqërvet; bëhi pra të-urtë posi gjërpënjtë, edhe të-butë posi pëllumbatë. **17** Edhe ruhi nga njerëzitë; sepse do t'u apënë juve ndër duar ndëpër bashkëndënje, edhe do t'u rrahënë ndëpër sinagogjit të tyre; **18** Edhe do t'u nxjerrënë juve për punë t'ime përpara të parëve edhe përpara mbretërve, për dëshmim mb'ata edhe mbë kombet. **19** Po kur t'u apënë juve ndë duar, mos kini kujdes se qysh a se ç'do të flisni; sepse do t'u epetë juve nd' atë orë ç'dotë flisni. **20** Sepse nukë jeni ju ata që flisni, po Frym'e Atit t'uaj që flet ndër ju. **21** Edhe vëllaj do të apë në dorë të vëllanë për të vrarë, edhe i ati të birrë; edhe bijtë do të ngrenë krye kundrë përindërvet e do t'i vrasënë. **22** Edhe do t'u kenë mëri juve të-gjithë për emërinë t'im; edhe ay që të duronjë gjer ndë funt, ky do të shpëtonjë. **23** Po kur t'u ndjekënë juve ndë këtë qytet, ikëni mbë tjatërinë; sepse me të-vërtetë po u them juve, se nukë do t'i mbaroni qytetet'e Israilit, gjer sa të vinjë i Bir'i Njeriut.

1- Atëhere do t'ju mudojnë dhe do t'ju vrasin. Pothuajse të gjithë perandorët romakë, përpara se të mbretëronte Konstandini i Madh, i kanë përndjekur të krishterët duke filluar që nga Neroni (54-68) e deri tek Diokliciani (248-305). Përndjekjet qenë të shumta, por historiani Honore e përcaktoi në 10-të numërin e tyre, duke i karakterizuar këto si më të përgjakshmet. Numëri dhjetë, u pranua si simbolik duke u krahasuar me dhjetë plagët (fatkeqësitë) e Faraonit, të cilat janë konsideruar si prototip i përndjekjeve ndaj të krishterëve.

Vetë Zoti ynë Jisu Krishti kishte parathënë: “Atëhere do t'ju mudojnë dhe do t'ju vrasin. Të gjithë popujt, do t'ju urrejnë për shkakun e emrit tim. Atëhere shumë do të lenë fenë do ta tradhëtojnë

njeri-tjetrin dhe do të kenë mëri njëri-tjetrin. Shumë profetë të rremë, do të ngrihen dhe do të gënjejnë shumë veta. Do të shtohet padrejtësia dhe dashuria e të shumtëve do të ftohet. Por kush do të durojë deri në fund, do të shpërblehet” (Mat.24. 9-13).

2- Nuk do t’i mbaroni qytetet derisa të vijë Biri i Njeriut.

Dishepujt fillimisht predikuan ungjillin tek judenjtë. Ata shkronin qytet më qytet deri sa të vinte dita. Vetëm pas rrënimit të Jerusalemit ata shkuan të predikonin ungjillin e shenjtë tek popujt paganë.

24 Nuk’ është nxënësi përmbi mësonjësini, as shërbëtori përmbi të zonë. 25 Mjaft është për nxënësinë të bënetë si mësonjësi i ti, edhe shërbëtori si i zoti. Ndë qoftë se të zon’e shtëpisë e quajtnë Veelizevull, sa më shumë shtëpjakësit’ e ti? 26 Mos u keni frikë pra atyreve; sepse nukë ka gjë të-mbuluarë që nukë do të zbulonetë; edhe gjë të-fshehurë që nukë do të dihetë. 27 Atë që po u them juve nd’errësirët, tho-e-ni ndë dritët, edhe atë që dëgjoni ndë vesht, lëçit-e-ni përmbi shtëpit. 28 Edhe mos kini frikë nga ata që vrasënë trupinë, e shpirtinë s’ munt t’a vrasënë trupinë, e shpirtinë s’ munt t’a vrasënë; po kini frikë më shumë nga ay që munt të humbasë ndë gjehenë edhe shpirtinë edhe trupinë. 29 Nukë shitenë dy zoq për një asprë? po një nga ata nukë do të bjerë mbi dhet, pa urdhërin’ e Atit t’uaj. 30 Po juve edhe qimet’e krejt u janë të-numëruara. 31 Mos kini frikë pra; juve ndani nga shumë zoq.

1- Nuk shiten dy zogj për një asprë. Të varfërit ushqeheshin me zogj. Aspra ishte monedhë romake.

DOMOSDOSHMERIA E POHIMIT

(Lluka 12:8-12)

32 Kushdo pra që të më rrëfenjë përpara njerëzet, edhe unë do t'a rrëfenj atë përpara t'im Eti që është ndë qiejt. 33 Po kush të më mohonjë përpara njerëzvet, do t'a mohonj edhe un'atë përpara t'im Eti që është ndë qiejt.

1- **Kush do të më rrëfenjë përpara njerëzve.** Në këtë rast ashtu si edhe në predikimin në mal, Krishti flet për veten e tij, si gjykues i njerëzve në jetën e përjetëshme. Ky varg e ka kuptimin që ai që do ta njohi si shpëtimtarin e tij do ta pranoh në jetën e përjetëshme.

PËRÇARJA E NJERËZVE

(Lluka 12:51-53)

34 Mos pandehni se kam ardhurë të vë paqtim mbi dhët; s'kam ardhurë vë paqtim, po thikë. 35 Sepse kam ardhurë të ndanj njerinë kundrë t'et, edhe bijënë kundrë s'ëmësë, edhe nusenë kundrë së vjehërrësë. 36 Edhe armiqt' e njeriut do të jenë shtëpjakësit' e ti.

1- **Thikë.** Thika nënkupton luftën. Pra ai që beson, bëhet luftëtar i Krishtit dhe ndeshet.

2- **Sepse kam ardhur të ndaj njerinë.** Këto vargje i ka parathënë profeti Mikea: “Sepse i biri turpëron të atin, bija ngre krye kundër nënës, e reja kundër vjehrës, armiqtë e secilit janë ata të shtëpisë së tij” (Mikea 7,6).

DASHURIA PËR JISUIN, KRITER GJYKIMI

(Lluka 14:26-27)

37 Ay që do t'an a t'ëmënë më tepërë se mua, nuk'është i-vëjejturë për mua; edhe ay që do bir a bijë më tepërë se mua,

nuk' është' i vëjjeturë për mua. 38 Edhe ay që nukë merr kryqin' e ti, e nukë vjen pas meje, nuk' është' i vëjjeturë për mua. 39 Ay që gjeti jetën' e ti do t'a humbasë; edhe ay që të humbasë jetën' e ti për punë t'ime do t'a gjenjë atë.

1-Kryqi. Krishti në këtë rast profetizon vdekjen e tij në kryq. Ai besimtar, i cili dëshiron që ta ndjekë me besnikëri Krishtin në jetën e tij duhet të ngrejë kryqin. Nëse ngren kryqin e tij dhe nddjek udhën që përshkoi Krishti atëherë ka dashurinë e vërtetë.

QËNDRIMI KUNDREJT APOSTUJVE

(Marku 9:41)

40 Ay që pret juve, më ka priturë mua; edhe ay që më pret mua, ka pritur' atë që më ka dërguarë mua. 41 Ay që pret profit mb'emërë profiti, pagë profiti do të marrë; edhe ay që pret të-drejtë mb'emërë të-drejti, pagë të drejti do të marrë. 42 Edhe ay që t'i apë vetëmë një kupë ujë të-ftohëtë ndonjëjt nga këta të vegjëlitë mb'emërë nxënësi, me të-vërtetë po u them juve, se nukë do t'e humbasë pagën' e ti.

1- Ai që pret profet në emër profeti. Fraza hebraike “në emër profeti” nënkupton apostujt e shenjtë. Ata që dëgjojnë apostujt në predikimin e tyre, do të marrin shpërblimin në qiell.

KREU I NJËMBËDHJETË

1 Edhe Jisuj kur mbaroj dyke porositurë të dy-mbëdhjetë nxënësit’e ti, iku andej, që të mësonjë e të lëçisnjë ndëpër qytetet t’atyre.

1-Porositi nxënësit e tij. Krishti i përgatiti nxënësit për të vazhduar veprën e tij. Apostujt përbënin bërthamën e parë, rreth së cilës u krijua Kisha Militante. Vetë dymbëdhjetë apostujt e shenjtë morën përsipër ta përhapnin ungjillin rreth e rrotull botës.

PYETJA E JOANIT

(Lluka 7:18-23)

2 Edhe Joani kur dëgjoj ndë burgt punërat’e Krishtit, dërgoj dy nga nxënësit’e ti, e i tha ati, 3 Ti je ay që ka për t’ardhurë, apo presimë tjetërë? 4 Edhe Jisuj u përgjeq e u tha atyre: Shkoni e epni zë Joanit për ato që dëgjoni e shihni. 5 Të-verbërë shohënë, e tëçalë ecëjnë; të-krromosurë qëronenë, edhe të-shurdhërë dëgjonjënë; të-vdekurë ngjallenë, e të-vobekve u rrëfenet’ Ungjilli. 6 Edhe i lumurë është’ay që të mos skandhalisetë mbë mua.

1- Ti je ai që ka për të ardhur. Në atë kohë Joan Pagëzori gjendej në burg, prandaj dërgoi dy nga dishepujt e tij për të pyetur Jisuin (Llukai 7,19). Krishti nuk u përgjigjet atyre prerë “Unë jam Mesia”, por u thotë:

2- **“Shkoni e thojini Joanit për mrekullitë që shihni”**. Profeti Isaia (35,5) e kishte parathënë: “Atëhere do të hapen sytë e të verbërve dhe veshët e shurdhërve”. Pas gjithë këtyre mrekullive ai ishte Mesia i shumëpritur. “Fryma e Zotit është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t’u dhënë një lajm të mirë të përlururve, më ka dërguar të lidh plagën e atyre që kanë zemër të thyer, të shpall çlirimin e atyre që janë në robëri, hapjen e burgut të burgosurve” (Isaia 61,1).

FIGURA E JOANIT

(Luka 7:24-35)

7 Edhe këta tek po shkoninë, Jisuj zuri t’i thotë gjindjesë për Joaninë, ç’dualltë të vini re ndë shkretëtirët? Kallam që tundetë nga era? 8 Po ç’dualltë të shihni? Njeri të-vëshurë me rroba të-buta? Ja ata që kanë veshurë rroba të-buta tek janë ndëpër shtëpirat të mbretërvet. 9 Po ç’dualltë të shihni? Profit? Me të-vërtetë po u them juve, edhe më tepërë se profit; 10 Sepse ky është’ ay për të-cilinë është shkruarë, “Ja unë tek dërgonj ëngjëllinë t’im përpara faqesë s’ate, i-cili dotë ndreqnjë udhënë t’ënde përpara teje”.

1-Më tëpër se profet. Populli doli në shkretëtirë për të parë Joanin. Vepra kryesore e Joanit ishte parapërgatitja e popullit për ardhjen e Mesisë. Prandaj quhet edhe pararendësi i Krishtit. Njerëzit mendonin se do të shikonin një njeri të veshur me rroba të buta, por veshja e Joanit ishte krejt ndryshe: “Vishej me një rrobë leshi të devesë dhe me një brez lëkure në bel, ai ushqehet me karkaleca e mjaltë” (Matheu 3,4).

2- Ja tek po dërgoj lajmëtarin. Kjo është një profeci e Malakias (3,1) “Ja unë po dërgoj lajmëtarin tim për të përgatitur rrugën përpara meje”. Lajmëtarin ishte Pararendësi, i cili i ftonte njerëzit në pendim.

11 Me të vërtetë po u them juve, se ndë mest t'atyreve që kanë lindurë prej grash nuk'është ngriturë ndonjë më i-math se Joan Pagëzori; po më i-vogëli ndë mbretërit të qiejvet është më i-math se ay. **12** Edhe që nga ditt' e Joan Pagëzorit e gjer ndashti mbretëri'e qiejvet shtrëngonet' edhe shtrëngimtarët' e rrëmbejn' atë. **13** Sepse gjithë profitërit' edhe nomi profitepsnë gjer mbë ditët të Joanit. **14** Edhe ndë doni t'a prisni këtë fjalë, ay është' Ilia, që kishte për të ardhurë. **15** Ay që ka veshë për të dëgjuarë, le të dëgjonjë.

1-Ai është Elia. Joani është më i madhi ndër profetët. Perëndia i kishte premtuar profetit Malakia që para ditës së fundit do t'i dërgonte Elinë për ta shpëtuar. "Ja unë do t'u dërgoj Elian, profetin, para se të vijë dita e madhe dhe e llahtarshme e Zotit" (Malakia 4,5).

2- Ai që ka veshë për të dëgjuar le të dëgjojë. Me këto fjalë paralajmërohet populli që të jetë në gadishmëri dhe të mendohet mirë.

KUNDËRSHTIMI I BASHKËKOHËSVE TË JISUIT

(Lluka 10:13-15)

16 Po me se t'a përgjanj këtë bres? U gjan çunavet të-vegjëlë që rrinë ndëpër tregjet, edhe u thërresënë shokëvet të tyre, e thonë, **17** I ramë fyellit për ju, edhe nukë kërcyetë; u bëmë vajë, edhe nukë qatë. **18** Sepse erdhi Joani që as hante, as pinte; edhe thonë, se ka djallinë. **19** Erdhi i Bir' i Njeriut dyke ngrën'e dyke pirë, e thonë, ja njeri hamës e verëpirës, mik i kumerqarëve e i fajtorëve. Edhe dollari e-drejtë dituria nga bijt' e saj.

1- I ramë fyellit për ju, edhe nuk kërcyet; u bëmë vajë, edhe nuk qatë. Në lindje ishte për zakon që dasmat shoqëroheshin

me të rëna fyelli dhe kërcime, ndërsa vdekjet më të qara. Ungjillori i krahason hebrenjtë me fëmijët e vegjël. Ata në vend që të frymëzohen nga predikimi i Joanit, e quajnë atë se kishte djallin. Ndërsa për Krishtin thonin që sqçerohej me farisenjtë dhe kumerqarët.

2- **Dituria nga bijtë e saj.** Këtu e ka fjalën për diturinë e Perëndisë, drejtësinë e tij për të gjithë ata që besojnë.

QYTETET QË NUK PENDOHEN

(Lluka 10:13-15)

20 Atëhere zuri të qërtonjë ata qytete, mbë të-cilët ubënë çudit' e-shuma t'ati, sepse nuk' u penduanë; **21** Mjerë ti Horazin, mjerë ti Vithsaida; sepse çuditë që janë bërë ndër ju, po t'ishinë bërë ndë Tyrë e ndë Sidhonë, që kur dot' ishinë penduarë ndë thes e ndë hi. **22** Veç po u them juve, se ndë Tyrë e ndë Sidhonë më i-duruarshim do të jetë mundimi ndë ditët të gjyqit, se mbë ju. **23** Edhe ti, Kapernaum, që je ngriturë lart gjer ndë qiellit, do të zbreç gjer ndë hadht; sepse këto çudi që janë bërë te ti, po t'ishinë bërë ndë Sodhomat, do të kishinë mbeturë gjer mbë ditët të-sotme. **24** Veç po u them juve, se mbë dhet të Sodhomavet më i-duruarshim do të jetë mundimi ndë ditët të gjyqit se mbë ty.

1- **Mjerë ti Korazin! Mjerë ti Besaida!** Korazini ishte një fshat i Galilesë dhe gjendej rreth dy milje larg prej Kapernaumit. Gjithashtu edhe Betsaida ishte në afërsi të Kapernaumit. Betsaida ishte vendlindja e Petros, Andreas dhe Filipit. Korazini dhe Betsaida qenë dy qytete, në të cilat Krishti kreu mrekulli.

2-**Tiri dhe Sidoni.** Qenë qytete të mëdha tregtare dhe gjendeshin në bregdetin e Finiqit. Këto qytete janë përmendur për jetë mëkatare.

3-**Kapernaumi.** Ka qenë qyteti më i dashur për Krishtin.

ZBULIMI I TË PËRULURVE

(Lluka 10:21)

25 Nd' atë kohë Jisuj u përgjeq e tha: Të lavduronj ty, o Atë, Zot'i qiellit edhe i dheut, se u'a fshehe këto punë të-diturvet e të mënçimvet, edhe u'a zbulove ato foshnjavet.

1-Foshnjave. Me këtë fjale krishti nënkupton gjithë njerëzit e dashur dhe të sinqertë si foshnjat. Krishti e tha këtë lutje pasi shtatëdhjetë dishepujt e tij u kthyen prej një udhëtimi misionar.

26 Po, o Atë, sepse kështu u pëlqye përpara teje. 27 Të-gjitha m'u dhanë në dorë nga im Atë; edhe asndonjë nuk'e njuh Birinë, veç Ati; edhe as Atën' s'e njuh njeri, veç Biri edhe ay, të-cilit të dojë Biri t'ja zbulonjë.

1- Asnjeri nuk e njuh Atin, përveç Birit. Karakterin e Atit, vetëm Krishti mund ta njohi, sepse ai e ka fuqinë nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë.

28 Ejani tek unë gjithë sa jeni të-lodhur'e të-ngarkuarë, edhe unë do t'u prënj juve. 29 Ngrini sgjedhënë t'ime mbi vetëhenë t'uaj, edhe mësoni prej meje; se jam i-butë edhe i-unjë të ndë zëmëret; edhe dotë gjeni të-prëjturë ndë shpirtërat t'uaj. 30 Sepse sgjedha ime është' e-mirë, edhe barra ime është' e lehëtë.

1- Ngrini zgjedhën. Në këtë rast Krishti e krahason barrën e tij me buajt kur janë në parmendë duke punuar tokën, pra nën zgjedhë. Që të mbaje mbi supë Ligjin e Dhiatës së Vjetër ishte një zgjedhë e rëndë, prandaj Krishti na fton që të ngremë zgjedhën e tij.

KREU I DYMBËDHJETË

MBAJTJA E SË SHTUNËS

(Marku 2:23-28, Lluca 6:1-5)

1 Nd' atë kohë Jisuj shkonte ndëpër të mbjellat një ditë të-shëtunë; edhe nxënësvet të ti u erdhi uri, edhe zunë të çkoqinë kallinj, e të hanë. **2** Edhe Farisenjtë kur panë i than'ati: Ja nxënësit' e tu tek bëjn' atë që nuk' është' e udhësë t'a bëjnë të-shëtunë. **3** Po ay u tha atyre: Nukë keni kënduarë ç'bëri Dhavidhi, kur i erdhi uri ati edhe atyre që ishinë bashkë me atë? **4** Qysh hyri ndë shtëpit të Perëndisë, edhe hëngri bukët'e parëvënjesë, të-cilatë nuk' ishte e udhësë t'i hante ay, as ata që ishinë bashkë me atë, po priftëritë vetëmë? **5** Apo nukë keni kënduarë ndë nomt, se të-shëtunatë priftëritë e prishnjënë të-shëtunënë ndë hieroret, edhe janë të-pafajm? **6** Edhe po u them juve, se këtu është një më i-math se hieroreja. **7** Edhe t'a kishitë diturë ç'është, "Dua përdëllim, e jo kurban", nukë dot' i kishitë dënuarë të-pafajmitë. **8** Sepse i Bir'i njeriut është' i zoti edhe i së-shëtunësë.

1- Filluan të këpusin kallinj e ti hanë. Ky veprim sipas ligjit të Moisiut ishte i ndaluar. "Kur hyn në arën e grurit të të afërmit tënd, mund të mbjellësh kallinj, por nuk mund të përdorësh drapërin" (Ligji i Përtërirë 23,25).

2- Hyri në shtëpinë e Perëndisë dhe hëngri bukët e paraqitjes. Me këto fjalë nënkuptojmë tempullin, në mesin e të cilit

gjendej një tryezë ku qenë vendosur 12 bukë, të cilat përfaqësonin 12 fiset e Izraelit. Bukët vendoseshin në dy rradhë mbi tryezën prej ari nga gjashtë për secilën. Mbi çdo rradhë vendosej temjan i pastër, i cili simbolizonte fljimin e bërë për Zotin. Në fillim të çdo jave bukët zëvendësoheshin. Ato që mbeteshin i hanin priftërinjtë që shërbenin në tempull. (Levetiku 24, 5-9). Gjithsesi Davidi hyri në tempull dhe i hëngri bukët e paraqitjes.

3- **Këtu është një më i madh se hieroreja.** Krishti në këtë rast flet për veten e tij.

SHËRIMI I BËRË DITËN E SHTUNË

(Marku 3:1-6, Lluka 6:6-11)

9 Edhe si iku andej, erdhi ndë sinagogjit t'atyre. 10 Edhe ja tek ishte një njeri që kishte dorënë të-tharë; edhe e pyetnë atë, dyke thënë: Nd' është e udhësë të shëronjë njeriu të-shëtunë; që t'a përfllisnin' atë.

1- **Të shtunave shkonte nëpër sinagoga.** Krishti i mësonte njerëzit çdo ditë. I mësonte nëpër male, fusha, fshatra dhe qytete. Veçse të shtunave shkonte nëpër sinagoga. E shtuna ishte ditë pushimi për hebrenjtë sepse në atë ditë ata mblidheshin dhe dëgjonin fjalën e Perëndisë. Pikërisht gjatë një dite të tillë adhurimi, Krishti bëri një mrekulli.

2- **Të shërojë të shtunën.** Këtë ditë hebrenjtë e kishin ditë falje dhe nuk duhej të bënin asnjë punë duke zbatuar porositë e dekalogut që thotë: "gjashtë ditë të javës punoni, por ditën e shtatë t'ia kushtoni adhurimit të Perëndisë. Farisenjtë nuk mund që ta kuptonin që shërimi nuk është punë, por bamirësi është vepër shenjtërimi e ditës së pushimit. Nuk dëshironin që të vazhdojnë shërimet sepse nuk donin që të lavdëroet emri i Perëndisë. Nga njera anë hiqen si shpresëtar duke kërkuar me rreptësi zbatimin e ditës së

pushimit dhe nga ana tjetër përdorin çdo lloj dinakërie dhe hipokrizie për të ulur autoritetin e Krishtit.

11 Edhe ay u tha atyre: Cili njeri nga ju do të jet'ay, që do të ketë një dele, edhe ndë i rëntë kjo ndë gropë ditën' e-shëtunë, nukë do t'a zërë e t'a ngrerë atë? 12 Sa më tepërë pra ndan njeriu nga delja! Përandaj është' e udhësë të bënjë mirë njeriu të-shëtunatë.

1- **Krishti u përgjigjet farisenjve:** Ta nxjerrësh delen nga gropa lejohet dhe nuk lejohet që ky njeri shpresëtar të shërohet nga sëmundja që e mundon prej vjitesh.

13 Atëhere i thotë njeriut, shtri dorënë t'ënde. Edhe ay e shtriti, edhe u bë e shëndoshë posi tjetëra. 14 Po Farisenjtë duallë e bënë këshillë kundrë ati, që t'a prishnjënë.

1- **Mrekullia e së shtunës.** Në mes të kësaj atmosfere entuzjazmi dhe gëzimi diçka stononte. Qenë farisenjtë të cilëve nuk i pëlqeu kjo gjë sepse ishte e shtunë. Ky varg ungjillor na sjell dy tipa njerëzish me karakter të kundërt: një njeri të thjeshtë e të përvuajtur, i cili u gëzua nga mrekullia dhe farisenjtë, që u dëshpëruan përse Krishti e shëroi të shtunën.

2- **Farisenjtë.** Tipa të tillë si farisenjtë, të cilët nën maskën e mbrojtjes së të vërtetës fshehin qëllime egoiste, interesa personale, synime të dobëta, smirë, e urrejtje ka mjaft. Këta tipa që ndryshe paraqiten dhe ndryshe janë, që flasin për ideale të larta, por që në shpirtin e tyre nuk gjen asnjë shenjë mirësie, Krishti do t'i kritikojë si hipokritë.

PROFECIA E ISAISË PËR JISUIN

15 Po Jisuj si e kupëtoj, iku andej; edhe vanë pas ati shumë gjindje, edhe i shëroj ata të-gjithë. **16** Edhe i porositi ata shtrënguarë të mos e dëftejn' atë; **17** Që të mbushetë ç'është thënë nga profiti Isai, që thotë, **18** “Ja shërbëtori im që e zgjodha, i-dashuri im, që e pëlqeu shpirti im; do të vë Frymënë t'ime mb' atë, edhe do të dëftenjë gjyq mbë kombet.

1- **Ja shërbëtori im.** Këtu e ka kuptimin që Krishti u përul aq shumë duke marrë natyrën e shërbëtorit të të tjerëve.

19 Nukë do të bënë fjalë, as nukë do të bërtasë; as nukë do të dëgjonjë ndonjë zën' e ati ndëpër rrugat. **20** Kallam të-shtypurë nukë shqyenjë, edhe li që nxjer tym nukë do të shuanjë gjersa të nxjerrë gjyqinë ndë mundje. **21** Edhe kombetë do të shprenjë mb'emërit t'ati.”

1- **Ai nuk do të zihet.** Me këto fjalë ungjillori nënkupton që Krishti nuk do të debatojë.

2- **Nuk do të bërtasë.** Gjithashtu Krishti nuk do të bërtasë nëpër rrugë siç bënin rabinët.

3- **Njerëzit do të shpresojnë.** Me të vërtetë njerëzit do të shpresojnë tek Krishti. Ata do ta presin si shpëtimtar për ti çliruar nga mëkatet.

PUSHTETI I JISUIT MBI DEMONËT

(Marku 3:20-27, Lluka 11:14-23)

22 Atëhere i prunë ati një të-djallosurë, të verbër' e të-shurdhërë; edhe e shëroj atë, kaqë sa i-verbëri edhe i-shurdhëre fliste edhe shihte. **23** Edhe gjithë gjindja habiteshin' e thoshinë, Mos është ky i bir' i Dhavidhit? **24** Po Farisenjtë kur dëgjuanë

thanë, Ky nukë nxjer djajtë, veç me anë të Veellzevullit, të-parit të djajvet.

1- **Me fuqinë e Beelzebulit.** Farisenjtë kishin qëllim që ta largonin Krishtin nga populli, prandaj thonin “ky i nxjerr demonët me ndihmën e Beelzebulit, të parit të djajve”.

25 Edhe Jisuj si njohu mendimet’ e atyreve, u tha atyre, çdo mbretëri ndë u ndaftë kundrë vetëhes’ së saj, shkretonetë; edhe çdo qytet a shtëpi ndë u ndaftë kundrë vetëhes’ së saj, nukë do të qëndronjë. 26 Edhe satanaj ndë nxjertë satananë, u nda kundrë vetëhes’ së ti; qysh do të qëndronjë mbretëri’e ati? 27 Edhe ndë qoftë se unë nxjer djajtë me anë të Veellzevullit, bijtë t’uaj me ç’anë i nxjerrënë? Përandaj ata do të jenë gjyqtarëtë t’uaj. 28 Po ndë qoftë se unë nxjer djajtë me anë të Frymës’ së Perëndisë, pa fjalë arriti mbë ju mbretëri’ e Perëndisë.

1- **Ai është i përçarë në vetvete.** Krishti i dëbon demonët, prandaj është e palogjikshme që ai të ketë marrëveshje me ta. Si është e mundur që farisenjtë e quajnë satanai që dëbon satananë? E vërteta është që demonët kanë lidhur marrëveshje për ta luftuar atë.

29 A qysh munt të hynjë ndonjë ndë shtëpit të të-fortit, e të rrëmbenjë enët’ e ati, ndë mos lithtë më përpara të-fortinë, edhe atëhere do t’a bënë rrëmullë shëpin’ e ati? 30 Ay që nuk’ është bashkë me mua, është kundrë meje; edhe ay që nukë mbleth bashkë me mua, përndan.

1- **Është kundër meje.** Në këtë rast Krishti e thotë hapur mendimin e tij: Ai që nuk është me mua është kundër meje. Njerëzit janë të lirë të zgjedhin, të përqafojnë të mirën dhe të fitojnë jetën e përjetshme, apo të keqen dhe të përfundojnë në ferr.

BLASFEMIA KUNDËR SHPIRTIT TË SHENJTË

(Marku 3:28-30, Lluca 12-10)

31 Përandaj u them juve, se çdo faj e çdo sharje do t'u ndjenetë njerëzvet; po sharja kundrë Frymës' së-Shënjtëruarë nukë do t'u ndjenetë njerësvet. 32 Edhe ati që të thotë fjalë kundrë të Birit të Njeriut, do t'i ndjenetë, po ati që të thotë fjalë kundrë Frymës' së- Shënjtëruarë, nukë, do t'i ndjenetë as mbë këtë jetë, as mb'atë që vjen.

1- Blasfemia ndaj Shpirtit të Shenjtë. Krishti porositi prerë dhe qartë, nëse mëkatet e tjera falen, blasfemia ndaj Shpirtit të Shenjtë nuk do të falet.

FJALËT GJYKOJNË NJERIUN

(Lluca 6:43-45)

33 A bëni drurinë të-mirë, edhe pemën'e ati të-mirë; a bëni drurinë të-lik, edhe pemën'e ati të-ligë; sepse druri njihetë nga pema. 34 Të-pjellë nepërkash, qysh munt të flisni të-mira, dyke qënë tëliq? Sepse goja flet nga tepëric' e zëmëresë. 35 Njeriu i-mirë nxjer të-miratë nga thesar'i mirë i zëmëresë; edhe njeriu i-lik nxjer të-liga nga thesar'i-lik. 36 Edhe po u them juve, se çdo fjalë të-kotë ndë e folçinë njerëzitë, dot' apënë fjalë për atë ndë ditët të giyqit. 37 Sepse nga fjalët' e tua do të dalç i-drejtë, edhe nga fjalët' e tua do të dënohesh.

1- Si mund të flisni mirë, kur jeni të këqinj. Dinakërinë e farisenjve Krishti e krahason me pemën e Edemit, me mosbindjen e protoplastëve, nëpërmjet së cilës erdhi mëkati në botë. Nëse veprat e Jisuit janë të mira atëherë edhe ai është i mirë. Ndërsa farisenjtë, të cilët blasfemojnë dhe shtrembërojnë të vërtetën janë të këqinj. Si konkluzion përfundimtar mund të themi që nuk mjafton që të bëjmë

vetëm vepra të mira në jetë, por të themi edhe fjalë të mira, sepse sipas fjalëve do të gjykohen njeriu.

SHENJA E JONAS

(Marku 16:1-4, Marku 8:11-12, Lluka 11:29, 32)

38 Atëhere u përgjeqnë ca nga shkronjësit' e nga Farisenjtë, dyke thënë: Mësonjës, duamë të shohëmë shënjë prej teje. **39** Edhe ay u përgjeq, e u tha atyre, bres i lik edhe kurvar lypën shënjë; edhe shënjë nukë do t'i epetë ati, përveç shënjës' së profitit Jona. **40** Sepse sindëkur Jonaj ishte ndë barkt të qitit tri dit e tri net, kështu do të jetë edhe i Bir'i njeriut ndë zëmëret të dheut tri dit e tri net. **41** Burra Ninevitë do të ngjallenë ndë ditët të gjyqit bashkë me këtë bres, edhe do t'a gjykonjë për të-lik; sepse u penduanë ndë të-lëçiturit të Jonajt; edhe ja këtu tek është më tepërë se Jonaj. **42** Mbretëresh'e Anës' së Mesditësë do të ngjalletë bashkë me këtë bres ndë ditët të gjyqit, edhe do t'a gjykonjë për të-lik; sepse erdhi nga anët'e fundit të dheut, që të dëgjonjë diturin'e Sollomonit; edhe ja këtu tek është më tepërë se Sollomoni.

1- Ky brez kurorëshkelës. Në Dhiatën e Vjetër Perëndia kishte lidhur besëlidhje me popullin hebraik. Në mënyrë metaforike mund të themi që Perëndia ishte dhëndëri dhe Izraeli që nusja. Ndarja e dhëndërit nga nusja quhet shkalke e kurorës.

2- Shenja e profetit Jona. Ashtu si profeti Joana qëndroi tri ditë në barkun e balenës, kështu edhe Biri i Njeriut do të qëndrojë tri ditë e tri net në zemët të tokës. Më pas ai to të ngjallet.

3- Banorët e Ninivit, të cilët u penduan me profecinë që u tha Jonai, ndërsa judenjtë nuk pendohen nga predikimi i Mesias, i cili është më i madh se profeti Jona. Ninivi ishte kryeqyteti i perandorisë Asiriane. Ky qytet shpëtoi vetëm me predikimin e profetit

Joana dhe përbën shembullin për të gjithë qytetet e tokës. “Atëherë Niniveasit i besuan Perëndisë, shpallën argjërime dhe u veshën me thes, nga më i madhi deri tek më i vogli nga ata” (Jona 3, 5).

4- **Mbretëresha e jugut.** Ajo jetonte në qytetin Sava dhe ishte mbretëresha e Egjiptit dhe Etiopisë. Mbretëresha erdhi nga skaji më i largët vetëm për të dëgjuar urtësinë e Sollomonit, ndërsa judenjtë kishin një më të ditur se Sollomoni dhe nuk donin ta dëgjonin.

KTHIMI I SHPIRTIT TË NDIYRË

(Lluka 11:24-26)

43 Edhe frym’ e-ndyrë kur del nga njeriu shkon ndëpër vende të-paujëshim, dyke kërkuarë të-prëjturë, e nukë gjen. 44 Atëhere thotë le të kthenem ndë shëpit t’ime, andej nga dolla. Edhe si vjen, e gjen atë të-zbrazëtë, të-fshir’ e të-stolisurë 45 Atëhere vete e merr me vetëhe shtatë fryma të-tjera më të-liga se vetëhen’e saj, edhe hyjn’ e rrinë atje; edhe të pastajmet’e ati njeriu bënenë më të-këqia se të-paratë. Kështu do të jet’ edhe mbë këtë bres të-lik.

1- **Endet nëpër vende të thata.** Hebrenjtë besonin që demonët banonin nëpër vende të lagështa, në pyje të cilët kishin pranë lumin ose liqenin.

2- **Këtij brezi të mbrapshtë.** Ky brez i mbrapshtë do të ndëshkohet, sepse është kthyer në gjendjen e mëparëshme të mëkatit. Judenjtë kanë qenë popull i zgjedhur dhe i bekuar, ndërsa tani katastrofa të tmerrëshme i presin.

NËNA DHE VËLLEZËRIT E JISUIT

(Marku 3:31-35, Lluka 8:19-20)

46 Edhe ay tek po ishte dyke folurë gjindjesë, ja e ëma edhe të vëllezërit’e ati tek po rrininë jashtë, e kërkoninë të flianinë

me atë. **47** Atëhere një njeri i tha ati: Ja jot'ëme edhe t'ët vëllezër po rrinë jashtë, e kërkojnë të flasënë me ty. **48** Po ay u përgjeq e i tha ati që tha këtë: Cila është im'më, edhe cilët janë t'im vëllezër? **49** Edhe shtriti dorën'e ti mbi nxënësit'e ti, e tha: Ja im'më edhe t'im vëllezër. **50** Sepse kush të bënjë dashurimin'e t'im Eti që është ndë qiejt, ay më është vëlla e motër' e mëmë.

1-Jot ëmë dhe vëllezërit. Për nënën dhe vëllezërit e Krishtit bëhet fjalë në ungjill. “Nuk quhet nëna e tij Mari, dhe vëllezërit e tij Jakob, Iose, Simon dhe Juda”? (Matheu 13,55). Në këtë rast Krishti nuk mohon nënën dhe vëllezërit e tij, me të cilët e lidh gjaku, por Ai ka prind e vëllezër të gjithë ata që besojnë në të dhe quhen të krishterë.

KREU I TREMBËDHJETË

PARAVOLIA E MBJELLËSIT

(Marku 4:1-9, Lluca 8:4-8)

1 Edhe mb'atë ditë si doli Jisuj nga shtëpia, rrinte për anë detit. **2** Edhe u nblotnë tek ay shumë gjindjë, kaqë sa ay hyri ndë lundrët e rrinte; edhe gjithë gjindja rrinte buzë detit. **3** Edhe u foli atyre shumë me paravoli, dyke thënë, ja mbjellësi tek doli të mbjellë.

1- **Rrinte pranë detit.** Këtu e ka fjalën për liqenin e Tiveriadhës.

2- **Ja mbjellësi tek doli të mbjellë.** Fara që mbillet simbolizon Fjalën e Perëndisë, ndërsa mbjellësi është vetë Krishti, i cili me anë të predikimeve të tij, mbolli farën e besimit në zemrat e njerëzve.

4 Edhe ay tek po mbillte, ca ranë për anë udhësë; edhe erthnë shpestë e i hëngrë të gjitha. **5** Ethe të-tjera ranë mbë gurishtet, tek s'kishte dhe shumë; edhe për-një-herë mbinë, sepse s'kishte dhe të-thellë; **6** Po kur lindi djelli, u doqnë, edhe passi nukë kishinë rrënjë, u thanë.

1- **Fara që ra pranë udhës.** Në rastin e parë zemrat e njerëzve qenë të ashpra e të ngurta si rruga që sado farë të hedhësh asnjëherë nuk ka për të mbirë. Ata që qëndrojnë përgjatë rrugës e

dëgjojnë fjalën e Perëndisë, por ajo qëndron në sipërfaqe, më pas vjen djalli dhe ua mer fjalën nga zemrat e tyre, që ata të mos i besojnë doktrinës së Ungjillit dhe të mos shpëtojnë.

2- **Farat që ranë në gurishte.** Në rastin e dytë zemrat e njerëzve i ngjajnë tokës me gurë. Ata në fillim e dëgjojnë me kënaqësi fjalën e Perëndisë, por besimi i tyre nuk është i thellë dhe i qëndrueshëm. Sapo shfaqen tundimet dhe vështirësitë entuziazmi i këtyre njerëzve shuhet dhe ata tërhiqen.

7 Edhe të-tjera ranë drizat, edhe u rritnë drizatë, e i mbytn'ato.

1- **Farat që ranë në driza.** Në rastin e tretë simbolizon zemrat e atyre njerëzve, të cilët e dëgjojnë fjalën e Perëndisë dhe përpiqen për ta zbatuar, por ua zënë frymën shqetësimet, pasuritë, kënaqësitë e jetës dhe nuk u ngelet kohë për kultivimin e shpirtit. Tek këto zemra fjala e Perëndisë përsëri nuk jep fryte. Në këtë kategori futen ata njerëz që në një pjesë të shpirtit të tyre mbollën lulet aromatike të virtuteve të krishtera dhe bashkë me to kultivuan ferrat e mëkatit. Janë ata njerëz që njerin sy e drejtojnë nga qielli dhe tjetrin drejt baltës së botës.

8 Edhe të-tjera ranë mbë dhe të-mirë; edhe epninë pemë, njëra një-qint, e tjatëra gjashtë-dhjetë, e tjatëra tridhjetë.

1- **Farat që ranë në dhe të mirë.** Rasti i fundit simbolizon njerëzit, zemra e të cilëve është tokë pjellore. Ata e dëgjuan me gëzim fjalën e Perëndisë dhe e ruajtën në zemrat e tyre. Paravolia e mbjellësit na kujton që secili prej nesh të shohi veten e tij dhe me ndershmeri e sinqeritet të përcaktojë se cilit rast i përket.

9 Kush ka veshë për të dëgjuarë le të dëgjonjë.

1- **Kush ka veshë.** Zemra e njeriut është si një arë, e cila edhe në qoftë se është e mbushur me gurë dhe gjemba, me vese e të meta, pasione dhe dëshira të liga, asnjëherë nuk duhet që t'i humbim shpresat. Por t'i lutemi gjithnjë Perëndisë, që të na e kultivojë këtë arë të çmuar që quhet shpirt njerëzor. Sepse edhe arra me gurë e gjemba po të kultivohet mund të bëhet tokë pjellore, kështu ndodh edhe me shpirtin njerëzor, nëse mbi të kalon plugu i dhimbjes dhe po të vaditet me lotët e pendesës atëhere ky shpirt do të zbutet dhe do të japë fryte.

2- **Le të dëgjojë.** Ashtu siç kultivon bujku arën për ta mbjellë, edhe i krishteri duhet ta kultivojë shpirtin e tij që të mbijë fjala e Perëndisë dhe të japë frytet me anë të virtyteve hyjnore. Kultivimi i shpirtit me këto virtyte bëhet vetëm duke studiuar Shkrimin e Shenjtë. Sado mëkatarë që të jemi vetëm duke lexuar Biblën do të na hapen sytë e besimit për të parë dritën e vërtetë.

PSE FLET JISUI ME PARAVOLI

(Marku 4:10-12, Lluca 8:9,10)

10 Edhe nxënësit' erthnë për'an' e i than' ati: Përse u flet atyre me paravoli?

1-**U flet atyre me paravoli.** Por ç'farë kuptojmë me fjalën paravoli? Ato janë figura dhe shembuj që janë marrë nga natyra dhe jeta e përditëshme e njerëzve. Me anën e paravolive Krishti paraqiste të vërtetat e besimit. Por që ato të bëheshin të kuptueshme nga shpirtrat e njerëzve, ai jepte shembuj të thjeshtë.

11 Edhe ay u përgjeq e u tha atyre: Sepse mbë ju është dhënë të merrni vesh të-fshehurat'e mbretëris'së qiejvet, po mb'ata nuk'është dhënë. 12 Sepse ati që ka do t'i epetë edhe më

edhe do të tepëronjë; po ay që nukë ka, edhe ç'të ketë do të merretë nga ay. **13 Përandaj u flas atyre me paravoli, sepse dyke parë nukë shohënë, edhe dyke dëgjuarë nukë dëgojnë, as nukë kupëtojnë.**

1- Prandaj u flas me paravoli. Çdo dëgjues i paravolive kupton aq sa e ka mundësinë e të kuptuarit. Krishti ka thënë gjithsej shtatë paravali për Mbretërinë e Qiejve. Këto paravoli mendohet se i ka thënë në një ditë, katër prej tyre i tha që nga varka dhe tre të tjerat kur dishepujt qenë të mbledhur në shtëpi.

14 Edhe mbushetë mb'ata profiti'e Isaisë, që thotë, "Me të-dëgjuarë dotë dëgjioni, po nukë dotë merrni vesh; edhe dyke parë dotë shihni, po nukë dotë kupëtoni". 15 Sepse u trash zëmër' e këti Iluazi, edhe dëgjuanë rëndë me veshët'e tyre, edhe mbyllnë syt'e tyre, semos shohënë ndonjë herë me sytë, edhe dëgojnë me veshëtë, edhe kupëtojnë me zëmërenë, edhe kthenenë, e i shëron ata. 16 Po juve u janë të-lumurë sytë, se shohënë; edhe veshëtë t'uaj, se dëgojnë. 17 Sepse me të-vërtetë po u them juve, se shumë profitër edhe të-drejtë dëshëruanë të shohënë sa shihni ju, edhe nukë panë; edhe të dëgojnë sa dëgjoni ju, edhe nukë dëgjuanë.

1- Nuk dëgojnë as nuk kuptojnë. Krishti i thoshte paravolitë e tij në atë mënyrë që njerëzit e thjeshtë e të sinqertë ti kuptonin, ndërsa armiqtë e tij të mos i kuptonin, me qëllim që të mos i përdornin fjalët e tij për ta luftuar më vonë.

SHPJEGIMI I PARAVOLISË SË MBJELLËSIT

(Marku 4:13-20, Lluka 8:11-15)

18 Ju pra dëgjoni paravolin'e mbjellësit. 19 Kujdo që dëgjon fjalën' e Perëndisë, edhe nuk' e kupëton, vjen i-ligu edhe

rrëmben atë që është mbjellë ndë zëmëret t'ati; ky është si ajo fara që u nbuall për an'udhësë.

1- **Fara që ra pranë udhës.** Në rastin e parë zemrat e njerëzve qenë të ashpra e të ngurta si rruga që sado farë të hedhësh asnjëherë nuk ka për të mbirë. Ata që qëndrojnë përgjatë rrugës e dëgjojnë fjalën e Perëndisë, por ajo qëndron në sipërfaqe, më pas vjen djalli dhe ua mer fjalën nga zemrat e tyre, që ata të mos i besojnë doktrinës së Ungjillit dhe të mos shpëtojnë.

20 Edhe ç'u mbuall mbë gurishtet, ky është ay që dëgjon fjalënë, edhe për-një-herë e merr me gëzim; 21 Po s'ka rrënjë ndë vetëhet të ti, andaj është për pak kohë; sepse kur të bënetë shtrëngim a të-ndjekurë për fjalënë, për-njëherë skandhalisetë.

1- **Farat që ranë në gurishte.** Në rastin e dytë zemrat e njerëzve i ngajnë tokës me gurë. Ata në fillim e dëgjojnë me kënaqësi fjalën e Perëndisë, por besimi i tyre nuk është i thellë dhe i qëndrueshëm. Sapo shfaqen tundimet dhe vështirësitë entuziazmi i këtyre njerëzve shuhet dhe ata tërhiqen.

22 Edhe ç'u mbuall ndër drizat, ky është ay që dëgjon fjalënë; po kujdesi i kësaj bote, edhe gënjimi i gjësë mbyl fjalënë, edhe bënetë i-papemshim.

1- **Farat që ranë në driza.** Në rastin e tretë simbolizon zemrat e atyre njerëzve, të cilët e dëgjojnë fjalën e Perëndisë dhe përpiqen për ta zbatuar, por ua zënë frymën shqetësimet, pasuritë, kënaqësitë e jetës dhe nuk u ngelet kohë për kultivimin e shpirtit. Tek këto zemra fjala e Perëndisë përsëri nuk jep fryte. Në këtë kategori futen ata njerëz që në një pjesë të shpirtit të tyre mbollën lulet aromatike të virtuteve të krishtera dhe bashkë me to kultivuan ferrat e mëkatit. Janë ata njerëz që njerin sy e drejtojnë nga qielli dhe tjetrin drejt baltës së botës.

23 Edhe ç'u mbuall mbë dhet të-mirë, ky është'ay që dëgjon fjalënë, edhe e kupëton; përandaj ay bije pemë, edhe bën njeri një-qint, edhe tjatëri gjashtë-dhjetë, e tjatëri tri-dhjetë.

1- Farat që ranë në dhe të mirë. Rasti i fundit simbolizon njerëzit, zemra e të cilëve është tokë pjellore. Ata e dëgjuan me gëzim fjalën e Perëndisë dhe e ruajtën në zemrat e tyre. Paravolia e mbjellësit na kujton që secili prej nesh të shohi veten e tij dhe me ndershmëri e sinqeritet të përcaktojë se cilit rast i përket.

PARAVOLIA E EGJRIT

24 Një tjatërë paravoli u pruri atyre, dyke thënë, Mbretëri'e qiejvet gjan me një njeri që mbolli farë të-mirë nd'arët të ti;

1-Njeriu që mbjell farën. Ai që mbjell farën është Krishti. Këtu e ka kuptimin që mbjell farën e mirë në zemrat e popullit.

2-Farë të mirë në arë të tij. Këtu me fjalën arë kuptojmë popullin dhe me farë të mirë kuptojmë njerëzit e drejtë.

25 po tek flininë njerëzitë, erdhi armiku i ati, e mbolli egjër ndë mest të grurit, edhe iku. 26 Edhe kur mbiu gruri e bëri pemë, atëhere u duk edhe egjëri. 27 Edhe shërbëtorët' erthnë përënë të-zotit të shtëpisë, e i thanë, Zot, nukë mbolle ti farë të-mirë ndë arët t'ënde? nga doli pra egjëri? 28 Po ay u tha atyre, Ndonjë njëri armik e ka bërë këtë. Edhe shërbëtorët' i than'ati, Do pra të vemi e t'a mbledhëm atë?

1-Këtë e ka bërë armiku. Armiku, i cili mbjell egjërin në arë është djalli.

29 Po ay tha, jo; sepse dyke mbledhurë egjërinë mos çkulni edhe grurëtë bashkë me atë. 30 Lër-i-ni të rritenë të dy

bashkë gjer mbë të-korrët edhe ndë kohët të të-korrit do t'u them korrësvet: Mblithni më përpara egjërinë, edhe e lithni dorëza, për të djegur; atë; po grurët' e mblithni ndë grunart t'im.

1-**Deri në të korra.** Të korrat simbolizojnë gjykimin e fundit.

2-**Do t'u them korrësve.** Këtu e ka kuptimin për engjëjt, të cilët kur të vijë koha e gjykimit do t'i ndajnë të mirët nga të këqijtë.

PARAVOLIA E KOKRRËS SË SINAPIT

(Marku 4: 30-32, Lluca 13:18,19)

31 Një tjetërë paravoli u pruri atyre dyke thënë: Mbretëri'e giejvet gjan me një koqe sinapi, të-cilën'e mori një njeri edhe e mbolli nd'arët të ti; 32 Ajo është më e-vogëlë se gjithë faratë; po kur rritëte, është me e-madhe se lakratë, edhe bënëte dru, kaqë sa vijnë shpest' e qiellit rrinë ndë degat t' ati.

1-**Kokrra e sinapit.** Hebrenjtë me kokrrën e sinapit nënkuptonin farën më të vogël, e cila ishte mikroskopike. Me kokrrën e sinapit ai krahason krishtërimin, i cili sapo kishte filluar të lindte dhe do të gjente hapësira për tu forcuar dhe shtrirë në të gjithë botën.

2- **Bëhet një pemë,** e cila gjendet në brigjet e Galilesë dhe në gjuhën hebraike quhet *hardal*. Kjo pemë prodhon kokkra sinapi prandaj evropianët e quajtën Salvadora Persica.

PARAVOLIA E BRUMIT

(Lluca 13:20,21)

33 Një tjetërë paravoli u foli atyre. Mbretëri e qiejvet gjan me brumë, të-cilin' e mori një grua, edhe e fshehu ndë tri masa mjelli, gjersa u mbrujt gjithë. 34 Këto të-gjitha u'a foli Jisuj gjindjvet me paravolira, edhe pa paravoli nuk'u fliste atyre; 35 Që të mbushetë ç'është thënë nga profiti që thotë, "Do të hap

gojënë t'ime me paravolira; do të flas gjëra të-fshehura që kur është ngrehurë bota”.

1- Do të zbuloj gjëra të fshehura. Ungjillori Mathe në këtë rast përmend atë që është parathënë prej kohësh prej profetit Asafi: “Do të hap gojën time për të thënë shëmbëlltyra, dhe kam për të paraqitur misteret e kohërave të lashta” (Psalmi 78,2).

SHPJEGIMI I PARAVOLISË SË EGJRIT

36 Atëhere Jisuj la gjindjen' e erdhi ndë shtëpit, edhe nxënësit'e ati i erthnë përënë e i thanë, zgjith-na paravolin'e egjërit t'arësë. **37** Edhe ay u përgjeq e u tha atyre: Ay që mbjeli farën' e-mirë është'i Bir'i njeriut; **38** edhe ara është bota; edhe far' e-mirë, këta janë të bijt' e mbretërisë; edhe egjëri janë të bijt'e të-ligut; **39** Edhe armiku, që mbolli ata, është djalli; edhe të-korrëte është të-mbaruarët' e jetësë; edhe korrësitë janë ëngjëjtë. **40** Sindëkur pra mblidhetë egjëri, edhe digjetë ndë zjarr, kështu do të jetë mbë të mbaruarët të kësaj jete. **41** I Bir'i njeriut dotë dërgonjë ëngjëjt; e ti, edhe do të mbledhënë nga mbretëri'e ati gjithë skandhalitë, edhe ata që punojnë paudhërinë; **42** Edhe do t'i hedhën'ata ndë furrët të zjarrit; atje do të jetë të-qarët'e të-kërcëlliturit'e dhëmbëvet. **43** Atëhere të-drejtëtë do të ndritnjënë si djelli ndë mbretërit t'Atit të tyre. Ay që ka veshë për të dëgjuar le të dëgjonjë.

1- Ai që mbjell farën. I zoti i shtëpisë, i cili mbjell farën e mirë është Krishti. Ara është bota.

2- Fara e mirë dhe egjra. Më fjalët fara e mirë ungjillori nënkupton njerëzit e drejtë, të cilët janë bijtë e mbretërisë. Ndërsa egjëri simbolizon mëkatarët, të cilët në ditën e gjykimit do të hidhen në furrë të zjarrit, ku do ketë vetëm qarje dhe kërcëllima dhëmbësh. Ai që ka mbjellë egrën është djalli.

3- **Korrja dhe korrësit.** Me fjalën e kohës së korrjes ungjillori simbolizon ditën e gjykimit përfundimtar. Ndërsa më korrësit ai nënkupton engjëjt. Në ditën e gjykimit Biri i Njeriut do të thërresi engjëjt, të cilët do të ndajnë mëkatarët nga të drejtët.

PARAVOLIA E THESARIT TË FSHEHUR

44 Përsëri mbretëri'e qiejvet gjan më një thesar të fshehurë nd'arët, të-cilinë kur e gjeti një njeri e fshehu; edhe nga gëzim'i ti vete e shet gjithë ç'ka, edhe ble atë arë.

1- **Një thesari të fshehur në një arë.** Paravolia e thesarit të fshehur është e pesta sipas rradhës. Në këtë paravoli, Krishti e krahason Mbretërinë e Qiejve me një fushë, ku njeriu gjen një thesar. Pra me anën e kësaj paravolie, nënkuptohen ata njerëz, të cilët nuk e kërkojnë mbretërinë, por kur e gjejnë atë papritur, e vlerësojnë dhe mohojnë gjithshka për të.

PARAVOLIA E MARGARITARIT TË ÇMUAR

45 Përseri, mbretëri'e qiejvet i ngjan më një njeri tregëtar, që kërkonte margaritarë të mirë; 46 i-cili kur gjeti një mrraritar shumë të-vjejturë, vate e shiti gjithë sa kishte, edhe e bleu atë.

1- **Margaritari i çmuar.** Kjo është paravolia e gjashtë, e cila flet për ata njerëz, të cilët e ndjejnë vlerën e mbretërisë dhe të së mirave materiale. Në këtë rast Mbretëria e Qiejve krahasohet me margaritarin e çmuar.

PARAVOLIA E RRJETËS

47 Përsëri, mbretëri'e qiejvet gjan me një rrjetë që u hoth ndë det, e mblodhi çdo farë gjëje; 48 Edhe si u mbush, e

nxuarrë atë ndë buzët të detit, edhe ndenjtn' e mbllohnë tëmiratë ndë enë, edhe të-ligat' i hothnë jashtë. 49 Kështu do të jetë mbë të-mbaruarët të jetësë; do të dalën' ëngjëjtë, e do të ndajnë të-liqtë nga të-drejtëtë, 50 Edhe do t'i hedhën' ata ndë furrët të zjarrit; atje do të jetë të-qarët' e të kërcëlliturit' e dhëmbëvet.

1- Rrjeta e hedhur në det. Paravolia e shtatë në pjesën e fundit përsërit atë të egjrit, d.m.th. sqaron ndarjen e mëkatarëve prej të drejtëve. Gjithashtu thekson dënimin e mëkatarëve në gjqin e fundit.

NJË PARAVOLI PËR NXËNËSIT

51 U thot' atyre Jisuj, A i kuptuatë këto të gjitha? I thon'ati, po, Zot. 52 Edhe ay u tha atyre, Përandaj çdo shkronjës që ka mësuarë punët' e mbretëris' së qiejvet gjan me një njeri zot-shtëpie, që nxjer nga thesar'i ti gjërra të-reja edhe të-vjetëra.

1- A i kuptuat të gjitha këto? Në këtë rast Krishti u drejtohet dishepujve të tij, të cilët e kanë kuptuar tashmë misionin e tyre për të mësuar mbarë botën se ç'farë është Mbretëria e Perëndisë.

JISUI NUK PRANOHET NË ATDHEUN E TIJ

(Marku 6:1-6, Lluka 4:16-30)

53 Edhe Jisuj si mbaroj këto paravolira, iku andej. 54 Edhe si erdhi ndë dhet të ti, i mësonte ata ndë sinagogjit t'atyre, kaqë sa çuditëshin' ata e thoshinë, Nga i erdhi këti këjo dituri, e këto fuqira? 55 A nuk' është ky i bir' i mjeshtrit? E ëm' e ati a nukë thuhetë Mariamë, edhe të vëllezërit' e ati Jakov, edhe Josi, edhe Simon, edhe Judhe? 56 Edhe të motrat' e ati a nukë janë të-gjitha ndër ne? Nga i erthnë këti pra këto të-gjitha? 57 Edhe skandhaliseshinë mb'atë. Po Jisuj u tha atyre, Nuk' është profit

i-panderçim, përveç nd'atdhet të ti e ndë shtëpit të ti. 58 Edhë nukë bëri atje shumë çudira, për pa-besërin' e atyreve.

1- **Erdhi në vendlindjen e tij.** Vendlindja e Jisuit ishte qyteti i Nazaretit. Në këtë qytet Jisui u rrit në familjen e marangozit Josif.

2- **Skandalizoheshin me të.** Origjina e thjeshtë familjare i shtynte hebrenjtë që të skandalizoheshin me bashkqytetarin e tyre. Ata gjithnjë e prisnin Krishtin si një luftëtar, i cili do t' i çlironte ata nga robëria e romakëve.

3- **Nuk bëri aty shumë mrekulli.** Në fakt në këtë qytet Krishti i kishte bërë disa mrekulli, por nuk vazhdoi të bënte të tjera, sepse nazareasit nuk donin ta pranonin që ai ishte mesia i premtuar nga profetët.

KREU I KATËRMBËDHJETË

PRERJA E KOKËS SË JOAN PAGËZORIT

(Marku 6:14-56, Lluca 3:19,20, 9:7-17, Joani 6:1-21)

1 Nd'atë kohë Irodhi katrurdhëtarësi dëgjoj zërin' e Jisujt, 2 Edhe u tha shërbëtorëvet të ti, ky është Joan Pagëzori; ay është ngjallurë nga të-vdekuritë, edhe përandaj punonenë çudira nga ay.

1- **Ky është Joan Pagëzori.** Profeti Isaia kishte profetizuar se Joani do të jetë “një zë që buçet në shkretëtirë”. Njerëzimi në atë kohë ishte larg Perëndisë dhe nuk i dëgjonte ftesat qiellore. Nevojitej pra njeriu i Perëndisë Joani për të ngritur me forcë zërin e tij duke prekur zemrat e njerëzve. Joani e vlerësoi ftesën që i bëri Perëndia, prandaj u bë i madh.

3 Sepse Irodhi zuri Joanë, edhe e lidhi, edhe e vuri në burg, për Irodhiadhënë gruan' e Filippit të vëllat; 4 Sepse Joani i thoshte ati, se nuk' është' e udhësë t'a kesh ti atë.

1- **Nuk është e lejueshme që të kesh gruan e vëllait tënd.** Joani sakrifikoi duke mos nguruar të kritikonte mbretin Herod, i cili bënte një jetë të shthurur. Joani e kritikoi hapur mbretin Herod, sepse kishte marrë gruan e vëllait të tij Filipit, Herodiatën. Me guxim që e karakterizonte, Joani i thotë: “Nuk është e lejueshme që të kesh

gruan e vëllait tënd”. Për këtë arrësyje Herodiata e urrente Joanin dhe donte të hakmerrej, sapo të gjente rastin.

2-Herod Tetrraku. Mbreti Herod vendosi të bashkëjetonte me gruan e vëllait të tij Filipit, Herodiatën, ndërsa gruan që kishte më kurorë, të bijën e princit Arab Aretit, ai e përzuri nga shtëpia.

3-Nuk është e udhës të martohesh me gruan e vëllait. Ligji i Moisiut e ndalonte këtë gjë. “Nuk do të zbulosh lakuriqësinë e gruas së vëllait tënd, nuk do t’i afrohesh gruas së tij, sepse ajo është kunata jote” (Levitiku 18,14).

5 Edhe donte t’ a vriste atë, po kishte frikë prej gjindjesë, sepse e kishinë për profit. 6 Edhe kur bënej të-fështuarët’e ditës së të-lindurit të Irodhit, e bija e Irodhiadhësë lojti valle ndë mest, edhe i pëlqeu Irodhit. 7 Përandaj iu zotua asaj me be t’i apë ç’ të lypte. 8 Edhe ajo, si u mësua prej s’ëmësë, thotë, ep-më kryet’e Joan Pagëzorit këtu mbë një talure.

1- Ditëlindja e Herodit. Hebrenjtë e kishin për zakon që festonin rrethprerjen, pra tëtë ditë pas lindjes. Herodi ishte qytetar romak dhe si i tillë festonte përvjetorin e lindjes.

2- Kërko kokën e Joan Pagëzorit. Herodi shtroi një gosti me rastin e ditëlindjes së tij, ku ftoi gjithë parinë e Galilesë. Gjatë gosisë bija e Heroditës kërceu një valle me të cilën i mahni të gjithë të pranishmit e në mënyrë të veçantë Herodin. Atëhere mbreti i entuzjasmuar i premtoi vajzës: “Kërko çfarë të duash dhe unë do të jap deri në gjsmën e mbretërisë sime”. Vajza vajti tek e ëma dhe e pyeti se çfarë të kërkonte. E ëma plot djallëzi i tha: “Kërko kokën e Joan Pagëzorit”.

9 Edhe mbretit i erdhi keq; po për betë, që kishte bërë, edhe për ata që ishinë ndë mësallët bashkë me atë, urdhëroj t’i epetë. 10 Edhe dërgoj e i pru kryetë Joanit ndë burgt. 11 Edhe

kryet' e ati u pru mbë një talure, e iu dha vashësë; edhe ajo j'a pruri s'ëmësë.

1- **Kokën e Joanit në pjatë.** Mbreti nuk mund që ta refuzonte premtimin që pati dhënë. Atëhere dërgoi një ushtar duke e urdhëruar që t'ia sillte kokën e Joanit në pjatë. Herodi gjakatar nuk përfaqëson vetëm mizorinë e njeriut të asaj kohe, por edhe njeriun e të gjithë kohrave, i cili është i mbyllur në egoizmin e tij të brendshëm. i sunduar nga egoizmi, ai shfarros gjithë ata që i dalin përpara. Zhduk ata që e kritikojnë dhe i vënë në dukje gabimet. Vret të gjithë ata që i konsideron armiq e kundërshtarë. Këtë bëri edhe me Joan Pararendësin.

2- **Ajo ia pruri së ëmës.** Pas Herodit bashkfaqtoje në krim është edhe Herodita, e cila me ligësinë dhe djallëzinë që e karakterizonte nuk nguroi të hakmerrej ndaj atij njeriu që e pati kritikuar për jetën e saj të pandershme. Ajo grua për hir të lavdisë dhe parave pati pranuar të bashkjetonte me vëllanë e burrit të saj. Sa gjë e ulët është kur nderi nuk llogaritet përpara lavdisë dhe parave?

12 Edhe erthnë nxënësit' e ati, e ngritnë trupinë, edhe e kallnë ndë varr; pastaj erthnë e i dhanë zë Jisujt.

1- **Nxënësit e tij e varrosën.** Joani kishte nxënës, njëri prej të cilëve kishte qenë Andrea. Joani u bë Pararendës me ftesën që i bëri Perëndia, u bë i madh me predikimin dhe misionin e tij.

NGOPJA E TË PESË MIJËVE

(Marku 6:30-44, Lluka 9:10-17, Joani 6:1-14)

13 Edhe Jisuj, kur dëgoj, iku andej me lundrë mbë një vënt të-shkretë veçanë; edhe gjindja kur dëguanë i vanë prapa mbë këmbë nga qytetetë. 14 Edhe kur dolli (Jisuj), pa shumë gjindje, edhe iu dhemp për ata, edhe shëroj të-sëmuret' e atyre. 15 Edhe si u ngrys, i erthnë për anë nxënësit e ati, e i thanë, se

vëndi është'i-shkretë, edhe koha ndashti ka shkuarë; lësho gjindjenë, që të venë ndëpër krye-fshatrat të blenë të ngrëna për vetëhen'e tyre.

1-Njerëzit kishin nevojë që të ushqeheshin. Krishti bashkë me dishepujt e tij udhëtonte përmes shkretëtirës dhe turmat e popullit e ndiqnin kudo. Njerëzit dëgjonin me vëmendje mësimet e Tij. Dalëngadalë bie muzgu dhe turma e njerëzve ende nuk po largohej. Ata njerëz duke dëgjuar fjalën e Perëndisë harruan se erdhi vakti i darkës dhe kishin nevojë që të ushqeheshin. Por vallë ku do të gjendej gjithë ai ushqim në mes të shkretëtirës?

16 Po Jisuj u tha atyre: Nukë kanë nevojë të venë; ep-u-nj ju atyre të hanë.

1- **Krishti i ngopi ata së pari shpirtërisht.** Pas frymëmarrjes dhe etjes, nevoja më e madhe biologjike e njeriut është uria. Pikërisht përpara një populli të uritur u gjend Krishti. Ishte ai popull që e kishte ndjekur pas në shkretëtirë për të dëgjuar predikimet e Tij dhe për ti shëruar. Veçse Krishti i ngopi ata së pari shpirtërisht dhe së dyti trupërisht duke iu treguar se kë duhet të kërkonin të parën.

17 Edhe ata i thon' ati, nukë kemi këtu veç pesë bukë edhe dy pishqe. 18 Edhe ay tha: Bi-m' i-ni mua ato këtu. 19 Edhe urdhëroj gjindjenë të rrijnë përmi barërat, edhe mori të pesë bukët'e të dy pishqetë, edhe ngriti sytë përjetë ndë qiejt e bekoj; edhe passi i theu, u'a dha bukëtë nxënësve, edhe nxënësitë gjindjesë. 20 Edhe hëngrrë të-gjithë e u ngijnjë; edhe ngritnë tepëricën'e copavet, dy-mbë-dhjetë kofinë plot. 21 Edhe ata që hëngrrë ishinë sindonja pesë mijë burra, veç gravet e çunavet.

1- **Krishti bekoj pesë bukët dhe dy peshqit.** Pasi përfundoi mësimdhënien e Tij, bekoj pesë bukët dhe dy peshqit që u ndodheshin në ato momente dhe me to u ngopën me mijëra njerëz. Por ajo që na

bën përshtypje është se njerëzit më parë dëgjuan fjalën e Perëndisë e më pas u ngopën me ushqimin trupor. Bekimi i Perëndisë në këtë rast ishte i pakursyer, sepse përveç ushqimit të shpirtit që ua dha pa kursim, në mënyrë të mrekullueshme u dha edhe ushqimin e trupit, kur bekoj pesë bukët dhe dy peshqit, duke ngopur pesëmijë njerëz. Ungjilli i sotëm na e tregoi qartë se cilëve iu dha bekimi i Perëndisë. Atyre njerëzve, të cilët braktisën shtëpitë e tyre nga dëshira për të takuar Krishtin dhe për të dëgjuar mësimet e Tij. Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti i bekoj bukët dhe populli filloi të hante. Momenti i ngrënies fillon dhe mbaron me lutje prandaj është i shenjtë.

ECJA E JISUIT MBI UJËRA

(Marku 6:45-52, Joani 6:1-21)

22 Edhe për-një-herë (Jisuj) shtrëngoju nxënësit'e ti të hyjnë në lundrë, edhe të shkojnë përtej më përpara se ay, gjersa të lëshonjë gjindjenë. 23 Edhe si lëshoj gjindjenë, hipi në malt meçanë që të faletë; edhe si u ngrys, ishte vetëm' atje.

1- Hipi nxënësit në lundër dhe vetë shkoi të falej në mal.

Këto vargje na mësojnë se si duhet t'i përballojmë stuhitë e jetës. Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti gjatë periudhës së predikimit të Tij, shoqërohej gjithnjë nga dishepujt. Por kemi edhe raste kur ai i lë ata vetëm. Pasazhi ungjillor na tregon se Jisui u kishte thënë dishepujve të tij që të kalonin detin e Galileës, ndërsa ai vetë u ngjiti në mal për t'u lutur.

24 Edhe lundra ishte ndashti në mest të detit dyke përpyeturë nga valët; sepse era ishte kundër.

1- Lundra përpyeju me valët në mes të detit. Udhëtimi po shkonte mirë, por papritur një furtunë e fuqishme i vuri dishepujt përpara një rreziku të madh. Deti i Galileës sa vinte e bëhej më i

egër. Errësira mbretëronte kudo, ndërsa barka e tyre lëkundej nëpër dallgët e fuqishme. Deti i trazuar shpesh hapte gojën për t' i përpirë. Në sytë e dishepujve të Krishtit agonia shtoej. Mungesa e mësuesit të tyre i shqetësonte. Nëse do ta kishin Krishtin në barkë, atëhere nuk kishin pse të frikësoheshin, por tashmë ai mungon. Dishepujt ndodhen në rrezik, agonia e vdekjes ishte fare pranë.

25 Edhe mbë të-katërtënë ruajtje të natësë Jisuj vate tek ata, dyke ecurë përmbi det. 26 Edhe nxënësitë kur e panë që po ecënte përmbi det, u trëmpnë e thanë, se është hije; edhe nga frika bërtitnë. 27 Po Jisuj për-një-herë u foli atyre, dyke thënë, kini zëmërë, unë jam mos u frikësoni.

1- Jisui vjen duke ecur mbi det. Sigurisht që Krishti nuk i la të humbisnin. Në të gdhirë, kur barka ishte larg bregut, panë Jisuin duke ecur përmbi ujë. Në mënyrë të çuditshme Krishti iu gjendet pranë dishepujve. Në fillim e kujtuan për fantazëm, por më pas e njohën.

28 Edhe Pjetri i u përgjeq e tha, Zot, ndë je ti, urdhëromë të vinj te ti mbi ujërat. Edhe ay tha, Eja. 29 Edhe Pjetri zbriti nga lundra, e eci mbi ujërat, që të vinte te Jisuj. 30 Po kur pa erënë të-fortë, u frikësua; edhe si zuri të kridhetë, bërtiti, dyke thënë, Zot, shtëpo-më. 31 Edhe Jisuj për-një-herë ngjati dorënë, e zuri, e i thotë: O besë-pak, përse qe me dy mëndje?

1- Petro filloi të ecte mbi valët e detit, por pas pak u fundos. Kjo që i ngjau Petros mund të na ndodhë edhe ne, atëhere kur stuhi të papritura çfaqen në jetën tonë. Ndërsa Petro i mbante sytë tek Krishti, ishte i sigurt dhe ecte mbi valët e detit. Por në momentin që i hoqi sytë nga Krishti duke parë detin e trazuar e harroi sigurinë dhe u fundos.

32 Edhe ata si hynë ndë lundrët, pushoj era. 33 Edhe ata që ishinë ndë lundrët erthnë e iu falnë ati, dyke thënë, me të-vërtetë je bir Perëndie.

1- **Me të vërtetë je bir Perëndie.** Problemi kryesor i dishepujve ishte se ata mendonin se qenë të vetmuar, por pikërisht në momentin më të vështirë Krishti iu gjendet pranë. Shpesh herë edhe ne mendojmë se Krishti u largua prej nesh, por sapo thërresim si Petro: “O Zot shpëtomë” ai vjen të na ndihmojë duke thënë: “Qetësuhuni dhe mos kini frikë”. Sepse Krishti me të vërtetë është Biri i Perëndisë.

SHËRIME NË GJENISARET

(Marku 6:53-56)

34 Edhe si shkuanë përtej erthnë ndë dhet Gjennisaret. 35 Edhe njerëzit’e ati vëndi, kur e njohnë, dërguanë ndëpër gjith’ ato anë edhe i prunë ati gjith’ ata që kishinë keq. 36 Edhe i luteshin’ ati të preknjë në pëqin’e rrobës’s’ ati vetëmë; edhe sa e preknë u shëruanë.

1-**Gjenisareti.** Gjendej në jug të Kapernaumit dhe kishte një fushë pjellore.

2-**Sa e preknë u shëruan.** Besimi i popullit tek Krishti sa vinte e rritej, saqë ata besonin se edhe me të prekur rrobat e tij mund të shëroheshin.

KREU I PESËMBËDHJETË

TRADITA NJERËZORE DHE POROSI HYJNORE

(Marku 7:1-13)

1 Atëhere vijnë te Jisuj shkronjësit' edhe Farisenjtë nga Jerusalmi, e i thonë, **2** Përse nxënësit' e tu shkelnjnë fjalënë që kanë lënë pleqtë? sepse s'lajnë duart'e tyre, kur hanë bukë?

1- **Përse shkelin traditën e pleqve?** Farisenjtë të nxitur nga cmira përpiqen të shtrembërojnë mrekullitë dhe të vërtetën duke e paraqitur Krishtin si shkelës i traditës.

2- **Përse nuk lajnë duart kur hanë bukë?** Ligji i Moisiut nuk e kishte të shkruar këtë gjë. Kjo ishte një traditë e trashëguar e farisenjve që përpara buke lanin duart e në disa raste vetëm gishtërinjtë.

3 Po ay u përgjeq e u tha atyre: Përse edhe ju shkelni porosin'e Perëndisë për fjalëtë t'uaj të-mbetura gojë mbë gojë nga pleqtë. **4** Sepse Perëndia porositi, dyke thënë, "Ndero t'ët atë, e t'ët ëmë;" edhe, "ay që flet keq për t'anë a për t'ëmënë le të vritetë." **5** Po ju thoni, kush t'i thotë t' et a s'ëmëse, se çdo e-mirë që të shohç prej meje është dhurëti, është mjaft, edhe munt të mos nderonjë t'an a t'ëmënë. **6** Edhe s'mbajtë porosin'e Perëndisë për fjalëtë t'uaj të-mbetura gojë mbë gojë. **7** Ipokritër, mirë profitepsi Isaia për ju, dyke thënë, **8** "Ky llaus (më atëronet me gojën'e ti, edhe) më nderon me buzëtë; po zëmër'e atyre është

lark prej meje. 9 Edhe kot më nderojnë, dyke mësuarë mësimë që janë porosira njerëzish”.

1- **Ndero prindërit.** Krishti ju kujton hebrenjëve që në Ligjin e Moisiut është shkruar që duhet të nderosh babën dhe nënën. Farisenjtë pretendonin se në rastin e flijimit nuk duhet të ndihmojmë prindërit duke u dhënë nga mishi i flijuar.

Ç’E BËN NJERIUN TË PAPASTËR

(Marku 7:14-23)

10 Edhe si thirri gjindjenë, u tha: Dëgjoni edhe kupëtoni. 11 Ç’ hyn ndë gojët nukë ndyn njerinë, po ç’ del nga goja, këjo e ndyn njerinë. 12 Atëhere u afëruanë nxënësit’e ati, e i thanë, a e di se Farisenjtë kur dëgjuanë këtë fjalë u skandhalisnë? 13 Edhe ay u përgjeq e tha: Çdo bimë që nuk’e ka mbjellë im atë qiellori, do të çkuletë. 14 Leni ata; se janë të-verbëre që u heqën’ udhënë të-verbërve; edhe ndë qoftë se i-verbëre i heq udhënë të-verbëri, të dy do të bienë ndë gropët.

1- **I verbëri i udhëheq rrugën të verbërit.** Në këtë rast Krishti i porositi dishepujt që të kenë kujdes nga farisenjtë, madje i këshilloi që të mos u flasin fare atyre. Krishti i krahasoi ata me të verbërin, sepse ata nuk duan që ta njohin dritën e Perëndisë së vërtetë.

15 Edhe Pjetri u përgjeq e i tha ati, dëfte-na këtë paravoli. 16 Edhe Jisuj tha, edhe po pa mënt jeni ju? 17 Edhe nukë po kupëtoni, se çdo gjë që hyn ndë gojët sbret ndë barkt, edhe nxiretë ndë të-dalurit? 18 Po ato që dalënë nga goja, dalënë nga zëmëra, edhe ato ndynë njerinë. 19 Sepse nga zëmëre dalënë mendime të-liq, vrasje, ndyrësira, kurvërira, vjedhe, dëshmime të-rem, vllasfimira. 20 Këto jan ato që ndynë njerinë; po të-ngrënë të me duar të-palara nukë ndyn njerinë.

1- **Ato që dalin nga goja e ndynë njeriun.** Krishti i porositi dishepujt që të kenë kujdes për ato fjalë që do të thonë, sepse fjalët

që dalin prej gojës burojnë nga zemra. Në këtë rast Jisui kujdeset për shpirtin e tyre që të jetë i pastër.

BESIMI I GRUAS KANANEASE

(Marku 7:24-30)

21 Edhe Jisuj si doli andej, iku nd'anët të Tyrës'e të Sidhonësë.

1-**Si u largua që andej.** Krishti largohet nga Kapernaumi dhe shkon në qytetet idhujtare të Tiros dhe Sodonit.

22 Edhe ja një grua Hananee tek doli nga ata sinorë, e i thërriste dyke thënë: Përdëlle-më, o Zot, bir'i Dhavidhit; ime bijë mundonetë keq prej djallit.

1- **Një grua kananease.** Kananeas quheshin fenikasit, të cilët qenë nga fisi i Haronit, nipit të Noes. Gruaja banonte në atë zonë, prandaj quhej kananease. Në të vërtetë ajo ishte idhujtare greke me preardhje sirofenikase. (Marku 7,26). Ajo i doli përpara Krishtit përpara se të hynte në qytetin e Fenikes.

2- **Përdëllemë o Zot, biri i Davidit.** Këto vargje ungjillore na tregojnë për një grua kananease, e cila ishte idhujtare dhe banonte në kufinj të Judesë. Kjo grua kishte një vajzë që torturohej nga demonët. Sapo dëgjoi se ishte duke ardhur Krishti, i doli përpara dhe filloi të thërriste me zë të lartë: “Ki mëshirë për mua, o Zot, Bir i Davidit”. Asaj nëne fatkeqe i digjej zemra tek shihte bijën e saj që vuante dhe kishte besim se Krishti do ta shëronte. Një idhujtare kërkon përdëllimin e Krishtit, në radhë të parë për veten e saj dhe për të bijën që vuan nga demonët.

23 Po ay nuk' iu përgjeq asaj ndoqë fjalë. Edhe nxënësit' e ati erthnë përanë e i luteshinë, dyke thënë, lësho-e atë, sepse po thërret prapa nesh.

1-Por ai nuk iu përgjigj. Me gjithë thirrjet e përgjërimit e saj, gruaja kananease nuk merr përgjigje. Sigurisht që Krishti e dëgjoji britmën e gruas, por nuk e bëri menjëherë mrekullinë, sepse donte të provonte besimin e durimin e saj. Vargjet e ungjillit vërtetojnë se dhembshuria më e madhe është ajo e nënës. Gruaja kananease torturohet nga dëshpërimi sepse vajza e saj sundohej nga demonët. Dhimbja e saj ishte e madhe, megjithatë ajo guxoi dhe iu afrua Krishtit duke kërkuar përdëllimin e Tij. Nuk ka dashuri më të madhe se ajo e nënës për fëmijën e saj.

24 Po ay u përgjeq e tha: Nuk' u dërguashë ngjetiu, veç te dhënt' e-humbura të shtëpis' së Israilit. 25 Pastaj ajo erdhi e i falej ati, dyke thënë: Zot, ndih-më. 26 Po ay u përgjeq e tha: Nuk'është mirë të-marrë njeriu bukën'e djemvet, e t'u'a hedhë këlyshëvet të qënvet. 27 Edhe ajo tha, Po, Zot; po edhe këlyshët'e qënvet hanë nga thërrimetë që bjenë nga truvez'e zotërinjvet.

1- Vetëm për delet e humbura të shtëpisë së Izraelit. Dishepujt e Krishtit kërkojnë që ta largojnë, por Krishti u thotë më zë të lartë me qëllim që ta dëgjonte edhe gruaja kananease: “Unë jam dërguar vetëm për delet e humbura të shtëpisë së Izraelit e ai që ka bukë për fëmijët e vet nuk mund që t'ua hedhë qenve”. Por gruaja nuk e humbi shpresën dhe qetësinë edhe pas këtyre fjalëve të Krishtit. Megjithatë ajo iu përgjigj me shumë përlulesi: “ E di o Zot që nuk jam fëmija yt sepse nuk jam judease, por një idhujtare e papastër dhe mëkatore. Ne që adhurojmë idhujt jemi si qentë, por edhe qentë ushqehen me thërrimët që bien nga tavolina e të zotit të tyre. O Zot më mjafton vetëm një thërrime nga përdëllimi yt.

28 Atëhere Jisuj u përgjeq e i tha asaj: O grua, besa jote është e-madhe; t'u bëftë si do. Edhe e bija u shërua që mb'atë herë.

1- **O grua, besa jote është e madhe.** Kananeasja i thërriti Krishtit për t'i shëruar vajzën dhe lutja e saj u bë realitet, sepse ajo u lut me besim. Gjithashtu u tregua e duruar dhe shumë e përlulur duke e krahasuar veten me qentë, të cilët hanë nga thërrimet që bien nga tavolina e të zotit të tyre. Krishti e bëri mrekullinë dhe bija a saj menjëherë u shërua. Mrekullia i detikohet lutjes këmbëngulëse të gruas kananease. Kështu bëni edhe juve, lutuni pa pushim dhe dyert e mbyllura do t'u hapen. Përdëllimi i Përendisë është për të gjithë njerëzit që pendohen, ashtu siç bëri edhe gruaja kananease, e cila nuk i humbi shpresat dhe nuk u tërhoq, por vazhdoi të lutet me përgjërime dhe me besim të patundur tek Krishti.

SHËRIME TË NDRYSHME

29 Edhe Jisuj iku andej, e erdhi përanë detit të Galilesë, edhe hipi në malt, e rrinte atje. 30 Edhe erthnë tek ay-shumë gjindje, që kishinë me vetëhe të-çalë, të-verbërë, të-shurdhërë, doracë, edhe shumë të-tjerë; edhe i hothnë përanë këmbëvet të Jisujt, edhe ay i shëroj ata; 31 Kaqë sa u çudidnë gjindja, kur panë të-shurdhërë të flasënë, doracë të-shëndoshurë, të-çalë të ecëjnë, edhe të-verbërë të shohënë; edhe lavduruanë Perëndinë e Israilit.

1- **Lavdëronin Perëndinë e Izraelit.** Këto mrekulli Krishti i bëri gjatë udhëtimit nga qyteti i Tiros në atë të Sidonit. Gjithashtu mrekulli bëri edhe në qytetin e Perës, i cili banohej nga idhujtarë.

NGOPJA E KATËR MIJË VETËVE

(Marku 8:1-10)

32 Atëhere Jisuj thirri për anë nxënësit' e ti, e tha: Me dhëmbetë për gjindjenë, sepse kanë ndashti tri dit që mbesënë për anë meje, e s'kanë ç' të hanë; edhe nukë dua t'i lëshonj ata pa ngrënë, se mos gajasënë udhësë. **33** Edhe nxënësit' e ati i thon' ati, Ku do të na gjendenë këtu ndë shkretëtirët kaqë bukë, sa të nginjenë kaqë gjindje? **34** Edhe Jisuj u tha atyre, Sa bukë keni? Edhe ata thanë, Shtatë, edhe pak pishqe të-vegjëlë. **35** Edhe ay urdhëroj gjindjenë të unjenë përdhe. **36** Edhe si mori të shtatë bukëtë edhe pishqetë, u fal ndersë, e i theu, e u' a dha nxënësve të ti, edhe nxënësitë gjindjesë. **37** Edhe hëngrrë të-gjithë, e u nginjnë; edhe ngritnë tepëricën' e copavet, shtatë shporta plot. **38** Edhe ata që hëngrrë ishinë katër mijë burra, veç gravet e çunavet të-vegjëlë.

1- Krishti bekoj shtatë bukët dhe peshqit. Pasi përfundoi mësimdhënien e Tij, bekoj shtatë bukët dhe peshqit që u ndodheshin në ato momente dhe me to u ngopën me mijëra njerëz. Por ajo që na bën përshtypje është se njerëzit më parë dëgjuan fjalën e Perëndisë e më pas u ngopën me ushqimin trupor. Bekimi i Perëndisë në këtë rast ishte i pakursyer, sepse përveç ushqimit të shpirtit që ua dha pa kursim, në mënyrë të mrekullueshme u dha edhe ushqimin e trupit, kur bekoj shtatë bukët dhe peshqit, duke ngopur katërmijë burra pa llogaritur gratë dhe fëmijët e tyre.

39 Edhe si lëshoj gjindjenë, hyri ndë lundrët, edhe erdhi ndë sinorët të Magdhallasë.

1-Krahinën e Magdalas. Sinori i Magdalasë ishte në perëndim të liqenit të Gjenisaretit.

KREU I GJASHTËMBËDHJETË

FARISENJTË KËRKOJNË SHENJA ÇUDIBËRËSE

(Marku 8:11-13, Lluca 12:54-56)

1 Edhe erthnë për anë Farisenjtë edhe Sadduqenjtë, edhe dyke ngar' atë kërkoninë t'u dëftente atyre shënjë nga qielli. **2** Po ay u përgjeq e u tha atyre, kur bënetë mbrëmje, thonë, do të bënetë koh' e mirë; sepse qielli është' i-kuq. **3** Edhe ndë mëngjest, sot do të bënetë koh' e ligë; sepse qielli është' i-kuq e i-vrërëtë. Ipokritër, faqen' e qiellit dini t'a çquani, po shënjat' e kohëravet nukë muntni? **4** Bres i-lik edhe kurvar kërkon shënjë; edhe shënjë nukë dot' i epet'ati, përveç, shënjës' së profitit Jona. Edhe i la ata e iku.

1- Shënjë nga qielli. Ndonëse farisenjtë dhe saduqenjtë qenë armiq ndërmjet tyre, gjithsesë për të luftuar Krishtin ata bashkohen në një frontë vetëm, duke kërkuar që tu tregonte një shënjë nga qielli. Vetëm Perëndia mund të bënte mrekulli nga qielli, ndërsa djalli dhe perënditë e idhujtarëve bënin vetëm mrekulli tokësore.

2- Shënjat e kohës. Këtu nenkuptoheh koha që kishin treguar profetët për ardhjen e Mesias.

3- Edhe i la ata e iku. Krishti la Galilenë dhe vajti drejt bregut lindor të liqenit Gjenisaret.

DOBËSIA E DISHEPUJVE PËR TË KUPTUAR

(Marku 8:14-21)

5 Edhe nxënësitë si erthnë përtej, harruanë të marrënë bukë. 6 Edhe Jisuj u tha atyre, shikoni e ruhi me kujdes nga brumi i Farisenjvet e i Sadhuqenjvet.

1- Ruhuni nga brumi i farisenjve dhe saducenjve. Ungjillori Mathe thekson që dishepujt dujet të kenë kujdes nga mësimdhënia e gabuar e farisenjve dhe e saducenjve. Ndërsa ungjillor Marku thekson: “Kini kujdes, ruhuni nga majaja e farisenjve dhe nga majaja e herodit” (Marku 8, 15).

7 Edhe ata mendonëshinë më vetëhen’ e tyre, dyke thënë. Se nukë muarmë bukë. 8 Edhe Jisuj si e kupëtoj, u tha atyre: Ç’ mendohi me vetëhenë t’uaj, o besëpakë, se nukë muartë bukë? 9 Edhe nukë po kupëtoni, as nukë mbani mënt të pesë bukët’ e të pesë mijëvet, edhe sa kofinë muartë? 10 As të shtatë bukët’ e të katrë mijëvet, edhe sa shporta muartë? 11 Qysh nukë kupëtoni se nuk’ u thashë juve për bukë të ruhi nga brumi i Farisenjvet e i Sadhuqenjvet? 12 Atëhere e kupëtuanë, se nuk’ u tha të ruhenë nga brum’ i bukësë, po nga nësimi i Farisenjvet e i Sadhuqenjet.

1- Majaja. Prej së cilës do të gatuhet e gjithë buka. Prandaj Krishti i porositi nxënësit e tij që të ruhen nga mësimdhënia e të pabesëve.

POHIMI I PJETRIT

(Marku 8:27-30, Lluca 9:18-21)

13 Edhe Jisuj kur erdhi mb’anët të Qesaris’ së Filippit, pyeste nxënësit’ e ti, dyke thënë: Cili thonë njerëzitë se jam unë i Bir’i njeriut?

1-Qsaria e Filipit. Ishte qyteti që ndërtoi Filip Tetraqi për nder të Perandorit Tiber.

14 Edhe ata thanë, ca thonë, se je Joan Pagëzori; e të-tjerë Iliu; e të-tjerë Jeremia, a një nga profitëritë. 15 U thot' atyre: Po ju cili thoni se jam unë? 16 Edhe Simon Pjetri u përgjeq e tha: Ti je Krishti, i bir'i Perëndis' së-gjallë.

1-Ti je Krishti, i Biri i Perëndisë së gjallë. Me këtë thënie të Petros, apostuj u bindën që ishte Mesia i vërtetë. Deri në atë kohë ishte përdorur termi “Biri i Njeriut”. Apostujt vetëm në këtë rast e kuptuan që Krishti ishte Mesia i premtuar.

17 Edhe Jisuj u përgjeq e i tha: I-lumurë je ti, Simon bir' i Jonajt, sepse mish edhe gjak nukë t'a shuloj ty këtë, po im Atë që është ndë qieit.

1- I lumtur je ti Simon, i biri i jonait. Petro përpara se të thirrej nga Krishti për tu bërë dishepull i tij quhej Simon. Babai i tij ishte Jonai. Petro me ndihmën e fuqisë hyjnore mund që ta njihte Mesinë.

18 Edhe unë po të them: Se ti je Pjetër (shkëmp) edhe përmbi këtë shkëmp do të ndërtonj kishënë t'ime; edhe dyert'e hadhit nukë do të kenë fuqi përmbi atë. 19 Edhe do të t'ap ty kjcjet' e mbretëris' së qiejvet; edhe ç'të lithç mbi dhet, do të jetë lidhurë ndë qiejt; edhe ç'të zgithç mbi dhet, do të jetë zgjidhurë ndë qiejt. 20 Atëhere porositi nxënësit' e ti të mos i thonë asnjëriu, se ay është Jisu Krishti.

1- Përmbi këtë shkëmp do të ndërtonj kishën time. Në gjuhën arama ishte shkëmi quhet Kefa. Besimi i Petros tek Krishti ishte i fortë si shkëmbi, prandaj edhe Zoti i thotë se mbi këtë shkëmb do të ngre kishën time.

JISUI PARATHOTË VDEJKEN

DHE NGJALLJEN E TIJ

(Marku 8:31-33, Lluca 9:21-22)

21 Që atëhere Jisuj zuri t'u dëftenj nxënëset të ti, se duhetë të vejë ndë Jerusolim, edhe të pësonjë shumë nga pleqt' e nga kryepriiftërit' e nga shkronjësitë, edhe të vritetë, edhe të-tretënë ditë të ngjalletë. **22** Atëhere Pjetri e mori mbë nj' anë, e zuri t'a qërtonjë, dyke thënë, le të të dhëmbetë vetëheja jote, Zot; nukë do ë bënë të këjo te ti. **23** Po ay u kthye e i tha Pjetrit: **Ikë prej meje, Satana, se më je skandhall; sepse s'ke ndër mënt punët' e Perëndisë, po punët; e njerësvet.**

1- Filloi tu sqarojë dishepujve. Krishti u flet hapur dishepujve që ditët po afroheshin dhe ata duhet të jenë të përgatitur për vështirësitë që i prisnin.

2- Ikë prek meje. Petro, i cili e kishte besën si shkëmbi, në këtë rast skandalizon Jisuin, duke i thënë “O Zot të shpëtoftë Perëndia”. Ashtu sikundër satani e ngau Krishtin në mal, në këtë rast i Petro dëshiron pa dashje që ta ngasë, prandaj edhe ai i drejtohet me fjalët: “Ik prej meje satana”.

KRYQI I NXËNËSVE TË VËRTETË

(Marku 8:34, 9:1, Lluca 9:23-27)

24 Atëhere Jisuj u tha nxënësvet të ti, **Kush të dojë të vinjë prapa meje, le të mohonjë vetëhen'e ti, edhe le të ngrerë kryqin'e ti, edhe let ë vinjë pas meje.** **25** Sepse ay që të dojë të shpëtonjë jetën'e ti, do t'a do t'a humbasë atë; edhe ay që të humbasë jetën'e ti për punë t'ime, do t'a gjenjë atë.

1-”**Kush të dojë të vijë pas meje...**”. Në këtë mënyrë na vë përpara një problem të madh të jetës sonë, atij të lirisë. Krishti na fton që ti shkojmë pas me vullnetin tonë të lirë. Me lirinë që i dha Perëndia, njeriu mund të zgjedhë rrugën që dëshiron, mund të dallojë të mirën nga e keqja, të vërtetën nga gënjeshtria, virtytin nga ligësia. Perëndia i le njerëzit që të jenë zotër të vullnetit të tyre. Krishti na fton që ti shkojmë pas sepse dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtojnë duke njohur të vërtetën. Shpëtimi vjen me pjesëmarjen në dashurinë e Perëndisë, e cila identifikohet gjithnjë me lirinë. Nuk mund të duash dikë pa qenë i lirë. Gjithashtu nuk mund të jesh i lirë nëse nuk dashuron. Prandaj edhe Ungjilli i sotëm na mëson se: “Kush të dojë “ i afrohet Krishtit, “Kush të dojë “ e pranon atë, “Kush të dojë “ shkon pas Tij etj. Njeriu është i lirë që ta pranojë besimin dhe fenë e krishterë, pa kurrfarë detyrimi.

2- **Le të mohojë veten.** Të gjithë që duan ti shkojnë pas Krishtit duhet të mohojnë veten e tyre, duke u larguar nga e kaluara mëkatore. Megjithatë nuk mjafton që vetëm të mohojmë vetveten, por duhet të ngremë edhe Kryqin tonë. Kryqi është simboli i brengave dhe shqetësimeve të jetës, sepse e gjithë jeta jonë është e mbushur me kryqe. Përreth nesh ka varfëri, fatkeqësi, përbuzje, sëmundje, padrejtësi, ngasje, skandale etj. Të gjithë këto që përmendëm janë kryqe që njeriu duhet ti ngrejë përditë. Prandaj lypset durim dhe nuk duhet që të humbasim shpresat. Jemi të detyruar që ta ngremë kryqin tonë, sado i rëndë që të jetë ai. Perëndia nuk do të na lerë të vuajmë më tepër se sa mund të durojmë. Kur na sheh që humbasim forcat afrohet, na jep zemër duke e mbajtur vetë pjesën më të rëndë të Kryqit. Prandaj le ta ngremë pa përtim kryqin e vetsakrifikimit sepse dikush kujdeset për ne.

3- **Le të ngrejë Kryqin e tij.** Krishti na parapregatit për të ecur pas Tij në rrugën e mundimshme të Kryqit. Duke bërë atë që bëri Krishti, do të thotë që ne ti ngjajmë atij dhe kjo nuk është gjë e

lehtë sepse duhet të vetsakrifikohemi. Akoma edhe vetë Krishti në një çast të vështirë kur ngriti Kryqin e mundimshëm e tregoi dobësinë e Tij njerëzore duke thënë: “Ati im, nëse është e mundur largoje prej meje këtë kupë”. Por menjëherë e ndjeu se nga Kryqi varej shpëtimi i botës dhe shtoi: “Megjithatë jo siç dua unë, por siç do ti” (Math.26,39). Me të vërtetë edhe ne në jetën tonë sa herë që torturohemi nga vetsakrifikimi për të tjerët duhet të themi: “ Jo siç dua unë, por siç do ti”, ashtu si i tha Krishti.

4- Le të më vijë pas. Dashuria e Tij kërkon të shpëtojë mbarë botën. Por njerëzit e sotëm i shmangen kryqit dhe e injorojnë atë. Por Krishti përsëri që nga lartësia e Kryqi na thërret: “Kush të dojë, le të vijë pas meje”. O njerëz të mirë! Krishti na thërret! Le të shkojmë pas Tij dhe nuk kemi për tu penduar kurrë!

26 Sepse ç’dobi ka njeriu, ndë fitoftë tërë botënë, e të dëmëtonjë shpirtin’e ti? Apo ç’ do të apë njeriu për këmbyerje të shpirtit të ti? 27 Sepse ka për t’ardhur’i Bir’i njeriut ndë lavdit t’Atit të ti bashkë me ëngjëjt’ e ti; edhe atëhere dot’ j’a çpaganjë gjithë-si-cilit pas të-punuarit t’ati. 28 Me te-vërtetë po u them juve, se janë ca nga ata që rrinë këtu, të-cilëtë nukë do të ngjëronjë në vdekje, gjer sa të shohënë të Birin’ e njeriut dyke ardhurë ndë mbretërit të ti.

1- Do t’ja çpaganjë gjithësecilit. Ai që do të ngrëjë Kryqin do të ketë dhimbje, do të sakrifikohet duke mohuar veten e tij dhe vetëm kështu mund ta fitojë jetën e përjetëshme duke imituar Krishtin. Kisha e Krishtit në të cilën bëjmë pjesë është një mbretëri dashurie dhe shpëtimi. Mbreti është Zoti i kryqëzuar, me duart e tij që qëndrojnë gjithnjë të hapura duke i përqaftuar gjithë njerëzit.

KREU I SHTATËMBËDHJETË

SHPËRFYTYRIMI I JISUIT

(Marku 9:2-13, Lluca 9:28-36)

1 Edhe pas gjashtë ditsh Jisuj merr më vetëhe Pjetrin' edhe Jakovin' edhe Joantinë të vëllan' e ati, edhe i ngjit mbë një mal të-lartë veçanë.

1- Jisui morri me vete Petron, Joantin dhe Jakovin. Shpërfytyrimi na paraqet potencialin e plotë të natyrës njerëzore dhe lavdinë, e cila do të mbulohet përsëri nga hiri i Perëndisë. Tre dishepujt, Petro, Jakovi dhe Joani bëhen dëshmitarë të lavdisë së Krishtit.

2 Edhe ndërroj fytyrënë përpara atyre; edhe faqeja e ati ndriti posi djelli, edhe rrobat' e ati u bënë të-bardha posi drita.

3 Edhe ja tek u duk në atyreve Moisiu edhe Iliu dyke folurë bashkë me atë.

1- Moisiu dhe Iliu. Që të dy profetët e kishin nga një vizion prej Perëndisë: Moisiu në malin e Sinait, ndërsa Iliu në Karmel. Moisiu përfaqëson të vdekurit, ndërsa Iliu që u mor në qiell nga një karrocë e zjartë përfaqëson të gjallët.

4 Edhe Pjetri u përgjeq e i tha Jisujt, Zot, mirë është të jemi ne këtu; ndë daç, le të bëjmë këtu tri tenda, një për ty, e një për Moisinë, e një për Ilinë. 5 Edhe ay tek po ishte dyke folurë, ja tek i mbolaj ata një re e ndriçime; edhe ja një zë nga reja tek thoshte, Ky është biri im i-dashuri, që e pëlqeva; atë dëgjoni.

1- Duke folur. Në malin Tabor ashtu si në pagëzimin e shenjtë në Jordan, Ati flet nga qiejt duke dëshmuar birin hyjnor Krishtin. Por edhe Shpirti i Shenjtë është i pranishëm në këtë ngjarje, jo si një pëllumb, por në formën e një drite verbuese që rrethon Krishtin dhe hedh dritë mbi gjithë malin. Kjo është drita e Shpirtit të Shenjtë. Shpërfytyrimi ndodhi 40 ditë pas vuajtjeve të Krishtit. Ai e

zgjodhi këtë moment të veçantë që t' u shfaqte dishepujve diçka nga lavdia e Tij hyjnore, me qëllim që të bëhej gati të duronte vuajtjet mbi kryq.

6 Edhe nxënësitë kur dëgjuanë, ranë përmbys, edhe u frikësuanë fort. 7 Po Jisuj erdhi për anë, e i zuri, edhe tha: Ngreuni, e mos u frikësoni. 8 Edhe ata kur ngritën syt' e tyre përpjetë, nuk panë asndonjë, përveç Jisunë vetëmë. 9 Edhe tek sbritninë nga mali, Jisuj i porositi, dyke thënë: Mos i thoni asnjëri se ç' patë, gjersa të ngjallet' i Bir' i njeriut nga të vdekuritë.

1- **Ngreuni, e mos u frikësoni.** Apostujt pasi dëgjuan zërin e Atit dhe panë renë e shndritshme, ranë në gjunjë, ndërsa Krishti gjatë shpërfytyrimit qëndronte në majë të malit duke folur me Moisiun dhe Ilian. Por Krishti në malin Tabor na paraqitet si Zot i të vdekurve dhe i të gjallëve duke na dhënë karakterin eskatologjik të Shpërfytyrimit. Apostujt në ditën e Shpërfytyrimit e panë lavdinë e Krishtit dhe shijuan gëzimin e Parajsës

10 Edhe nxënësit' e ati e pyetnë, dyke thënë, përse pra thonë shkronjësitë, se duhetë të vinjë më përpara Iliu? 11 Edhe Jisuj u përgjeq e u tha atyre, Iliu vjen më përpara, edhe dotë vërë ndë vëntt gjithë punëratë; 12 Po unë po u them juve, se Iliu erdhi ndashti, edhe nuk' e njohnë, po i bënë ç' deshnë; kështu edhe i Bir' i njeriut ka për të pësuarë nga ata. 13 Atëhere e kupëtuanë nxënësitë, se u tha për Joan Pagëzorinë.

1- **Çfaqja e hyjnisë së Krishtit.** Ata e panë fytyrën e Tij “të ndriçonte si diell”. Krishti iu çfaq dishepujve në Malin Tabor jo si një shërbëtor, por në formën e Perëndisë, si personi i tretë i Trinisë së Shenjtë. Ky trupëzim mbetet i pandashëm nga natyra e tij hyjnore, e cila është e përbashkët me Atin dhe Shpirtin e Shenjtë. Çfaqja e

hyjnisë së Krishtit është njëkohësisht një theofani e trinisë “Ati me anën e zërit dëshmoi Birin e tij të dashur, ndërsa Shpirti i Shenjtë u ndriçua bashkë me të me anën e resë së shndritshme”.

SHËRIMI I DJALIT ME SHPIRT DEMONI

(Marku 9:14-29, Lluca 9:37-43)

14 Edhe ata kur erthnë te gjindja, i erdhi për anë një njeri e i ra mbë gjunjë, dyke thënë, Zot, përdëlle t’im bir, 15 Sepse e zë lëngat’ e hënësë, edhe heq keq; sepse shumë herë bje ndë zjarr, e shumë herë nd’ujë; 16 Edhe e shpura te nxënësit; e tu, po nukë munt në t’a shëronjënë. 17 Edhe Jisuj u përgjeq e tha: O bres i-pabesë edhe i-shtrëmbërë, gjer kur do të jem bashkë me ju? Gjer kur dot’ u duronj juve? 18 Edhe Jisuj e qërtoj atë, edhe djalli doli nga ay, edhe djali u shërua që mb’atë herë.

1- **Është epileptik dhe vuan shumë.** Djaloshi vuante nga epilepsia dhe shpesh herë binte në zjarr dhe në ujë.

2- **Dishepujt nuk mundën ta shëronjënë.** Në kohën që Krishti bashkë me Petron, Jakovin dhe Joanin qëndonin në malin Tavor, babai ua solli fëmijën dishepujve, por ata nuk mundën që ta shëronin.

19 Atëhere nxënësit’ erthnë për anë Jisujt veçanë, e thanë, përse neve nukë muntmë t’a nxjerm’ atë? 20 Edhe Jisuj u tha atyre: Për pabesërinë t’uaj; sepse me të-vërtetë po u them juve: Ndë paçi besë sa një koqe sinapi, do t’i thoni këti mali, shko së-këtejmi atje, edhe do të shkonjë, edhe nukë do të jetë gjë që të mos muntni ju t’a bënt. 21 Edhe ky komp nukë del veç me të-falur’e me agjerim.

1- **Për pabesinë tuaj.** Dishepujt e pyetën Krishtin përse nuk mundën që ta nxirrnin djallin nga djaloshi? Krishti u përgjigjet që ju

nuk besuat, sepse nëse do të kemi sadopak besim (e krahason me një kokërr sinapi) atëherë mund të bëjmë mrekullira.

PARATHËNIA E DYTË E PËSIMIT
DHE E NGJALLJES SË TIJ
(Marku 9:30-32, Lluka 9:43-45)

22 Edhe ata tek po silleshinë për qark ndë Galilet, Jisuj u tha atyre; I Bir'i njeriut do të epetë ndër duart të njerësvet; 23 Edhe do t'a vrasën' atë, edhe të-tretënë ditë do të ngjalletë. Edhe atyre u erdhi keq fort.

1-Biri i njeriut do të jepet ndë duar të njerëzve. Krishti e sheh të njevojshme që t'u thotë dishepujve që do të tradhëtohet e do ta kapin njerëzit. Më pas ata do tavrasin atë dhe do të ngjallet në të tretën ditë. Këtë ua thotë që dishepujt të jenë të parapërgatitur që do të ndahen nga mësuesi i tyre.

SI E PAGOI JISUI TAKSËN PËR TEMPULLIN

24 Edhe kur erthnë ndë Kapernaum, erthnë përanë Pjetrit ata që merninë pagesën' e të dy drahamivet, edhe i thane: A nukë paguan mësonjësi juaj të dy drahamitë?

1- A nuk i paguan mësuesi juaj dy drahamitë? Drahamia ishte një lloj monedhe prej argjendi greke e barabartë me vlerën e një Denari. Çdo hebre, i cili kishte mbushur moshën 20 vjeç paguante taksën e tempullit. Kjo taksë, që kushtonte dy drahami paguej një herë në vit.

25 Ay thotë, Po. Edhe kur hyri ndë shtëpit, Jisuj e priti, dyke thënë: Si të duketë, Simon? Nga cilëtë marrënë pagesa a të-dhëna mbretërit' e dheut, nga bijt' e tyre, apo nga të-huajtë? 26

Pjetri i thot'ati, nga të-huajtë. Jisuj i tha ati: Bijtë pra janë të-liruarë.

1-Po e paguan. Petro duke mos e menduar gjatë tha një “Po” të pamenduar. Petro mendoi që Krishti i nënshtrohej vullnetarisht Ligjit. Por Krishti është Biri i Perëndisë dhe nuk paguan taksat që i kanë vënë mbretërit.

27 Po që të mos skandhalisim'ata, shko ndë det, e hith një grep, edhe ngre peshkun' e-parë që të dalë, edhe si t'i hapç gojënë, do të gjenç një statir; merr-e, e epu'a atyre për mua edhe për ty.

1- Për mua dhe për ty. Më këto fjalë Krishti e urdhëroi Petron që ta paguante taksën e tempullit për atë dhe për vete.

KREU I TETËMBËDHJETË

KUSH ËSHTË MË I MADHI

(Marku 9:33-37, 42-48, Lluca 9: 46-48, 17;1,2)

1 Nd ‘atë orë erthnë nxënësitë të Jisuj, e i thane: **Vallë cili është më i-math ndë mbretërit të qiejvet?** **2** Edhe Jisuj thirri për anë vetëhes’së ti një çun të-vogëlë, edhe e qëndroj atë ndë mest t’atyre, e tha, **3** Me të-vërtetë po u them juve, ndë mos u kthefshi, e të bëneni posi çunat’ e-vegjëlë, nukë do të hyni ndë mbretërit të qiejvet. **4** Kush të përunjë pra vetëhen’ e ti posi ky çun’i-vogëlë, ky është më i-math ndë mbretërit të qiejvet; **5** Edhe kush të presë një të-këtitillë çun të-vogëlë mb’emërit t’im, më ka priturë mua. **6** Po kush të skandhalisnjë një nga këta të vegjëlitë që më mbesojnë, është më mirë për atë të varetë një gur mulliri mbi qafët t’ati, edhe të kredhetë ndë funt të detit.

1- Një fëmijë të vogël si ky në emërin tim, më pranon mua. Fëmija i vogël që ngriti Krishti ndër krahë është Shën Ignati i Antiokisë. I hironitur prift prej apostujve të shënjtë, ai u zgjodh prej tyre episkop i Antiokisë gjatë viteve 68-70 p.K. Ignati quhej ndryshe edhe “Hyjmbajtësi” sepse kur ishte fëmijë Krishti e solli si shembull: “Dhe Jezusi, pasi thirri një fëmijë të vogël pranë vetes, e vuri në mes tyre dhe tha:- Nëse nuk ktheheni dhe të bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në Mbretërinë e Qiejve. Dhe kushdo

që pranon një fëmijë të vogël si ky në emërin tim, më pranon mua”(Matheu 18,2-5).

7 Mjerë bota nga skandhalihtë; sepse është nevojë të vinjënë skandhalihtë; po mjerë ay njeri, prej të-cilit vjen skandhalia. 8 Edhe ndë të skandhalihtë dora jote a këmba jote, prei, edhe hidh-i prej teje; është më mirë për ty të hynjë ndë jetët i-çalë a dorac, se të kesh dy duar a dy këmbë, e të hidhesh ndë zjarrt të-pasosurë. 9 Edhe ndë të skandhalihtë syri yt, nxir-e atë, e hidh-e prej teje; më mirë është për ty të hynjë ndë jetët me një sy vetëmë, se të kesh dy sy, e të hidhesh ndë gjehenet të zjarrit. 10 Shikoni, mos bëni për asgjë një nga këta të-vegjëlité; sepse po u them juve, se engjëjt’ e atyre ndë qiejt shohënë gjithënjë faqen’e t’im Eti që është ndë qiejt. 11 Sepse i Bir’ i njeriut erdhi të shpëtonjë të-humburinë.

1- Mjerë bota për skandalet. Në këtë rast Krishti paralajmëron për ngasjet që do të vijnë dhe rrezikun e madh të skandalisjes së gjithë njerëzve.

2- Mos përbuzni këta të vegjël. Krishti e ka fjalën për nxënësit e tij. Perëndia i ka bekuar dhe lavdëruar ata duke urdhëruar engjëjt e tij, të cilët shohin vazhdimisht fytyrën e tij.

PARAVOLIA E DELES SË HUMBUR

(Lluka 15:1-7)

12 Ç’ u duketë juve? Ndë pastë ndonjë njeri një qint dhën, edhe t’i humbasë një nga ato, a nukë le të nënte-dhjet’e nëntatë, e vete ndëpër malet të kërkonjë të-humburënë? 13 Edhe ndë qoftë se e gjen, me të-vërtetë po u them juve, se gëzonetë më tepërë për atë se për të nëntë-dhjet’e nëntatë, që s’kanë humburë.

14 Kështu nuk' është' e-dashurë përpara Atit t'uaj që është ndë qiejt të humbasë një nga këta të-vegjëlité.

1-Gëzohet më tepër. Krishti gëzohet shumë kur gjen delen e humbur. Këtu e ka kuptimin se Perëndia gëzohet kur një prej mëkatarëve kthehet në gjirin e kishës.

NDJESA PËR VËLLAIN

(Lluka 17:3)

15 Edhe ndë të bëftë faj yt vëlla, shko edhe qerto-e ndë mesi teje edhe t'ati vetëmë; ndë të dëgjoftë, e fitove t'ët vëlla; **16** Po ndë mos të dëgjoftë, merr me vetëhe edhe një a dy veta që të qëndronjë çdo fjalë ndë gojë dy a tre dëshmitarëve. **17** Edhe ndë mos i dëgjoftë ata, thua-j'a këtë kishësë; edhe ndë mos e dëgjoftë edhe kishënë, atehere ay le të jetë të ti posi gjentari e kumerqari. **18** Me të-vërtetë po u them juve: Ç'të lithni mbi dhet, do të jenë lidhurë ndë qielit; edhe ç'të sgjithni mbi dhet, do të jenë sgjidhurë ndë gielit. **19** Përsëri po u them juve, se ndë qofshinë mbi dhet dy veta nga ju mbë një fjalë, për çdo fare gjëje që të lypnjënë, do t'u bënet' atyre nga im Atë që është ndë qiet. **20** Sepse ku të jenë dy a tre veta mbledhurë mb'emërit t'im, atje jam edhe unë ndë mest t'atyre. **21** Atëhere i erdhi përnanë Pjetri, e tha, Zot, sa herë të më fëjenjë im vëlla, edhe t'ja fal ati? gjer mbë shtatë herë? **22** Jisuj i thot'ati: Nukë të them, gjer mbë shtatë herë, po gjer mbë shtatë-dhjetë herë nga shtatë.

1- **Le të jetë për ty si pagan dhe targambledhës.** Me fjalën pagan kuptojmë atë njeri, i cili nuk ishte judeas. Me fjalë të tjera quheshin ata njerëz, që u faleshin idhujve. Ndërsa targambledhësit, qenë ata njerëz të cilët mblidhnin taksat në favor të romakëve.

2- **Deri më sa herë duhet ta falë vëllanë?** Farisenjtë e jepnin faljen deri në tri herë. Petro e shtoi numrin në shtatë, ndofta që ky

numër simbolikisht konsiderohej i përkryer për judenjtë. Por sipas grigorit të Nisës, ekzistonte një traditë e lashtë tej judenjtë për ta falur tjetrin shtatë herë. Kjo e kishte origjinën nga dita e shtatë, pra ajo e pushimit të Perëndisë. Pra distën e pushimit atë të sabatit, Perëndia falte gjithë ata që pendoheshin sinqerisht.

PARAVOLIA E SHËRBËTORIT TË LIG

23 Përandaj mbretëri'e qiejvet gjau me një njeri mbret, që deshi të shohë llogari me shërbëtoret'e ti. **24** Edhe kur zuri të shohë llogari, i prunë një detuar që i kishte detyrë dhjetë mije tallanda. **25** Edhe ay pasi nukë kishte t'i lanjë, i zoti urdhëroj të shitet'ay, edhe grua'j'e ati, edhe të bijtë, edhe gjithë ç'kishte, edhe të lahetë detyra. **26** Po shërbëtori i ra ndër këmbë, e i lutej, dyke thënë, Zot, bënu zëmërë-gjerë mbë mua, edhe do të t'i lanj të-gjitha. **27** Edhe të zot si i u dhëmp për atë shërbëtuar, e lëshoj, edhe j'a la detyrënë. **28** Po ay shërbëtuar si dolli, gjeti një nga shokët'e ti shërbëtorë që i kishte detyrë ati një qint dinare; edhe si e zuri, e mbyste, dyke thënë: Laj-më ç'detyrë më ke. **29** Atëhere pra shoku i ti shërbëtuar i ra ndër këmbë, e i lutej, dyke thënë: Bënu zëmërë-gjerë mbë mua, edhe do të t'i lanj të-gjitha. **30** Edhe ay nukë donte, po shkoj edhe e vuri ndë burk, gjersa t'i lante detyrënë.

1-Mbreti deshi të shihte llogarinë e shërbëtorëve të tij. Mbreti është Perëndia, kurse shërbëtorët janë njerëzit. Borxhi i madh prej dhjetë mijë tallandash tregon mëkatet që bëjmë ne, ndësa borxhi i vogël prej njëqin dinarësh simbolizon falet që i bëjnë njerëzit njeri-tjetrit.

2- Më paguaj borxhin që më ke. Shërbëtori i mbushur gjithë gëzim kthehet për në shtëpinë e tij, për të njoftuar edhe pjestarët e tjerë të familjes që iu falën të gjitha borxhet që kishte. Mirëpo gjatë

rrugës takon një mikun e tij që i kishte një borxh të vjetër prej 10 dinarësh, e cila ishte një shumë e papërfillshme në krahasim me atë borxh që iu fal nga zotëria i tij. Menjëherë e zuri për fyti duke i thënë: “më paguaj borxhin që më ke “. Ai i ra në gjunjë dhe i lutej se do t’ia shlyente borxhin, por më kot. E futi në burg derisa t’i shlyente detyrimin.

31 Edhe shokët’ e ti shërbëtorë, kur panë se ç’ubë, u helmuanë fort; edhe erthnë e i rrëfyanë të zott gjithë sa u bënë. 32 Atëhere i zoti e thirri përanë, e i tha: Shërbëtuar i-lik, gjith’atë detyrë t’a lashë ty, sepse m’u lute; 33 Nukë duhej edhe ti t’a përdëllenje shoknë t’ënt shërbëtuar, sindëkur të përdëlleva edhe unë ty?

1- **Ti nuk ke aspak mëshirë për mikun tënd?** Kur mësoi për këtë gjë, zotëria i tij u zemërua shumë e i tha:”Unë të fala gjithë atë borxh të madh sepse mu lute, ndërsa ti nuk ke aspak mëshirë për mikun tënd?”

34 Edhe i zoti u zemërua, edhe e dha ndër duart t’atyre që mundojnë, gjer sa të lanjë gjithë detyrënë që i kishte ati. 35 Kështu edhe im Atë qiellori do t’ua bënë juve, ndë mos u’a falçi prej zëmëresë s’uaj gjithë-sicili të vëllat të ti fajet’e atyre.

1- **Detyrimi ndaj Perëndisë.** Kjo paravoli na kujton një nga çështjet më të rëndësishme të jetës sonë. Të gjithë i detyrohemi Perëndisë jo vetëm për dhuratat materiale e shpirtërore që na ka dhënë, por edhe për faljen e mëkatave tona të shumta. Këto janë borxhet tona që Zoti i gjithëmire na i fal, nëse edhe neve ua falim fajtorëve tanë. Perëndia nuk dëshiron lutjet dhe sakrificat tona nëse nuk i kemi falur të gjithë njerëzit tanë.

KREU I NËNTËMBËDHJETË

MARTESA DHE DIVORCI

(Marku 10:1-12)

1 Edhe Jisuj kur mbaroj këto fjalë, u ngrit nga Galilea, edhe erdhi ndë sinorët të Judhesë, përtej Jordhanit; 2 Edhe i vanë pas ati shumë gjindje; edhe i shëroj ata atje.

1- U ngrit nga Galileja dhe erdhi në Jude. Krishti sapo përfundoi misionin e tij në Galile, morri udhën drejt Judesë, pra për të shkuar në qytetin e shenjtë të Jerusalemit.

3 Edhe erthnë tek ay Farisenjtë dyke ngarë atë, e dyke thënë ati, a është e udhësë njeriu të lëshonjë gruan'e ti për çdo farë faje?

1- A është e udhës që njeriu ta lërë gruan? Farisenjtë mundohen që ta kapin me fjalë Krishtin. Hebrenjtë e kishin për traditë që gruaja ndahej edhe për një gabim të vogël.

4 Edhe ay u përgjeq e u tha atyre: Nukë keni kënduarë, se ay që bëri ata që ndë kryët të herësë, mashkull edhe femërë i bëri ata, edhe tha, 5 ‘Për këtë punë njeriu do të lërë t’an e t’ëmënë, edhe do të ngjitetë pas gruas’së ti, edhe të dy do të jenë një mish?’ Kaqë sa nukë janë me dy, po një mish. **6 Atë pra që Perëndia e bëri par, njeriu letë mos e ndanjë.**

1-Atë që bëri Perëndia, njeriu të mos ta ndajë. Pasi lidhen në martesë burri dhe gruaja janë një trup.

7 I thon' ati, Përse pra Moisiu ka porositurë t'i apë njeriu gruasë kartën'e ndarjesë, edhe t'a lëshonjë? 8 U thot' atyre, Sepse Moisiu për zëmër-ashpërimnë t'uaj u dha juve leje të lëshoni gratë t'uaj; po ndë kryet të herësë s'ka qënë kështu. 9 Edhe po u them juve, se ay që të lëshonjë gruan'e ti, përveç për punë kurvërie, edhe të martonetë me tjetërë, kurvëron: edhe ay që të martonetë me grua të lëshuarë, kurvëron. 10 Nxënësit'e ti i thonë: Ndë qoftë kështu pun'e njeriut me gruanë, nuk'është mirë të martonetë. 11 Edhe ay u thot' atyre: Nukë munt t'a presënë këtë fjalë të-gjithë, po atyreve që u është dhënë. 12 Sepse ka të-dredhurë që kanë lindurë kështu që nga barku i mëmësë; edhe ka të-dredhurë që u drothnë nga njerëzitë; edhe ka të-dredhurë që drothnë vetëhen'e tyre për mbretërin'e qiejvet. Ay që munt t'a presë këtë let'a presë.

1- Unë po u them. Me këto fjalë e ka kuptimin unë që kam fuqinë dhe zotërimin, që jam tashmë ligjëvënës. Martesa është ecuria e shenjtë, që kalon nga sakrifica në hyjnimin e dy bashkëshortëve.

2- Më mirë të mos martohen. Dishepujt tani e kuptuan peshën e porosisë, prandaj thonë më mirë të mos martohesh.

3- Eunukët. Janë ata të cilët do të mohojnë kënaqësinë trupore për t'ju kushtuar Perëndisë.

JISUI BEKON FËMIJËT

(Marku 10:13-16, Lluca 18:15-17)

13 Atëhere iu prun'ati ca çuna të-vegjëlë, që të vinte duartë mbi ata, e t'i bekonte; edhe nxënësitë i qertuanë. 14 Po Jisuj tha, lini çunat' e-vegjëlë, edhe mos i ndaloni të vijnë tek

unë; sepse e të-këtillevet është mbretëri'e qiejvet. 15 Edhe si vuri duartë mbi ata, iku andej.

1- **Lërimi fëmijët.** Kjo ngjarje u zhvillua në Perea. Dishepuj deshën ti përzinin fëmijët, sepse Krishti ishte i lodhur dhe nuk deshën që ta shqetësonin. Por Krishti u thotë atyre: “lërimi fëmijët të vijnë tek unë, sepse atyre u përket mbretëria e qiejve”. Të gjithë ata që duan të hyjnë në mbretërinë e qiejve duhet të jenë të pastër si fëmijët.

PASURIA DHE JETA E AMSHUAR

(Marku 10:17-31, Lluca 18:18-30)

16 Edhe ja tek i erdhi për anë një njeri, e i tha: Mësonjës i-mirë, ç'të-mirë të bënj që të kem jetë të-pasosurë?

1- **Mësues, çfarë duhet të bëj që ta trashëgoj jetën e përjetshme?** Jisui vendosi që të shkonte në qytetin e Peresë. Një njeri i pasur, u afrua tek burimi i përjetësisë që është Jisu Krishti, për të marë mësimet e duhura. Ai ia kishte kaluar mirë në tokë dhe të njëjntën gjë dëshironte ta vazhdonte edhe në përjetësi.

2- **Njeriu erdhi tek Jisui duke e ngacmuar me pyetje.** Shumë njerëz i janë afruar Jisuit për shkaqe të ndryshme. Disa i janë afruar për ta njohur, të tjerë për t'i kërkuar diçka, disa për tu bërë dishepuj të tij, të tjerë për tu shëruar dhe disa për ta tradhëtuar. Historia e Krishtëritimit i njeh me emra këta njerëz për shembull Apostull Andrea iu afrua Krishtit për tu bërë dishepull i tij prandaj u quait edhe i parëthirruri. Thomai nuk donte që ta besonte dhe Juda do ta tradhëtonte, ndërsa i pasuri i ungjillit donte që ta ngacmonte.

3- **Njerëzit që i afrohen Krishtit.** Krishti me çdonjerin prej tyre sillej në mënyrë analoge. Kjo ka ndodhur gjithnjë me Krishtin, gjithë sa vinin me besim e me zemër janë bekuar, ndërsa ata që i afrohen me dinakëri dhe për ta ngacmuar janë shkatërruar. Po ne si i afrohem Krishtit? Vetë Zoti dhe shpëtimtari ynë Jisu Krishti e ka

thënë mjaft qartë: “Ai që beson në mua nuk do të mbesë në errësi por do të ketë jetën e përjetëshme”. Vërtetë ai që beson më Krishtin jeton në përjetësi. Prandaj edhe i pasuri i Ungjillit të sotëm iu drejtua Krishtit që të mësonte se ç’ duhej të bënte që ta fitonte përjetësinë. Zoti ynë Jisu Krishti na e ka thënë qartë: “Unë jam në mes tuaj dhe Mbretëria e Perëndisë ka filluar”.

17 Edhe ay i tha, ç’ më thua i-mirë? Asndonjë s’është i-mirë veç një Perëndia. Po ndë do të hynjë nde jetët, ruaj porositë. I thot’ ati, cilatë? 18 Edhe Jisuj i tha, “mos vraç; mos kurvërojsh; mos vjethç; mos apç dëshmim të-rrem; Ndero të t’at’e t’ët ëmë;” edhe 19 “Të duash të-afërminë t’ënt posi vetëhenë t’ënde.” 20 Djaloshi i thot’ ati, Të-gjitha këto i kam ruajturë që mbë të-rit t’im; po ç’ më mbetetë më? 21 Jisuj i tha ati, ndë do të bënesht i-sosurë, shko e shit gjënë t’ënde, edhe ep-u’a të-vobeqvet; edhe do të kesh thesar ndë qiell, edhe eja, e ngit-m’u pas. 22 Po djaloshi kur dëgjoj këtë fjalë, iku i-helmuarë, sepse kishte shumë gjë.

1- **Zbato porositë.** Ai i kishte zbatuar porositë e Perëndisë, por sapo erdhi momenti që ta shiste pasurinë e tij, nuk pranoi. Vërtet djaloshi i pasur kishte duar të pastra sepse asnjëherë nuk kishte vjedhur, nuk kishte vrarë etj, por ai kishte një të metë, nuk i donte njerëzit që vuanin. Krishti na do që vërtet të jemi me duar të pastra, por ato të jenë të mbushura me vepra dashurie dhe bamirësie.

2- **Shit pasurinë.** Kur Krishti i tha që ta mohonte pasurinë dhe të ecte bashkë me të, ai u dëshpërua shumë. Fatkeqësisht disa njerëz nuk ndoqën Krishtin. Ata preferuan të përkohshmen dhe jo të përjetshmen, errësirën dhe jo dritën, gënjeshtrenë dhe jo të vërtetën. Një gabim themelor i djaloshtit të pasur ishte konceptimi mdërmjet të sotmes dhe përjetësisë. Ai mendonte se jeta e njeriut kufizohet vetëm ndërmjet lindjes dhe vdekjes duke e lënë mënjanë oqeanin e pafund të përjetësisë. Gabim mendojmë edhe ne kur kohën e masim me të

tashmen dhe të ardhmen duke krijuar përshtypjen se koha që jetojmë u përket vetëm kënaqësi të përkohshme dhe harrohet prespektiva e përjetësisë.

23 Edhe Jisuj u tha nxënësve të ti: Me të vërtetë po u them juve, se njeriu i-pasurë mezi do të hynjë në mbretërit të qiejve. 24 Edhe përsëri po u them juve, më kollaj është të shkonjë kamilla ndëpër vrimet të gjëlpërësë, se të hynjë i-pasuri në mbretërit të Perëndisë. 25 Edhe nxënësit'e ti, kur dëgjuanë, tmeroneshinë fort, e thoshinë, vallë cili munt të shpëtonjë? 26 Po Jisuj shtyri sytë mb'ata e u tha atyre, te njerëzitë këjo është punë që s' munt të bënetë, po te Perëndija të-gjitha janë të-mundura.

1- Është e vështirë që të hyjë i pasuri në mbretërinë e qiejve. Dëshëm që të theksonim se të pasurit nuk përjashtohen nga mbretëria e qiejve, por ata mund të hyjnë në të nëse bëjnë bamirësi. Kjo është gjë e vështirë për ta, por jo e pamundur.

2- Kush do të shpëtojë? Dishepujt të frikësuar e pyesin Krishtin se kush do të shpëtojë vallë? Jisui për ti qetësuar ata tha: "Të pamundurat për njerëzit janë të mundura tek Perëndia".

27 Atëhere u përgjeq Pjetri e i tha ati: Ja ne tek lamë të-gjitha, edhe erthmë prapa teje; vallë ç 'do të jetë mbë ne? 28 Edhe Jisuj u tha atyre: Me të-vërtetë po u them juve, se ju që më erthtë pas, në krijesët të-re, kur të rrijë i Bir'i njeriut mbi front të lavdis së ti, do të rini edhe ju mbi dy-mbë-dhjetë ftone dyke gjykuarë të dy-mbë-dhjetë farat'e Israilit. 29 Edhe kushdo që la shtëpi, a vëllezër, a motëra, a atë, a mëmë, a grua, a bij, a ara, për punë t'emërit t'im, do të marrë një qint për një, edhe do të trashëgonjë jetë të pasosurë. 30 Po shumë të-parë do të jenë të-prapësm, edhe të-prapësm të-parë.

1- **Në krijimin e ri.** Krishti u premton dishepujve që do të jenë të ulur në dymbëdhjetë frone për të gjykuar fiset e Izraelit.

2- **Të parët do të jenë të fundit.** Si shembull i të parëve që do të dalin të fundit janë të pasurit. Ndërsa i fundit do të dali në krye, përfaqësohet me Llazarin e varfër, me targambkedhësin e penduar etj.

KREU I NJËZETË

PARAVOLIA E VRESHTARËVE

1 Sepse mbretëri' e qiejvet gjan me një njeri zot shtëpie, i-cili doli që me natë të pajtonjë punëtorë për veshtin' e ti; 2 Edhe si pajtoj punëtorët nga një dinar ndë ditët, i dërgoj ndë veshtët të ti. 3 Pastaj doli ndaj të tretënë orë, e pa të-tjerë dyke ndënjurë ndë trekt pa punë. 4 U thot' edhe atyre, shkoni edhe ju ndë veshtet, edhe do t'u ap ç'të jet' e udhësë. 5 Edhe ata vanë. Përsëri doli ndaj të gjashtëtën' edhe të-nëntëtën' orë, edhe bëri po ashtu. 6 Edhe si doli ndaj të-një-mbë-dhjetëtën' orë, gjeti të-tjerë dyke ndënjurë pa punë; u thot' edhe atyre, Përse rrini këtu tërë ditënë pa punë? 7 I thon' ati, sepse asndonjë s'na pajtoj. U thot' atyre, shkoni edhe ju ndë veshtët, edhe do të merni ç'të jet' e udhësë. 8 Edhe si u ngrys, i zot'i veshtit i thotë kujdestarit të ti, Thirrë punëtorët, edhe laj-u pagënë atyre, dyke zënë nga të-prapësmitë gjer mbë të parët. 9 Edhe erthnë ata që ishinë pajtuarë ndaj të një-mbë-dhjetënë orë, edhe muarnë nga një dinar. 10 Edhe kur erthnë të-parëtë, pandehnë se do të marrënë më shumë; po edhe ata muarnë nga një dinar. 11 Edhe si muarnë, qaheshinë mbë të zon' e shtëpisë, dyke thënë, 12 Se këta të-prapësmitë bënë një orë, edhe i bëre si-një me ne që mbajtmë të-rëndit' e ditës' edhe vapënë. 13 Po ay u përgjeq e i tha njerit nga ata, mik, nukë të bënj keq; a nukë bëre fjalë me mua një dinar?

14 Merr t'ëndinë edhe ikë; edhe këti të-prapësmit do t'i ap si edhe ty; 15 Apo s' munt unë të bënj ç'të dua ndë punët t'ime? apo syri yt është'i-lik, sepse unë jam i-mirë? 16 Kështu do të jenë të-prapësmitë të-parë, edhe të-parëtë të-prapësm; sepse shumë veta janë të-thirrurë, po të-pakë të-sgjedhurë.

1- **Të parët do të jenë të fundit.** Këtë paravoli, Zoti e tha pak ditë përpara pësimeve të Tij dhe gjen zbatim në çdo popull, i cili gëzon mirëdashjen dhe mbrojtjen e Perëndisë. Me pronarin e vreshtit nënkuptojmë Perëndinë, ndërsa vreshti është populli i Izraelit. Herë pas here pronari dërgonte në vreshtë shërbëtorët e tij për të marrë prodhimin, sepse ishte e natyrshme që izraelitët në kohën e duhur duhet të dorëzonin frytet e punës së tyre. Pra koha ishte ora e nëntë, dymbëdhjetë, e tretë dhe e gjashtë. Ata që punuan vetëm një orë muarën pagë të barabartë me ata që punuan gjithë ditën. Kjo paravoli tregon se të parët do të jenë të fundit për të hyrë në Mbretërinë e qiejve. Për të hyrë në Mbretërinë e Qiejve nuk do të merret parasysh koha e punës, por vullneti ynë i mirë.

PARATHËNIA E TRETË E JISUIT PËR PËSIMIN DHE NGJALLJEN E VET

(Marku 10:32-34, Lluca 18: 31-43)

17 Edhe Jisuj dyke hipurë ndë Jerusolim, mori me vetëhe të dy-mbë-dhjetë nxënësitë mbë nj'anë mb'udhë, edhe u tha atyre, 18 Ja tek po hipëjmë ndë Jerusolim, edhe i Bir'i njeriut dot' epetë ndë duart të krye-priftëret edhe të shkronjësvet; edhe do t'a dënonjë në vdekje; 19 Edhe do t'a apënë ndë duart të kombevet që t'a përqeshnjën'e t'a rrahën'e t'a kryqëzonjë; edhe të-tretënë ditë do të ngjalletë.

1-**Jisui duke shkuar në Jerusalem.** Jisui u nis bashkë me dishepujt për të shkuar në Jerusalem.

KËRKESA E BIJVE TË ZEVEDHEUT

(Marku 10:35-45)

20 Atëhere i erdhi përanë e ëm'e të bijvet të Zevedheut bashkë me të bijtë, dyke luturë, e dyke lypurë një gjë nga ay. **21** Edhe ay i tha asaj: Ç' do? Ajo i thot'ati, thuaj të rrinë këta të dy bijt'e mi, njeri mbë të-djathtët t'ënt, e njeri mbë të-mëngjërët, ndë mbretërit t'ënde. **22** Po Jisuj u përgjeq e tha: Nukë dini se ç'lypni; muntni të pini kupënë, që do të pi unë, edhe të pagëzoneni me pagëzimmë që do të pagëzonem unë? Ata i thon'ati, Muntmë. **23** Edhe ay u thot' atyre, kupënë t'ime do t'a pini, edhe me pagëzimmë që pagëzonem unë do të pagëzonemi; po të rrinë mbë të djathtët t'im edhe mbë të-mëngjërët t'im, nuk'është në dorët t'ime t'a ap, po do t'u epet' atyre që u është bërë gati nga im Atë.

1- **Bashkë me bijtë e vet.** Nëna e bijve të Zevedheut ishte Saloma, e cila kishte dy djem Jakovin dhe Joanin. Saloma ju lut Krishtit që në mbretërinë e qiejve të vendoste bijtë e saj njerin në të majtë dhe tjetrin në të djathtë. Kjo ngjarje ka ndodhur në Perea.

2- **Bijtë e mi.** Saloma mendonte që mbretëria e Krishtit do të ishte njerëzore dhe tokësore. Sigurisht që vendet pranë fronit do të genë më të nderuarat.

24 Edhe të dhjetëtë, kur dëgjuanë, u zëmëruanë për të dy vëllezëritë. **25** Po Jisuj i thirri ata e tha: E dini se të-parët'e kombevet kanë pushtet mbi ata, edhe të-mëdhenjt'i urdhërojnë ata; **26** Po kështu nukë do të jetë ndër ju; po kush të dojë të bënet' i-math nder ju, le të jetë shërbëtori juaj; **27** Edhe kush të dojë të jet'i-parë ndër ju, le të jetë shërbëtori juaj; **28** Sikundrë i Bir'i njeriut nuk'erdhi që të shërbenetë, po që të shërbenjë, edhe t'apë jetën'e ti çpërblim për shumë veta.

1- **A mund ta pini kupën?** Pirja e kupës është përdorur si metaforë dhe mund të pihet për gëzim ose për hidhërim. Në rastin

konkret kupa simbolizon pësimin, ndërsa pagëzimi simbolizon vdekjen.

2- **Si çmim për shpëtimin e shumë vetëve.** Jeta e Birit të Perëndisë u dha për shpëtimin e njerëzve. Vetëm dashuria e pafund e Perëndisë mund të shpëtonte njerëzit nga mëkati dhe vdekja.

SHËRIMI I DY TË VERBBËRVE NË JERIKO

(Marku 10:46-52, Lluka 18:35-43)

29 Edhe ata tek po dilnin nga Jerihoja, i vanë pas ati shumë gjindje.

1-Tek po dilnin nga Jerikoja. Qyteti i Jerikosë gjendet shtatë deri në tetë orë larg Jerusalemit. Jerikoja ishte qytet ku zhvillohej tregtia. Për nga rëndësia ishte qyteti i dytë pas Jerusalemit. Jerikoja ishte qytet i bukur dhe i pasur, i mbushur me palma, trëndafila dhe gjelbërim.

30 Edhe ja dy të-verbërë, që rrinin mb’udhët, kur dëgjuanë, se po shkonte Jisuj, bërtitnë, dyke thënë, Përdëlle-na, o Zot, bir’i Dhavidhit. 31 Edhe gjindja i qertoj ata, që të pushonin; po ata bërtitnin më fort, dyke thënë, Përdëlle-na, o Zot, bir’i Dhavidhit.

1- O Jisu, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua. Ndërsa Jisui po i afrohej Jerikosë, dy të verbër qenë ulur përgjatë rrugës dhe po lypnin lëmoshë. Kur dëgjuan se po kalonte turma me njerëz ata pyetën se ç’po ndodhte. U thanë se po kalonte Jisui nga Nazareti. Atëherë ata bërrtitën: “O Jisu, Bir i Davidit, mëshirona”. Njerëzit që qenë përpara tyre u thanë që të pushonin, por ata i thërritën më fort: “O Jisu mëshirona”. Le të ndalemi pak dhe të analizojmë këto vargje: - Dy të verbër i thërrasin Krishtit për ndihmë, veçse njerëzit i shtyjnë dhe u thonë që të heshtin. Ata njerëz dëshironin të kënaqnin vetëm

veten e tyre, duke u shtyrë kush e kush ta prekte Krishtin, dhe nuk treguan interes për të verbërit. Në fakt ata njerëz besonin verbërisht tek Krishti, sepse besimi i tyre nuk shoqërohej nga dashuria për bashkëqytetarët e tyre. Besimi pa dashuri është i vdekur.

32 Edhe Jisuj qëndroj e i thirri ata, edhe tha, Ç' doni t'u bënj juve? 33 I thonë, Zot, të na hapenë sytë. 34 Edhe Jisujt si iu dhëmp për ta, preku syt'e atyre; edhe për një-here u hapnë syt'e atyre, e vanë pas ati.

1- **Zot të na hapen sytë.** Të verbërit vërtet kishin humbur dritën e syve, por nuk kishin humbur durimin. E pikërisht duke pasur besim të plotë tek Krishti, ata mundën të rigjenin dritën. Në çastin që të gjithë njerëzit shtyheshin, e nuk e ndihmonin, ata këmbëngulën që të takonin Krishtin edhe fituan.

2- **Vanë pas tij.** Sapo morën dritën e syve të verbërit ndiqën Krishtin duke lavdëruar Perëndinë. Sa u lartësuan të verbërit e Jerikosë, përballë atyre njerëzve që u thonin të heshtnin duke ua mbyllur rrugën për ta takuar Krishtin? Ndarja e besimit nga dashuria është një katastrofë e vërtetë. Mjaft të krishterë vijnë në Kishë me besim e shprestari dhe nga ana tjetër ata nuk i ndihmojnë bashkëqytetarët e tyre, nuk mbështesin njerëzit që kanë nevojë. Nëse duam të gjallërojmë jetën tonë shpirtërore, duhet ta mbushim atë me dashuri.

KREU I NJËZETENJË

HYRJA E JISUIT NË JERUSALEM

(Marku 11:1-11, Lluca 19:45-48), Joani 2:13-22)

1 Edhe kur u afëruanë ndë Jerusolim, edhe erthnë ndë Vithfagji ndaj malit të Ullinjvet, atëhere Jisuj dërgoj dy nxënës, dyke thënë atyre, 2 Shkoni mb' atë fshat që është përkundruell jush; edhe për-një-here dotë gjeni një gomare lidhurë, edhe një pulisht bashkë me atë; zgjidh-i-ni e m'i bini.

1-Kur u afruan në Jeruzalem. Krishti më datën tetë të muajit Nisan udhëtonte nga Jerikoja drejt Jerusalemit. Të premtën mbërritën në Vithani, ku Maria e motra e Llazarit leu këmbët e Krishtit me miro. Më datën dhjetë të muajit Nisan ishte ditë e dielë dhe ai u nis prej Betanisë për të hyrë në Jerusalem. Ishte dita ku sipas ligjit të Moisiut hebrenjtë përgatisnin qingjin. Pikërisht atë ditë që përgatitej qingji për t'u flijuar Krishti hyri në mënyrë triumfale në Jerusalem për t'i treguar popullit që ishte Mesia i shumëpritur. Pikërisht tani fillon edhe periudha e tretë e jetës së tij, ajo e pësimeve.

2- Betfage. Kjo fjalë në gjuhën hebraike do të thotë *shtëpia e fiqve*. Betfageja ishte një fshat i vogël ndërmjet Betanisë dhe Jerusalemit.

3 Edhe ndë u thëntë gjë juve ndonë njeri, t'i thoni, se Zoti ka nevojë për atë; edhe për-një-here do t'i dërgonj'ata. 4

Edhe gjithë këjo u bë, që të mbushetë ç'është thënë nga profiti, që thotë, 5 “Thoni bijësë Sionë; Ja mbreti yt tek po të vjen i butë, edhe hipurë mbi gomare, edhe mbi pulisht bir stëze.” 6 Edhe nxënësitë si vanë, edhe bënë sindëkur i urdhëroj ata Jisuj, prunë gomaren edhe pulishtinë; 7 Edhe vunë mbi ata rrobat’e tyre edhe e hipnë atë sipër’atyre.

1-Krishti hyri në Jeruzalem i hypur në një kriç gomari. Në lindje gomari konsiderohej si një kafshë e dobishme që përdorej për punë të ndryshme në kohë qetësie. Në Dhiatën e Vjetër përmendet se e përdorin princërit e mbretërit. Kur një princ shkonte për luftë, hypte në një kalë të fuqishëm, ndërsa kur shkonte për diçka paqësore ulej në shpinën e gomarit. Krishti jo pa qëllim e zgjodhi këtë kafshë, për të treguar se nuk përfaqsonte luftëtarin ose pushtuesin, siç e imagjinonin Judenjtë Mesian, por ai ishte një mbret paqësor.

2-Profecia e Zaharisë. Këtë e kishte profetizuar profeti Zaharia : “Mos kini frikë o bijtë e Sionit! Sepse mbreti juaj po vjen mbi një kërraç gomari”(Joani 12,15). Krishti duke përparuar si princ i paqes ecën me guxim e vendosmëri. Ai e di mirë se hyrja e Tij në Jeruzalem nuk bëhet për tu lavdëruar, por për tu sakrifikuar më pas në kryq. Krishti vjen në Jeruzalem paqësisht dhe i bindur në dëshirën e Atit. Por njerzit që e rrethonin nuk e kuptonin qëllimin e ardhjes. Ai i dinte kërkesat e atyre që thërrisnin “Hosana”. Kjo fjalë nuk përbën vetëm një lavdërim, por ka dhe një kuptim tjetër “Shpëtona”.

8 Edhe më e shumë e gjindjesë shtruanë rrobat’e tyre mb’udhë; edhe të-tjerë këputninë dega drush, e i shtroninë mb’udhë.

1-Degët e dafinave. Mijëra njerëz e presin atë me degë palmash nëpër duar e duke i shtruar udhën. Degët e palmave janë simbole të fitores dhe të gëzimit. Judenjtë e kishin për zakon që kur prisnin njerëz të mëdhenj ua shtronin rrugën me dafina.

9 Edhe gjindja që shkoninë përpara edhe ata që i vininë prapa bërtitninë, dyke thënë, Hosanna mbë të birin'e Dhavidhit; i-bekuar'është'ay që vjen mb'emërit të Zotit; Hosanna mbë të-lartatë.

1-”Hosana, i bekuar është ai që vjen në emrin e zotit.” (Joani 12,13). Hosana është fjalë siriane e cila e ka kuptimin: “O Zot, na ndihmo tani; o Zot bëj që tani të kemi mbarësi” (Psalmi 118, 25). Madhështore ishte hyrja triumfale e Krishtit në Jeruzalem. Mrekullia e ngjalljes së Llazarit që u bë një ditë më parë, kishte zgjuar kureshtjen e Judenjve, të cilët të pushtuar nga entuziazmi i kësaj mrekullie vrapuan që ta shihnin me sytë e tyre. Krishti duke ardhur në Jeruzalem në mënyrë triumfale, kërkon që t’i japi mesazhin popullit hebre: “Pendohuni se po afrohet Mbretëria e Qiejve”. Sa më shumë evoluojnë ngjarjet, duket qartë se “Mbretëria” për të cilën Ai fliste po vinte. Pikërisht tani që afrohej edhe fundi i Tij deklaronte se është: Ai që vjen në emrin e Zotit. Mesia i premtuar. Judenjtë e prisnin Mesian si një mbret luftarak, i cili do ti çlironte nga zgjedha e romakëve, veçse Krishti nuk ishte mbret tokësor por qiellor.

10 Edhe ay kur hyri ndë Jerusalem, u tunt tërë qyteti dyke thënë, Cili është ky? 11 Edhe gjindja thoshinë, ky është Jisuj, profiti, që është nga Nazareti i Galilesë.

1- Cili është ky. Hebrejntë prisnin një çlirim tjetër, por Krishti u tregoi se kundërshtarët ndaj të cilëve drejtohej revolucion i Tij, nuk janë Romakët, por diçka më e thellë, është tiranizmi që ushtrohet tek njerzit me anën egoizmit e mëkatit. Për më tepër Krishti e dinte se gjithë këto demonstrime të popullit, ishin të kota dhe sipërfaqësore. Sa ditë kaluan nga e Diela e Dafinave deri tek e Premtja e Zezë? Vetëm pesë ditë. Dhe janë pikërisht ata njerëz që sot brohorasin “Hosana” që do të thotë “Shpëtona”, që pas disa ditësh

do ta tradhëtojnë e mohojnë atë duke kërkuar prej Pilatit me gojën e tyre vdekjen e Krishtit duke thirrur: “Kryqëzoje, Kryqëzoje”.

2- **Që është nga Nazareti i Galilesë.** Krishti ka lindur në Betlehem, por u rrit në Nazaret, prandaj quhet Nazareas.

DËBIMI I TREGTARËVE NGA TEMPULLI

(Marku 11:15-19, Lluca 19:45-48, Joani 2:13-22)

12 Edhe Jisuj hyri në hieroret të Perëndisë, edhe nxori jashtë gjith’ata që shisnin’e blininë në hieroret, edhe përmbysi truvezat’ e truvezarëvet, edhe fronet’ e atyre që shisninë pëllumbatë; 13 Edhe u thot’ atyre, Eshtë shkruarë “Shtëpia ime do të qyhetë shtëpi lutjeje”; po ju e bët’ atë “shpellë vjedhësish”.

1-Në hierore të Perëndisë. Këtu nuk e ka kuptimin për vendin e shenjtë, por për oborrin e kombeve, i cili ishte shndëruar në pazar. Kjo ngjarje ndodhi ditën e hënë.

2-Shisnin pëllumba. Në tempull zakonisht njerëzit ofronin flijime. Më të varfërit duhej të ofronin një çift pëllumbash, ndërsa të pasurit ofronin një qingj.

3- Shtëpia ime do të quhetë shtëpi lutjeje. Me fjalën “shtëpia ime” kuptojmë tempullin e Sollomonit, i cili qe ndërtuar mbi malin Moria në vitin 1005 para Krishtit. Pas disa shkatërrimesh, tempulli qe rindërtuar gjatë viteve të mbretërimit të Herodit të Madh. Ndërtimi i tij zgjati rreth 46 vjet.

4- Shpellë vjedhësish. Profeti Jeremia ka profetizuar: “Ky tempull, i cili mban emrin tim, mos është bërë vallë në sytë tuaj një çerdhe hajdutësh?”(Jeremia 7,11).

14 Edhe i erthnë përënë të-verbër’e të-çalë në hieroret; edhe i shëroj ata. 15 Po krye-priftërit’ edhe shkronjësitë kur panë çudiratë që bëri, edhe çunatë dyke bërtiturë në hieroret e dyke thënë, Hosanna mbë të birin’ e Dhavidhit, u zëmëruanë, edhe i

than'ati, Dëgjon se ç'thonë këta? 16 Edhe Jisuj u thot' atyre, Po; kurrë s'keni kënduarë, "Se nga goj' e foshnjavet edhe e atyreve që pinë sisë bëre gati lavdim?" 17 Edhe si i la ata, doli jashtë qytetit ndë Vithani, edhe natën' e shkoj atje.

1-Doli jashtë qytetit në Betani. Betania qe një fshat i vogël dhe gjendej tre katër orë larg Jerusalemit. Nga Betania ishte Llazari, i cili jetonte bashkë me dy motrat e tij, Marinë e Martën. Krishti ka qenë edhe hetë të tjera në shtëpinë e Llazarit (Lluka 10,38), (Joani 11).

FIKU PA FRUT

(Marku 11:12-14, 20-24)

18 Edhe ndë mëngjest kur u kthye ndë qytet, i erdhi uri;

1- Në qytet. Këtu e ka fjalën për qytetin e Jerusalemit, në të cilin Krishti do të kryente misionin e tij.

2-I erdhi uri. Sipas ligjit të hebrenjve në rast urie lejohej që të haje nga pemët e huaja. Kjo ngjarje ka ndodhur të martën në mëngjes herët.

19 Edhe kur pa një dru fiku mb' udhë, erdhi mb' atë, po nukë gjeti gjë mb' atë, veç fletë vetëmë; edhe i thotë: Mos u bëftë më pemë prej teje për gjithë jetënë. Edhe drur' i fikut për-një-herë u tha. 20 Edhe nxënësitë kur panë, u çuditnë, e thanë: Qysh u tha drur' i fikut për-një-herë!

1- Druri i fikut u tha. Apostujt "Të nesërmen në mëngjes, duke kaluar panë që fiku ishte tharë me gjithë rrënjë" (Marku 11,20). Me drurin e fikut nënkuptojmë popullin judaik, të cilët Krishti i mallkon me tharrje si druri i fikut. Judenjtë qenë si fiku, i cili nga larg dukej sikur kishte fryte, por në realitet kishte vetëm gjethe.

21 Edhe Jisuj u përgjeq e u tha atyre, me të-vërtetë po u them juve, ndë paçi besë, edhe të mos jeni me dy mëndje, jo vetëmë këtë të drurit të fikut kini për të bërë, po edhe këti mali ndë i thënci, 22 Ngreu edhe bjerë ndë det, do të bënetë. Edhe gjithë sa të lypni ndë lutjet, dyke pasurë besë, do t'i merrni.

1-Në keni besë. Krishti u thotë dishepujve nëse kanë besë atëhere çdo gjë është e mundur për ta.

PUSHTETI I JISUIT

(Marku 11:27-33, Lluca 20:1-8)

23 Edhe kur erdhi ndë hieroret, erthnë përan' ati, atje ku mësonte, krye-priftërit' edhe pleqt' e llauzit, e thoshinë, me ç'farë pushteti bën këto? Edhe kush t'a ka dhënë këtë pushtet? 24 Edhe Jisuj u përgjeq e u tha atyre, do t'u pyes edhe unë juve një fjalë, të-cilënë ndë m'a thënci, edhe unë do t'u them juve me çfarë pushteti i bën këto. 25 Pagëzimi i Joanit nga ishte? Nga qielli a nga njerëzitë? Edhe ata mendoneshinë me vetëhen'e tyre, dyke thënë, ndë thëncimë, nga qielli dotë na thotë, përse nuk'i mbesuatë pra? 26 Edhe ndë thëncimë, nga njerëzitë, kemi frikë prej gjindjesë; sepse të-gjithë e kanë Joanë për profit. 27 Edhe iu përgjeqnë Jisujt, e i thanë, nuk e dimë. Edhe ay u tha atyre, as unë s'u them juve me ç'farë pushteti bën këto.

1- **Me ç'farë pushteti bën këto.** Anëtarët e Sinedrit e pyetën Krishtin: -Me çfarë pushteti i bënte mrekullitë? Ndërsa Jisui ia kthen atyre duke i pyetur: Joan Pagëzori ishte përfaqësuesi i njerëzve apo i Perëndisë? Nëse ata thonin që ishte i Perëndisë atëherë krishti do tu thoshte: -përse nuk e besuat atëhere? Nëse do të thinin që ishte përfaqësuesi i njerëzve do të kishin probleme me popullin, sepse Joani njihej si profet.

PARAVOLIA E DY BIJVE

28 Edhe qysh u duketë juve? Një njeri kishte dy bij; edhe erdhi tek i-pari e i tha, Bir, shko sot e puno ndë vreshtët t' im. **29** Edhe ay u përgjiq e tha, nukë dua; po pastaj u pendua, edhe vate. **30** Edhe erdhi tek i-dyti, e i tha po ashtu; Edhe ay u përgjeq e tha, unë vete Zot; edhe nukë vate. **31** Cili nga këta të dy bëri dashurimin' e t'et? I thonë, i-pari. Jisuj u thot' atyre, Me të-vërtetë po u them juve, se kumerqarët' edhe kurvatë venë më përpara se ju ndë mbretërit të Perëndisë. **32** Sepse Joani erdhi te ju ndë udhë drejtërie, edhe nuk'i besuatë; po kumerqarët' e kurvatë i besuanë; edhe ju si patë, nuk u penduatë pastaj, që t'i besoni.

1-Dy bijtë. Me anën e kësaj paravolie Krishti na tregon se njeri nga bijtë është populli, i cili nëse pendohet do të shpëtojë. Ndërsa biri i dytë përfaqëson farisenjtë, të cilët shfrytëzojnë popullin dhe tashmë kërkojnë gjakun e Krishtit.

PARAVOLIA E BUJQVE TË LIGJ

(Marku 12:1-12, Lluka 20:1-8)

33 Dëgjoni një tjetërë paravoli: Një njeri ishte zot shtëpie, i-cili mbollti një vreshtë, edhe e thuri me garth, edhe rëmoj mb'atë një tirë, edhe ndërtoj një pirk; edhe e dha atë ndër bujqër, edhe iku ndë dhe të-huaj.

1- Vreshti. Me pronarin e vreshtit nënkuptojmë Perëndinë, ndërsa vreshti është populli i Izraelit. Gardhi simbolizon Ligjin e Moisiut, i cili i veçonte izraelitët nga idhujtarët dhe i mbronte prej tyre. Kulla simbolizon tempullin, në të cilin judenjtë adhuronin

Perëndinë e vërtetë. Vreshtarët janë Kryepriiftërinjtë, të cilëve Perëndia iu besoi që të udhëhiqnin popullin e zgjedhur të Izraelit.

34 Edhe kur u afërua koh'e pemëvet, dërgoj shërbëtorët' e ti te bujqëritë, që të marrënë pemët'e ati.

1- **Dërgonte shërbëtorët.** Herë pas here pronari dërgonte në vreshtë shërbëtorët e tij për të marrë prodhimin, sepse ishte e natyrshme që izraelitët në kohën e duhur duhet të dorëzonin frytet e punës së tyre. Shërbëtorët që u dërguan për ti marrë këto fryte qenë profetët e Dhiatës së Vjetër, por vreshtarët disa prej tyre i rrahën e disa i vranë. Edhe atëhere kur Zoti u shpuri të dërguar të tjerë izraelitët u sollën në mënyrë mizore.

35 Edhe bujqëritë zunë shërbëtorët'e ati, e njerin'e rrahënë, e tjetërin'e vranë, e tjetërinë e vranë me gurë.

1- **Krimet e judenjve.** Të gjithë profetët u shanë, u përbuzën dhe u vranë. Jeremia u hodh në një gropë me baltë, Isainë e vranë, Zaharia u vra me gurë, Joan Pagëzorit i prenë kokën etj. Kushdo që dëgjon këto, habitet nga mizoritë e izraelitëve, megjithatë zemërgjerësia e Perëndisë ishte e madhe. Në një kohë kur çdokush mendonte se Zoti do ti shkatërronte ata, ndodhi e kundërta.

36 Përsëri dërgoj të tjerë shërbëtorë, më tepërë se tëparëtë, po ashtu u'a bënë edhe atyrë. 37 Edhe pastaj dërgoj të birrë tek ata, dyke thënë, t'im biri dot i kenë turp. 38 Po bujqëritë kur panë të birinë, thanë njeri tjerërit, Ky është trashëgimtari; ejani t'a vrasëmë, edhe të mbajmë trashëgimm' e ati. 39 Edhe si e zunë, e nxuarnë jashtë vreshtit, edhe e vranë.

1- **Dashuria e Perëndisë.** Perëndia vazhdon të tregojë dashurinë duke dërguar Birin e tij. Judenjët e nxorën jashtë Jeruzalemit dhe e kryqëzuan në kodrën e Golkothasë. Kështu

përndjekësit e profetëve bënë krimin më të madh, duke vrarë vetë Birin e Perëndisë.

40 Kur të vinjë i zot'i vreshtit, ç'do t'u bënë atyre bujqërvet? 41 I thonë: Keq e më keq do t'i prishnjë, edhe vreshtinë do t'ua apë të-tjerë bujqërve, të cilët do t'ja apënë pemëtë ndë kohët t'atyre.

1- **Ndëshkimi ndaj judenjve.** Zoti këtë radhë nuk i fali. Judenjtë do t'i dënonte me vdekje dhe vreshtin do tua jepte vreshtarëve të tjerë, të cilët do ta dorëzonin prodhimin në kohën e duhur. Perëndia i dënoi rëndë judenjtë me anën e legjioneve romake. Mijëra hebrej u kryqëzuan, Tempulli i famshën u rrënua dhe qyteti i Jeruzalemit u shkatërrua nga themelet, mbi të kaloi parmenda. Mbi një milion judenj u vranë, të tjerët u shitën si skllëvër në mbarë botën. Gjaku i Krishtit ra mbi kokat e tyre dhe të fëmijëve të tyre, ashtu siç e kërkuan ata vetë kur thërrisnin përpara Pilatit “Vdekje, vdekje, kryqëzoje”. Pasoja më e rëndë ishte se Perëndia ua mori hirin nga vreshti i judenjve dhe mboli një tjetër vreshtë Kishën e Krishterë me vreshtarë Apostujt, si udhëheqësit e popullit të zgjedhur.

42 Jisuj u thot' atyre: Kurrë s'keni kënduarë ndë shkronjat, “Gurinë, që s'e pëlqyen'ata që ndërtonjënë, ky u bë për krye çipi; nga Zoti u bë këjo, edhe është' e-çudiçime ndë syt t'anë?”

1- **Paravolia e “vreshtarëve të këqinj”.** Këtë paravoli, Zoti e tha pak ditë përpara pësimeve të Tij, në kohën kur pabesia e judenjve dukej sheshit. Kjo paravoli gjen zbatim në çdo popull, i cili gëzon mirëdashjen dhe mbrojtjen e Perëndisë dhe në të njëjtën kohë paralajmëron se do të ketë të njëjtin fat nëse sjellja e tij do të jetë si e judenjve.

43 Përandaj po u them juve, se mbretëri' e Perëndisë do të merretë nga ju, edhe do të epetë mbë një komp që bën pemët'e asaj. 44 Edhe ay që të bjerë mbi këtë gur, do të copëtonetë; edhe mbi atë që të bjerë do t'a dërmonjë. 45 Edhe krye-priftërit' edhe Farisenjtë kur dëgjuanë paravolit'e ati, e kupëtuanë, se thotë për ata; 46 Edhe kërkoninë t'a zënë, po patnë frikë prej gjindjesë, sepse e kishinë atë si profit.

1- **Mbi këtë gur.** Guri i qoshes quhet Krishti, i cili është themeluesi i krishterimit. Ky gur i qoshes lidh dy mure. Krishti si gur i qoshes që është bashkon dy popuj, judenjtë dhe idhujtarët, pra të gjithë sa besojnë në të. Krishterimi që ai predikoi është feja e të gjithëve.

KREU I NJËZETEDY

PARAVOLIA E DASMËS MBRETËRORE

(Lluka 14:15-24)

1 Edhe Jisuj u përgjeq përsëri e u tha atyre me paravolira, dyke thënë. 2 Mbretëri' e qiejvet gjan me një njeri mbret, i-cili bëri dasmë për të birr'e ti;

1-Mbreti bën dasëm për birin e tij. Paravolia na flet për një darkë madhështore, në të cilën ftohen që të marrin pjesë gjithë njerëzit. Kjo është darka e Mbretërisë së Perëndisë, në të cilën jemi të gjithë të ftuar. Mbreti simbolizon Perëndinë, ndërsa Biri është Biri i Perëndisë, Krishti.

3 Edhe dërgoj shërbëtorët' e ti të thërresën' ata që qenë ftuarë ndë dasmët, po nukë deshnë të vinjënë. 4 Përsëri dërgoj të-tjerë shërbëtorë, dyke thënë, thoj-u-ni atyre që janë ftuarë, ja tek bëra gati drekënë t'ime; demat' e mi edhe berrat' e-ushqyera janë gati; ejani ndë dasmët. 5 Po ata përtuan'e shkuanë, njeri n'arët të ti, e tjetëri ndë tregëtiti të ti; 6 Edhe të-tjerëtë zunë shërbëtorët' e ati, e i shanë, e i vranë.

1-Njeri shkoi në arë. Por të ftuarit nuk i përgjigjen ftesës duke nxjerë justifikime të ndryshme. I pari nxori justifikimin se bleu një arë dhe duhet të shkojë e ta shohë. Mos vallë nuk kishte mundësi që të shkonte një ditë tjetër? Në këtë grup njerëzish futen të

gjithë ata që e vrasim mendjen vetëm për pasurinë. Blejnë dhe shesin duke ia përkushtuar shpirtin e tyre parasë dhe nuk ju ngelet kohë për të mirat shpirtërore, që janë të përjetshme.

2-I dyti merrej me tregti. I dyti u justifikua se bleu pesë pendë qe dhe do të shkonte që ti provonte. Ky njeri ishte joshur prej tregëtisë dhe simbolizon ata që janë nënshtruar kënaqësive trupore dhe nuk gjejnë fuqi shpirtërore për të jetuar në mënyrë të ndershme dhe të virtytshme.

3-Zunë shërbëtorët dhe i shanë e i vranë. Në Darkën e Mbretërisë së Perëndisë jemi të ftuar të gjithë. Të parët Perëndia ftoi hebrenjtë, me qëllim që të bëhen edukatorë dhe udhërrëfyes të popujve të tjerë drejt Perëndisë. Por për fat të keq, ata jo vetëm nuk iu përgjigjën ftesës, por i keqtrajtuan profetët dhe shenjtoret. Më në fund bënë edhe krimin më të tmerrshëm duke kryqëzuar Jisu Krishtin.

7 Po mbreti kur dëgjoj u zëmërua; edhe dërgoj ushtërit' e ti, edhe prishi ata gjaksorëtë, edhe dogji qytetn' e atyre. 8 Atëhere u thotë shërbëtorëvet të ti, Dasma është gati, po ata që qenë të-ftuarë nuk'ishinë të-vëjejturë. 9 Shkoni pra ndëpër të-dalurat të udhëvet, edhe sa të gjeni, t'i ftoni ndë dasmët. 10 Edhe ata shërbëtorëtë duallnë ndëpër udhët, e mblotnë gjithë sa gjetnë, të-liq e të-mirë; edhe dasma u mbush me njerës që rrininë ndë mësallët. 11 Edhe mbreti kur hyri të shohë ata që rrininë ndë mësallët, pa atje një njeri që s'kishte veshurë rrobë dasme. 12 Edhe i thot' ati: Mik, si hyre këtu pa pasurë rrobë dasme? 13 Po ay mbëçëli gojënë. Atëhere mbreti u tha shërbëtorëvet: Lidh-e-ni atë prej këmbësh e prej duarsh, edhe ngri-e-ni, edhe hidh-e-ni ndë errësirët të-përjashtësme; atje do të jetë të-qarët' e të kërcelliturit' e dhëmbëvet. 14 Sepse shumë veta janë të-thirrurë, po të-pakë të sgjedhurë.

1-Shkoni dhe sa të gjeni ftoini në dasmë. Megjithatë Krishti i ftoi të gjitha kombet pa përjashtim në Darkën e Mbretërisë së Perëndisë. Për këtë bën fjalë edhe Ungjilli i sotëm. Perëndia urdhëroi që të ftohen të gjithë pa përjashtim, ata që gjendeshin nëpër sheshe, rrugë, shkolla, fabrika etj. Këtë ftesë Perëndia na e bën edhe neve për të marrë pjesë në Darkën e përjetshme qiellore. Atje do të shohim aq sa askush nuk ka parë dhe aq sa askush nuk ka dëgjuar.

2-Dhe mbreti kur hyri të shohë. Pas njeriut të pasur dhe bujar, fshihet vetë Perëndia, kurse darka që u pregatit për ne është tryeza shpirtërore, që solli në botë Zoti dhe shpëtimtari ynë Jisu Krishti. Është sakrifica e tij, është lënia e mëkateve për të hyrë në Mbretërinë e Qiejve. Në këtë tryezë hyjnore Perëndia i fton të gjithë njerëzit, sepse kërkon shpëtimin e të gjithëve. Ashtu si i zoti i shtëpisë dërgoi shërbëtorin e tij për të lajmëruar miqtë e tij që të vijnë në tryezë, po ashtu Perëndia dërgon njerëz, të cilët ftojnë të tjerët në Darkën Mistike. Dërgoi Krishtin, Apostujt, Etërit etj.

3-Shumë veta janë të thirrur, por pakë janë të zgjedhur. Le ta marim seriozisht Darkën e madhe të Mbretërisë së Qiejve. Le ti lëmë mënjane justifikimet dhe shfajësimet, sepse Perëndia na ka ftuar për një jetë të virtytshme. Nuk jemi të ftuar për baltën e kësaj bote, por për të shijuar kënaqësitë qiellore të jetës së përjetëshme. Le të mos joshemi pas tatëpjetës së jetës materiale dhe të pashpirtshme, sepse ne shikojmë se sa vjet do të rrojmë dhe jo si do të jetojmë. Krishti na fton të gjithëve në darkën e madhe të Mbretërisë së Tij, por jeta jonë materiale, egoizmi dhe dëshirat tona nuk na lenë që ta shijojmë Darkën Qiellore. Përse të humbasim kohë? Darka e madhe e dashurisë së Perëndisë na pret.... Ashtu siç thotë edhe Apostulli Pavli: “Tani është koha e përshtatëshme, sepse erdhi dita e shpëtimit”.

TAKSA PËR PERANDORIN
(Marku 12:13-17, Lluca 20:20-26)

15 Atëhere Farisenjtë van' e bënë këshillë, si t'a zënë ndë lak me fjalë. **16** Edhe dërgojnë tek ay nxënësit' e tyre bashkë me Irodhianëtë, dyke thënë, mësonjës, e dimë se je i-vërtetë, edhe mëson udhën' e Perëndisë me të-vërtetë edhe nukë do të dish as për ndonjë gjë: sepse nukë shikon mbë faqe njerëzish. **17** Thuajna pra, ç'të duketë? Eshtë e udhesë t'i apëmë pagesë Qesarit, apo jo? **18** Po Jisuj si njohu djallëzin' e atyre, tha, ç'më ngisni, ipokritër? **19** Dëfte-më-ni monedhën' e pagesësë. Edhe ata i prunë një dinar. **20** Edhe ay u thot' atyre, E kujt është këjo fytyrë edhe këjo përmbishkonjë? **21** Ata i thonë, E Qesarit. Atëhere u thot' atyre, Epni pra Qesarit ç' janë të Qesarit, edhe Perëndisë ç' janë të Perëndisë. **22** Edhe ata kur dëgjuanë u çuditnë, edhe e lan' atë, e iknë.

1- Herodianët. Qenë miqtë e herodit, tetrarkut të Galilesë. Ata përçmonin të shenjtat dhe qenë në armiqësi me farisenjtë. Gjithsesi kur bëhet fjalë për të diskretituar Krishtin ata e gjejnë gjuhën e përbashkët. Është pikërisht urrejtja, ajo që i bashkon të këqinjët. Herodianët ishin pro për tu paguar taksat romakëve.

2- **Pagesa për Qesarin.** Pagesa përfaqsonte shumën e një dinari, mbi të cilin ishte fytyra e Qesarit. Me përdorimin e kësaj monedhe hebrenjtë e njihnin Qesarin për perandor dhe taksën e tij e paguanin pa diskutim. Krishti u thotë atyre: Jepini Qesarit ç'farë janë të Qesarit dhe Perëndisë ç'farë janë të Perëndisë". Pra me fjalë të tjera mund të shprehemi që monedha, pra ana materiale i përket perandorit që ju ka nën zotërim dhe ana shpirtërore i përket Perëndisë, e cila ju ka krijuar sipas shembëlltyrës së saj.

PYETJA PËR NGJALLJEN E TË VDEKURVE

(Marku 12:18-27, Lluca 20:27-40)

23 Nd ‘atë ditë i erthnë përanë Saduqenj, të-cilëtë thonë se nukë ka të-ngjallurë; edhe e pyetnë, dyke thënë, 24 Mësonjës, Moisiu tha, “Ndë vdektë ndonjë pa pasurë bij, i vëllaj do të martonetë me gruan’e ati”, edhe do t’i ngjalljnë fare të vëllajt të ti. 25 Edhe ishinë ndër ne shtatë vëllezër; edhe i-pari si u martua, vdiq; edhe passì nukë kishte bir, j’a la gruan’e ti të vëllajt të ti, 26 Kështu edhe i-dyti, edhe i-treti, gjer mbë të-shtatëtinë. 27 Edhe më pastaj nga të-gjithë vdiq edhe gruaja. 28 Mbë të-ngjallurit pra, e kujt nga këta të shtatë do të jetë grua? Sepse të-gjithë e patnë marrë atë.

1- Saducenjët thonë se nuk ka të ngjallurë. Saducenjët nuk besonin në ngjalljen e të vdekurve, prandaj i bënë Krishtit këtë pyetje për ta zënë me fjalë. Prandaj saducenjët përdorën shembullin e shtatë vëllezërve, sepse ata përbuzin ngjalljen e të vdekurve.

29 Edhe Jisuj u përgjeq e u tha atyre: Jeni të gënjerë, se nukë dini shkronjatë, as fuqin’e Perëndisë. 30 Sepse mbë të-ngjallurit as martonenë, as martonjënë, po janë posi ëngjëj të Perëndisë ndë qiell. 31 Edhe për të-ngjallurit’e të-vdekurvet a s’kini kënduarë ç’u është thënë juve prej Perëndisë, kur thotë, 32 “Unë jam Perëndia i Avraamit, edhe Perëndia i Isaakut, edhe Perëndia i Jakovit?” Perëndia nuk’është Perëndi të-vdekurish, po të-gjallësh. 33 Edhe gjindja kur dëgjuanë, tmeroneshinë për mësimn’e ati.

1-”Unë jam Perëndia i Avraamit, edhe Perëndia i Isaakut, edhe Perëndia i Jakovit?”. Këto fjalë i tha Perëndia Moisiut shumë kohë pas vdekjes së patriarkëve (Eksodi 3,6) të cilat tregojnë pavdekshmërinë e shpirtit.

POROSIA MË E RËNDËSISHME

(Marku 12:28-34, Lluca 20:41-44)

34 Po Farisenjtë kur dëgjuanë se u mbylli gojë në Saduqenjvet, u mblotnë bashkë. 35 Edhe një nomtar nga ata e pyeti dyke ngar'atë, e dyke thënë; 36 Mësonjës, cila porosi është e-madhe ndë nomt? 37 Edhe Jisuj i tha ati, “Të duash Zotinë Perëndinë t'ënt me gjithë zëmërenë t'ënde, edhe me gjithë shpirtinë t'ënt, edhe me gjithë mëndjenë t'ënde”. 38 Këjo është porosi e-parë edhe e-madhe. 39 Edhe e-dyta që është si-një-një me atë është. “Të duash të-afërminë t'ënt posi vetëhenë t'ënde.” 40 Gjithë nomi edhe profitëritë varenë mbë këto të dy porosira.

1-Cila është porosia më e madhe. Një mësues i ligjit e pyeti Krishtin se çfarë duhej të bënte që të fitonte jetën e përjetëshme? Dhe pasi e mori përgjigjen e urtë;-Të duash së pari Perëndinë dhe së dyti të afërmin tënd,-komentuesi i ligjit i drejtoi Zotit pyetjen e dytë:-Cili është i afërmi im? Mësuesi i ligjit ia bëri këtë pyetje Krishtit, sepse në botën e atëhershme njeriu i afërm konsiderohej vetëm pjestari i familjes ose farefisi, ndërsa të tjerët konsideroheshin si të huaj. Krishti, me paravolinë që do t'i tregonte më pas i dha atij të kuptonte se i afërmi ynë duhet konsideruar jo vetëm njeriu i familjes por çdo njeri, i njohur ose i panjohur, mik ose armik i yni dhe se dashuria dhe njeridashja duhet të jenë njësoj për të gjithë njerëzit pa dallim.

2- Nomi dhe profecitë varen tek këto dy porosi. Krishti thekson që këto janë dy porositë më me vlerë të Dhiatës së Vjetër.

MESIA DHE DAVIDI

(Marku 12:35-37, Lluka 20:41-44)

41 Edhe tek ishinë mbledhurë Farisenjtë, Jisuj i pyeti, dyke thënë, 42 Ç'u duketë juve për Krishtinë? I bir'i kujt është? I thonë, i Dhavidhit. 43 U thot' atyre, qysh pra Dhavidhi me Frymë e quan atë Zot, dyke thënë, 44 "I tha Zoti Zotit t'im, rri mbë të-djathtët t'im gjersa të vë armiqt'e tu ndënë këmbje të këmbëvet të tua?" 45 Ndë qoftë pra se Dhavidhi e quan Zot, si është'i bir'i ati? 46 Edhe asndonjë nukë muntte t'i përgjigjej ndonjë fjalë; as nukë kuxoj ndonjë që mb'atë ditë t'a pyesë atë më.

1- **Biri i Davidit.** Krishti në këtë rast kërkon mendimin e farisenjve për origjinën e tij, jo për ti ngacmuar ata, por për ti mësuar. Farisenjtë e quanin Davidin më të lartë se Krishtin, pasi ishte pasardhësi i tij. Jisui nëpërmjet vetë Davidit dëshiron që t'u mësojë që është Zoti i Davidit, d.m.th. biri i Perëndisë. Fjalët "Biri i Davidit" në ungjillin sipas Matheut i ndeshim disa herë: (9, 27; 12, 23; 15, 22; 21, 9).

2- **Armiqtë e tu, stol të këmbëve të tua.** Këtë shprehje ungjillori Mathe e ka marrë nga libri i Psalmeve: "Ulu në të djathtën time deri sa t'i bëj armiqtë e tu stol të këmbëve të mia" (Psalmeve 110,1).

3- **Asnjë nuk mund ti përgjigjej.** Farisenjtë nuk mundën që ti përgjigjeshin, sepse ata qenë të mbushur me njohje tipike njerëzore dhe që nga ajo ditë nuk guxuan ta pyesnin më.

KREU I NJËZETETRE

DEBAT MIDIS FARISENJVE DHE DISHEPUJVE

(Marku 12:38-40, Lluca 11:37-52, 20:45-47)

1 Atëhere Jisuj i foli gjindjesë edhe nxënësve të ti,

1- U foli turmave dhe dishepujve. Ky është edhe fjalimi i fundit i Krishtit në publik. Krishti e filloi aktivitetin e tij në publik me predikimin në mal dhe me këtë debat ai e mbyll.

2 Dyke thënë, shkronjësit' edhe Farisenjtë ndënjtnë mbi fron të Moisiut;

1- **Shkronjësit.** Për shkronjësit në gjuhën greke janë përdorur tre emra: a) *Gramateas*, që e kishte kuptimin, ai që mbante regjistrat e dokumenteve publike (Veprat e Apostujve 19,35). b) *Nonodhidhaskalos*, që do të thotë mësimitdhënës i ligjit (Lluca 15, 7). c) *Nnomikos*, e ka kuptimin jurist (Matheu 22,35). Shkronjësit e njihnin shumë mirë ligjin.

2- **Mbi fron të Moisiut.** Froni ishte vendi ku ulej Moisiu, si mësues i popullit hebraik dhe komentues i porosive të Perëndisë. Tashmë mbi këtë fron uleshin shkronjësit dhe farisenjtë, të cilët qenë komentues të ligjit.

3 Gjithë sa t'u thonë pra juve t'i ruani edhe t'i bëni; po pas punëravet t'atyre mos bëni; sepse thonë edhe nukë bënjnë. 4 Sepse lithnjënë barrë të-rënda që nukë mbahenë, edhe i vënë përmbi kurrist te njerësvet; po me gishtin'e tyre nukë duanë t'i luanjnë. 5 Edhe gjithë punët'e tyre i bëjnë që të dukenë ndër njerëzit; edhe zgjeronjnë ruajtjet'a tyre edhe madhonjnë pëqinjt'e rrobavet të tyre;

1- Barë të rënda. Këtu e ka kuptimin që farisenjtë e detyronin popullin hebraik që të zbatonte tipikonë me detajet më të vogla. Madje ata nxorrën edhe rregulla të tjera, të cilat ungjillori i konsideron si barë e rëndë për popullin.

2- Zgjatnin thekët e rrobave. Farisenjtë e kishin për zakon që të zgjatnin thekët e rrobave të tyre. Këtë e bënin për t'u treguar më të zellshëm se të tjerët. Thekët janë përshkruar në librin e Numrave: "Folu bijve të Izraelit dhe u thuaj atyre që të bëjnë brez pas brezi thekë në cepat e rrobave të tyre dhe të vënë në çdo cep një kordon ngjyrë manushaqe" (Numrat 15, 38). Thekët u kujtonin hebrenjve, që të zbatonin porosinë e Perëndisë.

6 Edhe duanë kryet' e mësallësë ndëpër darkat, edhe vëndet' e-parë ndëpër sinagogjit; 7 Edhe të-përshëndoshuratë ndëpër tregjet, edhe të qyhenë nga njerëzitë, Ravvi (Mësonjës) 8 Po ju mos quhi Ravvi sepse një është mësonjësi juaj, Krishti, edhe të-gjithë ju jeni vëllezër. 9 Edhe mos quani ndonjë atë për ju mbi dhet; sepse një është Ati juaj, ay që është ndë qiejt. 10 As mos quhi mësonjës; sepse një është mësonjësi juaj, Krishti. 11 Po më i-madhi prej jush do të jetë shërbëtori juaj. 12 Edhe kush të lartësonjë vetëhen' e ti, do t'unjetë; edhe kush të-unjë vetëhen'e ti, do të lartësonetë.

1- **Rabi.** Me këtë fjalë hebrenjtë thërrisnin *mësuesin* e tyre. Farisenjtë si kryelartë që qenë kërkonin që të zinin gjithnjë vendet e para dhe njerëzit t'i thërrisnin me titullin Rabi.

2- **At.** Dishepujt nuk duhet ti drejtohen askujt me fjalën *At*, sepse vetëm një është *Atë*, ai që është në qiell. Në kohët e vjetra me termin *At* quheshin mësimsdhënësit. Në Dhiatën e Vjetër dëgjuesit dhe nxënësit e profetëve i quanin mësimsdhënësit *etër* të tyre. Në Dhiatën e Re, Apostulli Pavli i quan *bijtë e tij* ata që u rilindën më Krishtin. Dhe ata e quajtën apostullin që i mësoi *At* të tyre (Korintasve 4, 15).

KRIKKA PËR SHKRUESIT DHE FARISENJTË

13 Po mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; sepse mbylini mbretërin' e Perëndisë përpara njerëzet; sepse ju nukë hyni, edhe as ata që hynjënë nuk i lini të-hynjënë. **14** Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; sepse hani shtëpirat'e të-vejave, edhe këtë e bëni me shkak se bëni të-falura të-gjata; përandaj do të merrni më tepërë mundim. **15** Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; se shetitni detin'edhe tokënë për të bërë një të-kthyerë; edhe si të bënetë, e bëni atë bir gjenne dy herë më tepërë se vetëhenë t'uaj. **16** Mjerë ju udhëheqës të-verbërë, që thoni, kush të bënjë be mbë tempullinë, nuk' është gjë; po kush të bënjë be mb'arin'e tempullit, bënetë detuar.

1- **Shtëpitë e të vejave.** Farisenjtë pasuroheshin duke mashtruar vejushat, të cilat u besonin pasurinë. Ky ishte një veprim që binte ndesh me ligjin e Moisiut, i cili i mbronte vejushat.

2- **Proselitë.** Qenë të huajt, të cilët kishin pranuar judaizmin.

17 Të-marrë edhe të-verbërë! sepse cili është më i-math, ari, apo tempulli që shënjtëron arinë? **18** Edhe Kush të bënjë be

mbë therorenë, nuk'është gjë; po kush të bënjë be mbë dhurëtinë që është mbi atë, bënëtetë detuar. **19 Të-marrë edhe të-verbërë!** Sepse cila është më e-madhe, dhurëtia, apo therorja që shënjtëron dhurëtinë? **20 Ay pra që të bënjë be mbë therorenë, bën be mb'ate, edhe mbë gjith'ato që janë përmbi atë. 21 Edhe ay që të bënjë be mbë tempullinë, bën be mb' atë, edhe mb'atë që rri nd'atë. 22 Edhe ay që bën be mbë qiellë, bën be mbë fron'e Perëndisë, edhe mb'atë që rri mb'atë.**

1- **Ari i tempullit.** Me fjalët “ari i tempullit” kuptojmë të gjitha zbukurimet që gjendeshin në tempull. Ari i tempullit ishte i shënjtë, sepse gjendej në tempull. Krishti i gjykon farisenjtë, të cilët nuk dinin të vlerësonin që kush kishte më tepër vlerë.

2- **Altari.** Gjendej në oborrin e tempullit dhe shërbente për të sakrifikuar flijimet. Altari kishte përmasat 20 X 10.

3- **Betimi për tempullin.** Në këtë rast Krishti u thotë farisenjve që ai që betohet për tempullin, betohet për Perëndinë, sepse tempulli është fronti i Perëndisë.

23 Mjerë ju shkronjës e Farisenj, ipokritër; sepse epni të-dhjettën' e mëndresë, e të marajt e të qiminit; edhe kini lënë më të-rëndat' e nomit, gjyqin edhe përdëllimin edhe besënë; këto gjan t'i bëni, edhe ato të mos i lini. 24 Udhëheqës të-verbërë, që shtrythni mishkonjënë, edhe kamillën'e përpin.

1- **Jepni një të dhjetën.** Judenjtë duke ruajtur ligjin Mozaik jepnin 1/10 e produkteve të tyre për ushqimin e levitëve, një tjetër 1/10 të kafshëve dhe të bereqetit e ofronin në tempull dhe 1/10 për t'ua shpërndarë fukarenjve. Farisenjtë qenë shumë tipikë në këto gjëra dhe haronin përdëllimin e dashurinë.

2- **Udhëheqës të verbër.** Krishti i quan farisentë “Udhëheqës të verbër”, sepse ata nga njera anë kishin përpirë kamilën dha nga

ana tjetër kishin frikë se mos kapërdinin mushkonjën, e cila është krejt e papërfillshme në krahasim me kamilën.

3- Shtrydhni mushkonjën dhe kamilën e përpini. Farisenjtë kur pinin ujë e kullonin me një napë, nga frika se mos kishte rënë brenda ndonjë mushkonjë. Mushkonjat konsideroheshin insekte të ndyra nga hebrenjtë.

25 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; sepse qëroni të-përjashtësmen' e potirit edhe të kupësë, po përbrenda janë plot me rrëmbyerje e pa-vetëmbajtje. 26 Farise i-verbërë, qëro më përpara atë që është brënda ndë potirt edhe ndë kupët, që të bënet e-qëruarë edhe e-përjashtësmja e atyre. 27 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; sepse gjani me varre të-lyerë me gëlqere, të-cilëtë përjashta dukenë të-bukurë, po përbrenda janë plot me eshtëra të-vdekurish e çdo farë ndyrësie. 28 Kështu edhe ju, përjashta dukeni të-drejtë te njerëzitë, po përbrenda jeni plot me ipokrisi e me panomi.

1- Varre të lyer. Hebrenjtë, të cilët zbatonin me përpikmëri ligjin Mozaik, çdo vit më datën 15 të muajit Adhar lyenin varret me gëlqere të bardhë. Ata i lyenin varret jo vetëm për të qenë të pastër, por edhe për një arrësye tjetër që të dukeshin nga kalimtarët, sepse sipas ligjit Mozaik nëse një jude prekte një të vdekur, atëherë ai quhej i papastër.

29 Mjerë ju shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; sepse ndërtoni varret' e profitërvet edhe stolisni mrimoret' e të-drejtëvet; 30 Edhe thoni, Po të ishimë ne ndë ditt të atërvet t'anë, nukë dotë ishimë pjesëtarë me ata ndë gjakt të profitërvet. 31 Kështu pra dëshmoni për vetëhenë t'uaj, se jeni të bijt' e atyre që vranë profitëritë. 32 Mbushni edhe ju masën' e atërvet tuaj.

33 Gjerpinj, të-pjellë nepërkash, qysh do të ikëni nga dënimi i gjuhennësë?

1- **E kaloni masën e etërve tuaj.** Farisenjtë për të mohuar krimet që kishin bërë të parët e tyre hiqeshin si njerëz të moderuar. Ata qenë më të këqinj se të parët e tyre, të cilët vranë profetët. Farisenjtë qenë përndjekësit e Birit të Perëndisë.

2- **Gjarpërinj, pjellë nëpërkash.** Krishti i krahason farisentë me gjarpërinjtë sepse fjalët që ata nxirrnin prej gojës qenë helm. Ata nuk do t'i shpëtojnë dënimit të Perëndisë.

JISUI DHE JERUSALEMI

(Lluka 13;34,35)

34 Përandaj, ja unë tek do të dërgonj te ju profitër, edhe të diturë, edhe shkronjës; edhe ca nga ata do t' i vrisni e do t' i kryqësoni, edhe ca nga ata do t' i rrihni ndëpër sinagogjit t' uaj edhe do t' i ndiqni prej qyteti ndë qytet; 35 Që të vinjë mbë ju çdo gjak i-drejtë që është derdhurë, mbë dhet, që nga gjaku i Avelit të-drejtë e gjer mbë gjakt të Zaharisë, të birit të Varahiut, të-cilin'e vratë ndë mest të tempullit edhe të theroresë. 36 Me të-vërtetë po u them juve: Gjithë këto do të vijnë përmbi këtë bres.

1- **Po ju dërgoj profetë.** Këtu e ka kuptimin për apostujt, të cilët do të predikonin ungjillin e shenjtë në mbarë botën.

2- **Të bjerë mbi ju gjaku i drejtë.** Gjaku i pafajshëm i Abelit: “Zëri i gjakut të vëllait tënd më vëngon nga toka” (Zanafilla 4, 10). Gjithashtu profetin Zaharia, judenjtë e vranë në oborrin e tempullit. Për gjithë gjakun e derdhur, hebrenjtë do të ndëshkohen.

37 Jerusolim, Jerusolim, që vret profitëritë, edhe rreh me gurë ata që janë dërguarë te ti, sa herë desha të mbleth bijt'e

**tu, sindëkur pula mbleth zoqt'e saj ndënë krahët po nukë deshtë?
38 Ja shtëpia juaj tek po u lihetë e-shkretë. 39 Sepse po u them
juve, Nukë do të më shihni paskëtaj, gjersa të thoni, i
bekuar'është'ay që vjen mb'emërit të Zotit.**

1- **Shtëpia juaj po lihet e shkretë.** Krishti në këtë rast parathotë ndëshkimin për Jerusalemin. Perëndia kishte dërguar profetët, por judenjtë i vranë me gurë, kështu Perëndia do të veprojë.

2- **Nuk do të më shihni më.** Krishti do të largohet nga populli i Jerusalemit, por do të vijë atëhere kur të gjykojë të gjallët e të vdekurit.

3- **I bekuar është ai që vjen në emërin e Zotit.** Këto janë vargje të Psalmit 118, 26.

KREU I NJËZETEKATËRT

PARATHËNIA E SHEMBJES SË TEMPULLIT

(Marku 13:1,2, Lluka 21:5,6)

1 Edhe Jisuj doli e iku nga hieroreja; edhe nxënësit’e ati i erthnë për anë që t’i dëftenjënë ndërtesat’e hieroresë. 2 Po Jisuj u tha atyre: A nuk’i shihni gjithë këto? Me të-vërtetë po u them juve, se nukë do të mbetetë këtu gur mbi gur që të mos rrëzohetë.

1-A nuk i shihni gjithë këto. Krishti flet për madhësinë e tempullit, i cili kishte filluar të ndërtohej që në kohën e Irodit të Madh më vitet 20-19 para Krishtit dhe ka përfunduar në vitin 63 pas Krishtit.

2- Se nuk do të mbetet këtu gur mbi gur. Judejtë e prisnin Mesian si një prijës luftarak, i cili do ta udhëhiqte popullin e tyre, në luftë kundër pushtuesit romak. Kështu ata në vitin 66 të udhëhequr nga një “Mesia i rremë” shpërthyen në kryengritje, duke pushtuar një kështjellë e duke vrarë të gjithë ushtarët romakë që ndodheshin atje. Perandori ngarkoi gjeneralin Vespasian (9-79) (i cili ndodhej i dislokuar në Siri) për të shtypur kryengritjen. Në vitin 67 në krye të një ushtrie prej 60 mijë vetash, Vespasiani pushtoi Galilenë dhe ju afrua Jeruzalemit. Më pas në vitin 70, ai la të birin që quhej Titus (39-81) për të vazhduar fushatën. Titus rrethoi Jeruzalemin dhe pas një rrethimi prej gjashtë muajsh, Jeruzalemi u dogj dhe u shkatërrua. Mbi 100 mijë njerëz humbën jetën nga kolera, uria e lufta. Nga

Jeruzalemi mbetën vetëm gërmadhat e asgjë tjetër. Në këtë mënyrë, u plotësua profecia e Jisuit: “S’do të mbetet asnjë gur nga tempulli i Judejve”. Objektet e shenjta që mundën të shpëtonin nga flakët, i shërbyen Titusit si trofe për të hyrë në Romë, në vitin 71. Rreth 97 mijë njerëz, u trajtuan si skllevër duke u shitur nëpër katër anët e perandorisë.

Megjithatë Judejtë nuk vunë mend. Në kohën kur perandori Adrian urdhëroi që mbi tempullin e rrezuar të Jeruzalemit, të ngrihej një tempull pagan, judejtë ngritën krye përsëri. Ata nën udhëheqjen e një tjetër “Mesie të rremë” që quhej Bar-kohba në vitin 135 u hodhën në kryengritje kundër romakëve. Kjo kryengritje, u shtyp egërsisht duke u vrarë mbi 60 mijë judej. Mbi truallin e tempullit të judejve kaloi plugu, dhe mbi gërmadhat e Jeruzalemit, u ndërtua një kështjellë e madhe romake e quajtur (Elia Kapitolina) për nder të Jupiterit (Zeusi romak). Judejve ju ndalua me kërcënim me vdekje që t’i afroreshin kështjellës. Ky ishte një dënim i merituar për judejtë, për persekutimet e masakrat që kishin bërë ndaj apostujve dhe të krishterëve në përgjithësi.

MBARIMI I KËSAJ BOTE

(Marku 13:3-31, Lluca 21:7-33)

3 Edhe ay tek ishte dyke ndënjurë mbi malt të Ullinjet, nxënësit’ iu afëruanë mbë nj’anë, dyke thënë, thuaj-na, kur do të bënenë këto? Edhe cila është shënja e të-ardhurit t’ënt edhe e të mbaruarit të jetësë.

1-Nxënësit ju afruan mënjane. Këtu nuk bëhet fjalë për gjithë dishepujt e Krishtit, por vetëm për Petron, Jakovin, Joanin dhe Andrian.

2- **Cila është shenja?** Apostujt pasi mbërritën në malin e Ullinjve e pyetën Krishtin se cila ishte shenja e të ardhurit të tij.

4 Edhe Jisuj u përgjeq e u tha atyre: Shikoni, mos u gënjenjë juve ndonjë; 5 Sepse shumë veta do të vinjnë mb' emërit t'im, dyke thënë: Unë jam Krishti, edhe do të gënjenjën shumë veta.

1-Shumë veta do të vijnë në emrin tim. Në Shkrimin e Shenjtë bëhet fjalë për profetët e rremë: Teuda, “Sepse pak kohë më parë u ngrit Teuda dhe thoshte se ishte dikush” (veprat e Apostujve 5, 36) Simon Magjistari, “Prej kohësh në atë qytet ishte një njeri që quhej Simon, i cili merrej me magji dhe i bënte të çuditëshin njerëzit e Samarisë, gjoja sikur ishte njeri i madh” (Veprat e Apostujve 8, 9) etj. Gjatë historisë janë paraqitur rreth 24 vetë duke pretenduar se qenë Mesia.

6 Edhe do të dëgjoni luftëra e zëre luftërash; shikoni, mos trumbullohi, sepse të-gjitha këto gjan të bënenë; po e-pastajmja edhe nuk'është. 7 Sepse do të ngrithetë komp kundrë kombi, edhe mbretëri kundrë mbretërie; edhe do të jenë zira e murtaja, edhe tërmete vënt mbë vënt. 8 Po gjithë këto janë të-nisurit'e të-dhëmburavet.

1- Zi, murtaja dhe tërmete. Zi ka qenë në kohën e Qesar Klaudit (Veprat e Apostujve 11, 28). Kemi tërmetin e Frigjisë në vitin 61 pas Krishtit, i cili rënoi Laodicenë. Në Itali në vitin 63 u rrënua tërësisht Pompeu etj.

9 Atëhere do t'u apënë juve ndër duar për shtrëngim, edhe do t'u vrasënë juve; edhe do t'u kenë mëri juve gjithë kombetë për emërinë t'im. 10 Edhe atëhere do të skandhalisenë shumë veta, edhe dotë trathëtonjënë njeri tjetërinë, edhe do të kenë mëri njëri tjetërit. 11 Edhe shumë profitër të rrem do të ngrihenë, edhe do të gënjenjën shumë veta; 12 Edhe passi të

shumonetë panomia, dashuria e të-shumëvet do të ftohetë. 13 Po kush të duronjë gjer ndë funt, ky do të shpëtonjë. 14 Edhe ky ungjilli i mbretërisë do të leçitetë ndëpër gjithë botënë, për dëshmim mbë gjithë kombet; edhe atëhere do të vinjë fundi.

1- **Të gjithë kombet do tu urrejnë.** Këtu e ka fjalën për dishepujt, të cilët do të përndiqen nga kombet për shkakun e Krishtit.

2- **Përndjekjet ndaj të krishterëve.** Pothuajse të gjithë perandorët romakë, përpara se të mbretëronte Konstandini i Madh, i kanë përndjekur të krishterët duke filluar që nga Neroni (54-68) e deri tek Diokliciani (248-305). Përndjekjet qenë të shumta, por historiani Honore e përcaktoi në 10-të numërin e tyre, duke i karakterizuar këto si më të përgjakshmet. Numëri dhjetë, u pranua si simbolik duke u krahasuar me dhjetë plagët (fatkeqësitë) e Faraonit, të cilat janë konsideruar si prototip i përndjekjeve ndaj të krishterëve. Vetë Zoti ynë Jisu Krishti kishte parathënë: “Atëhere do t’ju mendojnë dhe do t’ju vrasin. Të gjithë popujt, do t’ju urrejnë për shkakun e emrit tim. Atëhere shumë do të lenë fenë do ta tradhëtojnë njeri-tjetrin dhe do të kenë mëri njëri-tjetrin. Shumë profetë të rremë, do të ngrihen dhe do të gënjejnë shumë veta. Do të shtohet padrejtësia dhe dashuria e të shumtëve do të ftohet. Por kush do të durojë deri në fund, do të shpërblehet”(Matheu 24. 9-13).

15 Kur të shihni pra “të-ndytët’e të-shkretuarit,” që është thënë nga profiti Dhaniil, dyke ndënjurë ndë ventt të-shenjtëruarë, (ay që këndon let’ a kupëtonjë;)

1- **Neverinë e shkretimit.** Krishti u thotë dishepujve që të largohen në male me qëllim që të mos e shohin gjakderdhjen. Ungjillori Mathe në këtë rast përdor një profeci të Danielit: “Ai do të lidhë gjithashtu një besëlidhje me shumë njerëz për një javë, por në mes të javës do t’i japë fund flijimit dhe blatimit; dhe mbi krahët e veprimeve

të neveritshme do të vijë një shkatërrues, deri sa shkatërrimi i plotë, që është dekretuar, do të bjerë mbi shkatërruesin” (Danieli 9, 27).

16 Atëhere ata që janë ndë Judhet le të ikëjnë ndëpër malet; **17** Kush të gjendetë mbi kulmit, letë mos zbresë që të marrë gjë nga shtëpi’e ti. **18** Edhe kush të gjendetë nd’arët le të mos kthenetë prapa, që të marrë rrobat’e tia. **19** Edhe mjerë ato që janë me barrë, e ato që kanë foshnja mbë gji nd’ato dit. **20** Edhe faluni, që të mos bënetë të ikuritë t’uaj ndë dimërë, as të-shëtunë. **21** Sepse atëhere do të jetë shtrëngim i-math, që nuk’ është bërë i-atillë, që ndë të-nisurit të-botësë e gjer ndashti, as nuk’është për të bërë. **22** Edhe të mos shkurtoneshin’ato dit, nukë do të shpëtonte asndonjë trup; po ato dit do të shkurtonenë për të-zgjedhuritë.

1- Ato ditë do të shkurtohen. Legjionet romake kishin për qëllim që ta merrnin Jerusalemin duke e rrethuar atë, por më vonë ndërruan mendje dhe vendosën që të shkatërrojnë muret e qytetit. Kështu shpëtoi gjysma e popullsisë së qytetit, pra njerëzit e zgjedhur.

23 Atëhere ndë u thëntë juve ndonjë: Ja tek është këtu Krishti, a aty, mos besoni. **24** Sepse do të agrihenë krishtër të-rrem, edhe profitër të-rrem, edhe do të bëjnë shënja të-mëdha edhe çudira, kaqë sa do të gënjenjën’edhe të-sgjedhuritë, ndë munçinë. **25** Ja tek u thashë juve më përpara. **26** Ndë u thënçinë pra juve: Ja tek është ndë shkretëtirët, mos dilni, ja ndë dhomat, mos besoni. **27** Sepse sindëkur vetëtima del nga lint djelli, edhe duketë gjer tek perëndon, kështu do të jetë edhe t’ardhurit’e të birit të njeriut. **28** Sepse ku të jetë kërma, atje do të mblidhenë shqiponjatë.

1-Ku të jetë kërma do të mblidhen shqiponjat. Kjo e ka kuptimin se Krishti do të shkojë atje ku janë njerëzit.

29 Edhe për-një-here pas shtrëngimit t'atyre ditve, djelli do t'erretë, edhe hëna nukë dotë apë ndriçimin'e saj; edhe yjtë do të bjenë nga qielli, edhe fuqit'e qiejvet do të tundenë. **30** Edhe atëhere do të duketë shënja e të Birit të njeriut ndë qielit; edhe atëhere do të bënjenë vajë gjithë farat'e dheut, edhe do të shohënë të Birin'e njeriut dyke ardhurë mbi ret të qiellit me fuqi e me lavdi shumë. **31** Edhe do të dërgonjë ëngjëjt'e ti me trumbetë që nxjer zë të-math, edhe do të mbledhënë të-zgjedhurit'e ati nga të katrë erëratë, prej fundit t'anëvet të qiejvet e gjer mbë funti të anëvet t'atyre. **32** Edhe nga drur' i fikut mësoni paravolinë; kur bënë të ndashti deg'e ati e-butë, edhe nxjer gjethetë, e dini se vera është afërë. **33** Kështu edhe ju kur të shihni gjithë këto, t'a dini se është afërë ndër dyert. **34** Me të-vërtetë po u them juve, ky bres nukë do të shkonjë, gjersa të bënenë të-gjitha këto. **35** Qielli edhe dheu do të shkonjënë, po fjalët'e mia nukë do të shkonjënë.

1- Ardhja e Birit të Njeriut. Në këtë rast ungjillori përdor profeci nga Dhiata e Vjetër: “Kur të të shuaj do t'i mbuloj qiejt dhe do t'i errësoj yjet, do ta zë diellin me një re dhe hëna nuk do të japë më dritën e saj” (Ezekiel 34, 7). “Sepse yjet e qiellit dhe yllësitë nuk do të shkëlqejnë më me dritën e tyre; dielli do të errësohet në lindjen e tij dhe hëna nuk do të përhapë më dritën e saj” (Isaia 13, 10).

2- Shenja e Birit të Njeriut. Si shenjë e ardhjes së Birit të njeriut ka për të qenë shfaqja e kryqit në qiell. Kjo është parathënë në Dhiatën e Vjetër: “Ja unë do të vij tek ti në një re të dendur, me qëllim që populli të të dëgjojë kur unë do të flas me ty, dhe të të besojë për gjithnjë” (Eksodi 19, 9).

3- Ky brez nuk do të kalojë. Krishti në këtë rast u premtonte dishepujve që ky brez nuk do të kalojë, pa u realizuar të gjitha këto.

Pra të gjitha profecitë që ka thënë, nuk do të kalojnë më tepër se 30-40 vjet dhe do të realizohen.

ARDHJA E PAPRITUR E MBARIMIT

(Marku 13:32-37, Lluca 17:26-30, 34-36)

36 Edhe për atë ditë, edhe për atë orë, asndonjë s’e di, as ëngjëjt’e qiejvet, veç im Atë vetëmë.

1- **Vetëm Ati im.** “Unë jam udha e vërteta dhe jeta: askush nuk vjen tek Ati, përveçse nëpërmjet Meje” (Joani 14, 4–6). Filipi, atëherë i tha: “Zot na trego Atin dhe na mjafton”. Ndërsa Jisui iu përgjigj edhe atij: “Kaq kohë që Unë jam me ju dhe ti akoma nuk më ke njohur o Filip? Kush më ka parë mua, ka parë Atin” (Joani 14, 8–9).

37 Edhe sindëkur ishinë ditt’e Noesë, kështu do të jetë edhe t’ardhurit’e Birit të njeriut. 38 Sepse sindëkur ishinë njerëzitë nd’ato dit përpara përmbytjesë, që hanin’e pininë, martoneshin’e martoninë, gjer mb’atë ditë që hyri Noeja nd’arkët; 39 Edhe nuk’e kupëtuanë gjersa erdhi përmbytja, edhe ngriti të-gjithë; kështu do të jetë edhe t’ardhurit’e të Birit të njeriut. 40 Atëhere dy veta do të jenë nd’arë; njeri merretë, e tjetëri lihetë. 41 Dy gra do të bluanjënë ndë mulli; njëra merretë, e tjetëra lihetë.

1- **Ardhja e Birit të Njeriut.** Do të jetë e papritur dhe askush nuk do të ketë mundësi të reagojë. Njerëzit do të jenë në punët e tyre të përditshme, burrat duke punuar në arra dhe gratë në punët e shtëpisë. Krishti do ti gjykojë njerëzit sipas veprave të tyre.

42 Rrini sgjuarë pra, sepse nukë dini mbë ç’orë vjen Zoti juaj. 43 Po këtë e dini, se t’a dinte i-zot’i shtëpisë, mbë ç’kohë të natësë vjen vjedhësi, do të rrinte sgjuarë, edhe nukë do të linte të

çponej shtëpi'e ati. 44 Përandaj edhe ju bëhi gati, sepse i Bir'i njeriut vjen me'atë orë, që nuk'u'a pret mëndja juve.

1- **Rrini zgjuar.** Në këtë rast Krishti na paralajmëron që të jemi zgjuar kurdoherë, për të pritur Birin e Njeriut. Ai do të vijë në atë orë kur nuk e mendojmë.

SHËRBËTORI BESNIK

(Lluka 12:41-48)

45 Vallë cili është ay shërbëtuar besëtar edhe i mëncim, të-cilinë i-zoti e vuri përmbi punëtorët të ti, që t'u apë atyre ushqimnë mdë kohë? 46 Lum ay shërbëtuar, të-cilinë, kur të vinjë i zoti, t'a gjenjë dyke bërë kështu. 47 Me të-vërtetë po u them juve, se do t'a vërë përmbi gjithë gjën'e ti. 48 Edhe ay shërbëtor'i-lik ndë thëntë ndë zëmëret të ti se, Im Zot mënon të vinjë; 49 Edhe të zërë të rrahë shokët e ti shërbëtorë edhe të hajë e të pijë bashkë me ata që dehenë; 50 I zot' i ati shërbëtori do të vinjë nd'atë ditë që ay nuk'e pret edhe nd'atë orë që nuk'e di; 51 Edhe do t'a ndanjë mbë nj'anë, edhe dotë vërë pjesën'e ati bashkë me ipokritëritë; atje do të jetë të-qarët'e të-kërcëlliturit'e dhëmbëvet.

1- **Shërbëtor besnik.** Në këtë paravoli të shkurtër Krishti na përmend njerëzit shprestarë, punëtorët besnikë të Perëndisë, të cilët kur të vijë Zoti do të jenë në krye të punëve.

2- **Duke dhënë ushqimin në kohën e duhur.** Këtu ungjillori e ka fjalën për apostujt, të cilët Krishti i caktoi që ti jepnin popullit “ushqimin e duhur”, pra të predikonin krishterimin.

KREU I NJËZETEPESTË

PARAVOLIA E DHJETË VIRGJËRESHAVE

1 Atëhere mbretëri'e qiejvet do të gjanjë me dhjetë vërgjërësha, të-cilatë muarnë llambadat'e tyre, e dualinë të presënë dhëndërrinë. 2 Edhe nga ato pesë ishinë të-mënçime, edhe pesë të-marra. 3 Ato të-marratë, kur muarnë lambat'e tyre, nukë muarnë vaj me vetëhe; 4 Po të-mënçimetë muarnë vaj ndë enët të tyre bashkë me llambat'e tyre. 5 Edhe dhëndërrri si u vonua, i zuri gjumi të-gjitha edhe flininë. 6 Edhe ndë mest të natësë u bë një të-thirrurë, Ja dhëndëri tek po vjen; dilni për të-pritur'atë. 7 Atëhere, gjith'ato vërgjërëshat' u ngritnë, edhe ndreqnë llambat'e tyre. 8 Po të-marrat'u thanë të-mënçimevet, Ep-na-ni nga vaji juaj; sepse po na shuhënë llambatë. 9 Edhe të-mënçimetë u përgjeqnë, dyke thënë: Mos nukë do të na dalë neve edhe juve; po më mirë shkoni tek ata që shesënë, edhe blini për vetëhenë t'uaj. 10 Edhe kur vanë të blenë, dhëndërrri erdhi; edhe ato që ishinë gati hynë bashkë me atë ndë dasmët, edhe u mbull dera. 11 Po pastaj vijn' edhe vërgjërëshat'e-tjere, e thonë. Zot, Zot, hap-na. 12 Po ay u përgjeq e tha: Me të-vërtetë po u them juve, nuk u njoh juve. 13 Rrini sgjuarë pra, sepse nuk'e dini ditën'as orënë, ndë të-cilën vjen i Bir'i njeriut.

1- **Dhjetë virgjërëshat.** Krishti na këshillon që të jemi gjithmonë gati si pesë virgjërëshat e zgjuara. Me virgjërëshat e zgjuara

nënkuptojmë njerëzit e drejtë. Pesë virgjëreshat e tjera mbetën jashtë Parajsës, sepse nuk qenë përgatitur për të pritur Dhëndërin. Me virgjëreshat e mara kuptojmë njerëzit mëkatarë.

2- **Dhëndri.** Në këtë paravoli Dhëndëri është Krishti, i cili do të vijë për të gjykuar të gjallët e të vdekurit.

3- **Dasma.** Me fjalën “dasëm” kuptojmë Mbretërinë e Qiejve.

4- **Rrini zgjuar.** Zoti dhe shpëtimtari ynë Jisu Krishti na porositi që të rrimë zgjuar, sepse nuk dimë ditën dhe orën kur do të vijë Biri i Njeriut.

PARAVOLIA E TALANTAVE

(Lluka 19:11-27)

14 Sepse dotë vinjë posi një njeri, i cili, kur do të ikënte ndë dhe të-huaj, thirri shërbëtorët’ e ti e u dha atyre gjën’ e ti; 15 Edhe njërit i dha pesë tallanda, e tjetërit dy, e tjetërit një; gjithësi-cilit si pas fuqis’ së ti; edhe për një- here iku ndë dhe të-huaj. 16 Atëhere ay që mori të pesë tallandatë, vate e punoj me ato, edhe bëri pesë tallanda të-tjere. 17 Kështu edhe ay që mori dy, fitoj edhe ay dy të-tjera. 18 Po ay që mori një-rënë, vate e rëmoj ndë dhet, edhe fshehu ergjëndin’ e të zott. 19 Edhe pas shumë kohë vjen i zoti i atyre shërbëtorëve, edhe sheh llogari me ata.

1- **Perëndia, pasi shqërndau tek njerëzit talanda të ndryshme fillon që t’u kërkojë llogari.** Paravolia e talandave na tregon se Perëndia, pasi shqërndau tek njerëzit talanda të ndryshme në një moment të caktuar fillon që t’u kërkojë llogari. Atëhere njeri nga shërbëtorët me dëshpërim të thellë iu ankua se i pati dhënë vetëm një dhunt, prandaj nuk e vuri në punë. Nëse do ti jepte më shumë do ti vinte në përdorim. Pikërisht në çastin e kërimit të llogarisë shtrohet problemi i barazisë. Perëndia na e dha barazinë duke na krijuar njerëz të lirë, por jo të gjithë njerëzit janë njësoj, dikujt i dha më shumë talente dhe dikujt më pak. Por e rëndësishme është që çdonjeri t’i përdori ato atëhere kur duhet dhe ashtu siç duhet.

20 Edhe si i erdhi përanë ay që pat marrë të pesë tallandatë, pruri pesë tallanda të-tjera, dyke thënë, **Zot**, pesë tallanda më dhe ndë dorë; ja tek fitova prej atyre pesë tallanda të-tjera. **21** Edhe i zoti i tha, të lumtë, shërbëtuar i-mirë edhe besëtar; mbë të paka që besëtar, mbi të-shuma do të të vë; hyrë ndë gëzimt të t'yt **Zott**. **22** Erdhi përanë edhe ay që pat marrë të dy tallandatë, edhe tha, **23** **Zot** dy tallanda më dhe ndë dorë; ja tek fitova prej atyre dy tallanda të-të-tjera. **I-Zoti** i tha, të lumtë, shërbëtuar i-mirë edhe besëtar: mbi të-paka qe besëtar, mbë të-shuma do të të vë; hyrë ndë gëzimt të t'yt **Zott**.

1- Gjykimi në lidhje me dhuntitë e dhuruara Perëndia. Këtë e vërteton më së miri paravolia e talantave ku njëri shërbëtor mori pesë talanda, tjetri dy dhe i fundit vetëm një. Perëndia au shpërndau atyre sipas mundësive, sepse e di aftësinë e gjithsecilit. Por në fund Perëndia do ta gjykojë secilin duke dhënë llogari se çfarë ka bërë me dhuntitë e dhuruara. Njerëzit mund të mos jenë të barabartë në talent por çfarëdolloj talenti që të kemi duhet që ta përdorim në shërbim të Perëndisë.

24 Erdhi përanë edhe ay që pat marrë një tallandë, e tha, **Zot**, të dinja, se je njeri i-ashpërërë, që korr tek nukë mbolle, edhe mbleth tek nukë përndave; **25** Edhe passi paçë frikë, vajta e fsheha tallandënë t'ënde ndë dhet; ja tek e ke tëndenë. **26** Edhe i zoti u përgjeq e i tha: Shërbëtuar i-lik edhe i-përtuarshim, ti e dinje, se unë korr tek nukë mbolla, edhe mbleth tek nukë përndava; **27** Duhej pra të vinje ërgjëndinë t'im te truvezarëtë; edhe kur të vinjam unë, do të mernja t'imenë bashkë me kamatënë. **28** Merrni pra prej ati tallandënë, edhe epj'a-ni ati që ka të dhjetë tallandatë.

1- Shërbëtori i lig. Shërbëtori i tretë filloi të shfajësohej për dembelizmin e tij, sepse në kohën që dy shërbëtoret e tjerë punuan

për ti shtuar talandat, ai e groposi talandën që i dhuroi Perëndia dhe më pas fajësoi padronin e tij. Ai dëshironte që t'ia kthente talandën në të njejtnë sasi që e kishte marrë duke simbolizuar ata njerëz që e quajnë veten të krishterë dhe nuk i vënë në jetë thesaret e besimit. Ndëshkimi i shërbëtorit na kujton se Perëndia pret shumë nga ne: “Ndaj atij që ka do t’i jepet dhe ndaj atij që nuk ka do ta humbasë”. Nga ky varg arrijmë në konkluzionin se mënyra e vetme për ti shtuar dhuratat e Perëndisë është që ti përdorim ato sa më mirë. Ti përdorin duke i shërbyer Perëndisë dhe të afërmit tonë.

29 Sepse kujtdo që ka do t’i epetë, edhe do t’i tepëronjë: edhe prej kujdo që s’ka, edhe atë që te ketë, do të merretë prej ati. 30 Edhe shërbëtorin’e pavëjejturë hidh-e-ni ndë errësirët të-përjashtësme; atje do të jetë të-qarët’e të-kërcëlliturit’e dhëmbëvet.

1- **Sepse kujtdo që ka do t’i jepet.** Dashuria e Perëndisë është e pakufishme, duke hapur krahët dhe i shpërndan dhuratat tek të gjithë njerëzit, të cilët i marrin ato nga duart e Perëndisë dhe shprehin mirënjohjen e tyre. Pra fuqia hyjnore na fali gjithçka që është e domosdoshme për jetën dhe duhet t’ja shpërblejmë duke u kultivuar shpirtërisht dhe të bëhemi adhurues të dritës hyjnore. Në paravolinë e talantave njeriu që udhëton është vetë Zoti, ndërsa kthimi i zotërisë simbolizon ardhjen e dytë të Krishtit në tokë për të gjykuar të gjallët dhe të vdekurit. Shërbëtorët janë njerëzit dhe talandat janë dhuratat që u jep Zoti njerëzve për shembull: urtësinë, shëndetin, pasurinë etj. Si konkluzion përfundimtar të kësaj paravolie mund të nxjerrim se çdo njeri ka marrë dhurata prej Perëndisë dhe duhet që ti përdori ato sipas dëshirës së Tij, duke bërë vepra të mira e të pëlqyeshme nga Zoti.

SI DO TË GJYKOHET BOTA

31 Edhe kur të vinj' i Bir'i njeriut ndë lavdit të ti, edhe gjithë ëngjëjt'e-shënjtëruarë bashkë me atë, atëhere do të rrijë mbi front të lavdis'së ti. **32** Edhe do të mblidhenë përpara ati gjithë kombetë; edhe do t'i ndanj' ata njërinë nga tjetëri, sindëkur bariu ndan dhëntë nga kecëritë; **33** Edhe do të vërë dhëntë mb'anë të-djathtë, edhe kecëritë mb'anë të mëngjërë.

1- **Ai do të ulet në fronin e lavdisë së Tij për të gjykuar njerëzit.** Këto vargje na paraqesin ardhjen e dytë të Krishtit, atëhere kur Ai do të vijë përsëri në tokë për të gjykuar të gjallët e të vdekurit. Herën e parë kur erdhi në tokë, Perëndia u bë njeri për të shpëtuar njerëzimin. Por njerëzit u treguan të pamëshirshëm duke e gjykuar Krishtin. Por herën e dytë do të jetë Krishti, Ai që do të gjykojë njerëzit. Gjykimi i Tij do të jetë me drejtësi dhe dashamirësi, jo siç e gjykuan njerëzit atë me ligësi.

2- **Njerëzit e drejtë, në të djathtë të Tij, ndërsa dhitë, domethënë mëkatarët, në të majtë.** Çasti i gjykimit do të jetë i tmerrshëm, sidomos për mëkatarët, sepse do t'u shfaqen të gjitha ligësitë përpara engjëjve dhe njerëzve. Ky çast do të jetë i hareshëm për njerëzit e drejtë, të cilët do të zënë vend në të djathtë të Atit. Askush nuk e di momentin e gjykimit të fundit, prandaj duhet të jemi kurdoherë të gatshëm.

34 Atëhere mbreti do t'u thot' atyre që rrinë mbë anë të-djathtë të ti, ejani të-bekuarët' e t'im Eti, trashëgoni mbretërinë që është bërë gati për ju që kur se është ngrehurë bota. **35** Sepse pata uri, e më dhatë të ha; pata et, e më dhatë të pi; i-huaj jeshë, edhe më muaritë ndë shëpi; **36** I-sveshurë, edhe më veshtë; u sëmurçë, edhe erthtë të më shihni; jeshë ndë burk, edhe erthtë tek unë. **37** Atëhere të-drejtëtë do t'i përgjigjenë, dyke thënë,

Zot, kur të pamë ty dyke pasurë uri e të ushqyemë? A dyke pasurë et, e të dhamë të pish? 38 Edhe kur të pamë të-huaj, e të muarmë ndëpër shtëpirat? A të-sveshurë, e të veshmë? 39 Edhe kur të pamë të-sëmurë, a ndë burk, edhe erthmë tek ti?

1- Ejani ju o të drejtë të trashëgoni mbretërinë e qiejve. Por në ç'mënyrë do të gjykohemi? Këtë përgjigje na e jep përsëri Ungjilli i sotëm:” Ejani ju o të drejtë të trashëgoni mbretërinë e qiejve, sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë të pi, isha i huaj dhe më gjetët strehë, isha i zhveshur dhe më veshët, isha i sëmurë dhe erdhët të më shihnit, isha në burg dhe më vizituat.” Është pikërisht dashuria që duhet të kemi për çdo të vobektë që është në vështirësi. Humanizmi ynë do të jetë njësia matëse në çastin e gjykimit, sepse tek fytyra e çdo fukarai duhet të shohim vetë Krishtin dhe ta duam atë, sepse të gjithë njerëzit jemi vëllezër, të krijuar sipas shembëlltyrës së Perëndisë. Nëse marrëdhëniet tona janë të mbushura me dashuri, atëhere ato do të shfaqim dashurinë e pafund të Perëndisë.

40 Edhe mbreti do të përgligjet' e do t'u thotë atyre: Me të-vërtetë po u them juve, sado që i bëtë njerit nga këta vëllezërit' e mi më të-vegjëlitë, m'a keni bërë mua.

1- Çfarëdo që i keni bërë njërit prej vëllezërve të mi të varfër, ma keni bërë mua. Neve sigirusht që do të na pëlqente ta krahasonim veten tonë me më të fuqishmit, me njerëz të famshëm e me rëndësi, ndërsa Krishti bëri të kundërtën duke e njësuar veten me më të dobëtit. Me këtë akt ai i dha njerëzimit orientimin e vërtetë, atë të barazisë dhe të vëllazërisë midis njerëzve duke thyer barrierat e pabarazisë e të përçmimit. Këtë e thotë mjaft qartë Ungjilli i sotëm:” Vërtet po ju them se çfarëdo që i keni bërë njërit prej vëllezërve të mi të varfër, ma keni bërë mua.”

41 Atëhere do t'u thot' edhe atyre që rrinë mbë anë të-mëngjërë: Ikëni prej meje, të-mallëkuarëtë, ndë zjarrr të-pasosurë, që është bërë gati për djallin'e për ëngjëjt'e ati. 42

Sepse paçë uri, e s'më dhatë të-ha; paçë et, e s'më dhatë të pi; 43 Jeshë i-huaj, e nukë më muartë përbrënda; i sveshurë, edhe nukë më veshtë; i-sëmurë edhe ndë burk, edhe nuk' erthtë të më shihni. 44 Atëhere do t'i përgjigjen' edhe ata, dyke thënë: Zot, kur të pamë ty dyke pasur'uri, a dyke pasur' et, a të huaj, a të-sveshurë, a të-sëmurë, a ndë burk, e nukë të shëbyemë? 45 Atëhere do t'u përgjigjet' e do t'u thot' atyre, Me të-vërtëtë po u them juve, sado që nuk'i bëtë njërit nga këta me të-vegjëlitë, as mua nukë m'a kini bërë. 46 Edhe këta do të venë ndë mundim të-përjetëshme; edhe të-drejtëtë ndëjetët të-përjetëshmë.

1- Largohuni prej meje o të mallkuar, në zjarrin e perjetshëm. Dashuria është ajo që do të gjykojë botën, sepse kush ka dashuri jeton sipas vullnetit të Perëndisë. Ai që shfaq dashuri ndaj të afërmit, beson se duke treguar dashuri me të vobektin, tregohet bamirës edhe ndaj Krishtit. Vendimin për çastin e gjykimit e japim ne, me veprat tona, sepse të drejtët do të jenë në të djathtë të gjykatësit dhe do tu thotë me gëzim: “Ejani o të bekuar të trashëgoni mbretërinë e qiejve, e cila është përgatitur për juve”. Ndërsa mëkatarëve do tu drejtohet me fjalët: “Largohuni prej meje o të mallkuar, në zjarrin e perjetshëm”.

KREU I NJËZETEGJASHTË

KOMPLOTI PËR VRASJEN E JISUIT

(Marku 14;1,2, Lluca 22:1,2, Joani 11:45-53)

1 Edhe Jisuj kur mbaroj gjithë këto fjalë, u tha nxënësve të ti, 2 E dini se pas dy ditsh është Pashka, edhe i Bir' i njeriut epetë ndë duar për të kryqëzuarë.

1- **Pas dy ditësh është Pashka.** Fjala Pashkë do të thotë kalim. Pashka është përkthimi i fjalës hebraike “Fashek” që në gjuhën greke (Pashka) do të thotë kalim. Siç përmendet edhe në librin e Eksodit (12:11), termi Pashkë bën fjalë kryesisht për ngjarjen e daljes së izraelitëve nga Egjypti, dhe shpëtimit të popullit të Perëndisë gjatë natës së Eksodit. Meqënëse kjo histori, pra therrja dhe gjaku i qengjit kishin një rëndësi qendrore (Eksodi 12:3-13) sepse bëhej fjalë për festën e Pashkës. Mbas vendosjes së hebregjeve në tokën e premtuar në Palestinë, festimi i Pashkës ishte ngjarja më e rëndësishme e popullit të zgjedhur të Perëndisë. Pashka festohej më datën 15 të muajit Nisan, si përkujtimi i daljes nga skllavëria e Egjyptit dhe e kalimit të Detit të Kuq. Pashka zgjaste shtatë ditë. Në vigjilje të festës, pra të Premten më 14 të Nisanit, therrej qengji dhe të shtunën, festohej Pashka.

2-Biri i njeriut do të jepet për tu kryqëzuar. Pashka Judaike ishte si prototipi i ngjarjeve të mëvonshme të jetës së Jisuit. Jisu Krishti e festoi Pashkën të enjten në mbrëmje, pra më datën 13

të muajit Nisan, gjatë Darkës Mistike. Të nesërmen më datën 14 të muajit Nisan “Qengji i Perëndisë” u sakrifikua (u kryqëzua). Mund të themi se Pashka Judaike ishte festa përkujtimore e eksodit ndërsa Pashka Kristiane ishte përkujtimi dhe përjetimi i Ngjalljes së Krishtit, i cili u sakrifikua në kryq për shpëtimin e njerëzimit. Në rastin e Pashkës Judaike kemi kalimin nga skllavëria e Egjyptit, ndërsa me Pashkën Kristiane kemi kalimin nga robërimi i mëkatit, në Ngjalljen. Qengji simbolizon Krishtin, ndërsa gjaku i qengjit simbolizon gjakun e Krishtit. Qengji blehej më datën 10 të muajit Nisan dhe piquej në hell. Gjatë pjekjes i kalonin edhe një dru tjetër tëk shpatullat, për të formuar kryqin. Qengji nuk duhej dëmtuar gjatë therrjedh dhe pjekjes, pra nuk i thyhej asnjë kockë. Të gjitha këto tregojnë që Perëndia në mënyrë simbolike përgatiste njerëzit, që të kuptonin sakrifikimin e Krishtit në kryq duke ngritur gjithë mëkatet e botës.

3 Atëhere u mblotnë krye-priftërit’ edhe shkronjësit’ edhe pleqt’ e llauzit ndë avlit të krye-priftit, që thuej Kaiafë; 4 Edhe bënë këshillë që t’a zënë Jisunë me kobim, edhe t’a vrasënë. 5 Edhe thoshinë, jo ndë të-kremtet, që të mos bënetë trazirë ndë gjindjet.

1- Jo në të kremte se bëhet trazirë. Sinedri pasi kuvendoi gjatë kishte vendosur që të mos ta kapte Krishtin në ditën e Pashkëve, sepse gjatë kësaj dite në qytetin e Jerusalemit kishte shumë njerëz.

LYERJA ME MIRË

(Marku 14:3-9, Joani 12:1-8)

6 Edhe Jisuj kur ishte ndë Vithani, ndë shtëpit të Simonit të-krromosurë, 7 Erdhi për an’ati një grua që kishte një allavastrë me vaj ere shumë të-shtrënjtë, edhe e derthi mbi kryet t’ati tek ishte dyke ndënjurë ndë mësallët.

1- Ndë shtëpit të Simonit të-kromosurë. Gjashtë ditë përpara Pashkës Krishti vajti në Vithani në shtëpinë e Simonit të kromosur. Simoni quhej i kromosur sepse më parë vuante nga kjo sëmundje. Në kohën që Krishti vizitoi shtëpinë e Simonit, ky i fundit sigurisht që ishte pastruar nga zgjebja.

2- Një grua që kishte një enë me mirë. Kjo grua ishte Maria e motra e Llazarit. “Atëherë Maria mori një liber, vaj të kushtueshëm prej nardi të pastër shumë të kushtueshëm, vajosi me të këmbët e Jisuit dhe i fshiu me flokët e saj; dhe shtëpia u mbush me erën e këtij vaji” (Joani 12, 3).

8 Edhe nxënësit’ e ati kur panë, u zëmëruanë, e thanë: Për ç’punë të humbasë këjo gjë? 9 Sepse ky vaj ere munt të shitej me shumë nder, edhe t’ epej ndëpër të vobeqt.

1 -Përse gjithë ky shpenzim? Në atë kohë miro kushtonte 300 denarë, vlerë e barabartë me 252 dhrahmi të asaj kohe. Ky ishte një shpenzim shumë i madh. Ndërsa Juda e tradhëtoi Krishtin për 30 argjenda, vlera e të cilave ishte 108 dhrahmi, pra çmimi i një skllavi.

10 Edhe Jisuj si kupëtoj, u tha atyre: Përse i epni mundime kësaj gruaje? Sepse këjo bëri punë të-mirë tek unë. 11 Sepse të-vobeqtë i keni për-herë me vetëhenë t’uaj; po mua nuk më kini përherë.

1- Mua nuk do të më këni përherë. Me këto fjalë Krishti u kujton dishepujve që orët e vdekjes së tij po afroreshin.

12 Sepse këjo, kur derdhi këtë vaj ere mbi trup t’im, e bëri këtë për të kalluritë t’im ndë varr. 13 Me të vërtetë po u them juve, kudo që të lëçitetë ky ungjill ndë gjithë botët, do të flitetë edhe ç’punë bëri këjo, që të mbahetë mënt.

1- Derdhi vaj mbi rupin tim. Hebrenjtë e kishin për zakon që të vdekurit, përpara se ti varrosnin i lyejnë me mirë.

2- Çfarë bëri kjo grua në përkujtimin tim. Me lyejen e Krishtit me mirë, Maria e motra e Lllazarit dhe e Martës hyri në historinë e mbarë njerëzimit.

TRADHËTIA E JUDËS

(Marku 14:10,11, Lluka 22:3-6)

14 Atëhere një nga të dy-mbë-dhjetë, ay që quhej Judhë Iskariot, vate te krye-priftërit'e tha, 15 Ç'do të më epni, edhe unë t'u ap juve atë ndër duar? 16 Edhe ata i dhanë tridhjet'argjenda. Edhe që mb'atëhere kërkonte kohë të-pëlqyerë t'a epte ndër duar.

1- Tridhjetë argjenda. Sipas ligjit të Moisiut “Në qoftë se kau godet një skllav ose një skllave, i zoti i kaut do t'i paguajë të zotit të skllavit tridhjetë sikla argjendi dhe kau do të vritet me gurë”(Eksodi 21,32). Pra për një të vlarë shpërblimi ishte tridhjetë mondhja argjendi.

2- Kohë të-pëlqyerë t'a epte ndër duar. Dita që Juda e tradhëtoi Krishtin ishte e mërkurë. Tradhëtia e Judës e ka kuptimin që ai i tha Sinedrit kohën dhe vendin kur Krishti ishte vetëm, me qëllim që ata ta kapnin atë në një moment kur nuk kishte njerëz.

DARKA MISTIKE

(Marku 14,13) Lluka (22,8)

17 Edhe të-parënë ditë të-pabrumjever, nxënësit' erthnë përënë Jisujt e i thanë, ku do të bëjmë gati për ty të hash Pashkënë? 18 Edhe ay tha: Shkoni ndë qytett tek-akëcili, edhe i thoni, Mësonjësi thotë, koha ime është' afërë; do të bënj pashkënë

të ti bashkë me nxënësit' e mi. 19 Edhe nxënësitë bënë sindëkur i porositi Jisuj, edhe bënë gati Pashkënë.

1- **Bëni gati Pashkën.** Darka e Pashkës shtrohej më 14 të muajit Nisan. Darka e Pashkës u shtrua në shtëpinë e ungjillor Markut, ndonëse ungjillori Mathe nuk e përmend në ungjillin e tij. E zonja e shtëpisë ku u shtrua darka ishte Maria e ëma e Markut. Petro dhe Joani blenë qingjin, e therrën në tempull dhe bashkë me gjellë të tjera, bukë të pa maja, verë etj, shtruan darkën mistike (Marku 14,13) Lluca (22,8).

20 Edhe kur u ngrys, ishte dyke ndënjurë ndë mësallët bashkë me të dy-mbë-dhjetët; 21 Edhe ata tek ishinë dyke ngrënë, tha: Me të-vërtetë po u them juve, se një nga ju do të, më trathëtonjë. 22 Edhe ata u helmuanë fort, edhe zunë t'i thonë gjithë-si-cili nga ata, Zot, mos jam unë? 23 Edhe ay u përgjeq e tha: Ay që ngjeu dorënë ndë kupët bashkë me mua, ky do të më apë ndër duar.

1- **Ay që ngjeu dorënë ndë kupët bashkë me mua.** Krishti u thotë dishepujve që njeri prej tyre do ta tradhëtonte. Kupa kishte brenda një lloj lëngu të përbërë prej rrushi, fiqsh dhe uthulle.

24 I Bir' i njeriut vete, sindëkur është shkruarë për atë; po mjerë ay njeri me anë të të-cilit epetë ndër duar i Bir'i njeriut; ishte mirë për atë njeri të mos kishte lindurë. 25 Edhe Judha, ay që e trathëtoj, u përgjeq e tha: Mos jam unë, Ravvi? I thot ati, ti po thua.

1- **Mos jam unë, Ravvi?** Juda doli hapur që e kishte tradhëtuar Krishtin. Pasi shkëmbeu fjalë me Jisuin, Juda doli nga dhoma dhe u largua (Joani 13,30).

26 Edhe ata tek po ishinë dyke ngrënë, Jisuj mori bukënë, edhe si e bekoj, e theu, e u'a dha nxënësvet, edhe tha: **Merrni e hani;** **27** ky është trupi im. **28** Edhe mori potirinë, edhe si u fal ndersë, u'a dha atyre, dyke thënë: **Pini të-gjithë prej këti;** sepse ky është gjaku im i dhjatës'sëre, që derdhetë për shumë për ndjesën'e fajevet. **29** Edhe po u them juve, se nukë kam për të pirë që ndashti e tutje nga këjo pemë, që pjell hardhia, gjer m'atë ditë, kur t'a pi të-re bashkë me ju ndë mbretërit të t'im Eti. **30** Edhe si psallnë, duallnë ndë malt të ullinjet.

1- Duke ngrënë. Darka kishte një mënyrë teleturgjike të përcaktuar. Sjelljen rrotull potirit, i cili kishte brenda verë dhe ujë, larjen e dyarve, lutjet e falenderimit, rrëfimi historik i festës, pjesë nga psallmet e Davidit dhe përfundonte me shpërndarjen e bukës.

2- Merrni e hani, ky është trupi im dhe pini prej këti se është gjaku im. Jisui mori një copë bukë dhe u tha dishepujve: Merrni e hani, ky është trupi im dhe pini prej këti se është gjaku im duke themeluar misterin e Eukaristisë Hyjnore.

3- Ky është gjaku im. Në Dhiatën e Vjerër kemi besëlidhjen e Moisiut: “Pastaj Moisiu mori gjakun, spërkati popullin me të dhe tha: -Ja gjaku i besëlidhjes që Zoti ka lidhur me ju sipas tërë këtyre fjalëve” (Eksodi 24,8). Krishti në këtë rast flet për gjakun e tij, që do të derdhej kur ta kryqëzonin. Pas përfundimit të ngrënies ngritën potirin e bekuar. Ngritja e potirit simbolizon Kungimin e Shenjtë.

4- Pasi psallnë. Pasi përfunduan darkën mistike, dishepujt bashkë me Krishtin kënduan psallmet 115 dhe 118.

PARATHËNIA E MOHIMIT TË PJETRIT

(Marku 14:27-31, Lluka 22:31-34, Joani 13:36-38)

31 Atëhere Jisuj u thot' atyre: **Gjithë ju do të skandaliseni mbë mua këtë natë; sepse është shkruarë, “Do t'i bie bariut, edhe dhënt' e tufësë do të përndahenë.”** **32** Edhe

passi të ngjallëm unë, do të vete përpara jush ndë Galilet. 33 Edhe Pjetri u përgjeq e i tha, Edhe të-gjithë ndë u skandhalisçinë mbë ty, unë nukë do të skandhalisem kurrë. Jisuj i tha, 34 Me të-vërtetë po të them, se këtë natë, para se të këndonjë këndesi, tri herë do të më mo-

honjë. 35 Pjetri i thotë, Edhe ndë u ndashtë të vdes unë bashkë me ty, nukë do të të mohoj. Kështu thanë edhe gjithë nxënësitë.

1- Pasi të jem ngjallur, do të shkoj përpara jush në Galile. Krishti do të shkojë në Galile si një bari i mirë. Atje do t'i mbledhi përsëri dishepujt e tij. Ungjillori Mathe frymëzohet nga profecia e Zakarisë: "Godite bariun dhe delet do të shpërndahen" (Zakaria 13, 7). Ndërsa ungjillori Joan shkruan: "Delet e dëgjojnë zërin e tij, dhe ai i thërret me emër dhe i prin jashtë. Dhe pasi i ka nxjerrë delet e tij, shkon para tyre; dhe delet e ndjekin, sepse e njohin zërin e tij" (Joani 10, 3-4).

2- Unë nuk do të skandalizohen kurrë. Në këtë rast Petro tregon besimin e tij tek Krishti.

LUTJA E JISUIT NË GJETHSEMANI

(Marku 14:32-42, Lluca 22:39-46)

36 Atëhere Jisuj vjen bashkë me ata ndë një fshat që thuhetë Gjethsimani; edhe u thotë nxënësve, rrini aty, gjer sa të vete e të falem atje. 37 Edhe mori me vetë Pjetrin' edhe të dy bijt' e Zevedeut, e zuri të hidhëronet' e t'i vinje rëndë. 38 Atëhere u thot' atyre, Shpirti im është' i hidhëruarshim gjer mbë vdekje; mbetuni këtu, edhe rrini sguarë bashkë me mua.

1-Në Gjethsemani. Gjethsemania gjendej në perëndim të malit të Ullinjve.

2-Mori me vete Petron dhe dy bijtë e Zevedeut. Krishti u thotë apostujve që të rrinin aty dhe me vete mori Petron dhe dy bijtë

e Zevedeut, të cilët qenë dhe në malin Tabor në momentin e shpërfytyrimit.

39 Edhe se vate pakëzë më tej, ra mbë faqe përmbys, dyke falur' e dyke thënë: Ati im, ndë qoftë se munt të bënetë, le të hiqetë prej meje këjo kupë; po jo si dua unë, po si të duash ti.

1- **Ra me faqe përmbys.** Hebrenjtë kur luteshin binin përdhe dhe vendosnin faqen në tokë. Këtë zakon e kishin trashëguar që nga Dhiata e Vjetër. “Por ata i ranë përmbys me fytyrën përtokë dhe thanë” (Numrat 16,22).

2- **Ati im largoje prej meje këtë kupë.** Me këto vargje Krishti tregon natyrën e tij të plotë njerëzore. Natyra njerëzore e njeriut gjithnjë është e dobët. Frika e vdekjes sundon mbi të gjithë, prandaj edhe Krishti i lutet Atit që ta largojë prej tij atë kupë.

40 Edhe vjen te nxënësitë, e i gjen ata dyke flejturë, edhe i thotë Pjetrit, kështu nukë munt të rrini sgjuarë një orë bashkë me mua? 41 Rrini sgjuarë edhe faluni, që të mos hyni ndë ngasje; sepse shpirti është' i gatishim, po mishi është' i pafuqishim.

1- **I gjen duke fjetur.** Këtu duket qartë dobësia trupore e dishepujve. Ata të lodhur siç qenë i zuri gjumi.

2- **Rrini zgjuar dhe faluni.** Krishti i porositi dishepujt e tij që të rrinë zgjuar dhe të luten vazhdimisht.

42 Prapë për-së dyti vate edhe u fal, dyke thënë: Ati im, ndë qoftë se nukë munt të hiqetë prej meje këjo kupë, që të mos e pi atë, let ë bënetë ënda jote. 43 Edhe erdhi e i gjen përsëri dyke flejturë; sepse syt' e atyre ishinë rënduarë. 44 Edhe si i la ata, vate përsëri e u fal përsë-treti, dyke thënë po atë fjalë. 45 Atëhere vjen te nxënësit' e ti edhe u thot' atyre, Flini pra, edhe prëhi; ja tek u afërua ora, edhe i Bir'i njeriut epetë ndë duar

fajtorësh. 46 Ngruhuni le të vemi; ja tek u afërua ay që do të më apë ndër duar.

1- U afrua ai që do të më japi ndër duar. Në këtë rast Krishti parandjen kapjen e tij dhe tradhëtinë e Judës.

ARRESTIMI I JISUIT

(Marku 14:43-52, Lluka 22:47-53, Joani 18:1-11)

47 Edhe ay tek ishte po dyke folurë, ja tek erdhi Judha, një nga të dy-mbë-dhjetë, edhe bashkë me atë erthnë shumë gjindje me thikë e me dru nga an'e krye-priftërvet edhe të pleqvet të llauzit. 48 Edhe ay që e epte atë ndër duar u dha atyre shënjë, dyke thënë: Atë që të puth unë ay është; zir-e-ni atë. 49 Edhe përnjëhere erdhi përanë Jisujt e tha: Gëzohu, Ravvi; edhe e puthi. 50 Edhe Jisuj i tha: Mik, përse erdhe? Atëhere u afëruanë e vunë duartë mbi Jisunë, edhe e zunë.

1- Një turmë e madhe me shpata dhe shkopinj. Romakët duke zbatuar udhëzimet e sinedrit dërgonin një regjiment ushtarësh për të mbajtur rregullin gjatë Pashkës. Përveç ushtarëve romakë qenë edhe shërbyesit e personeli i hierores.

2- **Mik, përse ke ardhur?** Krishti ndonëse e dinte që Juda ishte tradhëtari, megjithatë i drejtohet me fjalën “mik”. Krishti me këto fjalë i thotë atij që ta përfundonte misionin e tradhëtisë dhe ta dorëzonte. Ai dëshironte që kapja e tij të bëhej paqësisht.

51 Edhe ja një nga ata që ishinë bashkë me Jisunë ngjati dorënë, e nxori thikën' e ti, edhe i ra shërbëtorit të krye-priftit, e i preu veshnë. 52 Atëhere Jisuj i thot' ati: Kthe thikënë t'ënde ndë vënit të saj; sepse gjith'ata që vënë dorë mbë thikë, prej thike do të humbasënë. 53 Apo të duketë se nukë munt ndashti t'i lutem t'im Eti, edhe të më nxjerrë përpara më tepërë se dy-

mbë-dhjetë legjeona ëngjëjsh? 54 Qysh do të mbushenë pra shkronjatë, se kështu gjan të bënetë?

1- Dymbëdhjetë legjione engjëjsh. Legjioni ishte një regjiment romak i përbërë prej 6000 ushtarësh.

2- I preu veshin shërbëtorit të Kryepriftit. Petro nxori thikën dhe i preu veshin shërbëtorit të Kryepriftit. Ai quhej Malko (Joani 18,10). Krishti e këshilloi Petron.

55 Mb' atë orë Jisuj i tha gjindjesë, Posi mbë kursar keni dalë me thinkë e me dru të me ziri? për dita rrinjam te ju dyke mësuarë ndë hieroret, edhe nukë më zutë. 56 Po gjithë këjo u bë, që të mbushenë shkronjat'e profitërvet. Atëhere gjithë nxënësitë e lanë, e iknë.

1- Përse keni dalë me thika e dru? Krishti u thotë përse keni dalë të më zini me thika dhe dru, ndonëse unë kam qenë me ju duke mësuar dhe bërë mrekulli në tempull.

2- Që të përmbushen shkrimet e profetëve. Profetët kishin parashikuar gjithë pësimet e Krishtit. Në këtë rast ungjillori Mathe përpiqet të lidhi Krishtin me profetët e Dhiatës së Vjetër, me qëllim që t'i bindi hebrenjtë që ai është Mesia i vërtetë i dërguar nga Perëndia.

3- Dishepujt e lanë dhe ikën. Me këto fjalë tregohet dobësia e dishepujve të Krishtit. Ata u zhgënjyen nga mësuesi i tyre duke menduar që ishte i pafuqishëm të shpëtonte veten. Dishepujt ende nuk kishin besim të plotë tek Krishti, sepse ky i fundit ende nuk ishte lavdëruar. “Fryma e Shenjtë në fakt nuk ishte dhënë ende, sepse Jisui ende nuk ishte i lavdëruar” (Joani 7,39).

JISUI PËRPARA SINEDRIT TË MADH

(Marku 14:53-65, Lluca 22:54,-55, 63-71, Joani 18:12-14, 19-24)

57 Edhe ata si zunë Jisunë, e prunë te Kaiafa kryepriifti, atje ku ishinë mbledhurë skkronjësit' edhe pleqtë.

1- **E shpunë te Kajafa.** Në fillim Krishtin e shpunë tek Anna, i cili kishte qenë kryepriift dhe vjehëri i Kajafës. Përpara Annës nuk foli fare. Ishte duke u gdhirë dita e premtë. “Kajafa ishte ai që i kishte këshilluar judenjët se ishte e leverdisshme që një njeri të vdiste për popullin” (Joani 18,14).

2- **Pleqtë.** Qenë ruajtësit e ligjeve dhe të traditës. Në hebraisht quheshin *zaken* dhe në greqisht *prezbiteri*. Pleqtë gëzonin respekt të madh në popull, për shkak të urtësisë dhe diturisë së tyre. Ata rregullonin marrëdhëniet midis fiseve duke marrë vendime sipas të drejtës zakonore. Në çdo sinagogë kishte një grup pleqsh.

58 Po Pjetri i vate prapa për-së-largu, gjer ndë avlit të krye-priiftit; edhe si hyri brenda, rrinte bashkë me shërbëtorëtë, që të shihte fundinë. 59 Edhe krye-priiftitërit'e pleqt'e gjithë bashkë-ndënja kërkoninë dëshmim të-rrem kundrë Jisujt, që t'a vrisninë atë, po nukë gjetnë; 60 Edhe ndonëse erthnë shumë dëshmimtarë të-rrem, nukë gjetnë. 61 Po pastaj erthnë dy dëshmimtarë të-rrem, e thanë, ky tha, se munt të prish tempullin' e Perëndisë, edhe për tri dit t'a ndërtonj atë.

1- **Dëshmitarë të rremë.** Krerët e priiftërinjve kërkoninë dëshmitarë të rremë, të cilët dëshmuan përpara sinedrit që Krishti kishte blesfemuar. Sipas ligji judaik nëse dikush *blasfemonte* atëhere dënohej me vdekje. Por pasi nuk mund ta vërtetonin akuzën ata nuk kishin të drejtë që ta vrisnin. Kështu kërkuan të vërtetonin që ishte *kryengritës* dhe më pas ta shpinin tek romakët për ta ekzekutuar.

2- **Blasfemia.** Në kuptimin e mirëfilltë të fjalës është sharrje ndaj sendeve të shenjta dhe njerëzve.

3- **Por nuk gjetën.** Ligji hebraik e kishte që për të dënuar një njeri duhet të ishin të paktën dy dëshmitarë. Ata nuk gjetën ndjenja

kryengritje, por vetën dashuri, sepse Krishtit predikonte vetëm dashurinë madje edhe ndaj armiqve.

62 Edhe krye-prifti u ngrit e i tha: Nukë përgjigjesh fare? Çdëshmojnë këta kundrë teje? 63 Po Jisuj nukë bënte zë. Edhe krye-prifti u përgjeq e i tha: Të vë mbë e për Perëndin'e gjallë, të na thuash, ndë je ti Krishti, i Bir'i Perëndisë. 64 Jisuj i thot' ati: Ti po thua; po unë po u them juve, Që ndashti e paskëtaj do të shihni të Birr'e njeriut dyke ndënjurë mb'anë të-djathtë të fuqisë, e dyke ardhurë mbi ret të qiellit.

1- **Mbi retë e qiellit.** Ekziston një profeci e profetit Daniel dhe një vegim i tij, i cili e pa Birin e Njeriut të vijë përmbi retë me lavdi. “Unë shikoja disa vegime nate, dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i ditëve dhe iu afrua atij” (Danieli 7,13).

65 Atëhere kryepriifti çori rrobat'e tia, dyke thënë, se vllasfimisi: ç'nevojë kemi më për dëshimtarë? Ja ndashti tek e dëgjuatë vllasfimin'e ati. 66 Si u duketë juve? Edhe ata u përgjeqnë e thanë, Eshtë fajtuar për vdekje. 67 Atëhere e pshtynë atë ndër sy, edhe i ranë me grusht; edhe të-tjerë i ranë me shuplaka, dyke thënë, 68 Profiteps-na, o Krisht, cili është' ay që të ra?

1- **Është fajtor për vdekje.** Ligji i Moisiut parashikonte: “Dhe kushdo që shan emrin e Zotit do të dënohet me vdekje” (Levitiku 24,16).

2- **E pështynë.** Tej judenjhtë pështytja ishte ofendimi më i madh.

MOHIMI I PJETRIT

(Marku 14:66-72, Lluca 22:54-62, Joani 18:15-18, 25-27)

69 Edhe Pjetri rrinte përjashta ndë avlit; edhe i erdhi për anë një shërbëtore dyke thënë, Edhe ti ishnje bashkë me Jisu Galileasinë. 70 Po ay e mohoj përpara të-gjithëve, dyke thënë: Nukë di se ç’thua. 71 Edhe ay kur doli ndë derët të avllisë, e pa atë një tjetërë, edhe u thot’ atyre që ishinë atje: Edhe ky ish bashkë me Jisu Nazareasinë. 72 Edhe përsëri e mohoj me be: Se nuk’e njoh njerinë. 73 Edhe pas pakëzë erthnë për an’ati ata që ishinë dyke ndënjurë e i thanë Pjetrit: Me të-vërtetë edhe ti je nga ata; sepse edhe të-foluritë t’ënt të dëften ty. 74 Atëhere zuri të nemnjë e të bënë be: Se nuk’e njoh njerinë. Edhe për-një-here këndoj këndesi. 75 Atëhere i ra ndër mënt Pjetrit fjal’e Jisujt që i pat thënë: Se para se të këndonjë këndesi, tri herë do të më mohonjë; edhe doli jashtë, e qau hidhurë.

1- **Tek porta.** Shtëpitë e judenjve kishin përreth një oborr të brendshëm. Porta të nxirrte nga avllia për në qytet.

2- **Nga të folurit.** Petro e kishte origjinën nga Galilea. Ata që vinin nga Galilea i shqiptonin ndryshe disa bashtingëllore, pra dialekti i tyre ndryshonte. Gjithashtu Petron e njohu edhe kushëriri i tij, që quhej Malko. Këtij të fundit Petro i preu veshin dhe ai gjeti rastin që të hakmerrej. Malko ishte shërbëroti i kryepiftit. “Një nga shërbëtorët e kryepiftit, farefisi i atij, të cilit Petro i kishte prerë veshin, tha: -A s’ të pashë në kopësht me të?” (Joani 18, 26).

3- **Tre herë do të më mohosh.** Katër ungjillorët na tregojnë për tre mohimet e Petros me disa hollësi të ndryshme. Ai që ishte prezent në këtë rast ka qenë ungjillori Joan. “Petro e mohoi sërish, dhe menjëherë këndoi gjeli” (Joani 18,27).

KREU I NJËZETESHTATË

JISUI I DORËZOHET PILATIT

(Marku 15:1, Lluca 23:1,2, Joani 18:28-32)

1 Edhe si u gdhi, gjithë krye-priftërit'edhe pleqt'e llauzit dhan'e muarnë këshillë kundrë Jisujt, që t'a vrasënë. 2 Edhe si e lithnë, e shpunë edhe e dhanë ndër duart të Pondi Pillatit, qivernitarit.

1-Si u gdhi. Pasi u gdhi dita e premte u mblo dh Sinedri për të marrë vendimin duke ngritur akuzën, me anën e së cilës do ta paditnin tek Pilati.

2-E dhanë në duart e Ponc Pilatit. Ponc Pilati ishte prokuratori i Judesë dhe ka qeverisur në vitet 26-36 pas Krishtit. Rezidenca e tij ishte në Qesarinë e Palestinës.

VETËVRASJA E JUDËS

(Veprat 1:18-19)

3 Atëhere kur pa Judha, ay që e trathëtoj, se u gjykua për vdekje, u pendua, edhe ktheu prapë të tri-dhjetë argjëndatë te krye-priftëret' edhe te pleqtë, dyke thënë: Fëjjeva që dhashë ndër duar gjak të-pafajm. 4 Edhë ata thanë: Ç' punë kemi neve? Ti ke për parë. 5 Edhe ay si hodhi argjëndatë ndë tempulit, iku; edhe vate e u var.

1-Si hodhi argjendat në tempull iku dhe u var. Juda hodhi 30 monedhat e argjenda në tempull dhe u vetvarr.

6 Edhe krye-prifteritë si muarnë argjendatë, thanë: Nuk'është'e udhësë t'i vëm'ato ndë thesart të tempullit, sepse janë çmim gjaku. 7 Edhe si dhan' e muarnë këshillë, blenë arën' e shtëmbarit me ato, për të kallurë ndë varr atje të-huajtë. 8 Përandaj ajo arë u quajt Arë gjaku, gjer mbë ditët të-sotme. 9 Atëhere u mbush ç'është thënë me anë të profitit Jeremi, që thotë, "Edhe muarnë të tri-dhjet' argjendatë, çëmimm'e të çëmuarit nga të bijt'e Israilit, 10 edhe i dhanë ndë arët të shtëmbarit, sikundrë më posositi Zoti."

1-Ara e gjakut. Ligji i Moisiut nuk e lejonte që paratë e tradhëtisë të përdroreshin si dhuratë për tempullin, prandaj me ato lekë blenë arën e shtëmbarit, me qëllim që të varrosnin atje të huajt. Që nga ajo kohë edhe deri më sot ajo arë është quajtur "ara e gjakut". U quajt kështu sepse kjo arë u ble me para gjaku. Në gjuhën aramaishte quhej "Akeldama" që do të thotë "Ara e gjakut" (Veprat e Apostujve 1,18).

2-Të huajtë. Me fjalët "të huajt" nënkuptojmë judenjët nga krahina të tjera, të cilët vinin për pelegrinazh në Jerusalem dhe vdisnin aty. Këtu nuk bëhet fjalë për të huajt, domethënë për kombet e tjera, sepse judenjët i quanin ata të padenjë dhe nuk kushtonin kujdes për ta.

3- I dhanë në arën e shtëmbarit sikundër porositi Zoti. Këto i kishin parathënë profetët: "Hidhja poçarit çmimin madhështor, me të cilin ata më vlerësuan. Atëhere i mora tridhjetë siklat prej argjendi dhe i hodha në shtëpinë e Zotit për poçarin" (Zakaria 11,13).

DËNIMI I JISUIT

(Marku 15:2-15, Lluca 23:3-5, 13-25, Joani 18:33, 19:16)

11 Edhe Jisuj ndënji përpara qivernitarit; edhe qivernitari e pyeti, dyke thënë: Ti je mbreti i Judhenjvet? Edhe Jisuj i tha: Ti po thua. 12 Edhe kur përflitej nga krye-priftëritë edhe nga pleqtë, nukë përgjigje asfare. 13 Atëhere Pillati i thotë: Nukë dëgjon sa dëshmojnë kundër teje? 14 Po ay nuk' iu përgjeq as mbë ndonjë fjalë, kaqë sa qivernitari çuditej fort. 15 Edhe qivernitari kishe zakon për të-kremte t'i lëshonte gjindjesë një të-lidhurë, atë qe të donin' ata. 16 Edhe atëhere kishinë një të-lidhurë me emërë, që thuhej, Varnava. 17 Ata pra tek ishinë mbledhurë, Pillati u tha atyre: Cilinë doni t'u lëshonj juve? Varavvanë, apo Jisunë që thuhetë Krisht. 18 Sepse e dinte, se e dhanë ndër duar nga çmiri.

1-Cilin doni të lëshoj Barnabën apo Krishtin? Judenjhtë qenë grumbulluar në oborrin e Pretores, sepse ishte ditë Pashke. Zakonisht në ditë të tilla falej ndonjë i akuzuar. Pilati mendoi se populli, në një ditë të tillë të shënuar do të falte Jisuin, madje edhe vetë Pilati dëshironte që ta linte të lirë sepse nuk po shikonte ndonjë faj. Tek përsoni i Krishtit ai dallonte: 1) pafajësinë, 2) ishte viktimë e të tjerëve, 3) gruaja e Pilatit i kishte folur për pafajësinë e Krishtit.

2- Barnabai ishte kryehajdut, gjithashtu akuzohej edhe për vrasje. Fjala “barnaba” në gjuhën hebraike do të thotë “biri i atit”.

19 Edhe ay tek po rrinte mbi front të gjyqit, gruaja e ati dërgoj tek ay, e i tha: Ti mos i bëj gjë ati të-drejti, sepse sot pësova shumë nd'ëndërrë për atë.

1- Po rrinte në fronin e gjyqit. Vendi i gjykimit ishte përjashta. “Pilati e çoi jashtë Jisuin dhe u ul në selinë e gjykatës, në vendin e quajtur “Kalldrëm”, e në hebraisht “Gabatha” (Joani 19,13).

2- Gruaja e Pilatit quhej Klaudia Prokulla dhe e këshilloi burrin e saj që të mos përzihet me çështjen e atij të drejti.

20 Edhe krye-priftërit' edhe pleqtë i mbushnë mëndjenë gjindiesë që të lypnjënë Varavvanë, edhe Jisunë t'a prishnjënë. **21** Edhe qivernitari u përgjeq e u tha atyre: Cilinë doni nga këta te dy t'u lëshonj juve? **22** Edhe ata thanë, Varavvanë. Pillati u thot' atyre: Ç' t'a bënë pra Jisunë që thuhetë Krisht? Të-gjith'i thonë: Letë kryqëzonetë. **23** Edhe qivernitari tha, Përse? Ç'të-keqe ka bërë? Po ata bërtitninë më tepërë, dyke thënë: Le të kryqëzonetë. **24** Edhe Pillati si pa se s' ka dobi, po më tepërë trazyrë bënetë, mori ujë e lau duartë përpara gjindjesë, dyke thënë: I-pafajm jam nga gjaku i këti të-drejti; ju kini për të parë. **25** Edhe gjithë llauzi u përgjeq e tha, gjaku i ati qoftë mbi ne, edhe mbi bijtë t'anë. **26** Atëhere u lëshoj atyre Varravanë; edhe Jisunë si e rrahu me shufrë, e dha ndër duar që të kryqëzonetë.

1-Le të kryqëzohet. Kryqëzimi ishte dënimi me anën e të cilit romakët ndëshkonin keqbërësit. Kryqëzimit i paraprinte rrahja me kamzhik. Pas gjykimit i dënuari që shkonte për në vendin e kryqëzimit duhet që ta mbante vetë kryqin. Duke ecur nëpër rrugë dikush qëndronte përpara tij dhe mbante ndër duar një parullë në të cilën ishte shkruar faji për të cilin i akuzuari po kryqëzohej.

2-Gjaku i ati qoftë mbi ne dhe mbi bijtë tanë. Pa kaluar 40 vjet gjaku i të drejtit ra mbi kokat e judenjve. Jerusalemi u shkatërrua dhe rreth një milion judenj u vranë. Ky ishte një dënim i merituar për judentë, të cilët kryqëzuan Krishtin.

JISUI TALLET NGA USHTARËT

(Marku 15:16-26, Joani 19:2-3)

27 Atëhere ushtëtarët' e qivernitarit muarnë me vetëhe Jisunë ndë pretorët (guvernatore), edhe mbllohnë mbi atë gjithë tufën' e ushtëtarëvet. **28** Edhe e sveshnë, e i veshnë ati një rrobë të-gjatë të-kuqe. **29** Edhe gërshëtuanë një kurorë ferrash, e j'a vunë mbi kryet, edhe i dhanë një kallam ndë dorët të-djathtë;

edhe ranë mbë gjunjë përpara ati, edhe e përqeshninë, dyke thënë: Gëzohu, o mbret i Judhenjvet. 30 Edhe si e pshtynë muarnë kallamin' e i bininë krejt t'ati. 31 Edhe passi e përqeshnë, i sveshnë rrobën' e-kuqe, edhe i veshnë rrobat' e tia; edhe e shpunë t'a kryqëzonjënë.

1-Pësimet e Krishtit. Gjatë pësimeve, (përshtytjet, shuplakat, rrahiet, sharjet, përqeshiet, rrobën e kuqe, kallamin, sfungjerin, uthullën, gozhdët, shtizën) natyra njerzore e Jisuit do provonte sprovat të tmerrshme, ndërsa natyra hyjnore e Tij, do të mbetej përgjithmonë e qëndrueshme brënda një qetësie të përkryer. Fshikullimi me kamzhik ishte tortura më e madhe që i bëhej një keqbërësi. Atë e lidhnin në atë mënyrë që kurrizi të ekspozohej krejtësisht dhe fillonin fshikullimet. Kamzhiku përbëhej prej një rripi lëkure, në të cilin qenë mbërthyer copa plumbi. Fshikullimi ishte një sprovë e vështirë. Jisui vetësakrifikohet me dashje: “Askush nuk ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij.” (Joani 15:13)

2- E shpunë që ta kryqëzojnë. Sipas ligjit romak ai që kryqëzohej qëndronte i varur në drurin e kryqit derisa të vdiste nga etja dhe uria, torturë kjo, e cila mund të zgjaste edhe disa ditë. Ndërsa ligji hebraik theksonte që trupi i keqbërësit duhej zbritur nga kryqi dhe të varrosej përpara se të binte muzgu. Mund të themi, se dashuria më e madhe e Perëndisë arrin kulmin me kryqëzimin e Krishtit për mëkatet e njerzimit. “Sepse Perëndia e deshi aq botën sa, dha Birin e Tij të Vetëmlindur, që kushdo që beson në të të mos humbasë, për këtë jetë të përjetëshme”(Joani 3:16).

KRYQËZIMI I JISUIT

(Marku 15:21-32, Lluka 26:43, Joani 19:16)

32 Edhe dyke dalë, gjetnë një njeri Qirineas, që e kishte emërinë Simon; këtë e zunë angari që të ngrerë kryqin' e ati.

1-Duke dalë. Sipas ligjit judaik ekzekutimet me vdekje kryheshin jashtë qytetit të shenjtë. “Pastaj Zoti i tha Moisiut: -Ky njeri duhet të vritet, e tërë asambleja do ta vrasë me gurë jashtë kampit” (Numrat 15,35).

2-Simon Kirineasi. Ligji romak e detyronte keqbërësin që ta mbante vetë kryqin deri në vendin e ekzekutimit. Krishti i dërmuar keqazi nga rrahjet u rrëzua gjatë udhës së mundimshme. Ushtarët romakë ia dhanë kryqin Simon Kirineasit, i cili e shpuri deri në Golgotha. Simoni ishte idhujtar nga qyteti Kirë i Libisë. Simoni po kthehej nga puna, ndërkohë që ushtarët romakë e detyruan që të mbante kryqin (Lluka 23, 26). Simon Kirineasi ishte babai i dy fëmijëve i Aleksandrit dhe i Rufit (Marku 23,26).

33 Edhe kur erthnë ndë një vënt që thuhetë Gollgotha, ay është që thuhetë Vëndi i Kresë, 34 I dhanë të pijë uthullë të-përzjerë me t’ëmbëlth; po ay si u ngjërua, nukë desh të pijë.

1-Në një vend që quhet Golgotha. Ishte një kodër në afërsi të Jerusalemit, në të cilën persekutoheshin fajtorët. Pikërisht mbi këtë kodër u kryqëzua Krishti. Gjithashtu sipas traditës në Golgotë gjendej edhe kafka e Adamit. Në ungjillin sipas Markut thuhet: “Jisuin e prunë në një vend që quhet Golgota, që në përkthim do të thotë: -vendi i kafkës” (Marku 15,22).

35 Edhe si e kryqëzuanë, hothnë shortë, e ndanë rrobat’e ati; që të mbushetë ç’është thënë nga profiti. “Ndanë rrobat’e mia ndë mest të tyre, edhe mbi të-veshurit t’im hothnë shortë.”

1- Ndanë rrobat e mia. Përpara kryqëzimit, keqbërësit ia zhvishnin rrobat dhe e mbështillnin vetëm me një pëlthurë në mes. Kjo kryhej me qëllim që ai të ishte më i lirshëm nga krahët dhe këmbët për ta mbërthyer në kryq.

36 Edhe dyke ndënjurë e ruanin' atë atje. 37 Edhe vunë sipërë krejs' s' ati punën' e ati të-shkurarë: Ky është Jisuj mbreti i Judhenjvet. 38 Atëhere kryqëzonenë bashkë me atë dy kursarë, një mb'anë të-djathtë, edhe një mb'anë të mëngjërë.

1-Mbreti i Judenjve. Përmbi kryq vihej një tabelë mbi të cilën shkruhej faji që kishte bërë krimineli. Në rastin e Krishtit u shkruajt: Ky është mbreti i Judenjve.

2- Kryqzimi i Krishtit. Figura qendrore e skenës së kryqëzimit është Krishti i kryqëzuar, i mbështjellë me një rrobë të bardhë në mezin e Tij. Ai paraqitet i pajetë, me sy të byllur me krye të anuara nga e djathta. Koka e Tij është e kthyer nga ata që gjendeshin në çastin e kryqëzimit, nga ata që e deshën dhe nga ata që thirrën kryqëzoheni. Sytë e Tij janë të mbyllur dhe gjaku i rrjedh nga balli, nga duart dhe nga brinja e shpuar. Në rrëketë e gjakut të të kryqëzuarit vështrimi ynë dallon Perëndin Triadike e Golgothaja kthehet në Theofani. Jisu Krishti mbetet fitimtar, jo vetëm për faktin se u kryqëzua, por nga qëllimi për të cilin kjo u krye. Rrëketë e gjakut kullojnë nga duart, këmbët më pas njomin drurin e Kryqit.

3- Kryqi. Kryqi i Zotit është vendosur në shkëmbijtë e Golgothasë, ku në një zgavër poshtë tij ikonografi na paraqitet një kafkë, mbi të cilën pikon gjaku i Tij. Është kafka e Adamit, që sipas Traditës, vdiq dhe u varros aty. Duart e tij janë të shtrira në kryq, me pëllëmbët e hapura, si të jetë, duke u lutur. Duket qartë, se me pësimet e Tij, Krishti paqtoi njeriun me Perëndinë. Kryqi përmbledh planin e Perëndisë për barë botën. Me dimension vertikal, Ai bashkon tokën me qiellin, ndërsa me atë horizontal përqafton të gjithë njerëzit.

39 Edhe ata që shkoninë përënë e shaninë atë dyke tundurë krerët'e tyre, e dyke thënë, 40 Ti që prish tempullinë, edhe për tri dit e ndërton, shpëto vetëhenë t'ëndë; ndë je i Bir'i Perëndisë, sbrit nga kryqi. 41 Kështu edhe krye-priftëritë bashkë

me shkronjësit' e pleqtë dyke përqeshurë atë thoshinë. 42 Të-tjerë shpëtojnë, vetëhen' e ti nukë munt t'a shpëtonjë; nd'është mbret'i Israilit, le të sbresë ndashti nga kryqi, edhe do t'i besojmë. 43 Shprente mbë Perëndinë; le t'a shpëtonjë tani, ndë e do; sepse tha: Se jam bir Perëndie. 44 Gjithashtu edhe kursarëtë që ishinë kryqëzuarë bashkë me atë e shaninë.

1- **E shanin.** Njeri nga keqbërësit e shante Krishtin, kurse tjetri iu lut: “Kujtomë, o Zot kur të vish në mbretërinë tënde” (Lluka 23, 42).

VDEKJA E JISUIT

(Marku 15:33-39, Lluka 23:44-48, Joani 19:28-30)

45 Edhe që mbë të-gjashtëtën'orë ubë një errësirë mbi gjithë dhenë gjer mbë të-nënttën'orë. 46 Edhe mbë të-nënttën'orë Jisuj bërtiti me zë të-math, dyke thënë, “Ili, Ili llama Savahthani?” që do me thënë: “Perëndia im, Perëndia im, përse hoqe dorë prej meje?”

1-**Errësira mbuloi dhenë.** Me të vërtetë u bë një errësirë e madhe sikur të kishte ndodhur eklipsi i diellit. Të gjithë Judenë e pushtoi errësira, ndonëse ishte Pashkë, e cila festohej me hënën e plotë dhe eklipsi ishte gjë e pamundur. Kuptimi figurativ i kësaj është që përpara një veprimi kaq mizor edhe dielli i fshehu rrezet e tij.

2-**Eli, Eli, lama sabaktani.** Eshtë një shprehje në gjuhën aramaishite e cila do të thotë: “Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?”

47 Edhe ca nga ata që ishinë atje kur dëgjuanë, thanë, se ky po thërret Ilinë. 48 Edhe përnjë-herë u lëshua një nga ata, e mori një sfungar, edhe e mbushi me uthullë, edhe e vuri mbë një kallam, e i epte të pijë. 49 Edhe të-tjerëtë thoshinë: Le të

shohëmë, ndë qoftë se vjen Ilia t'a shpëtonjë. 50 Edhe Jisuj përsëri bërtiti me zë të-math, e dha shpirtinë.

1- **E dha shpirtin.** Krishti ndonëse ishte Perëndi i vërtetë dorëzon shpirtin tek Ati Qiellor me qëllim që të përmbushet ajo që është shkruar për të.

51 Edhe ja kurtin'e tempullit tek u ça mbë dy prej së-larti gjer poshtë; edhe dheu u tunt: edhe gurëtë plasnë; 52 edhe varret' u hapnë, edhe shumë trupa shënjtorësh që kishinë vdekurë u ngjallnë; 53 Edhe dualinë nga varretë pas të-ngjallurit t'ati, e hynë ndë qytet të-shënjtëruarë, edhe u duknë mbë shumë veta.

1-**Kurtina e tempullit u ça më dysh.** Kurtina e tempullit ndante vendin e shenjtë nga vendi shumë i shenjtë. Kurtina ishte me ngjyrë të kuqe dhe kishte të qendisur disa kerubimë (Eksodi 36,35). Kurtina tregonte pengesën që ekziston midis Perëndisë dhe njeriut në gjendjen e mëkatit. Me flijimin e Krishtit në kryq kurtina e tempullit u hoq. Në letrën drejtuar hebrenjve 10, 19-20 thuhet: “Duke pasur, pra o vëllezër, liri të plotë për të hyrë në shenjtërore me anë të gjakut të Jisuit, me anë të një udhe të re dhe të gjallë që ai përuroi për ne me anë të velit, domethënë të mishit të tij”.

54 Edhe urdhër-qindësi edhe ata që ishinë bashkë me atë dyke ruajturë Jisunë, kur panë tërmetin' edhe ç'punëra u bënë, u frikësuanë fort, e thanë: Me të-vërtetë ky paska qënë bir Perëndie.

1-**Kryeqindëshi.** Pas Joanit shohim kryeqindëshin Longini, i cili drejtoi kryqëzimin, me veshjen e tij ushtarake. Prania dhe mënyra e paraqitjes së tij në ikonë janë mjaftë domethënëse. Ai është dëshmitar okular i kryqëzimit e megjithëse i huaj, emocionohet e mallëngjehet nga Hyjnia e Zotit Ai ishte fare pranë kryqit dhe dëgjoi Krishtin të lutet: “O Atë, fali ata, se s'dinë se ç'bëjnë”. Kryeqindëshi pyeti veten:

Unë e kryqëzova dhe ai u lut për mua dhe më fali? Në atë çast, toka u lëkund dhe shkëmbijtë plasën.

2- Me të vërtetë ky është Biri i Perëndisë. Kryeqindëshi dhe ushtarët e tij, kur panë tërmetin, thanë: Me të vërtetë ky është Biri i Perëndisë (Mateu 27:51) Por, një tërmet dhe më i fuqishëm tronditi shpirtin e Logonit dhe e ktheu në predikues të Krishtit. Në ikonën e kryqëzimit paraqiten muret e Jeruzalemit. Është pikërisht Jeruzalemi i Ri, që u ndriçua me dritën e Krishtit, ashtu siç na e paraqisin edhe Himnet e Pashkës: “Ndriçohu, ndriçohu, o Jeruzalem i ri, se lavdia e Zotit përmbi ty ka lindur sot...”.

55 Edhe atje ishinë shumë gra dyke vënë re prej së-largu; të-cilatë kishinë vaturë prapa Jisujt nga Galilea, dyke shërbyer’ ati; 56 ndër mest t’ atyre ishte Maria Magdhalini, edhe Maria e ëm’e Jakovit edhe e Josiut, edhe e ëm’e të bijvet të Zevedheut.

1- Pranë Kryqit qëndron Hyjlindësja me gratë Miraprrurëse. Ndër to ishin Maria Magdalena, Maria e ëma e Jakovit, si dhe e ëma e bijve të Zebedeut. Hyjlindësja qëndron në këmbë dhe me njërën dorë të mbështetur në faqe. Vajtimi i saj është i papërmbajtshëm, e megjithatë, ka besim të plotë në hyjninë e të Birit. Për këtë Shkurtorja e të Premtes së Zezë na kujton: Kur e pa Maria mbi drurin, thoshte: Ndonëse u kryqëzove, Ti je Biri im dhe Perëndija im.

VARRIMI I JISUIT

(Marku 15:42-46, LLuka 23:50-54, Joani 19:38-42)

57 Edhe si u ngrys, erdhi një njeri i-pasurë nga Arimathea që e kishte emërinë Josif, që edhe ay vetë kishte qënë nxënës te Jisuj. 58 Ky vate te Pillati e lypi trupin’e Jisujt. Atëhere Pillati, urdhëroj t’i epetë trupi.

1-Askush nuk paraqitet për të marë trupin e pajetë të Krishtit. Krishti gjendet i vdekur përmbi Kryq. Orët kalojnë. Dielli është duke perënduar. Ç’do të bëhet tani me trupin e Krishtit? Mjerisht nuk po paraqitet askush. Ku janë vallë dishepujt? Ku është Petro që e donte aq shumë? Ku janë ata mijëra njerëz që Krishti i pati shëruar prej sëmundjesh të ndryshme? Ku janë ata të uritur që Krishti i pati ushqyer në shkretëtirë? Mos vallë nuk e duan? –E vërteta është se dashuria e tyre është e pakët. Ata druhen e dridhen përpara armiqve të Krishtit. Tremben e nuk guxojnë të ngjiten në Golgotha, sepse kanë frikë. Kush pra, guxoi e vajti tek Pilati për ti kërkuar trupin e Krishtit për ta varrosur. Cilët qenë guximtarët e asaj kohe?

2-Josif Arimateasi. Papritur, në kodrën e Golgothasë vijnë e duken heronjtë e besimit dhe të dashurisë së Krishtit. Ata vijnë për të bërë detyrën e tyre fisnike ndaj të vdekurit. Ata nuk druhen, nuk kanë frikë por vijnë me guxim. I pari është Josifi nga qyteti i Arimathesë. Ai kishte pasuri të madhe si dhe pozitë të lartë shoqërore. Shquhej për fisnikërinë e karakterin e tij. Ishte i njohur tek paria dhe pushteti, madje deri tek Pilati. Josifi pra, mori vendimin që të shkonte tek Pilati, për ti kërkuar trupin e Jisu Krishtit për ta varrosur. Lypsej guxim dhe heroizëm sepse mund të rrezikohej të dënohej edhe me vdekje.

59 Edhe Josifi mori trupnë edhe e pshtolli me pëlhurë të-pastrëtë; 60 Edhe e vuri ndë varrt të ti të-ri, që e kishte rëmuarë ndë shkëmpt, edhe si rrukillisi një gur të-math ndë derët të varrit, iku.

1- Josifi merr trupin e Krishtit. Pilati, pasi u sigurua prej kryeqindëshit që Krishti kishte vdekur, ia dorëzoi atë Josifit, duke e lejuar që ta merrte. Josifi i mallëngjyer largohet prej Pilatit dhe bleu

të gjitha gjërat që nevojiteshin për një varrim. Bashkë me Josifin vijnë edhe disa gra.

61 Edhe atje ishte Maria Madghalini, edhe Maria tjetërë, dyke ndënjurë kundruall varrit.

1- **Gratë Miroprurëse.** Midis tyre ishte edhe nëna e Zotit. Kjo pra ishte shoqëria e shenjtë që teksa dielli perëndonte, u ngjit në Golgothanë e frikshme dhe me duart që u dridheshin prej mallëngjimit e zbritën Krishtin prej Kryqit, i lanë plagët, e mbështollën me një çarçaf të bardhë trupin e Tij të shenjtë, e me nderim e vunë në një varr të zbrazët, të gdhendur në shkëmb. Ajo shoqëri e guximshme, me Josifin dhe gratë Miraprirurëse, me guximin që iu dha dashuria për Krishtin, mbetën përjetë shembuj të guximit për të krishterët e të gjithë kohrave.

RUAJTJA E VARRIT

62 Edhe mbë të-nesërmenë, që është pas së prëmtësë, u mblotnë krye-priftërit' edhe Farisenjtë te Pillati, 63 Dyke thënë, Zot, neve mbajmë mënt, se ay gënjeshtari tha kur qe edhe i-gjallë, se pas tri ditsh do të ngjallem. 64 Urdhëro pra të ruhetë varri gjer mbë të-tretënë ditë, se mos vijnë nxënësit'e ati natën' edhe e vjedhënë, edhe i thonë llauzit, se u ngjall nga të-vdekuritë; edhe gënjeshtër'e-pastajmë do të jetë më e-keqe se e-para. 65 Edhe Pillati u tha atyre, Keni ruajtës, shkoni, e sigure-eni si të dini. 66 Edhe ata vanë e sigururanë varrinë, dyke vulosurë gurinë bashkë me ruajtësitë.

1- **Pas së premtës.** Këtu e ka kuptimin për ato orë të së premtës pas perëndimit të diellit dhe kishte filluar dita e së shtunës, e cila ishte ditë pushimi.

2- **Ruajtësit e varrit** qenë ushtarët romakë të udhëhequr nga kyeqindëshi, i cili quhej Longin. Ata ndonëse ishte ditë e shtunë dolën në punë për të ruajtur varrin e Krishtit.

3- **Vulosën varrin.** Ata e vulosën varrin me qëllim që të pengonin dishepujt për të marrë trupin e Krishtit dhe më pas të thonin në popull që ai u ngjall. Prandaj ushtarët kishin marrë urdhër që ta ruanin varrin për tri ditë.

KREU I NJËZETETETË

NGJALLJA E JISUIT

(Marku 16:1-8, Lluca 24:1-12, Joani 20:1-10)

1 Edhe si shkoj e-shëtuna, dyke gdhir'ë-Djelë, që është' e para dit'e javësë, erdhi Maria Magdhalini, edhe Maria tjetërë, që të shihninë varrë.

1-Dhe Maria tjetër. Tek ungjilli sipas Markut kemi: “Si kaloi e shtuna, Maria Magdalena dhe Maria, nëna e Jakovit dhe Salomeja blenë aroma për të shkuar të vajosin Jisuin” (Marku 16,1). Ndërsa Ungjillori Llukai na thotë: “..qenë Maria Magdalena, Joana, Maria nëna e Jakovit...” (Lluca 24,10). Cila ishte Maria tjetër? Me siguri që ka qenë Maria, nëna e Jakovit. Salomeja ishte nëna e djemve të Zevedeut, ndërsa Joana ishte gruaja e Huzës.

2 Edhe ja tek u bë një tërmet i-math; sepse ëngjëll'i Zotit sbriti nga qielli, edhe erdhi e rrukullisi gurinë nga dera e varrit, edhe rrinte sipër'ati. 3 Edhe faqeja e ati ishte posi vetëtimë, edhe rroba e ati e bardhë posi dëborë. 4 Edhe ata që ruanin' u trëmbnë nga frik'e ati; edhe u bënë posi të-vdekurë. 5 Edhe ëngjëlli u përgjeq e u tha gravet, Mos kini frikë; sepse e di se kërkoni Jisunë që u kryqëzua. 6 Nukë ështëë këtu; sepse u ngjall, sindëkur pat thënë. Ejani, shihni vëndinë ku dergjej Zoti. 7

Edhe shkoni shpejt e u thoni nxënësve t'ati, se u ngjall nga të-vdekuritë; edhe ja tek po vete ay më përpara se ju ndë Galilet; atje do t'a shihni atë; ja tek u thashë juve.

1-Nuk është këtu sepse u ngjall. Të Dielën e Pashkës kremtojmë “Ngjalljen e Krishtit” duke festuar fitoren e tij mbi vdekjen. Është e kremtja më e rëndësishme e kishës. Në të Dielën e Pashkës të krishterët duhet të marin kungimin e shenjtë për të cilin janë pregatitur nëpërmjet kreshmimit trupor e shpirtëror. E theksojmë se duhet qëndruar deri në përfundim të liturgjisë hyjnore për të marë bekimin e madh. Nuk duhet të ndodhë siç e bëjnë disa të cilët nga mosdia largohen menjëherë sapo ndezin lambadhën dhe shkojnë nëpër shtëpitë e tyre për të ngrënë darkën e pashkës. Të mos bëhet pra ashtu siç thotë psalmi 68 “Le të ngrihet Perëndia dhe le të shpërndahen armiqtë e tij dhe le të ikin prej faqes së tij ata që i kanë mëri”. E mbas këtij vargu kemi edhe një tropar tjetër të psalmit që i përket shpresëtarëve. “Kjo është dita që ka bërë Zoti, le të ngazëllohemi dhe le të dëfremjmë në atë”.

8 Edhe ato duallnë shpejt nga varri me frikë edhe me gëzim të-math, edhe u sulnë t'u apënë zë nxënësve t'ati. 9 Edhe dyke vaturë t'u epninë zë nxënësve t'ati, ja Jisuj tek u poq me ato, e u tha, Gëzohi. Edhe ato i erthnë për anë, e i zunë këmbëtë, edhe iu falnë. 10 Atëhere Jisuj u tha atyre: Mos kini frikë, shkoni, ep-u-ni zë vëllezërvet të mi, që të shkonjnë ndë Galilet, edhe atje do të me shohënë.

1-Vëllezërit e mi. Me këto fjalë nënkuptojmë apostujt, të cilët qenë vëllezërit e Krishtit.

2-Atje do të më shohin. Krishti i ringjallur ju shfaq dishepujve dymbëdhjetë herë. 1) Ju shfaq Maria Magdalenës (Marku 16,9). 2) Ju shfaq grave mirapurrëse (Matheu 28,5), 3). Ju shfaq Petros (Lluka 24,12) dhe (1 Korintasve 15,5). 4) Ju shfaq dy

dishepujve në Emaus (16,12), 5). Ju shfaq dhjetë apostujve (Joani 20, 19), 6). Ju shfaq njëmbëdhjetë dishepujve (Joani 20, 21), 7). Ju shfaq shtatë dishepujve në liqenin e Tiberiadës (Joani 21, 5), 8) Ju shfaq njëmbëdhjetë nxënësve në malin e Galilesë (Matheu 28,18). 9) Ju shfaq më tepër se pesëqind vëllezërve (1 Korintasve 15, 6), 10). Ju shfaq Jakovit (1 Korintasve 15, 7). 11) Ju shfaq gjithë nxënësve (1 Korintasve 15, 7). 12) Ju shfaq Apostujve gjatë Analipsit (Lluka 24,50).

RAPORTIMI I ROJEVE TË VARRIT

11 Edhe ato tek ishinë dyke vajturë, ja ca nga ruajtësitë tek erthnë ndë qytett, e u dhanë zë krye-priftëret për gjithë sa u bënë. 12 Edhe ata u mblohnë bashkë me pleqtë, edhe si muarnë e dhanë këshillë u dhanë ushtëtarëvet mjaft argjenda, 13 dyke thënë, thoni, se nxënësit' e ati erthnë natën' edhe e vothnë tek po flinimë ne. 14 Edhë ndë u dëgjofhtë këjo nga qivernitari, ne do t' i mbushim' ati mëndjenë, edhe do të bëjmë që ju të mos kini kujdes. 15 Edhe ata si muarnë argjendatë, bënë sikundrë u mësuanë. Edhe këjo fjalë u përhap ndëpër Judhenjt gjer mbë ditët të-sotme.

1- **U thanë kryepriftërinjve.** Këtu bëhet fjalë për Annën dhe Kajafën.

2- **Thoni erdhën dishepujt dhe e morën.** Judenjtë pretendonin që rojen e kishte zënë gjumi dhe Krishtin erdhën dishepujt dhe e morrën. Këtë e bënë për të mohuar ngjalljen e Krishtit.

DËRGIMI I DISHEPUJVE PËR TË PREDIKUAR

(Marku 16:14-18, Lluka 24:36-49, Joani 20:19-23, Veprat 1:6-8)

16 Edhe të një-mbë-dhjetë nxënësitë vanë ndë Galilet, ndë atë mal që i pat porositur' Jisuj. 17 Edhe kur e panë, i u faln' ati; po ca nga ata ishinë me dy mëndje. 18 Edhe Jisuj erdhi

përanë, e u foli atyre, dyke thënë: M'u dha çdo pushtet ndë qiell edhe mbi dhet. 19 Shkoni pra e mësoni gjithë kombetë, edhe i pagëzoni mb'emërit të Atit e të Birit e të Frymës'së Shënjtëruarë; 20 Edhe i mësoni ata të ruanjnë gjithë sa u kam porositurë juve; edhe ja unë tek jam bashkë me ju gjithë dittë gjer mbë tëmbaruarët të jetësë. Amin.

1-Mu dha çdo pushtet si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Pushteti u plotësua. Mesia erdhi prej Atit që të sundojë botën. Ky është triumfi i ngjalljes së Krishtit.

2- **Shkoni dhe mësoni gjithë kombet.** Krishti i porosit dishepujt që të përfundojnë veprën që ai nisi. Mësoni gjithë kombet më fjalën e dashurisë dhe jo me dhunë. Shkoni tek të gjithë fiset dhe gjithë njerëzit pa kurfarë dallimi.

3- **Duke i pagëzuar në emër të Atit, Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë.** Ashtu siç ishte rrethprerja për judenjtë si shenjë e përkushtimit ndaj Perëndisë, për të krishterët do të jetë pagëzimi, që do të thotë pastrim i zemrës dhe rilindje nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë.

4- **Unë do të jem bashkë me ju.** Krishti është kurdoherë më mes të krishterëve, nëpërmjet mistereve të kishës, nëpërmjet lutjes si dhe të prezencës së kudondodhur të tij. Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti është koka e kishës së krishterë.

5- **Amin.** Është ndajfolje dhe në gjuhën hebraike do të thotë “me të vërtetë, sigurisht”. Pohojmë se realisht, me të vërtetë dhe sigurisht pranojmë se mbretëria, fuqia dhe lavdia i përkasin vetëm Perëndisë Triadike, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në jetë të jetëve.

BIBLIOGRAFI

- Arkimandrit Timothe K. Kilifi, *Komenti i Ungjijve dhe Veprave të Apostujve*, “Georgios Papanikolau”, Athinë 1999.
- Arkimandrit Timothe K. Kilifi, *Predikime nga amvoni*, “Georgios Papanikolau”, Athinë 1998.
- Arkimandrit Anthim Rusa, *50 Himne Ngjallësore*, Athinë 1973.
- At. Jovan Chani, *Ungjijtë e së Dielave*, St. Louis 1930.
- Antonios Alevizopulos, *Orthodhoksia jonë*, “Dhialogos”, Athinë 1994.
- Antonios Alevizopulos, *Kisha Orthodhokse*, “Dhialogos”, Athinë 1994.
- Athanas Dhelikostopulu, *Besimi i orthodhoksëve*, “Apostoliqi Dhiakonia”, Athinë 1992.
- Andrea Llukani, *Predikime*, “Tekno Paper”, Tiranë 2003.
- Andrea Llukani, *Fjalor Teologjik*, “Tekno Paper”, Tiranë 2005.
- Andrea Llukani, *Apostujt, Etërit e Kishës & Shkrimtarët Kishtarë*, “Tekno Paper”, Tiranë 2005.
- Andrea Llukani, *Historia e Krishterimit*, “Tekno Paper”, Shën Vlash 2002.
- Dhimitrios Panajotopulos, *Komentimi i Liturgjisë Hyjnore*, “Sotir”, Athinë 1994.
- Protopresviter Tomas Hopko, *Besimi Orthodhoks*, Adhurimi, (Përkthim nga Mitropoliti i Korçës Joani), botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997.

- Panajot Andriopulu, *Tema të teologjisë së Dhiatës së Re*, “Dhespina Mavromati”, Athinë 1990.
- Predikime te Etërve nga Mali i Shenjtë*, (Të përkthyer nga Kosta Xhumba dhe Pirro Kondili).
- Fori Tërpinini, *Si e gjeta rrugën e Dritës, predikime fetare e morale*, “Koti”, Korçë 2001.
- Imzot Theofan Noli, *Katekizmë e shkurtër e Kishës Orthodhokse*, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass 1991.
- Imzot Theofan Noli, *Uratore e Kishës Orthodhokse*, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass 1941.
- Imzot Theofan Noli, *Kremtore e Kishës Orthodhokse*, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass 1947.
- Imzot Theofan Noli, *Triodi dhe Pesëdhjetorja*, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass 1952.
- Imzot Theofan Noli, *Lutjesorja*, “Kosherja Orthodhokse”, Selanik 1997.
- Imzot Theofan Noli, *Pesëdhjetore e Vogël*, “Kosherja Orthodhokse”, Selanik 1997.
- Imzot Theofan Noli, *Java e Madhe e Shenjtë*, “Kosherja Orthodhokse”, Selanik 1997.
- Imzot Nikë Prela, *Fjalori Biblik*, Ferizaj 1994.
- Ilia Mastrojanopulu, *Shkallesat e Ungjillit*, “Zoi”, Athinë 1994.
- Episkop Irineu, *Ftillizim i Ungjillit pas Matheut*, “Luarasi”, Tiranë 1944.
- Erasmus Schmid, *Concordance to the Greek nev Testament*, “Astir”, Athinë 1990.
- Strongs Exhaustive Concordance of the Bible*, World Bible Publishers.
- Episkop Efthim K. Stiliu, *Fjalor i vogël kristjan*, “Apostoliqi Dhiakonia”, Athinë 1995.

- Lluka Fili, *Perikope paralele të Ungjijve sinoptikë*, “Simetria”, Athinë 1994.
- Mitropoliti i Patrës Nikodhimi, *Mesazhe të Javës së Madhe*, “Apostoliq Dhiakonia”, Athinë 1995.
- Mitropoliti i Atikis Nikodhimi, *Predikimet e së shtunës*, “Spora”, Athinë 1998.
- Mitropoliti i Atikis Nikodhimi, *Fara e Fjalës*, “Spora”, Athinë 1994.
- Nestle-Aland, *Novum Testament Graece*, Deutsche Bibelgesellschaft, Stuttgart 1993.
- Joan Panagopulu, *Hyrje në Dhiatën e Re*, “Dhespina Mavromati”, Athinë 1995.
- Jorgos Galitis, *Historia e epokës së Dhiatës së Re*, “Purnara”, Selanik 1992.
- Kostandinos Kurkulas, *Pnevmatiqi antilali*, “Nea”, Athinë 1996.
- Kleopa Ilie, *Predikime shpirtërore*, “Kosherrja Orthodhokse”, Selanik 1998.

PASQYRA E LËNDËS

Çyrje

ËREU I PARË

Gjenealogjia e Jisu Krishtit
Lindja e Jisu Krishtit

KREU I DYTË

Falja e magëve
Vrasja e foshnjave
Kthimi nga Egjipti

KREU I TRETË

Predikimi i Joan Pagëzorit
Pagëzimi i Jisuit

KREU I KATËRT

Ngasjet e Jisuit
Thirrja e dishepujve
Veprimtaria në Galile

KREU I PESTË

Predikimi në mal
Dishepujt, kripë dhe dritë e botës
Krishti dhe ligji
Kurvërimi
Divorci
Betimi
Hakmarrja
Dashuria për të afërmin

KREU I GJASHTË

Lëmosha
Lutja
Urata zotërore
Kushti për faljen nga perëndia
Argjërimi
Thesari
Kandili i trupit
Perëndia dhe paratë
Ankthi për jetën

KREU I SHTATË

Gjykimi
Margaritarët dhe derrat
Plotësimi i kërkesave të lutjes
Ligji i artë
Dera e ngushtë

Profetët e remë
Nxënësi i vërtetë
Paravolia e dy shtëpive
Jisui, mësues i vërtetë

KREU I TETË

Shërimi i lebrozit
Shërimi i shërbëtorit të kryeqindëshit
Shërimi i vjehrrës së Pjetrit
Kushtet për të qenë dishepull
Qetësimi i stuhisë
I demonizuari i Gergesasë

KREU I NËNTË

Shërimi i të paralizuarit
Thirrja e Matheut
Pyetja për argjërimin
Shërimi i gruas me hemoragji
Ngjallja e vajzës së kryetarit të sinagogës
Shërimi i dy të verbërve
Shërrime të ndryshme
Jisui dhe izraelitët

KREU I DHJETË

Dërgimi i dymbëdhjetë dishepujve
Udhëzime për misionin
Kundërshtimi i botës për misionin
Domosdoshmëria e pohimit

Përçarja e njerëzve
Dashuria për Jisuin, kriter gjykimi
Qëndrimi kundrejt apostujve

KREU I NJËMBËDHJETË

Pyetja e Joanit
Figura e Joanit
Kundërshtimi i bashkëkohësve të Jisuit
Qytetet që nuk pendohen
Zbulimi i të përulurve

KREU I DYMBËDHJETË

Mbajtja e së shtunës
Shërimi i bërë ditën e shtunë
Profecia e Isaisë për Jisuin
Pushteti i Jisuit mbi demonët
Blasfemia kundër shpirtit të shenjtë
Fjalët gjykojnë njeriun
Shenja e Joanit
Kthimi i shpirtit të ndyrë
Nëna dhe vëllezërit e Jisuit

KREU I TREMBËDHJETË

Paravolia e mbjellësit
Pse flet Jisui me paravoli
Shpjegimi i paravolisë së mbjellësit
Paravolia e egjrit
Paravolia e kokrrës së sinapit
Paravolia e brumit

Shpjegimi i paravolisë së egjrit
Paravolia e thesarit të fshehur
Paravolia e margaritarit të çmuar
Paravolia e rrjetës
Një paravoli për nxënësit
Jisui nuk pranohet në atdheun e tij

KREU I KATËRMBËDHJETË

Prerja e kokës së Joan Pagëzorit
Ngopja e të pesë mijëve
Ecja e Jisuit mbi ujëra
Shërime në Gjenisaret

KREU I PESËMBËDHJETË

Tradita njerëzore dhe porosi hyjnore
Ç' e bën njeriun të papastër
Besimi i gruas kananease
Shërime të ndryshme
Ngopja e katër mijë vetëve

KREU I GJASHTËMBËDHJETË

Farisenjtë kërkojnë shenja çudibërëse
Dobësia e dishepujve për të kuptuar
Pohimi i Pjetrit
Jisui parathotë vdekjen dhe ngjalljen e tij
Kryqi i nxënësve të vërtetë

KREU I SHTATËMBËDHJETË

Shpërftyrimi i Jisuit
Shërimi i djalit me shpirt demoni
Parathënia e dytë e pësimit dhe e ngjalljes së tij
Si e pagoi Jisui taksën për tempullin

KREU I TETËMBËDHJETË

Kush është më i madhi
Paravolia e deles së humbur
Ndjesa për vëllain
Paravolia e shërbëtorit të lig

KREU I NËNTËMBËDHJETË

Martesa dhe divorci
Jisui bekon fëmijët
Pasuria dhe jeta e amshuar

KREU I NJËZETË

Paravolia e vreshtarëve
Parathënia e tretë e Jisuit për pësimin dhe ngjalljen e vet
Kërkesa e bijve të Zevedheut
Shërimi i dy të verbërve në Jeriko

KREU I NJËZETENJË

Hyrja e Jisuit në Jerusalem
Dëbimi i tregtarëve nga tempulli

Fiku pa frut
Pushteti i Jisuit
Paravolia e dy bijve
Paravolia e bujqve të ligj

KREU I NJËZETEDY

Paravolia e dasmës mbretërore
Taksa për perandorin
Pyetja për ngjalljen e të vdekurve
Porosia më e rëndësishme
Mesia dhe Davidi

KREU I NJËZETETRE

Debat midis farisenjve dhe dishepujve
Kritika për shkruesit dhe farisenjtë
Jisui dhe Jerusalemi

KREU I NJËZETEKATËRT

Parathënia e shembjes së tempullit
Mbarimi i kësaj bote
Ardhja e papritur e mbarimit
Shërbëtori besnik

KREU I NJËZETEPESTË

Paravolia e dhjetë virgjërëshave
Paravolia e talantave
Si do të gjykohet bota

KREU I NJËZETEGJASHTË

Komploti për vrasjen e Jisuit
Lyerja me mirë
Tradhëtia e Judës
Darka Mistike
Parathënia e mohimit të Pjetrit
Lutja e Jisuit në Gjethsemani
Arrestimi i Jisuit
Jisui përpara sinedrit të madh
Mohimi i Pjetrit

KREU I NJËZETESHTATË

Jisui i dorëzohet Pilatit
Vetëvrasja e Judës
Dënimi i Jisuit
Jisui tallet nga ushtarët
Kryqëzimi i Jisuit
Vdekja e Jisuit
Varrimi i Jisuit
Ruajtja e varrit

KREU I NJËZETETETË

Ngjallja e Jisuit
Raportimi i rojeve të varrit
Dërgimi i dishepujve për të predikuar

Bibliografi
Pasqyra e lëndës

